

ANALIZA



E PRAKTIKËS GJYQËSORE

të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e
Njeriut lidhur me gjuhën e urrejtjes
dhe krimin e urrejtjes

ANALIZA

e praktikës gjyqësore të
Gjykatës Evropiane për të
Drejtat e Njeriut lidhur
me gjuhën e urrejtjes dhe
krimin e urrejtjes

Mirjana Lazarova Trajkovska, Marharyta Zhesko

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

316.625:316.647.5]:341.645.5(44)(094.9)

343.3/.7:316.647.5]:341.645.5(44)(094.9)

LAZAROVA Trajkovska, Mirjana

Analiza e praktikës gjyqësore të gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe krimin nga urrejtja /

[Mirjana Lazarova Trajkovska, Marharyta Zhesko]. - Shkup : OSBE, 2021.

- 121 стр. ; 30 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4788-74-4

1. Zhesko, Marharyta [автор]

а) Говор на омраза -- Европски суд за човекови права -- Судска практика -- Високошколски учебници б) Криминал од омраза -- Европски суд за човекови права -- Судска практика -- Високошколски учебници

COBISS.MK-ID 55746053

Përmbajtja

Korniza konceptuale.....	4
Pjesa A. - Gjuha e urrejtjes.....	7
I. Negacionizmi dhe revizionizmi.....	8
II. Urrejtja etnike.....	15
III. Urrejtja fetare.....	20
IV. Fjalimi politik.....	31
V. Miratimi i terrorizmit.....	39
VI. Gjuha homofobe e urrejtjes.....	43
VII. Nxitja e diskriminimit ose urrejtjes racore.....	48
VIII. Gjuha e urrejtjes dhe interneti.....	55
IX. Ofendimi i nëpunësve shtetërorë.....	60
Pjesa B - Krimi nga urrejtja.....	62
I. Veprat penale të urrejtjes të motivuara nga prejardhja racore ose etnike.....	73
II. Veprat penale të motivuara nga anshmëria fetare.....	79
III. Veprat penale të urrejtjes së motivuar nga anshmëria kundër personave me aftësi të kufizuara.....	82
IV. Veprat penale të urrejtjes së motivuar nga orientimi seksual, identiteti gjinor dhe shprehja gjinore.....	84
V. Interseksionaliteti.....	94
VI. Veprat penale të urrejtjes me bazë gjinore.....	96
Lista e rasteve të gjuhës së urrejtjes.....	99
Lista e rasteve të krimit të urrejtjes.....	101
BIBLIOGRAFIA.....	102

Korniza konceptuale

Korniza konceptuale e këtij botimi bazohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (këtej e tutje GJEDNJ ose Gjykata e Strasburgut) lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe veprat penale të urrejtjes, si dhe standardet minimale për respektimin e të drejtave të njeriut që implementohen me këtë praktikë gjyqësore. Palët kontraktuese kanë për obligim t'i respektojnë këto standarde, si dhe t'i zbatojnë dhe t'i avancojnë. Ky botim është ndarë në dy pjesë: Pjesa A që fokusohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me gjuhën e urrejtjes, ndërsa pjesa B ka të bëjë me praktikën gjyqësore lidhur me veprat penale të urrejtjes. Duke marrë parasysh se praktika gjyqësore e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) është vëllimore, veçanërisht lidhur me veprat penale të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes, është bërë përzgjedhja e domosdoshme duke u fokusuar në vendimet më të rëndësishme dhe më ndikuese të Gjykatës.

Gjuha e urrejtjes

Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut fillon nga supozimi për lirinë e shprehjes. Individët duhet doemos të jenë të lirë, kreativë gjatë të shprehurit dhe gjithashtu të kenë edhe të drejtë të informohen. Megjithëse e drejta lirisë së shprehjes nuk bie në mesin e të drejtave absolute që i garanton Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Gjykata në Strasburg e përkrah perceptimin liberal për lirinë e shprehjes dhe vazhdimisht insiston në atë që opinioni ka të drejtë t'i dëgjojë idetë, madje edhe atëherë kur ato janë shokuese ose nuk pranohen nga shumica, nëse këto ide iniciojnë çështje me interes publik dhe çojnë drejt debatit publik. Mirëpo, disa forma të gjuhës nuk janë të mbrojtura me të drejtën e lirisë së shprehjes. Si deklaratat që nxisin dhunë, diskriminim ose urrejtje në bazë të racës, përkatësisë etnike dhe kombësisë, ato duhet doemos të ndalohen.

Praktika e GJEDNJ-së konfirmoi se format e të shprehurit që përmbajnë gjuhë të urrejtjes janë të ndryshme dhe kanë formën e materialeve

të shkruara, fletushkave, ofendimeve verbale, ilustrimeve, karikaturave, materialeve reklamuese ose promovuese, simboleve, grafiteve ose veprave artistike të publikuara nëpër media të ndryshme, veçanërisht së fundmi edhe nëpërmjet internetit. GJEDNJ-ja pranon se në shoqëri demokratike dhe pluraliste është e domosdoshme të pengohen ose sanksionohen format e gjuhës që nxisin, inkurajojnë, përkrahin ose arsyetojnë urrejtjen ose dhunën në bazë të mostolerancës. Për këtë qëllim, sanksionet ose kufizimet e theksuara doemos duhet të përcaktohen me ligj, të kenë një qëllim legjitim dhe të jenë proporcionale me qëllimin legjitim që tentojnë ta arrijnë. Nëpërmjet nenit 10 paragrafi 2, Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut konfirmon se realizimi i lirisë së shprehjes përfshin edhe përgjegjësi dhe obligime dhe mund, vetëm në rrethana të rrepta, të kufizohet ose sanksionohet nëse kushtet e rrepta paraqesin masa të domosdoshme për sigurinë shtetërore integritetin territorial dhe sigurinë publike, ruajtjen e rendit dhe parandalimin e parregullsive dhe krimeve, mbrojtjen e shëndetit dhe moralit, dinjitetit ose të drejtave të tjerëve, si dhe kufizimin e përhapjes së informatave konfidenciale ose ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësisë.

Kjo qasje bazohet gjithashtu edhe në domosdoshmërinë për ta mbrojtur lirinë e shprehjes duke parandaluar përdorimin e gabueshëm dhe keqpërdorimin e mbrojtjes së të drejtave të individëve nëpërmjet KEDNJ-së. Në nenin 17 të Konventës theksohet qartë se asnjëri nen i Konventës nuk mund të interpretohet në mënyrë që të mundësohet e drejta e një shteti, grupi ose individit për të ndërmarrë aktivitete ose masa që ndikojnë në të drejtat ose liritë që janë të pranuar me Konventë, ose që të kufizojnë këto të drejta dhe liri në masë më të madhe se ato që janë paraparë me Konventën. Në fillim, pjesa më e madhe e aktgjykimeve lidhur me gjuhën e urrejtjes janë analizuar nga GJEDNJ-a duke zbatuar nenin 17, duke mos i përfillur zbatimet në lidhur me gjuhën e urrejtjes. Në praktikën më të re gjyqësore, analiza e GJEDNJ-së më së shpeshti e merr parasysh nenin 10, ku si pikënisje merret supozimi se liria e shprehjes mund të kufizohet në kushte të caktuara dhe se shtetet kanë të drejtë që ta bëjnë atë kur forma e fjalës bazohet në mostolerancë, nxitje dhe inkurajim të urrejtjes dhe dhunës.

Nga ana tjetër, teknikat dhe teknologjitë e reja shpijnë drejt hapjes së çështjes për mbrojtjen e lirisë së shprehjes në internet. Si i tillë, rasti *Delfi A.S. kundër Estonisë*¹, hapi një kapitull në praktikën gjyqësore të Gjykatës në lidhje me gjuhën e urrejtjes në internet.² Nëpërmjet këtij rasti, GJEDNJ-ja i përkrah obligimet e shteteve për ta sanksionuar nxitjen e gjuhës raciste dhe ksenofobe, kërcënimet ose ofendimet me motive raciste, negacionizmin, miratimin, arsyetimin ose minimizimin e gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit, madje edhe kur ato shprehen nëpërmjet komenteve të shkrimeve të publikuara në portalet e internetit.

Pa dyshim, në cilëndo formë, gjuha e urrejtjes reflektohet negativisht në lirinë e shprehjes në secilën shoqëri demokratike duke lënë pasoja të përhershme në shoqëri. Idetë që nxisin, inkurajojnë ose përhapin urrejtje, ndikojnë në lirinë e të tjerëve, që në situata të tilla shteti duhet doemos të ketë masa ligjore për të parandaluar përhapjen e ideve të tilla. Kjo ka rëndësi të veçantë sepse para se të arrijë rasti para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shpeshherë kalojnë vite në procedura para instancave dhe organeve kombëtare, e që deri atëherë thelbi i gjuhës së urrejtjes mund të rritet në hidhërim, mosotolerancë, e madje në disa raste edhe në dhunë. Duke e ditur rëndësinë e sundimit të së drejtës, institucionet, gjykata, mbrojtësit e të drejtave të njeriut si dhe studentët e drejtësisë, duhet doemos ta dinë praktikën e Gjykatës së Strasburgut dhe duhet të dinë se si ta zbatojnë atë.

Shtetet nënshkruese të Konventës kanë obligim pozitiv të sigurojnë zbatimin e KEDNJ-së në pajtim me parimin e subsidiaritetit. Si i tillë, implementimi efektiv i standardeve dhe parimeve që janë pjesë e Konventës patjetër duhet të jenë prioriteti kryesor i shteteve.³

1 *Delfi kundër Estonisë, kërkesa ankimore nr. 64569/09, e datës 10 tetor 2013 [Pjesa I].*

2 Në këtë drejtim, është e rëndësishëm *Protokolli Shtesë i Konventës për krimin kibernetik, në lidhje me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike*. Ky Protokoll ka hyrë në fuqi më 1 mars 2006, në kuadër të Këshillit të Evropës dhe direktiva të shumta të Komisionit Evropian.

3 *Skordino kundër Italisë, kërkesë ankimore nr. 36813/97, Këshilli i Madh Gjyqësor i datës 26.03.2006.*

Praktika e parimit dhe efektit të *res interpretata* nënkupton qasje në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut, në gjuhët e vendeve anëtare. Gjithashtu, është e rëndësishme që të përfshihet edhe praktika gjyqësore e Strasburgut në programin mësimor të fakulteteve juridike dhe akademive për edukimin dhe trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve, ose në programet e institucioneve tjera që organizojnë trajnime dhe edukime të grupeve të caktuara të njerëzve të cilët duhet doemos ta ndjekin praktikën gjyqësore (siç është Oda e Avokatëve). Pikërisht për faktin që qëllimi ynë është t'i njoftojmë nga afër gjykatësit, prokurorët, avokatët, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe subjekteve të tjera për ndryshimet dhe arritjet më të rëndësishme të standardeve lidhur me ndalimin e keqpërdorimit të lirisë së shprehjes, që në këtë botim përqipemi t'i transmetojmë dhe prezantojmë vendimet dhe rastet më të rëndësishme dhe më të reja lidhur me gjuhën e urrejtjes. Së këndejmi, besojmë se praktikuesit e të drejtave të njeriut do të inkurajohen që të vazhdojnë me ndjekjen dhe analizën e praktikës së GJEDNJ-së. Në fakt edhe koncepti i demokracisë moderne bazohet në fuqinë për të qenë i informuar si dhe në punën e vazhdueshme për avancimin dhe përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Krimi i urrejtjes

Veprat penale të urrejtjes janë vepra penale të kryera me motiv të anshmërisë.⁴ Sipas kësaj, vepra penale e urrejtjes (1) gjithmonë bazohet në veprën penale që përbën vepër të dënueshme sipas së drejtës penale dhe (2) motivohet nga anshmëria ose paragjykimi. Autori i veprës penale të urrejtjes e zgjedh viktimën në bazë të përkatësisë së vërtetë ose imagjinare ndaj një grupi ose në bazë të lidhjes së viktimës me një grup të caktuar. Veprat penale të urrejtjes mund të drejtohen ndaj një ose më shumë anëtarëve ose prone që lidhet me një grup të caktuar, që kanë ndonjë karakteristikë të përbashkët, e cila është e pandryshueshme ose fundamentale, siç është “raca”, përkatësia etnike, gjuha, religjioni, kombësia, orientimi seksual, identiteti gjinor ose ndonjë karakteristikë tjetër. Veprat penale të urrejtjes dallohen nga diskriminimi.

4 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi nr. 9/09, “Lufta kundër veprave penale nga urrejtja”, Athinë, 1-2 dhjetor 2009.

Megjithëse veprat penale të urrejtjes mund të konsiderohen si shembull ekstrem i diskriminimit, ekziston dallim ndërmjet këtyre dy koncepteve. Në pjesën e diskriminimit mungon elementi esencial i veprës që përbën veprën penale. Çështjet e diskriminimit mund të zgjidhen sipas së drejtës civile, madje edhe kur dënimi është sanksion penal. Sipas kësaj, kornizat juridike dhe institucionale me të cilat rregullohen diskriminimi dhe veprat penale të urrejtjes janë të ndryshme.⁵

Veprat penale të urrejtjes gjithashtu dallohen nga gjuha e urrejtjes. Gjuha e urrejtjes më së shpeshti nënkupton format e shprehjes që motivohen nga armiqësia, që tregojnë ose nxisin armiqësi ndaj një grupi ose personi të caktuar për shkak të përkatësisë në atë grup.

Siç është e përshkruar hollësisht në këtë botim, në pjesën e Gjuhës së urrejtjes, megjithëse mbrohet e drejta themelore e lirisë së shprehjes dhe mendimit, duhet doemos të ndalohen deklaratat që nxisin dhunë, diskriminim ose urrejtje në bazë të racës, përkatësisë etnike ose kombësisë. Meqë gjuha e urrejtjes mund t'i nxisë ose të jetë element shoqëruar në veprat penale të urrejtjes, të dy konceptet janë të lidhura në mënyrë të ndërsjellë. Konventa Evropiane e Të Drejtave të Njeriut ("Konventa") nuk ka ndonjë nen konkret për krimin e urrejtjes, mirëpo me këtë Konventë përcaktohet detyra e shtetit për ta hetuar dhe dënuar dhunën që është kryer ndaj individëve dhe ta kryejë këtë detyrë pa diskriminim. Nëpërmjet praktikës së vet gjyqësore, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ("Gjykata") në mënyrë plotësuese e analizoi këtë detyrë lidhur me veprat penale të urrejtjes, veçanërisht detyrën për të zbuluar dhe hetuar në mënyrë efektive motivimin e anshmërisë. Konkretisht, detyra e tillë procedurale për hetimin dhe zbulimin e motiveve diskriminuese del nga neni 2 (e drejta e jetës), neni 3 (e drejta e personit të mos ekspozohet ndaj maltretim) dhe neni 8 (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare) lidhur me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës.

5 OSBE/ODIHR, Parandalimi dhe reagimi ndaj krimeve të urrejtjes: Një udhëzues burimesh për OJQ-të në rajonin e OSBE-së, 2009, <https://www.osce.org/odihr/39821>.

Pjesa e Krimin të urrejtjes në këtë botim ka për qëllim ta rrisë vetëdijen për krimin e urrejtjes dhe obligimet e shtetit në këtë drejtim, sipas Konventës, si dhe të mundësojë arritshmëri më të madhe të progresit më të rëndësishëm të standardeve në këtë drejtim, për profesionistët e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë penale, si dhe faktorët tjerë siç janë avokatët, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, aktivistët dhe studentët e drejtësisë.

Konkretisht në pjesën I është dhënë një shqyrtim i kornizës së Konventës për Krimin e urrejtjes. Duke prezantuar aktgjykimet konkrete, në këtë shqyrtim janë theksuar detyrat lidhur me krimin e urrejtjes dhe aspektet operative, siç dalin nga interpretimi i Konventës nga ana e Gjykatës në praktikën e saj gjyqësore. Pjesët II-VII përmbajnë pjesë tematike dhe përfshijnë lloje të caktuara të anshmërisë, siç është prejardhja racore dhe etnike, religjioni, aftësitë e kufizuara, orientimi seksual dhe identiteti gjinor, interseksionaliteti dhe dhuna në bazë gjinore. Në këto pjesë është dhënë një analizë e detajuar⁶ e aktgjykimeve kryesore, përfshirë edhe më të rejat. Secili rast që është zgjedhur për analizë pasqyron një aspekt të caktuar të interpretimit të gjykatës për detyrat e shtetit lidhur me veprat penale të urrejtjes dhe dukuria e krimin të urrejtja, në përgjithësi. Secili rast përfshin rezyme të fakteve, analizë të Gjykatës dhe konkluzione të bashku me koment. Duke pasur parasysh natyrën praktike të botimit, në këto pjesë gjithashtu janë dhënë referencat për resurset relevante që janë përpiluar nga organizatat ndërkombëtare, siç janë OSBE/ODIHR, Këshilli i Evropës dhe Agjencia e të Drejtave Fundamentale e BE-së.

6 Ju lutemi të vini re se për qëllimet e këtij publikimi, analiza mbulon vetëm aspekte që kanë të bëjnë me krimin e urrejtjes dhe detyrat e shtetit në këtë drejtim, dhe nuk mbulon aspekte të tjera të të drejtave të njeriut që ishin pjesë e rasteve të përzgjedhura.

Pjesa A – Gjuha e urrejtjes

Roli i sistemit të të drejtave të njeriut i cili është përcaktuar me Konventën është përcaktimi i çështjeve të politikës publike me interes të përgjithshëm, duke ngritur standardet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe duke zgjeruar praktikën gjyqësore për të drejtat e njeriut në tërë komunitetin e shteteve të Konventës⁷. Prandaj, aktgjykimet dhe vendimet e Gjykatës shërbejnë për qartësimin, mbrojtjen dhe përgatitjen e rregullave të cilat janë vendosur me këtë Konventë, duke kontribuar për respektimin e obligimeve nga ana e shteteve të cilat i kanë ndërmarrë si Palë kontraktuese.⁸ Për këtë arsye, Gjykata e ka potencuar rolin e Konventës si “instrument kushtetues për rendin publik evropian” në fushën e të drejtave të njeriut.⁹ Për shumicën e kërkesave para GJEDNJ-së lidhur me gjuhën e urrejtjes është miratuar vendim në bazë të nenit 10 ose nenit 17 të Konventës. Gjatë interpretimit të nenit 10 të Konventës, Gjykata ka vendosur se “liria e shprehjes përbën një prej bazave esenciale të shoqërisë (demokratike), një prej kushteve themelore për përparimin e tij dhe për zhvillimin e secilit njeri”. Gjykata disa herë e ka potencuar rëndësinë e këtij neni, i cili nuk zbatohet vetëm për “informata” ose “ide” që janë të zbatueshme ose konsiderohen si joofenduese ose indiferente, por edhe për ato që ofendojnë, shokojnë ose shqetësojnë; të tilla janë kërkesat për pluralizëm, tolerancë ose liri të mendimit pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”.¹⁰ Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, askush nuk është i autorizuar të thirret në dispozitat e Konventës me qëllim për t’i dobësuar ose shkatërruar idealet dhe vlerat

e një shoqërie demokratike¹¹. Prandaj, qëllimi i përgjithshëm i nenit 17 është parandalimi i grupeve totalitare ose ekstremiste që t’i shfrytëzojnë në interes të tyre parimet e theksuara në Konventë.¹² Neni 17 është i lidhur edhe me konceptin e “demokracisë që është e aftë për t’u mbrojtur”¹³

Neni 10 i Konventës - Liria e shprehjes “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur mendim dhe për të pranuar dhe kumtuar informata dhe ide pa ndërhyrje të organeve publike dhe pavarësisht kufijve. Ky nen nuk do t’i pengojë shtetet për të kërkuar licencimin e ndërmarrjeve të radiodifuzionit, ndërmarrjeve televizive si dhe kinemave.

2. Meqë shfrytëzimi i këtyre lirive në vete përmban detyra dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose dënimeve të përcaktuara me ligj dhe janë të domosdoshme për një shoqëri demokratike, me interes për sigurinë kombëtare, integritetin territorial ose sigurinë publike, për parandalimin e anarkisë ose krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve, për parandalimin e zbulimit të informatave që janë të besueshme ose për ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësisë.”

Neni 17 i Konventës - Ndalimi i keqpërdorimit të të drejtave “Asgjë në (Konventën) nuk mund të interpretohet si dispozitë e cila nënkupton çfarëdo të drejte e cilitdo shtet, grup ose person, për të marrë pjesë në çfarëdo aktiviteti ose të kryejë çfarëdo veprë për shkatërrimin e ndonjë prej të drejtave dhe lirive të përcaktuara këtu ose për kufizimin e tyre në masë më të madhe sesa që është paraparë në Konventën”.

7 Konstantin Markin kundër Rusisë [Këshilli i Madh Gjyqësor], 30078/06, § 89, KEDNJ, 2012.

8 Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar, 18 janar 1978, § 154, Seria A nr. 25, dhe, së fundmi, Jeronoviç kundër Lituaniës [Këshilli i Madh Gjyqësor], nr. 44898/10, § 109, 5 korrik 2016.

9 Bosphorus Hava Yolları Turizm ve Ticaret Anonim Şirketi kundër Irlanda [Këshilli i Madh Gjyqësor], nr. 45036/98, § 156, KEDNJ 2005-VI.

10 Hendisajd kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 49; Observer dhe Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 59.

11 Refah Partisi (Partia e Mirëqenies) dhe të tjerë kundër Turqisë [Këshilli i Madh Gjyqësor], 2003, § 99.

12 V. P. kundër Polonisë (vendim), 2004; Paksas kundër Lituaniës [Këshilli i Madh Gjyqësor], 2011, § 87.

13 Vogt kundër Gjermanisë, 1995, §§ 51 dhe 59; Zhdanoka kundër Letonisë [Këshilli i Madh Gjyqësor], 2006, § 100; Erdell kundër Gjermanisë (vendim), 2007; Perinçek kundër Zvicrës [Këshilli i Madh Gjyqësor], 2015, § 242.



Negacionizmi dhe revizionizmi

Gjykata supozon se mohimi i Holokaustit dhe revizionizmi nxisin urrejtje ose mostolerancë. Arsyetimi se mohimi i tyre është vepër penale ka të bëjë me faktin që Holokausti është një fakt historik i definuar qartë dhe në atë aspekt mohimi i tij doemos duhet të konsiderohet si një ideologji antidemokratike dhe antisemitizëm¹⁴. Së këndejmi, në rastin lidhur me mohimin e Holokaustit, nëse Gjykata e zbaton drejtpërdrejt nenin 17, duke e shpallur ankesën si jokompatibile *ratione materiae* ose në vend të kësaj konsideron se mund të zbatohet neni 10, duke u thirrur në nenin 17 në fazë të mëvonshme kur e heton domosdoshmërinë nga ndërhyrja e supozuar, paraqet vendim që sillet sipas rasteve individuale dhe ky vendim do të varet nga të gjitha rrethanat e secilit rast në veçanti.

Garodi kundër Francës (Kërkesë ankimore nr. 65831/01) (vendim për lejueshmëri) nga 24 qershori i vitit 2003

Shënim për procedurën:

Parashtruesi i kërkesës ankimore, z. Garodi, ka parashtruar padi kundër Francës për shkeljen e lirisë së shprehjes, lirisë së mendimit, si dhe për diskriminim dhe shkelje të të drejtave të tij procedurale në procesin e procedurës penale. Ankesa është parashtruar më 23 tetor të vitit 2000.

Rezime e fakteve

Ankuesi (z. Garodi) ka qenë autor i librit me titull *Mitet e themelimit të Izraelit modern*, që më vonë ishte ribotuar përsëri me titull *Samisdat Roxxher Garodi*. Ai është ballafaquar me disa kallëzime penale nga shoqatat e ish-anëtarëve të rezistencës, persona të dëbuar dhe organizatat për të drejtat e njeriut.

Kjo shpuri në pesë hetime gjyqësore dhe pesë grupe të posaçme të procedurave penale sipas Ligjit të lirisë së shtypit nga data 29 korrik 1881. Më 16 dhjetor të vitit 1998, Gjykata e Apelit në Paris e shpalli ankuesin fajtor për kontestimin e ekzistimit të krimeve kundër njerëzisë, shpifje racore ndaj një grupi njerëzish (komuniteti hebre) në publik si dhe për nxitjen e diskriminimit dhe urrejtjes racore. Gjykata e Apelit ka shqiptuar dënime të burgimit me kusht dhe dënime në para. Këto aktgjykime u konfirmuan edhe nga Gjykata e Apelit në pesë aktgjykimet e datës 12 shtator të vitit 2000.

Ankesa nga ana e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkelje në pajtim me nenin 10 (liria e shprehjes) dhe shkelje të nenit 6 (e drejta e gjykimit të drejtë) veçmas ose bashkë me shkeljen e nenit 4 të Protokollit 7 (e drejta që të mos gjykohet ose dënohet dy herë). Gjithashtu, ankuesi ka pohuar sa ka pasur shkelje të nenit 9 (liria e të menduarit, vetëdijes dhe religjionit) dhe nenit 14 (ndalimi i diskriminimit).

Vendimi i Gjykatës

Lidhur me nenin 10, gjykata është thirrur në nenin 17 (ndalimi i keqpërdorimit të të drejtave) që pengon individët për t'i shfrytëzuar të drejtat e Konventës si bazë për t'u përfshirë në aktivitetet ose veprimet që kanë për qëllim cenimin e të drejtave dhe lirive të mbrojtura me Konventën. Pas analizës së librit në fjalë, Gjykata ka konstatuar se ankuesi, siç është konstatuar nga ana e gjykatave vendore, ka përvetësuar teori revizioniste dhe në mënyrë sistematike e ka kontestuar ekzistimin e krimeve kundër njerëzimit, që janë kryer ndaj komunitetit hebraik. Gjykata ka konstatuar se qëllimi i veprës ka qenë akuza ndaj viktimave të holokaustit, për falsifikim të historisë. Sipas Gjykatës, kontestimi i ekzistimit të krimeve kundër njerëzimit nga ankuesi ka qenë një

14 Perinçek kundër Zvicrës, kërkesë ankimore nr. 27510/08, [Këshilli i Madh Gjyqësor], aktgjykim i 15 tetorit 2015, §§ 234 dhe 243.

prej formave më serioze të shpifjes racore dhe nxitjes së urrejtjes e që ka përbërë kërcënim serioz për rendin publik. Gjykata ka konstatuar se libri si tërësi ka tendenca të qarta për revizionizëm dhe si i tillë është në kundërshtim me vlerat fundamentale që janë të mbrojtura me Konventën. Së këndejmi, Gjykata ka konstatuar se ankuesi nuk mund të thirret në nenin 10 dhe se dëshira e tij bie ndesh me Konventën.

Lidhur me aktgjykimet e ankuesit për shpifje racore dhe nxitje të urrejtjes racore, Gjykata ka konstatuar se Gjykatat vendore kanë dhënë arsye të mjaftueshme dhe relevante për gjykimin e ankuesit dhe është konstatuar se përzierja që i është bërë në raport me lirinë e tij të shprehjes, si e tillë, ka qenë e domosdoshme për një shoqëri demokratike. Gjykata e ka shpallur si të pabazë këtë ankesë. Në raport me nenin 6 dhe nenin 4 të Protokollit 7, pasi që është konstatuar se procedurat e ndryshme penale janë udhëhequr njëkohësisht dhe kanë qenë për vepra të ndryshme penale, neni 4 nga Protokollit 7, si i tillë ka qenë i pazbatueshëm.

Lidhur me nenin 6, Gjykata ka konstatuar se në raport me ndërlikimin e rastit dhe natyrën e veprave të dënueshme, kërkesa për të vepruar me procedurat e ndryshme penale njëkohësisht është e arsyeshme, ndërsa motivet me të cilat arsyetohet refuzimi për t'iu bashkëngjitur procedurës janë shqyrtuar paralelisht. Gjykata ka konstatuar në mënyrë të barabartë se asgjë nuk është sugjeruar në atë se ankuesi nuk ka pasur gjykim të drejtë. Së këndejmi, gjykata ka konstatuar se ankesa është e pabazë. Gjykata ka konstatuar në mënyrë të barabartë se ankesat në pajtim me nenin 9 dhe nenin 14 janë të palejueshme sepse ankuesi nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike vendore.

Komenti ndaj vendimit

Ky rast tregon se nëse gjatë konstatimit ka pasur shkelje të lirisë së shprehjes të ankuesit, Gjykata i kushton vëmendje të veçantë kontekstit historik dhe faktik të veprës penale të supozuar, si dhe formulimit dhe detajeve faktike të deklaratës së kontestuar (në këtë rast përmbajtjes së librit).

Ankuesi ka bartur përgjegjësi penale për shkak të librit të tij me të cilin e ka mohuar ekzistimin e dhomave me gaz; shfarosjen masive dhe

sistematike të hebrejve e ka përshkruar si “mashtim” dhe Holokaustin si “mit”; paraqitjen e tyre e ka quajtur “biznes i Shoah” ose “mistifikime për qëllime politike” dhe e ka kontestuar edhe numrin e viktimave hebraike si dhe arsyen e vdekjes së tyre. Ai i ka banalizuar ato krime duke i krahasuar me vepra për të cilat i ka akuzuar aleatët dhe e ka vënë në pikëpyetje legjitimitetin duke mohuar procedurat e Tribunalit të Nirnbergut. Për Gjykatën, përmbajtja kryesore dhe kuptimi i përgjithshëm i librit të ankuesit e me këtë edhe qëllimi i tij, kanë qenë revizioniste dhe në kundërshtim me vlerat fundamentale të Konventës, gjegjësisht drejtësinë dhe paqen. Kontestimi i realitetit të krimeve kundër njerëzimit ka qenë në drejtim të ripërtëritjes së regjimit kombëtar socialist dhe akuzimit të viktimave për falsifikimin e historisë. Sipas kësaj, kjo formë e mohimit përbën një prej formave më serioze të shpifjes racore të hebrejve dhe nxitjes së urrejtjes.

Duke u thirrur në nenin 17, ankesa e ankuesit sipas nenit 10 është shpallur si e papërputhshme *ratione materiae* me dispozitat e Konventës. Deri në atë masë që aktgjykimi i ankuesit ka qenë edhe lidhur me kritikën e tij ndaj shtetit të Izraelit dhe komunitetit hebraik, kjo pjesë e ankesës me sa duket ka qenë e pabazë: ai nuk është kufizuar me atë kritikë, por në fakt është zotuar qëllimin e dëshmuar racist.

Garodi është argument se Gjykata kujdeset për motivin dhe qëllimin e ankuesit gjatë konstatimit nëse shfrytëzimi i së drejtës së lirisë së shprehjes nga ana e ankuesit është ose nuk është në kundërshtim me Konventën (dhe prandaj ka të drejtë të mbrojtjes sipas nenit 10). Në këtë aspekt, Gjykata ka refuzuar që t'u lejojë ankuesve t'i shfrytëzojnë të drejtat që dalin nga Konventa në mënyrë që është në kundërshtim me të kundërt ose që mund t'i cenojë të drejtat dhe liritë tjera që janë të mbrojtura me Konventën. Së këndejmi, neni 17 shërben si mbrojtje nga keqpërdorimi i të drejtave dhe lirive që dalin nga Konventa në mënyrë që është në kundërshtim me vlerat e KEDNJ-së. *Garodi* është vendim i rëndësishëm që tregon se deklaratat me të cilat mohohen faktet historike, veçanërisht Holokausti, nuk mund të jenë pjesë e mbrojtjes në nenin 10, sepse ato janë në kundërshtim me parimet e drejtësisë dhe së drejtës së Konventës dhe si të tilla janë të papërputhshme me *ratione materiae* me KEDNJ-në.

M'Bala kundër Francës (Kërkesa ankimore nr. 25239/13 (vendim për lejueshmëri) nga 20 tetori 2015

Shënim për procedurën:

Parashtruesi i kërkesës ankimore (Diudone M'Bala M'Bala) është ankuesi i cili është shtetas francez, ndërsa ankesa ka të bëjë me shkeljen e supozuar të nenit 10 (liria e shprehjes) dhe nenit 7 (nuk ka dënim pa ligj), ankesa është parashtruar më 10 prill të vitit 2013, ndërsa dëgjimi ka qenë më 20 tetor të vitit 2015.

Rezyme e fakteve:

Parashtruesi i kërkesës së ankesës është komik francez që është marrë edhe me aktivitete politike. Në vitin 2008 ai ka realizuar një interpretim me titull *J'ai fait l'con*. Në fund të shfaqjes, e ka ftuar në skenë Robert Forisonin, i cili disa herë ka qenë i gjykuar në Francë për mendime negacioniste ose revizioniste dhe mohim të ekzistimit të dhomave të gazit në kampet naziste të përqendrimit. Ankuesi ka ftuar një aktor të veshur me pizhame me vija në të cilat ishte qepur edhe ylli i Davidit, për t'i ndarë z. Forisonit "çmimin për pafytyrësi dhe si i padëshiruar i shoqërisë". Policia e kishte incizuar këtë incident.

Më 27 mars të vitit 2009 Prokurori Publik e ka ftuar ankuesin që të paraqitet para *Tribunal de Grande Instance* të Parisit, me akuzën se ka shprehur ofendim publik ndaj një personi ose grupi të personave për shkak të prejardhjes ose përkatësisë së tyre, ose papërkatësisë së tyre ndaj një bashkësie të caktuar etnike, kombësie, race ose religjioni. Akuzat ka qenë lidhur me përdorimin e tij të gjesteve dhe gjuhës gjatë shfaqjes së tij, deri në atë masë sa që në shfaqje ka pasur elemente të shprehjeve ofenduese dhe përbuzjes ose gjuhë të urrejtjes. Disa shoqata të ish-personave të dëbuar për antiracizëm, antisemitizëm dhe organizata të të drejtave të njeriut, kishin aplikuar për t'iu bashkëngjitur procedurës si palë civile.

Gjykata Tribunal de Grande Instance, më 27 tetor të vitit 2009 e ka shpallur fajtor ankuesin duke e dënuar me dënim në para prej 10.000 euro dhe kishte që në llogari të ankuesit të shpallet njoftim për urdhëresën gjyqësore dhe dënimin në gazetën ditore *Le Monde* dhe *Le*

Parisien-Aujourd'hui en France. Në aktgjykimin nga data 17 mars të vitit 2011, Gjykata e Apelit në Paris e ka konfirmuar aktgjykimin për fajin e ankuesit dhe sanksionet e shqiptuara. Ankuesi dhe tri palë civile kishin parashtruar ankesë në aspekt juridik, e dyta ishte shpallur si e papranueshme nga Gjykata e Apelit e cila e kishte hedhur poshtë ankesën e ankuesit.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkeljen e nenit 7 dhe nenit 10 të Konventës, duke theksuar se kufizimi i lirisë së tij të shprehjes nga ana e gjykatave franceze nuk ka qenë as e parashikueshme e as e domosdoshme.

Vendimi i Gjykatës

GJEDNJ-ja ka pranuar se neni 10 është element thelbësor i shoqërisë demokratike dhe zbatohet në mënyrë të barabartë edhe për satirën dhe format e tjera të shprehjeve artistike dhe komenteve sociale. Praktika gjyqësore e Gjykatës ka përcaktuar kufizime të qarta lidhur me lirinë e shprehjes, duke konsideruar se çdo vërejtje që është në kundërshtim me vlerat themelore të Konventës, nuk është pjesë e mbrojtjes së nenit 10 në pajtim me nenin 17.

GJEDNJ-ja ka theksuar se gjykata vendore e kanë dënuar ankuesin për shprehje publike të respektit ndaj një individi që njihet për nga idetë negacioniste të tij dhe ka organizuar prezencë të një aktori të veshur si person i dëbuar nga kampet e përqendrimit, për t'i ndarë çmimin, gjë që është bazë me të cilën përqeshet simboli i religjionit hebraik. Gjykata është pajtuar me vlerësimin e fakteve që është bërë nga gjykatat vendore, veçanërisht me konkluzionin se veprimi i ankuesit ka pasur përmbajtje të fortë të antisemitizmit. GJEDNJ-ja ka konstatuar se deklaratat e ankuesit nuk e kanë larguar nga mysafirët e tij, por përkundrazi e kanë nxitur të vazhdojë më tutje.

Gjykata ka përsëritur se në kontekst të nenit 10, komentet ofenduese duhet doemos të rishqyrtohen në aspekt të rrethanave dhe në tërë kontekstin e tyre. Duke marrë parasysh se ankuesi ka treguar paraprakisht një përcaktim të fortë politik dhe ka qenë tanimë i dënuar për ofendime racore, elementet kontekstuale dhe vërejtjet reale të shprehura në skenë, kanë

pasur qëllim që ta dënojnë antisemitizmin. Gjykata ka vërejtur se duke marrë parasysh tërë kontekstin, ankuesi nuk mund të veprojë si artist që ka të drejtë të shprehet nëpërmjet satirës, humorit ose provokimit. GJEDNJ-ja konsideron se ky akt përbën një demonstrim të “urrejtjes dhe antisemitizmit, përkrahje të mohimit të Holokaustit”. Gjykata ka vërejtur se vepra ka pasur karakter të theksuar të negacionizmit dhe antisemitizmit, prandaj ankuesi është përpjekur ta largojë nenin 10 nga propozimi i tij real dhe e ka shfrytëzuar të drejtën e tij të lirisë së shprehjes për qëllime që janë në kundërshtim me Konventën. Në pajtim me nenin 17, ankuesi nuk mund të gëzojë të drejtat nga neni 10, ndërsa kërkesa e tij ankimore është refuzuar si e papërputhshme *ratione materiae* me Konventën.

Komenti ndaj vendimit:

Ky rast e paraqet analizën e detajuar të GJEDNJ-së gjatë vlerësimit nëse është penguar e drejta e lirisë së shprehjes së ankuesit. Gjykata vendimin e saj e ka bazuar në vlerësim, duke marrë parasysh faktorët e ndryshëm relevantë, përfshirë edhe përmbajtjen e deklaratave të ankuesit, qëllimet e tij, si dhe kontekstin historik dhe faktik, që i ka detyruar organet nacionale të ndërhyjnë në lirinë e shprehjes së ankuesit. M’Bala M’Bala është vendim i rëndësishëm se Gjykata nuk e toleron shfrytëzimin e të drejtave të Konventës në mënyrë që është në kundërshtim me Konventën, ose në mënyrë që ka për qëllim cenimin e të drejtave dhe lirive tjera të KEDNJ-së. Aktivitetet e tilla, në bazë të nenit 17, nuk bëjnë pjesë në format e shprehjes që kanë dobi nga mbrojtja nga neni 10. Prezantimi i pacipë i qëndrimit antisemitist përplot urrejtje, i maskuar si një produksion artistik, nuk mund të barazohet me format argëtuese, sado qofshin ato satirike dhe provokuese, për të siguruar mbrojtjen sipas nenit 10.

Akti i tillë ka qenë njësoj i rrezikshëm si një sulm i plotë dhe i ashpër dhe për këtë ka revokuar zbatimin e nenit 17 (§§ 39-40). Kërkesa ankimore është refuzuar si *ratione materiae* e papërputhshme me dispozitat e Konventës. Ky rast është një vendim i rëndësishëm se deklaratat negacioniste dhe revizioniste lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur gjatë Holokaustit janë si *ratione materiae* të papërputhshme me Konventën dhe si të tilla nuk bëjnë pjesë në mbrojtjen nga neni 10.

Viliamson kundër Gjermanisë (Kërkesa ankimore nr. 64496/17) (vendim për lejueshmëri) nga 8 janari i vitit 2019

Shënim për procedurën:

Kërkesa ankimore është parashtruar kundër Gjermanisë më 28 gusht të vitit 2017 dhe dëgjimi i Gjykatës është mbajtur më 8 janar të vitit 2019. Parashtruesi i kërkesës ankimore është shtetas britanik.

Rezime e fakteve

Ankuesi është ish-anëtar i Shoqërisë Shën Pij i dhjeti (Saint Pius X Society), vëllazëri ndërkombëtare e klerikëve, e themeluar në kundërshtim me reformat kishtarë të Mbledhjes së Dytë të Vatikanit. Kryepeshkopi, themeluesi i vëllazërisë, në vitin 1988 ka shenjtëruar katër peshkopë, përfshirë edhe ankuesin, pa pëlqimin e Papës. Si rezultat i kësaj, Kongregacioni i peshkopëve kishte deklaruar se ata që janë shenjtëruar në këtë mënyrë, përfshirë edhe ankuesin, janë përjashtuar automatikisht. Në vitin 2009, Kongregacioni i peshkopëve kishte vendosur ta tërheqë përjashtimin e ankuesit dhe peshkopëve nga vëllazëria e përmendur, të cilët ishin ende të gjallë. Ankuesi më pas është përjashtuar nga Shoqata Shën Pij i dhjeti.

Në nëntor të vitit 2008, ankuesi ka pasur një intervistë me një gazetar nga kanali televiziv suedez SVT-1, që është incizuar gjatë seminarit të Shoqërisë Shën Pij i dhjeti në Gjermani, me ç’rast ankuesi kishte deklaruar se nuk beson në ekzistimin e dhomave të gazit në kampet naziste të përqendrimit. Kjo intervistë është transmetuar më 21 janar të vitit 2009 në televizionin suedez me parapagim, si dhe në internet. Gazetari më pas, incizimin e intervistës, ia kishte ofruar një gazetar të revistës gjermane *Der Spiegel*. Para transmetimit të intervistës në televizion, *Der Spiegel* ka publikuar një artikull me deklaratat e ankuesit lidhur me ekzistimin e dhomave të gazit, të cilat që më pas janë publikuar edhe në gazeta tjera gjermane. Ankuesi kishte parashtruar ankesë për ndalim preliminar të gjykatave civile gjermane, për urdhër për largimin e incizimit të intervistës nga ueb faqja e SVT-së, urdhër që intervista të

mos shfrytëzohet për qëllime tjera, përveç për programin për të cilin është transmetuar.

Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Gjykata Rajonale në Nirnberg-Furt, sepse atëherë ishte konsideruar se pëlqimi i ankuesit e arsyeton shpërndarjen e intervistës.

Më 22 janar të vitit 2009 kishte filluar procedura paraprake kundër ankuesit, Gjykata e Qarkut në Regensburg e kishte shpallur ankuesin fajtor për nxitjen e urrejtjes dhe e kishte dënuar me 120 gjoba ditore me nga 100 euro. Pas ankesës, Gjykata e Qarkut e kishte ulur dënimin, e që më vonë edhe ishte shfuqizuar nga Gjykata e Apelit në Nirnberg, duke e ndërprerë kështu procedurën.

Më 2 tetor të vitit 2012, me kërkesë të Prokurorit Publik, është lëshuar një urdhër tjetër ndëshkuese kundër ankuesit me të cilin ai është shpallur fajtor për nxitjen e urrejtjes dhe është dënuar me 100 gjoba ditore me nga 65 euro. Pas ankesës së ankuesit, dënimi ishte ulur në 90 gjoba ditore me nga 20 euro. Pas ankesës plotësuese të ankuesit, Gjykata Rajonale në Regensburg ka vlerësuar se deklarata e ankuesit për mohimin e ekzistimit të dhomave të gazit gjatë regjimit nazist dhe vrasjes së hebrenjve në dhoma të gazit, njeka qenë mohim i veprave të gjenocidit, të kryera nga regjimi nazist.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi ishte ankuar për shkeljen e nenit 10 (liria e shprehjes).

Vendimi i Gjykatës

GJEDNJ-ja ka konstatuar se kërkesa është e papranueshme. Ankuesi është ankuar se gjykatat gjermane e kanë zbatuar gabimisht të drejtën vendore për veprën e kryer. Kërkuesi ka pohuar se e ka shfrytëzuar të drejtën e tij për lirinë e shprehjes në mënyrë që ka qenë e ligjshme në një shtet anëtar (Suedi), por e ndaluar në shtet tjetër anëtar, ku ajo konsiderohej e paligjshme (Gjermani).

Gjykata nuk e ka pranuar këtë argument dhe ka përsëritur se kërkuesi e kishte dhënë deklaratën në fjalë në Gjermani, megjithëse ai kishte jetuar normalisht diku tjetër dhe ka qenë në dijeni se deklarata është në kundërshtim me të drejtën vendore gjermane. Kështu, GJEDNJ-ja

ka konstatuar se vlerësimi i gjykatës rajonale gjermane është i arsyeshëm dhe i bazuar, veçanërisht sepse vepra ishte kryer në Gjermani, gjë që ka qenë karakteristikë kryesore e veprës penale sipas të drejtës vendore, intervista gjithashtu është paraqitur publikisht dhe aplikimi i së drejtës gjermane ka qenë i parashikueshëm. Gjykata ishte pajtuar me pikëpamjen e Gjykatës Rajonale Gjermane se intervista ka përmbajtur mohim të qartë të ekzistimit të dhomave të gazit dhe vrasjes së hebrenjve në ato dhoma gazi nën regjimin nazist, që nënkupton nënvlerësim të akteve gjenocide kundër hebrenjve dhe cenim serioz të paqes publike në Gjermani. Sipas kësaj, Gjykata arrin në përfundim se ankuesi ka shfrytëzuar të drejtën e tij për lirinë e shprehjes për të promovuar ide që janë në kundërshtim me vlerat e Konventës. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se ndërhyrja e imponuar në lirinë e shprehjes së ankuesit është në proporcion me qëllimin e dëshiruar legjitim dhe ka qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Koment për vendimin

Uilliamson ndjek praktikën gjyqësore ekzistuese të Strasburgut, në të cilën Gjykata përsërit se deklaratat me negacionizëm ose revizionizëm janë në kundërshtim me Konventën dhe si të tilla nuk do të përfitojnë nga mbrojtja sipas nenit 10 të Konventës.

Gjithashtu, Gjykata i ka kushtuar vëmendje të veçantë kontekstit historik dhe faktik të çështjes, si dhe faktit që deklarata është dhënë në Gjermani, që ka qenë karakteristikë kryesore e veprës. Megjithëse ka qenë i vetëdijshëm se deklaratat e tij i nënshtroheshin përgjegjësisë penale në Gjermani dhe mund të tërhiqnin interes të veçantë atje, ankuesi nuk arriti ndonjë marrëveshje konkrete me televizionin suedez për çfarëdo ndalimi ose kufizimi të shfrytëzimit të incizimit të intervistës dhe kjo me të vërtetë mund të shihej në Gjermani nëpërmjet televizionit satelitor ose online. Duke iu referuar nenit 17, Gjykata e hodhi poshtë ankesën si e pabazë. Sipas Gjykatës, fakti që ankuesi është përpjekur ta shfrytëzojë të drejtën e tij për lirinë e shprehjes për të promovuar ide në kundërshtim me tekstin dhe frymën e Konventës, ka pasur rëndësi të madhe në vlerësimin e domosdoshmërisë së ndërhyrjes sipas nenit 10.

Pastors kundër Gjermanisë (Kërkesa ankimore nr. 55225/14) (vendim për lejueshmëri) nga 3 tetori i vitit 2019

Shënim për procedurën:

Shtetasi i Gjermanisë z. Udo Pastors (ankuesi) më 30 korrik 2014 kishte parashtruar kërkesë ankimore për një rast kundër Republikës Federative të Gjermanisë lidhur me shkeljen e supozuar e nenit 10 dhe nenit 6 (1) të Konventës. Dëgjimi ishte realizuar më 9 korrik 2019.

Rezyme e fakteve:

Ankuesi ka qenë deputet dhe kryetar i Partisë Demokratike Kombëtare të Gjermanisë (NPD) në parlamentin e Maklenbugut – Pomerania Perëndimore. Ankuesi bashkë me anëtarët e grupit parlamentar të Partisë Demokratike Kombëtare nuk kishin marrë pjesë në evenimentin e organizuar në parlament më datë 27 janar të vitit 2010, Dita e përkujtimit të Holokaustit. Ditën e nesërme ankuesi ka mbajtur fjalim në Parlament duke e kontestuar Holokaustin. Në shkurt të vitit 2012, ishte revokuar pacenueshmëria e ankuesit nga parlamenti i vendit. Kundër ankuesit ishin parashtruar padi penale për deklaraten e dhënë dhe ai ishte dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 8 muajsh. Për ankesën e ankuesit, Gjykata rajonale kishte konkluduar se ankuesi e ka mohuar shfarosjen masive të hebrenjve, që ishte kryer në Aushvic. Gjykata ishte fokusuar në përdorimin e disa nocioneve nga ankuesi si “barazh i propagandave dhe gënjeshtreve” dhe “Projektimi i Aushvicit” (Aushwitzprojektion). Gjykata rajonale ka qenë e bindur bindur se ankuesi nuk ka pasur për qëllim të përcjellë mesazh me të cilin vihet në pikëpyetje e vërteta për Aushvicin dhe atë ta përcjellë në Parlament pa u ndërmarrë kurrfarë masash parlamentare. Ankesa e ankuesit në Gjykatën e Apelit në Rostok ishte refuzuar. Pasi kishte zbuluar se njëri prej tre gjykatësve në Gjykatën e Apelit në Rostok ishte bashkëshort i gjykatëses së qarkut që e kishte dënuar ankuesin në shkallë të parë, ankuesi kishte parashtruar ankesë për anshmëri. Ankesa për anshmëri ishte hedhur poshtë, duke e theksuar faktin se është shqyrtuar vetëm aktgjykimi i ankesës së miratuar nga Gjykata Rajonale, që si e tillë, kishte qenë ankesë e pabazë.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkelje të supozuar të nenit 10 (liria e shprehjes) dhe shkelje të nenit 6 (e drejta për gjykim të drejtë), duke theksuar se gjykatës i mungon paanshmëria.

Vendimi i Gjykatës

GJEDNJ-ja ka ritheksuar se neni 17 i Konventës, lidhur me nenin 10, duhet të zbatohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe raste ekstreme dhe duhet t’u referohet atyre në rastet kur deklaratat janë në kundërshtim me vlerat e Konventës. Pika vendimtare është se pavarësisht deklaratave, qofshin ato verbale ose joverbale, janë të orientuara kundër vlerave themelore të Konventës. Gjykata e theksoi edhe rëndësinë e fjalimeve politike në Kuvend dhe rëndësinë që e ka liria e shprehjes në këtë aspekt. Mirëpo, Gjykata ka theksuar se nevojiten kufizime të caktuara.

Duke marrë parasysh këtë, në rastin konkret Gjykata ka vlerësuar se deklaratat e ankuesit e tregojnë “urrejtjen e tij ndaj viktimave të Holokaustit”. Edhe pse GJEDNJ-ja e pranoi rëndësinë e fjalës në parlament, ai ka konsideruar se heqja e imunitetit të ankuesit nga ndjekja nga Parlamenti i vendit ka rëndësi të veçantë.

Gjykata ka përsëritur se vetëm do të konstatojë nëse ndërhyrja në të drejtën e ankuesit për lirinë e shprehjes ka qenë “e domosdoshme në shoqërinë demokratike”. Gjykata është pajtuar me vlerësimin e fakteve të Gjykatës Rajonale, ka pranuar se Gjykata Rajonale e ka vlerësuar fjalimin e ankuesit në tërësi. Gjykata i ka dhënë rëndësi fundamentale faktit se ankuesi e ka planifikuar fjalimin e vet më herët, duke zgjedhur qëllimisht fjalët e tij, gjë që është kualifikuar si mohim i Holokaustit, si dhe ankuesi ka treguar urrejtje ndaj viktimave të Holokaustit. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se ankuesi ka tentuar ta shfrytëzojë të drejtën e tij për lirinë e shprehjes si mënyrë për promovimin e ideve që janë në kundërshtim me Konventën. Gjykata ka pranuar se ndërhyrja në të drejtën e lirisë së fjalës meriton një shqyrtim të veçantë në kontekst të përfaqësuesve parlamentarë, megjithatë gjykata ka theksuar se këto dëshmi meritojnë një mbrojtje të vogël nëse përmbajtja e tyre është në kundërshtim me vlerat demokratike të Konventës. Duke marrë parasysh këtë,

Gjykata ka konstatuar se ankuesit nuk i është shkëlur neni 10. Lidhur me nenin 6, Gjykata ka konkluduar se nuk ka dyshime të arsyeshme objektive për paanshmërinë e Gjykatës së Apelit dhe si e tillë nuk ka shkelje të nenit 6. Gjykatësit Grozev dhe Mits kanë pasur mendim të përbashkët, pjesërisht të kundërt. Ata janë pajtuar me konkluzionet e gjykatës në aspekt të nenit 10, por nuk janë pajtuar me shumicën lidhur me mungesën e dyshimeve të arsyeshme objektive për paanshmërinë e Gjykatës së Apelit, duke konsideruar se ka pasur shkelje të nenit 6.

Koment për vendimin

Ky rast është në pajtim me praktikën paraprake gjyqësore të Gjykatës që ka të bëjë me negacionizmin, në kontekst të diskutimeve politike. Gjykata e ka përsëritur rëndësinë e shqyrtimit të rreptë të kufijve të imponuar në lirinë e shprehjes në kontekst të fjalimeve politike dhe diskutimeve parlamentare, duke mundësuar një shtrirje më të gjerë të lirisë së shprehjes dhe kontrollit më të rreptë të ndërhyrjeve ligjore në lirinë e shprehjes në këtë kontekst.

Gjykata e ka përsëritur domosdoshmërinë për të shfrytëzuar nenin 17 vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur procedura është eksplicite ose në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Konventën. Në këtë rast, Gjykata preferon të shqyrtohet baza e ankesës së ankuesit sipas nenit 10, sepse ndërhyrja në të drejtën dhe lirinë e shprehjes ka kërkuar shqyrtimin më të thellë kur ndërhyrja ka qenë lidhur me deklaratat e dhëna nga përfaqësuesit e zgjedhur në Parlament. Gjykata i ka dhënë rëndësi esenciale faktit se ankuesi e ka planifikuar më herët fjalimin e tij, qëllimisht duke fshehur mesazhin e tij të vërtetë. Së këndejmi, neni 17 ka pasur rol të rëndësishëm sepse ankuesi ka tentuar ta shfrytëzojë të drejtën e tij të lirisë së shprehjes me qëllim të promovimit të ideve që janë në kundërshtim me tekstin dhe frymën e Konventës, të cilat kanë pasur rëndësi të madhe gjatë vlerësimit të domosdoshmërisë së ndërhyrjes. Ankesa e ankuesit sipas nenit 10 në fund është hedhur poshtë si e pabazë. Duke marrë parasysh këto elemente kontradiktore, në këtë rast mund të shihet se Gjykata i ka dhënë vëmendje të veçantë përmbajtjes së deklaratës së ankuesit, kontekstit se si është dhënë dhe qëllimeve të ankuesit. Rasti i tanishëm tregon se madje edhe në kontekst të fjalimeve politike,

ku Gjykata edhe ka qasje më të madhe, aktet dhe deklaratat me të cilat keqpërdoren të drejtat nga Konventa dhe janë në kundërshtim me vlerat e Konventës, nuk bëjnë pjesë në mbrojtjen sipas neneve të Konventës.

Urrejtja etnike



Me qëllim për të konstatuar nëse ndonjë sjellje e caktuar përbën keqpërdorim të të drejtave, Gjykata i shqyrton me kujdes qëllimet që i synon ankuesi kur bazohet në Konventën dhe përputhshmërinë e tyre me këtë instrument. Në shumicën e rasteve lidhur me urrejtjen racore ose etnike, Gjykata konsideron se duke u ankuar për dënimin për nxitje të urrejtjes, ankuesit në esencë kanë pohuar se është shkelur e drejta e tyre e lirisë së shprehjes që është e garantuar me nenin 10 të Konventës. Në rast të tillë, Gjykata në fillim thekson se ajo nuk duhet të konstatojë se cilat argumente nevojiten sipas të drejtës kombëtare për të dëshmuar ekzistimin e elementeve përbërëse të veprës nxitje të urrejtjes. Para se gjithash, organet kombëtare, veçanërisht gjykatat, janë ato që duhet ta interpretojnë dhe ta zbatojnë drejtësinë vendore. Gjykata ka për detyrë vetëm t'i rishqyrtojnë vendimet sipas nenit 10, të cilat janë miratuar në pajtim me kompetencën e tyre të çmuar. Gjykata më tutje përsërit se megjithëse praktika e tyre gjyqësore e ka ruajtur natyrën e gjykimit dhe esencës së lirisë së shprehjes brenda një shoqërie demokratike, ajo gjithashtu i ka caktuar kufijtë e asaj të lirisë. Konkretisht, Gjykata konsideron se gjuha që është e papërshtatshme me vlerat e shpallura dhe të garantuara me Konventën, do të largohet nga mbrojtja e nenit 10 në bazë të nenit 17 të Konventës.¹⁵

Në këto raste, neni 17 është relevant kur ankuesi përpiqet të keqpërdorë dispozitat e Konventës në kundërshtim me qëllimin e saj të vërtetë, duke e shfrytëzuar të drejtën që garantohet me qëllim për të arsyetuar, promovuar ose realizuar veprime që: janë në kundërshtim me tekstin dhe frymën e Konventës; janë jompatibile me demokracinë dhe/ose vlerat tjera fundamentale të Konventës; i shkelin të drejtat dhe liritë e pranuar me të. Kur ankuesi tenton t'i arsyetojë të drejtat e tij sipas Konventës në mënyrë që i shkel të drejtat dhe vlerat e mbro-

jtura me Konventën, sjellja e tillë mund të kualifikohet si keqpërdorim i së drejtës së zbatimit individual në kuptim të nenit 35 §3 (a).

Gjatë vlerësimit të sjelljes dhe qëllimeve të ankuesit në aspekt të nenit 17, Gjykata i merr parasysh vlerat që janë të proklamuar dhe të garantuara me Konventën, veçanërisht ato që janë të shprehura në Preambulën e saj, edhe atë: drejtësia dhe paqja; demokracia dhe liria efektive politike; zgjidhja paqësore e konflikteve ndërkombëtare dhe shenjtërisë së jetës së njeriut; toleranca, paqja dhe mosdiskriminimi social; barazia gjinore; bashkëjetesa e pjesëtarëve të shoqërisë pa segregime racore.

***Pavell Ivanov kundër Rusisë
(Kërkesa ankimore nr. 35222/04)
(vendim për lejueshmëri) nga 20
shkurt 2007***

Shënim për procedurën:

Parashtruesi i kërkesës së ankesës, shtetas rus, ka parashtruar ankesë më 27 gusht të vitit 2004 kundër Rusisë. Gjykata ka debatuar më 20 shkurt të vitit 2007.

Rezyme e fakteve:

Ankuesi është themelues dhe pronar i vetëm i gazetës *Russkoye Veche*, që çdo muaj që nga viti 2000 me shpenzime të ankuesit. Në vitin 2003, ankuesi është nxjerrë para gjykatës me akuzën për nxitje publike të urrejtjes etnike, racore dhe fetare nëpërmjet përdorimit të medieve masive. Rasti në prokurori ka qenë se ankuesi ka bërë thirrje për përjashtimin e hebrenjve nga jeta shoqërore dhe e ka treguar qëllim të keq ndaj grupit etnik të hebrenjve nëpërmjet një serie publikimesh. Gjykata e Qytetit e ka liruar ankuesin më datë 8 shtator 2003, duke konstatuar se nuk është dëshmuar që ai është autori i botimeve. Ky vendim është shfuqizuar nga Gjykata Rajonale e cila e kishte kthyer ras-

¹⁵ Shihni Hendisajd kundër Mbretërisë së Bashkuar, të datës 7 dhjetor 1976, Seria A nr. 24, § 49, dhe lings kundër Austrisë, e datës 8 korrik 1986, Seria A nr. 103, § 41.

tin. Ankuesi ka kërkuar nga Gjykata e Qytetit që të urdhërojë përgatitjen e një raporti historik-social për qartësimin e çështjeve të cilat i ka refuzuara Gjykata. Më 24 shkurt të vitit 2004, Gjykata e Qytetit e ka shpallur ankuesin fajtor për nxitje të urrejtjes racore, kombëtare dhe fetare dhe e ka ndaluar që të merret me gazetari, publikim dhe shpërndarje të informatave nëpërmjet medieve masive në një periudhë 3 vjeçare. Ankuesi kishte parashtruar ankesë, duke kundërshtuar se nuk ka mundur të nxisë urrejtje kombëtare meqë hebrenjtë nuk ekzistojnë as si racë e as i kombësi. Gjykata Rajonale e ka konfirmuar aktgjykimin.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës:

Ankuesi është ankuar në përgjithësi se dënimi i tij për nxitje të urrejtjes racore nuk është i arsyeshëm. Gjithashtu, ankuesi është ankuar për shkeljen e nenit 13 të gjykatave vendore dhe të nenit 14 si person i diskriminuar për shkak të bindjeve të tij fetare.

Vendimi i Gjykatës:

Gjykata ka konsideruar se ankesa e ankuesit për gjykimin për nxitje të urrejtjes racore lidhur me botimet e tij, në esencë ka qenë shkelje e supozuar e lirisë së shprehjes të ankuesit, në pajtim me nenin 10. Gjykata e ka përsëritur natyrën vendimtare dhe thelbësore të lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike, por ka konfirmuar përsëri se kjo liri është e kufizuar në veçanti atje ku gjuha që shfrytëzohet është e papërshtatshme me vlerat e garantuara me Konventën, kështu duke e përjashtuar atë nga mbrojtja sipas nenit 10 në bazë të nenit 17 të Konventës.

Qëndrimi i GJEDNJ-së ka qenë se ankuesi ka qenë autor i disa shkrimeve dhe ka publikuar artikuj në të cilat hebrenjtë janë paraqitur si “burimi i së keqes në Rusi”, duke e akuzuar tërë grupin etnik se po përgatisin konspiracion kundër popullit rus dhe vazhdimisht ua ka shkurtuar hebrenjtë të drejtën për dinjitet kombëtar dhe e ka mohuar ekzistimin e tyre si komb. Së këndejmi, gjykata është pajtuar me vlerësimin e gjykatave vendore, që konsiderojnë se botimet e ankuesit kanë nxitur urrejtje ndaj popullit hebraik, që ka qenë në kundërshtim me vlerat themelore të Konventës dhe kështu edhe të nenit 17 të Konventës, ankuesi

nuk mund të ketë përfitime për mbrojtje sipas nenit 10.

Gjykata njëkohësisht nuk ka gjetur argument se është shkelur e drejta e ankuesit në gjykim të drejtë. Pasi ka konstatuar se ankesa e ankuesit sipas nenit 10 ka qenë e papërshtatshme *ratione materiae* me Konventën, ankuesi nuk ka pasur kurrfarë pretendimi kontestues se është viktimë e shkeljes së Konventës dhe, si rrjedhojë, neni 13 është i pazbatueshëm për rastin. Më tej, pasi neni 14 nuk ekziston si i pavarur, është konstatuar se ankesat e ankuesit sipas neneve esenciale të Konventës janë të papranueshme, respektivisht nuk ka pasur mundësi për zbatimin e nenit 14.

Koment për vendimin

Në këtë rast, Gjykata ka përsëritur se deklaratat që shokojnë, ofendojnë ose shqetësojnë, bëjnë pjesë në mbrojtjen nga neni 10. Gjykata e ka përsëritur sërish rëndësinë vendimtare të lirisë së shprehjes siç është e mbrojtur sipas nenit 10, mirëpo i ka baraspeshuar këto të drejta me kufizimet e këtyre të drejtave. Në rastin konkret, ankuesi e ka kaluar pragun e rasteve që kanë të drejtë për mbrojtje sipas nenit 10. Me të vërtetë, Gjykata ka konstatuar se deklaratat e ankuesit kanë nxitur urrejtje ndaj një grupi të caktuar, sepse ankuesi është përpjekur që t'i shfrytëzojë të drejtat e tij sipas nenit 10 për të nxitur urrejtje në bazë të përkatësisë etnike. Duke i shqyrtuar faktet, pronari dhe redaktori i gazetës ka qenë i dënuar për shkrime dhe publikime të një serie të artikujve që i paraqesin hebrenjtë si burim i së keqes në Rusi, duke bërë thirrje për përjashtimin e tyre nga jeta shoqërore. Ai e ka akuzuar tërë grupin etnik për konspiracion kundër popullit rus, i ka veshur ideologji fashiste udhëheqësisë hebraike dhe ua ka shkurtuar të drejtën e dinjitetit kombëtar hebrenjtë. Gjykata nuk ka dyshuar në raport me kuptimin e shprehur antisemitist të qëndrimeve të ankuesit. Sulmi i tillë i përgjithshëm dhe i ashpër ndaj një grupi etnik është drejtuar kundër vlerave themelore të Konventës, veçanërisht tolerancës, paqes sociale dhe mosdiskriminimit. Duke marrë parasysh këtë, Pavell Ivanov kundër Ruisë tregon se gjuha e urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike nuk është pjesë e mbrojtjes nga neni 10 i Konventës duke e zbatuar nenin 17.

***Ballsit-Lideikiene kundër Lituanisë
(Kërkesa anikomore nr. 72596/01) e
datës 4 nëntor 2008***

Shënim për procedurën:

Kërkesa e ankesës është parashtruar kundër Republikës së Lituanisë, nga ankuesja znj. Danute Ballsit-Lideikiene, shtetase e Lituanisë, më 23 maj të vitit 2001, ndërsa është shqyrtuar nga Gjykata më 7 tetor të vitit 2008.

Rezyme e fakteve:

Në mars të vitit 2001, gjykatat vendore kanë konstatuar se ankuesja e ka shkelur nenin 214 nga Kodi i kundërvajtjeve për të drejtën administrative, për shkak të publikimit dhe shpërndarjes së “Kalendarit lituanez 2000”, ku është promovuar urrejtja etnike për prejardhjen polake, ruse dhe hebraike. Ankuesja kishte marrë vërejtje administrative, ndërsa ishin konfiskuar edhe ekzemplarët që nuk ishin shitur.

Ankesa e ankueses drejtuar Gjykatës

Ankuesja është ankuar për shkelje të nenit 6 (1) dhe 6 (3)g (e drejta e dëgjimit dhe gjykimit të drejtë), duke u ankuar se rasti është shqyrtuar nga Gjykata e shkallës së parë pa i ftuar edhe ekspertët në seancë dhe se Gjykata Supreme Administrative nuk ka mbajtur diskutim për ankesën. Ankuesja është ankuar se edhe konfiskimi edhe ndalimi i kalendarit kanë qenë në kundërshtim me nenin 10.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se gjykata e shkallës së parë ka emëruar ekspertë të cilët është dashur të konstatojnë nëse “Kalendari lituan 2000” ka promovuar urrejtje etnike dhe nëse konkretisht ka pasur përmbajtje antisemite, antipolake, antiruse ose shprehje të superioritetit të lituanëve në krahasim me grupet tjera etnike. Megjithëse Gjykata është mbështetur dukshëm në konkluzionet e ekspertëve, ankuesit nuk i është dhënë mundësia të dëgjohen ekspertët për të përcaktuar kredibilitetin e tyre ose të pyeten për konkluzionet e tyre. Refuzimi i kërkesës së saj për të pyetur edhe ekspertët para një gjykate të hapur nuk i ka plotësuar kërkesat nga neni 6 (1). Gjykata me

6 vota “për” dhe 1 “kundër” ka konkluduar se ka shkelje të nenit 6.

Lidhur me nenin 10, gjykata ka konsideruar se qëllimi i dënimit (dënim administrativ dhe konfiskim i botimeve) ka qenë për të mbrojtur dinjitetin dhe të drejtat e grupeve etnike që jetojnë në Lituani, në të cilat është thirrur “kalendari lituan”, Gjykata i ka kushtuar vëmendje të veçantë shqetësimit të pushtetit lidhur me kontekstin e rastit, që u është referuar çështjeve të integritetit territorial dhe pakicave kombëtare. Gjykata i ka shqyrtuar dhe obligimet e Lituanisë sipas së drejtës ndërkombëtare për të ndaluar çfarëdo përfaqësimi të urrejtjes kombëtare dhe për të mbrojtur personat që u nënshtrohen kërcënimeve si rezultat i identitetit të tyre etnik. Gjykata ka konstatuar se organet kompetente vendore nuk e kanë tejkulluar kufirin e tyre të diskrecionit shtetëror gjatë shqyrtimit të shqetësimit serioz dhe nevojës së madhe shoqërore për të ndërmarrë masa kundër ankueses. Gjykata ka konkluduar se ndërhyrja në të drejtën e ankuesit për lirinë e shprehjes është e duhur dhe e domosdoshme në një shoqëri demokratike dhe për të mbrojtur të drejtat e tjerëve, duke konkluduar njëzëri se nuk ka shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Ky vendim e tregon vendosjen e baraspeshës ndërmjet së drejtës së ankuesit për lirinë e shprehjes dhe interesat demokratike, ndaj të cilave ka vepruar Gjykata për të konstatuar nëse ndërhyrja në lirinë e shprehjes së individit ka qenë proporcionale. Së këndejmi, Gjykata i ka marrë parasysh kontekstin e veçantë kombëtar, obligimet ndërkombëtare të shtetit si dhe reagimet negative që janë paraqitur në nivel ndërkombëtar në raport me deklaratimet e kontestuar. Ankueses, botuese, i është shqiptuar vërejtje administrative për shkak të botimit që përmban deklaratat që promovojnë pretendime territoriale, duke shprehur nacionalizëm agresiv ku janë potencuar hebrenjtë dhe polakët si kryerës të krimeve ushtarake dhe gjenocidit ndaj lituanëve. Ekzemplarët e botimit që nuk janë shitur janë konfiskuar. Gjykata nuk ka zbuluar shkelje të nenit 10, sepse deklaratat e kontestuar që nxisin urrejtje kundër polakëve dhe hebrenjve, kanë mundur të shkaktojnë shqetësim serioz të organet kompetente, veçanërisht në aspekt të natyrës së ndjeshme

të çështjeve të pakicave kombëtare dhe integritetit territorial pas shpalljes së serishme të pavarësisë së Lituanisë në vitin 1990. Gjykata, sipas gjykimit të saj nuk e ka ngritur çështjen për zbatimin e nenit 17.

Gjykata, gjithashtu i ka kushtuar vëmendje natyrës së deklaratave të ankueses që janë konsideruar si nacionaliste dhe etnocentrike dhe kanë paraqitur formë të nxitjes së urrejtjes në bazë të përkatësisë etnike, që me të drejtë ka shkaktuar shqetësime serioze. Njëherësh, gjykata e ka marrë parasysh edhe llojin dhe nivelin e sanksionit të shqiptuar kundër ankueses, si dhe kontekstin faktik që ka sjellë nevojën e domosdoshme shoqërore, duke arsyetuar ndërhyrjen në lirinë e shprehjes së ankueses. Në këtë aspekt, *Ballsit-Lideikiene kundër Lituanisë* e tregon kontrollin e rreptë të baraspeshës ndërmjet të drejtave të ndryshme konvencionale që i shfrytëzon Gjykata.

Atamançuk kundër Rosisë (Kërkesa ankimore nr. 4493/11) e 11 shkurt 2020

Shënim për procedurën:

Ankuesi, shtetas rus, ka parashtruar kërkesë për ankesë kundër Federatës Ruse më 18 janar 2011, për të cilën gjykata ka mbajtur debat jopublik më datë 14 janar të vitit 2020.

Rezyme e fakteve:

Ankuesi është pronar i një gazete lokale, i cili është dënuar për nxitje të urrejtjes për shkak të një artikulli të gazetës me përmbajtje ofenduese për grupet etnike joruse. Ankuesi ka deklaruar se këto grupe janë të prira ndaj krimeve dhe do të “derdhen gjak, përdhunohen, plaçkitin dhe robërojnë, sipas ideve të tyre barbare” dhe se “janë pjesëmarrës në shkatërrimin e vendit”. Artikulli është botuar dy herë, në dy gazeta lokale, në një rajon multietnik. Ankuesi është dënuar për çdo publikim, me dënim në para prej 5.100 euro dhe 2 vite ndalim të ushtrimit të veprimtarisë së gazetarisë dhe botimit. Megjithëse dënimi lidhur me publikimin e parë nuk është ekzekutuar, dënimi i dytë është zëvendësuar me dënim punë me dobi të përgjithshme në kohëzgjatje prej 100 orësh.

Ankesa nga ana e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkelje të së drejtës për lirinë e shprehjes sipas nenit 10. Ankuesi është ankuar edhe për shkelje të nenit 6 (1), duke pohuar se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se vendimet e gjykatave vendore janë bazuar në arsyet relevante për dënimin e ankuesit dhe gjykatat në veçanti e kanë marrë parasysh kontekstin e dënimit, që është përcaktuar në kontekst të legjislacionit vendor në aspekt të luftës kundër gjuhës së urrejtjes dhe mbrojtjes së të drejtës, veçanërisht të grupeve etnike joruse që jetojnë në rajonin e ankuesit.

Gjithashtu, gjykata ka vërejtur se deklarata e ankuesit nuk ka mund të kontribuojë në debatin publik për çështjen relevante e as që ka qenë ai qëllimi i tij kryesor. Deklarata gjithashtu nuk ka pasur edhe bazë faktike. Gjykata ka vërejtur se madje edhe nëse artikulli nuk do të kishte thirrje eksplicite të akteve të dhunës, organet kombëtare kanë vepruar në kuadër të margjinës së tyre të kompetencave. Së këndejmi, Gjykata ka konkluduar se me këtë rast janë zbuluar edhe rrethana të jashtëzakonshme që e kanë arsyetuar dënimin e shqiptuar ndaj ankuesit, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë së gazetarisë në kohëzgjatje prej 2 viteve nuk e ka penguar shtypin që të vazhdojë veprimtarinë si mbikëqyrës të shoqërisë demokratike.

Në fund, Gjykata nuk ka konstatuar shkelje të nenit 6 (1), duke konsideruar se refuzimi i kërkesës së ankuesit që të thirret një specialist i filologjisë, nuk e ka cenuar drejtësinë gjatë procedurës penale.

Koment për vendimin

Aludohet në faktin se ky rast e pasqyron baraspeshën e dobët që GJEDNJ-ja tenton ta arrijë ndërmjet kufijve të lirisë së shprehjes, lirisë së shtypit dhe kufijve të tolerancës. Gjykata i ka shqyrtuar deklaratat e ankuesit se grupet etnike joruse që jetojnë në Rusi do të “derdhen gjak, përdhunohen, plaçkitin dhe robërojnë,

sipas ideve të tyre barbare” dhe se “do të marrin pjesë (janë pjesëmarrës) në shkatërrimin e vendit”. Gjykata nuk ka konstatuar shkelje të nenit 10 lidhur me gjykimin penal të ankuesit dhe ndalimin dyvjeçar të veprimtarive të gazetarisë dhe botimit që i janë shqiptuar në atë drejtim. Megjithëse Gjykata në fund ka vendosur të mos miratojë vendim për zbatimin e nenit 17, vendimi dukshëm është bazuar në praktikën gjyqësore lidhur me këtë dispozitë. Me këtë rast parashtrohet pyetja se deri në cilën shkallë mund të lejohet censura e lirisë së shprehjes, veçanërisht në shtyp, me qëllim të mbrojtjes së paragjytimeve tjera. Në rastin konkret, Gjykata e përsërit rolin esencial të lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike, por prapëseprapë e njeh rolin e shtetit dhe margjinën e tij në kufizimin të kësaj lirie, ku ekziston ndonjë dëm potencial nga gjuha e urrejtjes.

Gjatë përcaktimit nëse ndërhyrja është legjitime, në mënyrë të domosdoshme dhe proporcionale Gjykata i ka marrë parasysh faktet se jeta e ankuesit nuk është cenuar nga ndalimi, veçanërisht duke marrë parasysh se gazetaria nuk ka qenë aktivitet kryesor i tij, se me atë aktivitet është marrë kohë pas kohe. Kjo e tregon baraspeshën të cilën gjykata e realizon gjatë konstatimit të faktit nëse ka qenë e domosdoshme dhe proporcionale ndërhyrja në lirinë e shprehjes së ankuesit.



Urrejtja fetare

Gjykata është thirrur në praktikën e saj të vendosur gjyqësore se liria e mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit është një nga themelet e “shoqërisë demokratike” në kuptim të Konventës. Meqë komunitetet fetare në mënyrë tradicionale ekzistojnë në formë të strukturave të organizuara, e drejta e besimtarëve të lirisë së besimit, që e përfshin edhe të drejtën e praktikimit të religjionit të tyre në bashkësi me tjerët, e përfshin edhe pritshmërinë se besimtarëve duhet t'u lejohet të mbledhen lirshëm¹⁶. Në kontekst të lirisë së religjionit, shtetet kanë një margjinë të madhe vlerësimit në sferë veçanërisht delikate, të raporteve të tyre me bashkësitë fetare¹⁷. Shteti ka obligim të qëndrojë neutral dhe i paanshëm gjatë realizimit të fuqisë së tij rregulluese dhe në raportet me religjionet, besimet dhe grupet e ndryshme të bashkësive fetare. Shteti ka obligim pozitiv për ta ruajtur pluralizmin dhe funksionimin e drejtë të demokracisë, që si karakteristikë kryesore e ka mundësinë që e ofron për të zgjidhur problemet e një vendi nëpërmjet dialogut, pa përdorur dhunë fizike dhe verbale. Bashkëveprimi i harmonishëm i personave dhe grupeve me identitet të ndryshëm ka rëndësi esenciale për arrijtjen e kohezionit social¹⁸.

Fuqia e shtetit për të mbrojtur institucionet e dhe qytetarët e tij nga personat ose shoqatat që mund t'i cenojnë ata, duhet doemos të shfrytëzohet në mënyrë të kujdesshme, meqë përjashtimet nga rregulla e lirisë së bashkimit duhet të interpretohen rreptë, ndërsa vetëm në rastet dhe arsyet e domosdoshme mund të arsyetohen kufizimet e asaj lirie.

16 Hasani dhe Çausi kundër Bullgarisë [Këshilli i Madh Gjyqësor], nr. 30985/96, § 62, KEDNJ 2000-XI.

17 Ça'are Shallom ve Tsedek kundër Francës [Këshilli i Madh Gjyqësor], nr. 27417/95, § 84, GJEDNJ 2000-VII.

18 Izetin Dogan dhe të tjerë kundër Turqisë [Këshilli i Madh Gjyqësor], nr. 62649/10, § 109, GJEDNJ 2016.

Norvud kundër Mbretërisë së Bashkuar (Kërkesa ankimore nr. 23131/03) (vendim për lejueshmëri) 16 nëntor 2004

Shënim për procedurën:

Ankuesi është shtetas i Mbretërisë së Bashkuar që e ka parashtruar kërkesën ankimore në Gjykatën Evropiane e të Drejtave të Njeriut më datë 16 korrik 2003, lidhur me shkeljet e supozuara nga ana e Mbretërisë së Bashkuar të nenit 10 dhe 14 nga Konventa. Seanca gjyqësore është mbajtur më datë 16 nëntor të vitit 2004.

Rezime e fakteve:

Ankuesi ka qenë organizator rajonal i PNB (Partisë Kombëtare Britanike – parti politike skajshmërisht e djathtë), ai në dritaren e tij kishte vendosur një pllakat të madh e siguruar nga PNB-ja në periudhën ndërmjet muajt nëntor 2001 dhe janar 2002. Në pllakatin është paraqitur fotografia e kullave binjake në flakë me fjalinë “Islami jashtë Britanisë – Mbroni britanikët” dhe simboli i gjysmëhënës dhe yllit në shenjë të ndalimit.

Pas ankesave të publikut, policia e kishte larguar pllakatin. Ankuesi ishte akuzuar për veprë të rëndë penale të shfaqjes armiqësore ndaj një grupi racor dhe fetar, me shkrim të tillë, shenjë ose simbol të dukshëm që është kërcënues, ofendues, që në sytë e dikujt tjetër mund të shkaktojë shqetësim, panik dhe mërzë. Ndaj kësaj, ankuesi është deklaruar se është i pafajshëm duke pohuar se pllakati nuk ka qenë ofendues sepse i është referuar islamizimit ekstrem dhe ka pohuar se gjykimi i tij do të ishte shkelje e së drejtës së tij të lirisë së shprehjes në pajtim me nenin 10 të Konventës.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është thirrur në shkeljen e nenit 10 (liria e shprehjes) dhe nenin 14 (ndalimi e diskriminimit).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka konstatuar se deklaratimet e ankuesit nuk kanë qenë *ratione materiae* në përputhje me Konventën. Me të vërtetë, duke u thirrur në nenin 17, Gjykata ka përsëritur se qëllimi i nenit është të pengojë individët dhe grupet që ta shfrytëzojnë Konventën për qëllime personale. Gjykata ka përsëritur se në praktikën paraprake gjyqësore, Gjykata ka përcaktuar se neni 10 nuk mund të përfshihet në kuptimin që do të jetë në kundërshtim me nenin 17.

Gjykata është pajtuar me vlerësimin e gjykatave vendore se fjalët dhe fotografia paraqesin “shprehje publike të sulmit kundër të gjithë myslimanëve në Mbretërinë e Bashkuar”. Kjo ka paraqitur sulm të ashpër kundër një grupi fetar si tërësi, duke e ndërlidhur atë grup me një akt terrorist. Gjykata ka konkuduar se deklaratat e tilla kanë qenë në kundërshtim me vlerat themelore të mbrojtura me Konventën dhe, si i tillë, akti i prezantimit të pllakatit ka qenë vepër që bën pjesë në kuadër të nenit 17 dhe nuk ka gëzuar mbrojtje nga neni 10 ose neni 14.

Koment për vendimin

Ankuesi është dënuar për shkak se ka vendosur një pllakat në dritaren e banesës së tij me përmbajtje të kullave binjake në flakë me fjalinë “Islami jashtë Britanisë – Mbroni britanikët” dhe simboli i gjysmëhënës dhe yllit me shenjë të ndalimit. Sulmi i tillë i përgjithshëm dhe i ashpër ndaj një grupi fetar, duke e lidhur atë si tërësi me një vepër të rëndë terroriste nuk ka qenë në përputhje me vlerat e proklamuar dhe të garantuara me Konventën. Në bazë të nenit 17, vepra e tillë nuk ka gëzuar mbrojtje sipas nenit 10 ose nenit 14. Gjykata e ka injoruar argumentin e ankuesit se pllakati është prezantuar në rajon rural që nuk është i ekspozuar ndaj tensioneve racore ose fetare, andaj edhe nuk ka argumente se një mysliman i vetëm e ka parë pllakatin. Kërkesa e ankesës është hedhur poshtë si e papërputhshme *ratione materiae* me dispozitat e Konventës. Theksohet fakti se ky rast është një presedan i bindshëm dhe i

qartë që tregon se liria e shprehjes nuk do të mbrohet me Konventën kur shfrytëzohet për nxitje të urrejtjes, thirrje për dhunë ose ofendim të individëve ose grupeve në bazë të religjionit të tyre.

Ky rast tregon se neni 17 shërben si mbrojtje që tregon se Konventa nuk shfrytëzohet për interes publik që është në kundërshtim me vlerat e Konventës, në rastin konkret shprehjes publike ose prezantimit të sulmeve, si thirrje për dhunë ose urrejtje ndaj grupeve tjera fetare.

I. A. Kundër Turqisë (Kërkesa ankimore nr. 42571/98) e 13 shtatorit 2005

Shënim për procedurën:

Rasti ka të bëjë me kërkesën ankimore kundër Republikës së Turqisë, të parashtruar në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut nga ana e shtetasit turk, z. I.A., më datë 18 maj të vitit 1998. Gjykata ka mbajtur seancën gjyqësore më datë 28 qershor dhe 25 gusht të vitit 2005.

Rezime e fakteve:

Ankuesi është pronar dhe drejtor administrativ i shtëpisë botuese (Berfin), që në vitin 1993 ka botuar një roman të Abdulla Riza Erguven, të titulluar “Yasak Tumceler” (Frazat e ndaluara).

Prokurori publik në Stamboll, në aktakuzën nga data 18 prill të vitit 1994 e ka akuzuar ankuesin për blasfemi kundër “Zotit, religjionit, profetit dhe librit të shenjtë” nëpërmjet botimit të librit të kontestuar. Kjo akuzë është bazuar në raportin profesional të përgatitur me kërkesë të prokurorit publik.

Në letrën drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë në Stamboll, ankuesi e ka kontestuar raportin profesional, duke theksuar se libri është një roman, ndërsa e ka kontestuar edhe paanshmërinë e personit profesional. Është përgatitur raport i dytë profesional nga ana e Këshillit të Ekspertëve, me ç'rast ankuesi e ka kontestuar saktësinë duke deklaruar se ajo është një kopje e raportit të parë. Ankuesi është dënuar me bur-

gim në kohëzgjatje prej dy vitesh dhe me dënim në para. Gjykata Kombëtare e ka zëvendësuar dënimin me dënim në para, ashtu që në fund i është urdhëruar ankuesit të paguajë dënim ekuivalent me 16dollarë amerikanë. Ankuesi është ankuar edhe në Gjykatën e Kasacionit, duke theksuar se libri vetëm shpreh pikëpamjet e tij, ndërsa gjithashtu i ka kontestuar edhe raportet profesionale. Gjykata e Kasacionit e ka konfirmuar aktgjykimin e kontestuar.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkeljen e nenit 10 të Konventës (e drejta e lirisë së shprehjes).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se dënimi i ankuesit përbën ndërhyrje në të drejtën e tij të lirisë së shprehjes, kjo ka qenë ndërhyrje që është përcaktuar me ligj dhe ka realizuar qëllimet legjitime për parandalimin e parregullsive dhe mbrojtjes së moralit dhe të drejtave të të tjerëve. Gjykata ka vërejtur se vlerësimi ka qenë lidhur me çështjen nëse ndërhyrja ka qenë “e domosdoshme në një shoqëri demokratike”.

Gjykata ka përsëritur se liria e shprehjes është bazë esenciale e një shoqërie demokratike dhe kusht themelor për përparimin e tij dhe “vetëpërbushjen e çdo individi”. GJED-NJ-ja rikujtoi se neni 10 paragrafi 2 i mbron jo vetëm informatat dhe idetë që nuk përmbajnë ofendime, që pranohen qetësisht dhe janë të paanshme, por edhe ata që ofendojnë, shokojnë ose shqetësojnë.

Gjykata ka përkujtuar serealizimi i lirisë sipas paragrafit 2 nga neni 10 në vete përmban edhe detyra dhe përgjegjësi. Si rrjedhojë, mund të ekzistojë një detyrë legjitime që të shmangen shprehjet që janë të “panevojshme” si ofendim dhe blasfemi në kontekst të bindjeve fetare. Në këtë aspekt, Gjykata ka pranuar se shteti ka një margjinë të caktuar të rrvlerësimit, që është e pakufizuar, gjatë përcaktimit të asaj që konsiderohet si “e domosdoshme për një shoqëri demokratike”. Gjykata e ka theksuar mungesën e një koncepti të unifikuar evropian për kërkesat për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, në raport me sulmet ndaj bindjeve të tyre fetare. Kjo, sipas gjykatës, i jep shtetit një margjinë më të gjerë të vlerësimit. Mirëpo, Gjykata ka para-

lajmëruar se ajo duhet të miratojë vendim përfundimtar për faktin nëse kufizimi i imponuar nga shteti është i përshtatshëm me Konventën, e atë e bën me vlerësimin nëse rrjeti është i përshtatshëm me “nevojën e domosdoshme shoqërore” dhe është “proporcionale me qëllimin legjitim ndaj të cilit synohet”.

Ky rast përfshin peshimin e interesave të kundërshtuara ndërmjet dy lirive fundamentale. Në këtë aspekt, Gjykata ka konsideruar se rasti ka të bëjë me komentet që kanë qenë “sulm me ofendime” ndaj profetit të islamit. Citati u është referuar deklaratave konkrete që në mënyrë legjitime mund të kuptohen si sulme ndaj besimtarëve të atij religjioni. Së këndejmi, Gjykata ka vlerësuar se masat e ndërmarra i dedikohen mbrojtjes nga sulmet ofenduese të gjërave që konsiderohen si të shenjta për myslimanët, e kështu edhe masa mund të konsiderohet për përmbushjen e “nevojës së domosdoshme shoqërore”. Me 4 kundrejt 3 votave, Gjykata ka konkluduar se autoritetet vendore nuk e kanë kaluar margjinën e vlerësimit, dhe se nuk ka pasur shkelje të nenit 10. Gjykatësit Kosta, Kabral Bareto dhe Jungvirt kanë pasur mendime të ndryshme. Megjithatë gjykatësit pranojnë se deklaratat e dhëna janë pa dyshim ofenduese, ata kanë vërejtur se këto deklaratat nuk duhet të merren në mënyrë të izoluar si bazë për gjykimin e tërë librit. Gjykatësit njëherësh kanë pohuar se megjithatë dënimi ka qenë i lehtë, i tjetërsuar nga 2 vite burgim në dënim në para, çdo lloj i dënimit penal mund të ketë “ndikim frikësues” ndaj mediave dhe shtypit dhe t'i dekurajojë botuesit për të botuar libra që nuk janë konformiste. Kjo, sipas qëndrimit të gjykatësve, ka krijuar rrezik të madh për vetë censurim që ka qenë e rrezikshme për lirinë. Sipas kësaj, gjykatësit kanë konstatuar se me të vërtetë ka pasur shkelje të nenit 10 të këtij rasti.

Koment për vendimin

Sugjerohet në atë që ky rast e tregon zbatimin e margjinës së vlerësimit që të konstatohet se çfarë është ofenduese dhe çfarë është e mbrojtur me Konventën në aspekt të fjalës që ka të bëjë me religjionin. Ky rast konfirmon se shtetet dhe organet kombëtare duhet të vendosin një baraspeshë delikate ndërmjet lirisë së shprehjes nga njëra anë dhe lirisë së të drejtave nga ana tjetër, veçanërisht të së drejtës së tyre të lirisë së besimit.

Së këndejmi, çështja në këtë rast nënkupton matjen e interesave të kundërshtuara gjatë realizimit të dy lirive fundamentale, gjegjësisht të drejtës së ankuesit për të shprehur publikisht qëndrimet për doktrinën fetare nga njëra anë dhe të drejtës së tjerëve për respektimin e lirisë së tyre të mendimit, vetëdijes dhe religjionit nga ana tjetër. Gjykata përsërit se pluralizmi, toleranca dhe liria e mendimit janë shenja të një shoqërie demokratike. Ata që e kuptojnë dhe e shfrytëzojnë lirinë për të shprehur religjionin e tyre, pa marrë parasysh nëse e bëjnë si pjesëtarë të shumicës ose pakicës fetare, normalisht se nuk mund të mos jenë pjesë e çdo lloj kritike. Ata doemos duhet ta tolerojnë dhe pranojnë mohimin e bindjeve të tyre fetare nga personat tjerë, madje edhe propagimin e doktrinave që janë me qëndrim armiqësor ndaj besimit të tyre dhe personave tjerë.

Ky rast nuk ka të bëjë vetëm me komentet shokuese, ofenduese ose provokuese, por edhe me sulmet ofenduese ndaj profetit të islamit. Gjykata e ka theksuar faktin se ekziston një tolerancë e caktuar për kritikë të doktrinës fetare në shoqërinë turke, që është e lidhur thellë me parimin e sekularitetit, besimtarët mund në mënyrë të arsyeshme të ndihen si pjesë e sulmeve të paarsyeshme dhe ofenduese nëpërmjet pasuseve të caktuara të publikimit të ankuesit. Konkluzioni i Gjykatës është se masat e ndërmarra në raport me deklaratimet për të cilat bëhet fjalë, kanë për qëllim të sigurojnë mbrojtje nga sulmet ofenduese të çështjeve që myslimanët i konsiderojnë të shenjta dhe në atë aspekt gjykata ka konstatuar se me të drejtë mund të konsiderohet se masa e ka plotësuar nevojën e domosdoshme shoqërore.

Për këtë arsye nuk mund të thuhet se organet kompetente e kanë tejkaluar margjinën e tyre të vlerësimit në atë aspekt dhe se arsyet e theksuara nga gjykatat vendore për të arsyetuar ndërmarrjen e masave të tilla kundër ankuesit, kanë qenë relevante dhe të mjaftueshme. Lidhur me proporcionalitetin e masës së kontestuar, Gjykata me vëmendje e ka shqyrtuar faktin se gjykatat vendore nuk kanë vendosur që ta konfiskojnë librin dhe, sipas asaj është konsideruar se dënimi i parëndësishëm i shqiptuar në para ka qenë proporcional me qëllimet që realizohen.

Është interesant që të përmendet se shumica në rastin konkret i ka kushtuar një vëmendje të

veçantë përmbajtjes së deklaratës së kontestuar, kontekstit se si është dhënë, si dhe lehtësisë së fjalisë. Duke marrë parasysh këtë, shumica ka zbuluar se ndërhyrja e gjykatave vendore në të drejtën e lirisë së shprehjes së ankuesit ka qenë në aspekt të çështjes së rëndësishme shoqërore dhe ka qenë proporcionale dhe e domosdoshme. Megjithatë aktgjykimi kundërthënës deri diku ka qenë në pajtim me këtë analizë, shumica e ka vërejtur ndikimin e frikësimit potencial që mund ta ketë ndërhyrja e tillë në lirinë e shprehjes së botuesve.

Erbakan kundër Turqisë, (Kërkesa ankimore nr. 59405/00) e 6 korrikut 2006

Shënim për procedurën:

Ankuesi është shtetas turk (z. Nexhmetin Erbakan) që e ka parashtruar kërkesën e tij ankimore në Gjykatën më 26 korrik të vitit 2000, kundër Republikës së Turqisë.

Rezyme e fakteve:

Ankuesi është politikan që ka qenë kryeministër i Turqisë nga qershori i vitit 1996 deri në qershor të vitit 1997, ndërsa në periudhën relevante kohore ka qenë edhe kryetar i Refah Partisi (Partisë së Mirëqenies), e cila u shpërbë në vitin 1998 për shkak të pjesëmarrjes në aktivitete në kundërshtim me parimet e sekularizmit.

Ankuesi ka mbajtur fjalim publik në shkurt të vitit 1994 gjatë fushatës së zgjedhjeve lokale, për çka është iniciuar procedurë penale kundër tij 4 vite më vonë. Procedura është iniciuar për shkak të nxitjes së urrejtjes dhe armiqësisë ndërmjet njerëzve nëpërmjet komenteve gjatë fjalimit të tij. Në vitin 2000 ankuesi është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej një viti si dhe dënim në para. Duke marrë parasysh situatën në qytetin ku e ka mbajtur fjalimin në periudhën relevante kohore, kur banorët kanë qenë viktimat të veprave terroriste nga organizatat ekstremiste, Gjykata e Sigurisë Shtetërore ka konstatuar se ankuesi, duke bërë dallim të veçantë në fjalimin e tij ndërmjet besimtarëve dhe jobesimtarëve, e ka tejkaluar kufirin e pranueshëm të lirisë në debatin politik.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkeljen e nenit 10 dhe nenit 6 paragrafi 1, duke pohuar se dënimi i tij e cenon të drejtën e tij të lirisë së shprehjes dhe se rasti i tij nuk është shqyrtuar nga një gjykatë e pavarur dhe paanshme për shkak të pranisë së një gjykatësi ushtarak të Gjykatës Shtetërore të Sigurisë.

Vendimi i Gjykatës:

Lidhur me nenin 10, Gjykata kë vërejtur se nëpërmjet përdorimit të terminologjisë fetare, ankuesi e thjeshtëson dallimin ndërmjet besimtarëve dhe jobesimtarëve, duke thirrur që të formohet dallim politik në bazë të përkatësisë fetare.

Gjykata e ka pranuar rëndësinë e parandalimit të mostolerimit në cilëndo formë, që është pjesë përbërëse e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Njëherësh, gjykata e ka vërejtur këtë natyrë fundamentale të lirisë së shprehjes gjatë debateve politike në shoqëritë demokratike. Gjykata ka vërejtur se autoritetet vendore nuk janë munduar të përcaktojnë përmbajtjen e fjalimit për të cilin bëhet fjalë 5 vite pas mbledhjes dhe atë e kanë bërë atë vetëm në bazë të një video incizimi autenticiteti i të cilit nuk ka qenë i paqartë.

Gjykata gjithashtu ka theksuar se është vështirë të konstatohet fakti se atëherë kur është mbajtur fjalimi, ai ka qenë “rrezik i tanishëm” ose “rrezik i drejtpërdrejtë”. Gjykata gjithashtu i ka kushtuar vëmendje dënimit shumë të rreptë që është shqiptuar ndaj ankuesit, i cili kishte qenë një politikan shumë i njohur. Kjo e ka detyruar Gjykatën që të miratojë konkluzion, me gjashtë vota “pro” dhe një “kundër”, se është bërë shkelje e nenit 10, meqë procedura e iniciuar penale kundër ankuesit 4 vite e 5 muaj pas komenteve të supozuara, nuk ka qenë proporcionale me qëllimet e synuara legjitime. Krahas kësaj, Gjykata njëzëri ka votuar se ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1, duke theksuar se ankuesi ka pasur arsye legjitime për t’u frikuar se gjykata vendore nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme, sepse ka përfshirë gjykatës ushtarak në mesin e anëtarëve të vet.

Koment për vendimin

Sugjerohet në atë se se ky rast e përsërit rëndësinë kryesore të lirisë së fjalës në kontekst të debateve politike. GJEDNJ-ja është mbështetur në faktin se procedura është iniciuar pas shumë viteve pas mbajtjes së fjalimit, nuk ka pasur argument të qartë për autenticitetin e videos në të cilën janë thirrur gjykatat, e as që ka pasur argument se fjalimi ka përbërë rrezik.

Megjithëse Gjykata në këtë rast e ka përsëritur rëndësinë e eliminimit të mostolerancës dhe gjuhës së urrejtjes e cila nxit urrejtje dhe diskriminim, veçanërisht në bazë fetare, rasti është i rëndësishëm lidhur me kontrollin e rreptë që e zbaton Gjykata në rastet e ndërhyrjes në lirinë e shprehjes në kuadër të debatit politik.

***Bellkasem kundër Belgjikës,
(Kërkesa ankimore nr. 34367/14)
(vendim për lejueshmëri) e 27
korrikut 2017***

Shënim për procedurën:

Ankuesi (z. Fuad Belkasem), shtetas belg, e ka parashtruar kërkesën e tij ankimore kundër Belgjikës më datë 29 prill të vitit 2014.

Rezyme e fakteve:

Ankuesi ka qenë udhëheqës dhe zëdhënës i organizatës “sharia4Belgium”, e cila u shpërbë në vitin 2012. Ankuesi konkretisht ka qenë i përndjekur për vërejtjet që i ka nxjerrë dhe publikuar në YouTube lidhur me ministrin belg të mbrojtjes dhe bashkëshortin e vdekur të një politikaneje belge. Konkretisht, ankuesi i ka ftuar shikuesit t’i mposhtin jomuslimanët, t’u mbajnë një leksion dhe të luftojnë kundër tyre. Ankuesi ka qenë i dënuar me burgim në kohëzgjatje prej dy vitesh dhe dënim në para prej 550 euro, sepse ankuesi ka parashtruar ankesë. Aktgjyrimi është konfirmuar, por ekzekutimi i dënimit me burg ishte prolonguar për pesë vite. Gjykata e Kasacionit e hodhi poshtë ankesën e mëtejme të ankuesit, duke konsideruar se ankuesi pa dyshim i ka nxitur të tjerët në diskriminim në bazë të besimit dhe diskriminim, segregim, urrejtje ose dhunë ndaj jomuslimanëve.

Ankesa deri te Gjykata nga ana e ankuesit

Ankuesi është ankuar për shkeljen e nenit 10 (liria e shprehjes) duke deklaruar se ai kurrë nuk ka pasur qëllim të nxisë persona të tjerë për urrejtje, dhunë ose diskriminim, por vetëm i ka propaguar idetë dhe mendimet e tyre.

Vendimi i Gjykatës

GJEDNJ-ja e ka vërejtur natyrën esenciale të lirisë së shprehjes në shoqërinë demokratike, por njëkohësisht ka theksuar se praktika e saj gjyqësore ka konstatuar kufizime të kësaj të drejte, që rezultojnë me përjashtimin e deklaratave të caktuara nga mbrojtja sipas nenit 10. Gjykata ka vërejtur se deklaratat e ankuesit në disa video që i ka publikuar në YouTube u kanë bërë thirrje shikuesve t'i mposhtin myslimanët, t'u mbajnë leksion dhe të luftojnë kundër tyre. Në këtë aspekt, Gjykata është pajtuar se komentet e ankuesit pa dyshim kanë qenë përplot urrejtje dhe janë pajtuar me konstatimin e gjykatës vendore se ankuesi ka tentuar të nxisë urrejtje, diskriminim dhe dhunë ndaj jomyslimanëve. GJEDNJ-ja konsideron se një sulm i tillë i përgjithshëm dhe i ashpër ka qenë i papërshtatshëm me vlerat themelore të Konventës. Gjykata ka theksuar se konkretisht lidhur me vërejtjet e ankuesit për sheriatin, se ai paraprakisht ka vendosur që mbrojtja e shariatit, njëkohësisht duke thirrur në dhunë, mund të konsiderohet si formë e "gjuhës së urrejtjes". Gjykata më tej ka vërejtur se legjislacioni belg, ashtu siç është zbatuar në rastin konkret, ka qenë në pajtim me rekomandimet relevante të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, të orientuara drejt ndalimit të nxitjes së urrejtjes, dhunës ose diskriminimit.

Së këndejmi, Gjykata ka konkluduar se në pajtim me nenin 17, ankuesi nuk mund të kërkojë mbrojtje sipas nenit 10 të Konventës, sepse qëllimi i tij real ka qenë të shfrytëzojë të drejtën e tij të lirisë së shprehjes për qëllime të cilat janë dukshëm kundërshtim me vlerat themelore të Konventës.

Koment për vendimin

Ankuesi është dënuar me dënim në para dhe dënim me burg për shkak të disa videove në platformën YouTube, në të cilën ai i ka thirrur

shikuesit t'i mposhtin jomyslimanët, t'u mbajnë leksion dhe të luftojnë kundër tyre. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, një sulm i atillë i përgjithshëm i ashpër dhe i shprehur me urrejtje është i papërshtatshëm me vlerat e tolerancës, paqes sociale dhe jodiskriminimit. Rasti i paraqet ato deklaratat që thirrin në dhunë, urrejtje ose diskriminim ndaj një grupi për shkak të bindjeve fetare, që përbën formë të gjuhës së urrejtjes dhe si të tilla janë të papërshtatshme me vlerat themelore të Konventës, në pajtim me nenin 17. Krahas kësaj, rasti tregon se kur ankuesi bazohet në lirinë e tij të shprehjes për të thirrur në vendosjen e shariatit duke përdorur dhunë, Gjykata konsideron se kjo shprehje është përdorim i të drejtave të ofruara sipas Konventës, në mënyrë të kundërt me vlerat e saj dhe si rrjedhojë nuk mund të jetë nën mbrojtjen e Konventës.

E. S. kundër Austrisë, (Kërkesa ankimore nr. 38450/12) e 25 tetorit 2018

Shënim për procedurën:

Ankuesja (E.S), shtetase austriake, ka parashtruar ankesë në Gjykatë kundër Austrisë për shkeljen e nenit 10.

Rezime e fakteve:

Në vitin 2009, ankuesja ka realizuar 2 seminare me titull "Informata themelore për islamin", në të cilat ajo ka folur për martesën në mes të profetit Muhamed dhe Ajshes (vajza 6 vjeçare), me të cilën ai kishte pasur marrëdhënie kur ajo kishte mbushur 9 vjet. Në këto seminare, ankuesja ka theksuar se Muhamedi "ka dashur ta bëjë atë me fëmijë" dhe ka bërë një krahasim me fjalët "56-vjeçar dhe vajzë 6-vjeçare... Si ta quajmë atë nëse jo pedofili?". Në vitin 2011, Gjykata Rajonale e Vjenës ka konstatuar se deklaratat e ankueses nënkuptojnë se Muhamedi ka pasur prirje pedofili. Ankesa është dënuar për nënçmimin e doktrinave fetare dhe i është shqiptuar dënim prej 480 eurosh. Pas ankesës së ankueses, Gjykata e Apelit në Vjenë i ka konfirmuar konstatimet e gjykatës para-prake.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesja është ankuar për shkeljen e të drejtës së saj të shprehjes (neni 10) nga ana e gjykatës vendore.

Vendimi i Gjykatës

GJEDNJ-ja ka vërejtur se gjatë realizimit të lirisë së dikujt për të shprehur religjionin e vet sipas nenit 9 të Konventës, nuk mund të pritet të përjashtohet nga çfarëdo kritike, doemos duhet të tolerohet mohimi i bindjeve fetare. Gjykata ka përsëritur se vetëm aty ku shprehjet i tejkalojnë kufijtë e mohimit të kritikës dhe ku nxisin mostolerancë fetare, shteti ka të drejtë legjitime t'i konsiderojë si jokompatibile me respektimin e lirisë së mendimit, vetëdijes e religjionit dhe mund të ndërmarrë masa proporcionale për t'i kufizuar.

GJEDNJ-ja ka vërejtur në rastin konkret, lënda ka qenë veçanërisht e ndjeshme ndaj kontekstit, ndërsa ndikimet potenciale të deklaratave varen nga situata e vendit përkatës ku janë shprehur. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata ka konsideruar se shteti ka pasur margjinë të gjerë të vlerësimit në këtë rast.

Gjykata ka vërejtur se gjykatat vendore kanë sqaruar në mënyrë thelbësore se pse konsiderojnë se deklaratat e ankueses mund të shkaktojnë zemërim, veçanërisht sepse nuk është dhënë në mënyrë objektive dhe do të kontribuojë për debat me interes publik. Gjykata është pajtuar me gjykatat vendore se ankuesja ka qenë e vetëdijshme se qëndrimet e saj kanë qenë pjesërisht të pabaza dhe se kanë pasur potencial për të shkaktuar zemërim. GJEDNJ-ja nuk ka gjetur kurrfarë motivi për të shmangur kualifikimet e gjykatës vendore për deklaratat e shprehura nga ankuesja si aktgjykime për rregullsi. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se gjykatat vendore me vëmendje kanë krijuar një baraspeshë ndërmjet së drejtës së ankueses për lirinë e shprehjes dhe të drejtat e tjerëve për të mbrojtur ndjenjat e tyre fetare. Gjykata ka vërejtur se është e papërshtatshme që me nenin 10 të vihen në të “njëtin thes” deklaratat inkriminuese me shprehje të tjera të pranueshme të mendimit, si dhe të theksohet se ajo i bën të pranueshme deklaratimet që i tejkalojnë kufijtë e lejuar të lirisë së shprehjes. Njëherësh, Gjykata ka theksuar se

gjykojë që i është shqiptuar ankueses ka qenë e matur dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet si sanksion joproportional. Sipas kësaj, Gjykata ka konkluduar se nuk ka shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Ky rast është presedan për faktin që dalin përgjegjësi dhe obligime së bashku me të drejtat nga të cilat që ankuesit mund të kenë dobi sipas nenit 10. Ankuesja në deklaratën e saj ka kombinuar deklaratat inkriminuese që kanë qenë faktikisht të pabaza dhe kanë shkakuar zemërim, së bashku me shprehjen e mendimit, që sipas Gjykatës paraqet një formë të shprehjes që i ka tejkaluar kufijtë e lejuara të lirisë së shprehjes. Deklarimet e ankueses nuk janë dhënë në mënyrë objektive për të kontribuar në debat me interes publik. Ankuesja e ka përshkruar vetveten si eksperte nga sfera e doktrinës islame dhe një kohë të caktuar ka mbajtur seminare të atij lloji. Prandaj, patjetër është dashur të jetë e vetëdijshme se deklaratat e saj pjesërisht bazohen në fakte të pavërteta dhe se prezantimi i sendeve të besimit fetar në mënyrë provokuese mund t'i lëndojë ndjenjat e pasuesve të atij religjioni dhe mund të kuptohet si shkelje e frymës së tolerancës, që është një prej bazave të shoqërisë demokratike.

Ankuesja i ka atribuar prirje pedofili Muhamedit si një dëshirë e tij e përgjithshme seksuale, pa e njoftuar në mënyrë neutrale publikun për të kaluarën historike, si pasojë që nuk ka pasur mundësi për debat serioz për atë çështje. Me këtë qasje, ajo ka dhënë një mendim për rregullat pa bazë të mjaftueshme faktike dhe pa kurrfarë argumentesh për atë qëllim. Argumenti i ankueses se duhet të tolerohen disa deklaratat individuale gjatë diskutimit të drejtpërdrejtë nuk ka qenë i përshtatshëm me nenin 10 të Konventës. Gjykata ka vendosur se deklaratat e bazuara (dukshëm) në fakte të pavërteta nuk mund të gëzojnë mbrojtje sipas nenit 10. Në raport me proporcionalitetin e sanksionit, është vërejtur se ankuesja është urdhëruar të paguajë dënim të matur prej vetëm 480 euro për të tri deklaratat, megjithëse Kodi Penal ka paraparë dënim me burgim prej gjashtë muajsh. Dënimi i shqiptuar në para ka qenë i skajshëm, respektivisht dënim më i ulët i mundshëm sipas shkallës ligjore të dënimit. Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, sanksioni penal nuk ka qenë joproportional. Gjykata

ka vërejtur se gjykatat vendase në mënyrë të përmbledhur e kanë vlerësuar kontekstin më të gjerë të deklaratave të ankueses dhe me kujdes e kanë baraspeshuar të drejtën e saj për lirinë e shprehjes me të drejtat e personave të tjerë për të mbrojtur ndjenjat e tyre fetare në shoqërinë austriake. Krahas kësaj, deklaratat e kontestuar nuk janë formuluar në mënyrë neutrale me qëllim në mënyrë objektive të kontribuojnë në debatin publik për martesat e fëmijëve. Së këndejmi, gjykatat vendore kanë konkluduar se faktet në fjalë përmbajnë elemente të nxitjes së mostolerancës. Ata nuk e kanë tejkaluar margjinën e tyre të vlerësimit dhe ndërhyrjen në të drejtën e ankuesit sipas nenit 10, që është përshtatur me nevojën e domosdoshme shoqërore dhe ka qenë proporcionale me qëllimin e dëshiruar legjitim.

Ky rast është një shembull se Gjykata e ka pranuar rolin primar të organeve vendore gjatë përcaktimit të baraspeshës së drejtë që duhet të vendoset ndërmjet të drejtave të konfliktit, veçanërisht kur ka të bëjë me çështje fetare. Rasti tregon se GJEDNJ-ja do të intervenojë vetëm në vendimin e pushtetit nacional ku ka motive të forta për ta bërë atë ose kur pushteti vendor arrin baraspeshë që paraqet dukshëm një ndërhyrje në të drejtat e ankuesit që është joproportionale dhe e panevojshme. Kjo qasje mund të interpretohet si pranim nga ana e GJEDNJ-së të një margjine më të madhe të vlerësimit të autoriteteve vendore ku duhet të arrihet baraspesha ndërmjet lirisë së shprehjes dhe lirisë së besimit.

Ibragim Ibragimov dhe të tjerë kundër Rusisë, (Kërkesa ankimore nr. 1413/08 dhe 28621/11) e 28 gushtit 2018

Shënim për procedurën:

Rasti rrjedh nga dy kërkesa ankimore kundër Federatës Ruse që janë parashtruar nga shtetasi rus dhe dy organizata joprofitabile ruse më datë 3 dhjetor të vitit 2007 dhe 4 prill të vitit 2011. Gjykata ka mbajtur seanca jopublike më datë 10 korrik të vitit 2018.

Rezyme e fakteve:

Ankuesit kanë publikuar ose kanë autorizuar botimin e librave nga përmbledhja Risale-I Nur, e cila ka qenë egzegë e Kuranit të shkruar nga Said Nursi, tekstet e të cilit nga autoritetet myslimane në Rusi dhe jashtë vendit janë konsideruar si pjesë e një islami të zakonshëm mesatar, që promovon bashkëpunimin ndërmjet religjioneve dhe duke kundërshtuar aplikimin e dhunës. Organet kompetente vendore i kanë shpallur këto libra si literaturë ekstremiste, si rezultat i asaj që ka qenë e ndaluar botimi dhe shpërndarja e tyre, ndërsa kopjet që nuk janë distribuar është dashur të konfiskohen.

Ankesa deri te Gjykata nga ana e ankuesit

Ankuesit janë ankuar në shkeljen e nenit 10 (lirisë së shprehjes) duke marrë parasysh nenin 9 (lirinë e besimit).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes së ankuesve, ka pasur bazë të vlefshme juridike në legjislacionin juridik. Sidoqoftë, Gjykata ka vërejtur se Komisioni i Venedikut e ka shprehur mendimin e vet se përkufizimi i shprehur me legjislaturën vendore për “aktivitetin ekstremist” ka qenë tepër përfshirës dhe jopreciz, për këtë arsye Gjykata e ka lënë të hapur çështjen për atë nëse ndërhyrja ka qenë e përcaktuar me ligj.

Gjykata ka vërejtur se gjatë sjelljes së aktgjykim-it që libri në fjalë ka përmbajtur pikëpamje ekstremiste, gjykata vendore nuk ka bërë vlerësim

të pavarur të tekstit, por është bazuar në mendimin e kontestuar profesional, që në fakt ka përmbajtur njohuri juridike për natyrën ekstremiste të librit. Gjykata ka vërejtur se gjykata vendore nuk ka diskutuar për domosdoshmërinë e ndalesës së librave, kontekstin në të cilin janë publikuar, natyrën dhe tekstin e tyre, e as për pasojat e dëmshme potenciale.

Njëkohësisht, Gjykata ka theksuar se megjithëse gjykata vendore dhe autoritetet nuk kanë vërejtur kurrfarë rrethanash që do të potenconin natyrën e ndjeshme të kontekstit në periudhën relevante kohore kundër shprehjeve në libra të cilat potencialisht mund të shkaktojnë konflikt serioz ndërfetar ose të shkaktojnë pasoja të dëmshme.

Gjykata gjithashtu ka vërejtur se nuk është dëshmuar se shprehjet mund të nxisin dhunë, urrejtje ose mostolerancë. Sipas kësaj, Gjykata ka konkluduar se gjykatat vendore nuk i kanë zbatuar standardet që kanë qenë në pajtim me parimet e nenit 10 dhe nuk kanë arritur të sigurojnë motive relevante ose të mjaftueshme për ndërhyrjen, duke konstatuar njëzëri se ka pasur shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Ky rast shërben si shembull i cili dëshmon se shkallë e caktuar e margjinës së vlerësimit është në dispozicion të shteteve që janë palë kontraktuese të Konventës, ku liria e shprehjes prek çështjet që mund t'i ofendojnë bindjet personale, veçanërisht në aspekt të religjionit. Pikërisht si rezultat i mungesës së konsensusit evropian për nivelin e mjaftueshëm të mbrojtjes së të drejtave të tjerëve në lidhje me bindjet fetare, vepra mund të jetë vepër e rëndë penale lidhur me bindjet fetare të një personi, dhe mund të dallohet shteti nga shteti tjetër që është palë kontraktuese e Konventës.¹⁹

Si rezultat i doktrinës së margjinës së vlerësimit, roli i Gjykatës është i kufizuar në shqyrtimin e masave vendore sipas nenit 10. Kjo nënkupton shqyrtimin e rastit si tërësi nga ana e Gjykatës, duke u fokusuar me proporcionalitetin e masës e cila është e zbatuar nga autoritetet vendore, veçanërisht nëse masat kanë qenë relevante

dhe të mjaftueshme. Kjo analizë paraqet shqyrtim nga ana e Gjykatës nëse masat vendore janë në pajtim me parimet e nenit 10.

Ibrahim Ibrahimov dhe të tjerë kundër Ruisë e zgjeron lirinë e shprehjes dhe e tregon kontrollin e rreptë që e zbaton Gjykata për të konstatuar nëse ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes, është bërë duke synuar qëllimin legjitim me motive të mjaftueshme dhe relevante. Në këtë rast, fakti se gjykatat vendore nuk kanë zbatuar vlerësim të pavarur, duke u bazuar plotësisht në konstatimet (përfshirë edhe konstatimet juridike) nga mendimi profesional, nuk përbën vlerësim të mjaftueshëm dhe adekuat.

Tagijev dhe Husejnov kundër Azerbejxhanit (Kërkesa ankimore nr. 13274/08) e 5 dhjetorit 2019

Shënim për procedurën:

Ankuesit (g.Tagijev dhe g.Husejnov), shtetas të Azerbejxhanit, kishin parashtruar ankesë kundër Azerbejxhanit në Gjykatën Evropiane të Të Drejtave të Njeriut më datë 7 mars të vitit 2008. Në vitin 2011, ndërsa lënda është udhëhequr në gjykatën e Strasburgut, ankuesi i parë është vrarë me thikë, për këtë arsye Gjykata ka pranuar që bashkëshortja e tij të vazhdojë me ankesën si ankuese.

Rezyme e fakteve:

Ankuesit kanë qenë një shkrimtar dhe redaktor kryesor dhe përgjegjës i një gazete, që ishin dënuar me burgim prej 3 dhe 4 vitesh, në mënyrë përkatëse, për publikimin e një artikulli (të titulluar “Evropa dhe ne”), në të cilën kritikohet islami, më 1 nëntor të vitit 2006 në gazetën “Sanat Gazetti”.

Artikulli ka marrë kritika të ashpra nga personalitete dhe organizata fetare të Azerbejxhanit dhe Iranit, për shkak të krahasimeve në mes të traditave lindore dhe perëndimore dhe fjalëve negative ndaj islamit. Në nëntor të vitit 2006, prokurorët publikë kanë iniciuar procedurë penale kundër ankuesve për nxitjen e urrejtjes fetare dhe armiqësisë, që janë bërë publikisht ose nëpërmjet medimeve masive. Pas

¹⁹ Ibragim Ibragimov dhe të tjerë kundër Ruisë, kërkesa ankimore nr. 1413/08 28621/11, § 95.

dënimeve adekuate, ankuesit kishin parashtruar ankesa kundër aktgjyqimeve të tyre në bazë të shkeljes së nenit 10 të KEDNJ-së, por Gjykata e Apelit i ka konfirmuar aktgjyqimet pa i marrë parasysh shkeljet e mundshme të së drejtës së lirisë së shprehjes.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatësit

Ankuesit janë ankuar për shkeljen e së drejtës së tyre të lirisë së shprehjes (neni 10).

Vendimi i Gjykatës

Pas shqyrtimit të rastit, Gjykata e Strasburgut ka konkluduar se aktgjyqimet penale të shqiptuara për ndërhyrjen në të drejtën e tyre të lirisë së shprehjes, por se kjo ndërhyrje është përcaktuar me ligj dhe synon një qëllim legjitim “mbrojtjen e të drejtave të tjerëve” dhe “parandalimit të parregullsive”. Mirëpo, Gjykata ka konstatuar megjithëse artikulli në fjalë përmban vërejtje që kanë të bëjnë me islamin dhe implikimet e tij shoqërore dhe filozofike, kryesisht kanë bërë krahasim ndërmjet vlerave perëndimore dhe lindore i ka shprehur idetë e autorit. Në këtë aspekt, Gjykata ka vërejtur se artikulli nuk duhet të rishqyrtohet vetëm në kontekst të bindjeve fetare, por edhe në kontekst të debatit që ka qenë çështje me interes publik meqë ka pasur lidhje me rolin e religjionit në shoqëri dhe në zhvillimin e shoqërisë.

Gjykata është pajtuar me analizën e gjykatës vendore se vërejtje të caktuara që janë dhënë në artikull, veçanërisht lidhur me profetin Muhamed dhe myslimanët që jetojnë në Evropë, nga ana e disa personave konsiderohen si sulm ofendues ndaj profetit dhe myslimanëve dhe si të tilla mund të shkaktojnë urrejtje fetare. Mirëpo, Gjykata ka vërejtur se gjykatat vendore nuk kanë dhënë sqarime megjithëse vërejtjet konkrete në fjalë paraqesin nxitje të urrejtjes fetare dhe armiqësisë.

Konkretisht, gjykata ka konsideruar se është e papranueshme që gjykatat vendore vetëm t'i përsërisin konkluzionet e raportit të mjekësisë ligjore, që ka përmbajtur shumë më tepër se sa zgjidhje të thjeshta të çështjeve gjuhësore dhe fetare, përfshirë edhe analizën e karakteristikave juridike për vërejtjet në fjalë. Gjykata ka vërejtur se edhe gjykatat vendore nuk e kanë marrë parasysh kontekstin e rastit, inter-

esin publik, si dhe qëllimin e autorit që mund ta arsyetojë provokimin ose teprimin deri në një shkallë të caktuar. Gjykata ka vërejtur se gjykatat vendore madje as që kanë tentuar të baraspeshojnë të drejtën e ankuesve për lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e së drejtës së personave fetarë që të mos ofendohen në bazë të besimeve të tyre.

Gjithashtu, Gjykata e ka vërejtur kapacitetin për ndikimin e shkaktimit të frikësimit mbi realizimin e lirisë së shprehjes së shtypit në Azerbajxhan. Së këndejmi, Gjykata njëzëri ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Ky rast e tregon ngushtimin e përfshirjes së margjinës së vlerësimit të organeve kompetente vendore kur vendimi i tyre ndikon negativisht në lirinë e shtypit ose kur liria e shprehjes ka të bëjë me tema të interesit publik. Në këtë rast, artikujt e kontestuar nuk kanë të bëjnë vetëm me çështje fetare, por edhe kanë iniciuar çështje me interes publik, veçanërisht duke diskutuar për rolin e religjionit dhe shoqërisë, si dhe religjionit për zhvillimin e shoqërisë. Ankuesit janë dënuar me burgim për nxitjen e urrejtjes fetare për shkak të një shkrimi në të cilin kritikohet islami dhe që i përmban këto elemente: “Morali në islam është një akt mashtrues....Në krahasim me Jezu Krishtin...profeti Muhamed thjesht është një krijesë tmerruese.” Gjykata nuk ka parë asgjë në deklaratat e kontestuar që bën thirrje në zbatimin e nenit 17 dhe ka konstatuar se dënimi i ankuesve është shkelje e nenit 10.

Vendimet e gjykatave vendore nuk kanë dhënë sqarim pse vërejtjet konkrete që i përmban shkrimi paraqesin nxitje të urrejtjes fetare dhe armiqësisë. Ata vetëm se i kanë përsëritur konkluzionet e raportit të të mjekësisë ligjore që “përmban qartazi shumë më tepër se sa zgjidhje të thjeshta të çështjeve gjuhësore dhe fetare - siç janë, për shembull, definimi i rëndësisë së fjalëve dhe shprehjeve të caktuara ose rëndësisë së tyre fetare - dhe në esencë i ka përcaktuar karakteristikat juridike të vërejtjeve të kontestuara. Gjykata ka përcaktuar se ajo situatë është e papranueshme dhe ka potencuar se vetëm gjykatat duhet doemos t'i zgjidhin

të gjitha çështjet juridike.²⁰ Edhe gjykatat vendore nuk kanë shqyrtuar nëse konteksti i rastit, për interesin dhe qëllimin publik të autorit në raport me artikullin e kontestuar e kanë arsyetuar përdorimin e mundshëm të një shkalle të caktuar të provokimit ose teprimit. Njëkohësisht, gjykatat vendore në vendimet e tyre madje edhe nuk kanë tentuar për të baraspeshuar të drejtën e ankuesve për lirinë e shprehjes me mbrojtjen e të drejtës së personave fetarë, që të mos ofendohen në bazë të besimeve të tyre. Gjithashtu, “rrethanat e këtij rasti nuk kanë zbuluar kurrfarë arsytimi për imponimin e sanksioneve të këtilla të rrepta, që mund të shkaktojnë ndikim tmerrues mbi realizimin e lirisë së shprehjes në Azerbajxhan dhe të ndalin shtypin për diskutim të hapur lidhur me çështjet e religjionit, rolit të tij në shoqëri ose çështje tjera me interes publik”.²¹ Për këtë arsye, dënimi penal i ankuesve ka qenë joproporcional me qëllimet e synuara dhe konform kësaj, dënimi i këtillë nuk është “i domosdoshëm në një shoqëri demokratike”. Gjykata e ka përsëritur kërkesën e përgjithshme për të siguruar respektimin e qetë të të drejtave që janë të garantuara me nenin 9 për personat me bindje të tilla, përfshirë edhe detyrën, më së shumti mund të shmangen shprehje që janë blasfemi dhe me ofendime të panevojshme për të tjerët, në raport me objektet e shenjta që respektohen. Kështu, gjykata ka potencuar se shprehjet me të cilët tentohet të nxitet ose arsyetohet urrejtja në bazë të mostolerancës, përfshirë edhe mostolerancën fetare nuk e gëzojnë mbrojtjen që e jep neni 10 i Konventës. Rasti tregon se Gjykata në veçanti do të marrë parasysh kontekstin specifik të rastit, qëllimet precize të autorit, si dhe interesin publik për përhapje të deklaratave të kontestuara (dhe nëse ato kontribuojnë për debat me interes publik). Elementet e tilla mund të arsyetojnë një shkallë të caktuar të provokimit ose teprimit. Si i tillë, ky rast është në dobi të qëndrimit se atje ku deklarata është me interes publik ose kur bëhet fjalë për lirinë e shtypit, Gjykata do të lejojë kufizimin e lirisë së shprehjes vetëm në raste të rrepta dhe vetëm kur ajo ndërhyrje është plotësisht e arsyeshme.

20 Ibid, § 47.

21 Ibid, § 49.

Fjalimi politik

IV.

Gjykata gjithmonë i ka dhënë rëndësi të veçantë faktit se publikimi i informatave, dokumenteve ose fotografive në shtypin shërben për interesin publik dhe kontribuon për debat me interes të përgjithshëm. Interesi i tillë mund të vendoset vetëm si rezultat i rrethanave. Në këtë aspekt, Gjykata në mënyrë konsistente ka konsideruar se janë të vogla mundësitë për kufizimin e fjalimeve politike ose për debat për çështje me interes publik. Sipas mendimit të Gjykatës, interesi publik zakonisht ka të bëjë me çështje që e tangojnë publikun deri në atë shkallë që të ketë legjitimitet të interesohet për ta, që e tërheqin vëmendjen e tyre ose që dukshëm e tangojnë, veçanërisht për shkak se ato ndikojnë në mirëqenien e qytetarëve ose jetës në shoqëri. Kjo gjithashtu ka të bëjë edhe me çështjet që mund të shkaktojnë kundërtënie të konsiderueshme, që kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme shoqërore ose që përfshijnë problem për të cilin publiku dëshiron të informohet.²² Liria e shprehjes paraqet një prej bazave më të rëndësishme esenciale të çdo shoqërie demokratike dhe një prej kushteve themelore për përparim dhe vetëplotësimin e secilit individ. Bazohet edhe paragrafit 2 nga neni 10 dhe zbatohet jo vetëm për “informata” ose “ide” të cilat janë të pranuar ose konsiderohen si të pranuar që nuk ofendojnë ose për çështje të pajtimit, por edhe ato që ofendojnë, shokojnë ose shqetësojnë.²³

Megjithatë, pavarësisht se kush i realizon të drejtat dhe liritë e përcaktuara, ai person ndërmerr edhe “obligime dhe përgjegjësi”. Mes tyre, në kontekst të debatit publik, është legjitime të përfshihet edhe obligimi për të shmangur sa më tepër shprehje që janë të panevojshme dhe ofenduese për të tjerët, dhe me këtë i lëndojnë të drejtat e tyre, për këtë edhe kontribuojnë për çfarëdo forme të debatit publik të mund

të mundësojnë një përparim të mëtejshëm të raporteve njerëzore. Krahas kësaj, një margjinë e caktuar e vlerësimit është në përgjithësi e disponueshme edhe për shtetet që janë palë kontraktuese të Konventës, kur e rregullojnë lirinë e shprehjes lidhur me çështjet që mund t'i ofendojnë bindjet private personale në sferën e moralit. Hetimi nëse ndërhyrja për të cilën ankohet ankuesi ka qenë “e domosdoshme në shoqëritë demokratike” kërkon që Gjykata të konstatojë nëse ajo ka përkuar me “nevojë të domosdoshme shoqërore”, nëse ka qenë proporcionale me qëllimin e synuar legjitim dhe nëse arsyet të cilat autoritetet kombëtare i theksojnë si arsyetim, janë relevante dhe të mjaftueshme.²⁴ Gjatë vlerësimit nëse ekziston “nevojë” e tillë dhe se çfarë masa menaxhuese duhet të ndërmerren, autoriteteve kombëtare u mbetet margjinë e caktuar rëndësisë vlerësimit. Sidoqoftë, kjo fuqi e vlerësimit nuk është e kufizuar, por shkon dorë për dorë me mbikëqyrjen evropiane nga ana e Gjykatës, që ka për detyrë të miratojë vendim final për atë nëse kufizimi është i harmonizuar me lirinë e shprehjes siç është e mbrojtur me nenin 10.²⁵

Krahas kësaj, pa dyshim se shprehjet konkrete që përmbajnë gjuhë të urrejtjes, të cilat mund të jenë ofenduese për individë ose grupe të caktuara, nuk janë të mbrojtura me nenin 10 të Konventës.²⁶

22 Udhërrëfyes për nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Liria e shprehjes, azhurnimi i fundit më 31.12.2020, fq. 30, §130.

23 Hendisajd kundër Mbretërisë së Bashkuar, e 7 dhjetorit 1976, Seria A nr. 24, fq. 23, § 49.

24 The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar (Kërkesa ankimore nr. 1), e 26 prillit 1979, Seria A nr. 30, fq. 38, § 62.

25 Nilsen dhe Xhonsen kundër Norvegjisë [Këshilli i Madh Gjyqësor], nr. 23118/93, § 43, KEDNJ 1999-VIII.

26 Në aspekt të fjalimit të urrejtjes dhe zmadhimit të dhunës, shikoni mutatis mutandis, Surek kundër Turqisë (Kërkesë ankimore nr. 1) [Këshilli i Madh Gjyqësor], nr. 26682/95, § 62, KEDNJ 1999-IV.

Gunduz kundër Turqisë, (Kërkesa ankimore nr. 35071/97) e 4 dhjetorit 2003

Shënim për procedurën:

Ankuesi (z. Gunduz) është shtetas turk që ka parashtruar kërkesë ankimore në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut më datë 21 janar të vitit 1997, për të cilën Gjykata ka mbajtur diskutim të mbyllur më datë 13 nëntor të vitit 2003.

Rezime e fakteve:

Ankuesi ka qenë udhëheqës i një sektit radikal islam (Tarikar Aczmendi) që ka marrë pjesë në një program televiziv (Ceviz Kabugu), me qëllim për ta prezantuar sektin dhe idetë e saj para publikut në kuadër të një diskutimi ku kishte edhe pjesëmarrës tjerë. Ankuesi në mënyrë të detajuar i ka theksuar qëndrimet e tij për temat siç janë veshja fetare, religjioni, sekularizmi dhe demokracia në Turqi, por edhe për Islamin. Ankuesi ka dhënë deklarata kritike për demokracinë dhe haptazi kishte bërë thirrje për ligjin e sheriatit. Në vitin 1995 është parashtruar akuzë kundër ankuesit dhe prokurori publik ka iniciuar procedurë penale kundër tij me arsyetimin se fjalori i ankuesit gjatë programit i ka nxitur njerëzit për urrejtje dhe armiqësi. Ankuesi është dënuar nga gjykata e sigurisë me dënim me burg në kohëzgjatje prej dy vitesh dhe i është urdhëruar të paguajë dënim në para. Gjykata e Kasacionit e ka konfirmuar këtë aktgjykim.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkeljen e të drejtës së tij të shprehjes në pajtim me nenin 10.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se nuk ka pasur kontest në lidhur me ndërhyrjen në të drejtën e ankuesit për lirinë e shprehjes nëse ajo është përcaktuar me ligj e as nëse është realizuar për qëllim legjitim (ndalimi i anarkisë, krimin, mbrojtja e moralit dhe mbrojtja e të drejtave të të tjerëve). Gjykata ka vërejtur se programi prezanton një sekt dhe fokusohet në rolin e religjionit në shoqërinë demokratike, për të cilën Gjykata ka theksuar se është çështje me interes pub-

lik, dhe se kufizimi i këtillë i lirisë së shprehjes në këtë drejtim duhet që të kontrollohet rreptë. Gjykata ka vlerësuar se deklaratat e ankuesit që i përshkruajnë institucionet bashkëkohore sekulare si “të padëgjueshme” nuk mund të konsiderohen si thirrje për dhunë ose formë e gjuhës së urrejtjes në bazë të mostolerancës fetare. Gjykata ka vlerësuar se programi është realizuar drejtpërdrejt, duke i pamundësuar ankuesit ta riformulojë deklaratën ose të tërheqë nga përdorimi disa terma të caktuar. Gjykata gjithashtu ka vërejtur natyrën interesante të diskutimit, të cilës Gjykatat vendore nuk i kanë dhënë rëndësi adekuate. Gjykata ka bërë dallim në aspekt të deklaratave të dhëna për Sheriatin, në këtë rast dhe praktikës së mëparshme gjyqësore. Gjykata ka përsëritur se deklaratat për propagimin, nxitjen ose arsyetimin e urrejtjes në bazë të mostolerancës nuk janë pjesë e mbrojtjes së nenit 10.

Sidoqoftë, Gjykata ka vërejtur se vetëm mbrojtja e sheriatit, pa bërë thirrje dhune për të aritur atë, mund të konsiderohet si formë e gjuhës së urrejtjes. Gjykata i ka kushtuar vëmendje të posaçme kontekstit në të cilin janë dhënë vërejtjet, veçanërisht qëllimit të programit për të prezantuar sektin dhe qëndrimin ekstremist të liderit të tyre, që janë balancuar me intervenimin e pjesëmarrësve tjerë. Kështu, Gjykata ka konstatuar se ndërhyrja nuk ka pasur bazë të mjaftueshme dhe ka miratuar konkluzion me gjashtë vota kundrejt një vote, se ka pasur shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Ky rast e tregon kontrollin e rreptë që e zbaton GJEDNJ-ja kur ndërhyrja në lirinë e shprehjes ka të bëjë me lirinë e shtypit dhe lirinë e shpërndarjes dhe përhapjes së informatave. “Rasti karakterizohet, konkretisht edhe me faktin se ankuesi është dënuar për deklaratat që gjykatat vendore i kanë klasifikuar si “gjuhë të urrejtjes”. Duke marrë parasysh instrumentet relevante ndërkombëtare dhe praktikën e vet gjyqësore, Gjykata në veçanti potencoi se toleranca dhe respektimi i dinjitetit të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike, pluraliste. Sipas kësaj, në parim mund të konsiderohet se në shoqëri të caktuara demokratike është e domosdoshme të sanksionohen ose madje edhe të pengohen të gjitha format e shprehjes që

përhapin, nxisin, promovojnë ose arsyetojnë urrejtje në bazë të mostolerancës, me kusht që çfarëdo “formalitete”, “kushte”, “kufizime” ose “dënime” të shqiptuara ose të aplikuara, të cilat na imponohen, duhet të jenë proporcionale me qëllimin e dëshiruar legjitim.”²⁷

Është interesante të potencohet se gjatë konstatimit nëse kufizimi i lirisë së shprehjes ka qenë e arsyeshme, shumica është bazuar në kontekstin konkret të rastit, qëllimin e programit, forumin ku është shprehur deklarata e kontestuar, si dhe interesin publik kur lejohet përhapja e ideve. Së këndejmi, Gjykata i ka kushtuar vëmendje të veçantë faktit se nuk ka pasur nxitje të drejtpërdrejtë ose të qartë të urrejtjes ose thirrjes për dhunë, sipas deklaratës së ankuesit dhe se qëndrimet ekstremiste të ankuesit ishin baraspeshuar me deklaratat dhe qëndrimet e pjesëmarrësve tjerë. Në kundërshtim me këtë, mendimi i kundërt i gjykatësit në masë të madhe është bazuar me përmbajtjen e porosisë së ankuesit dhe implikimet kulturore, duke marrë parasysh se deklaratat kanë qenë gjuhë e urrejtjes.

Sugjerohet në faktin se rasti është shembull i cili e dëshmon kontrollin më të rreptë që e zbaton Gjykata gjatë ndërhyrjes në format e lirisë së shprehjes, kur mund të kontribuojnë për një debat me interes publik, ose përhapjen e informatave në publik.

***Faruk Temell kundër Turqisë,
(Kërkesa ankimore nr. 16853/05) e 1
shkurtit 2011***

Shënim për procedurën:

Ankuesi (z. Faruk), shtetas turk, ka parashtruar ankesë kundër Republikës së Turqisë më datë 16 prill të vitit 2005, që është shqyrtuar nga Këshilli më datë 11 janar të vitit 2011.

Rezime e fakteve:

Ankuesi ka qenë kryetar i seksionit rinor provincial HADEP (Partia Demokratike Popullore), parti politike lokale, ku gjatë një konference partiake është deklaruar lidhur me problemin kurd dhe nevojën për një zgjidhje demokratike. Në deklaratat e ankuesit ai kishte protestuar kundër intervenimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Irak dhe burgimit të Abdulla Oxhallan. Ankuesi është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 10 muajsh dhe me dënim në para, me arsyetimin se e ka lartësuar dhunën dhe aktivitetet terroriste.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkeljen e së drejtës së tij të lirisë së shprehjes (neni 10) si rezultat i aktgjykimit për shkak të deklaratës së dhënë. Ankuesi gjithashtu është ankuar për shkeljen e nenit 6 paragrafi 1 (e drejta e gjykimit të drejtë) sepse nuk i është lejuar ndihma e avokatit gjatë fazës hetimore.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se gjykatat vendore kanë interpretuar disa pjesë të deklaratave të ankuesit pa i marrë parasysh si një tërësi. Gjykata ka konkluduar se gjykatat vendore nuk e kanë shqyrtuar deklaratën e plotë dhe nuk u kanë kushtuar vëmendje kushteve të deklaratës si tërësi, e as kualitetit ose personalitetit të ankuesit. Gjithashtu, Gjykata ka vërejtur se gjykata vendore nuk e ka shqyrtuar vendin dhe kontekstin në të cilin është dhënë deklarata, e as adresat e porosisë. Si rezultat, Gjykata nuk mund të pajtohet me vlerësimin e gjykatës vendore. Gjykata ka vërejtur se deklarata e ankuesit nuk ka nxitur dhunë e as që ka mundur të konsiderohet se përbën gjuhë të urrejtjes. Gjykata në veçanti ka vërejtur se kur deklarata do të lexohet si tërësi, nuk mund të konsiderohet si nxitje për aplikimin e dhunës ose rezistencës së armatosur. Së këndejmi, Gjykata ka konkluduar se aktgjykimi i ankuesit nuk është parashtruar për të synuar “nevojë të domosdoshme sociale” dhe si e tillë paraqet shkelje e nenit 10. Gjykata ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1.

27 Gunduz kundër Turqisë (Kërkesë ankimore nr. 35071/97), aktgjykim i 4 dhjetorit 2003, § 40.

Koment për vendimin

Ky rast paraqet argument për kontrollin e rreptë të ndërhyrjes në të drejtën e lirisë së shprehjes në kontekst të diskutimeve dhe debateve politike. Gjegjësisht, Gjykata ka kryer kontroll të rreptë të vlerësimit që e kanë bërë gjykatat vendore, veçanërisht duke marrë parasysh faktin nëse gjykatat vendore i kanë shqyrtuar të gjithë faktorët relevantë. Gjykata i ka kushtuar vëmendje të posaçme edhe faktit se në rastin konkret deklarata e ankuesit nuk paraqet nxitje për dhunë ose urrejtje dhe si e tillë nuk ka qenë gjuhë e urrejtjes. Deri në këtë shkallë, ky rast e zgjeron lirinë e shprehjes dhe e potencon kontrollin e rreptë që e shfrytëzon Gjykata, kur ndërhyrja bëhet ndaj një fjalimi politik.

Alltëntash kundër Turqisë, (Kërkesa ankimore nr. 50495/08) e 10 marsit 2020

Shënim për procedurën:

Ankuesi është shtetas turk (z. Xhihan Alltëntash) i cili ka parashtruar ankesë kundër Republikës së Turqisë më datë 10 tetor të vitit 2008 para GJEDNJ-së. Gjykata ka debatuar më datë 4 shkurt të vitit 2020.

Rezime e fakteve:

Ankuesi ka qenë redaktor i një gazete mujore (Tokat Demokrat). Në vitin 2007 ankuesi ka publikuar një artikull me titull “M. dhe miqtë e tij janë ende idhuj të gjallë të rinisë”. Shkrimi ka qenë lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur në mars të vitit 1972, kur anëtarë të dy organizatave ilegale kishin marrë peng tre shtetas britanikë që punonin në bazën ushtarake të NATO-s në Turqi. Pengjet ishin dërguar në një shtëpi ku ishin të vendosur edhe anëtarë të tjerë të organizatës. Pas rrethimit policor të kësaj shtëpie, kidnapuesit kishin refuzuar të dorëzohen duke shkëmbyer zjarr me policinë para se t’i vrisnin edhe pengjet, ku të gjithë kryengritësit përpos njërit ishin vrarë gjatë luftimeve.

Në artikullin e vitit 2007, kryengritësit ishin përshkruar si “idhuj” të cilët ishin “masakruar”. Pas publikimit të artikullit, ankuesi ishte

akuzuar për vepër penale lartësim të veprave penale ose kriminelëve, për çka edhe është dënuar dhe është urdhëruar të paguajë dënim gjyqësor prej 430 eurosh.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi ishte ankuar për shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (e drejta për qasje në gjykatë) meqë nuk ka pasur mundësi të parashtrojë ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Ankuesi gjithashtu është ankuar për shkeljen e nenit 10 (liria e shprehjes).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se aktgjykimi penal që i është shqiptuar ankuesit njeka përbërë ndërhyrje në të drejtën e tij të lirisë së shprehjes dhe se kjo ndërhyrje është bërë për qëllime legjitime (mbrojtje të sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike, ruajtja e integritetit territorial dhe parandalimi i krimit). Gjykata gjithashtu ka pranuar se artikulli është publikuar në një kontekst veçanërisht tensionues shoqëror, duke marrë parasysh ndjeshmërinë e popullatës në raport me ngjarjet në fjalë, sidomos duke marrë parasysh faktin se artikulli është publikuar në rajonin ku ka ndodhur incidenti para 35 vitesh.

Gjykata e ka theksuar edhe miratimin në fjalë të veprimeve të dhunshme, që janë bërë nga individë, duke i prezantuar si veprime heroike, ku janë përdorur shprehje si “revolucionarë të rinj” dhe “idhuj të rinisë”, e më pas duke e përshkruar vdekjen e tyre gjatë konfliktit të armatosur me policinë, nëpërmjet nocioneve si për shembull “të masakruar”. Kështu, Gjykata ka vërejtur se artikulli mund të konsiderohet si lartësim ose, më së paku, arsyetim i një dhune që ka ndodhur gjatë ngjarjeve konkrete. Së këndejmi, Gjykata me shumicë ka konkluduar se duke marrë parasysh margjinën e vlerësimit që u është dhënë organeve kombëtare kompetente dhe peshën e dënimit të shqiptuar ndaj ankuesit, Gjykata ka konstatuar se ndërhyrja nuk mund të konsiderohet si i papërputhshëm me nenin 10 dhe se është proporcionale me qëllimin e përcaktuar legjitim. Gjykata gjithashtu ka konkluduar njëzëri se ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1 si rezultat i pamundësisë për ankesë ndaj një çështje juridike kundër vendimit të shkallës së parë.

Koment për vendimin

Ky rast e njeh margjinën e vlerësimit lidhur me ndërhyrjen në lirinë e shprehjes kur ajo është bërë për qëllime legjitime, veçanërisht kur kufizimet e tilla janë të arsyeshme për shkak të një konteksti të caktuar social ose një ndjeshmërie historike si në këtë rast.

Sugjerohet në atë se rasti është i rëndësishëm lidhur me atë se parashtruesit e kërkesës ankimore nuk do të mund të bazohen në mbrojtjen që e ofron neni 10, kur synojnë që ta promovojnë, lartësojnë ose arsyetojnë dhunën. Megjithatë, është interesante të përmendet se mendimi i ndarë i gjykatësit Bardsen, me të cilin është pajtuar edhe gjykatësi Pavli, insiston në rëndësinë e shumëllojshmërisë së ideve në një shoqëri demokratike, duke konsideruar se idetë ofenduese, shokuese ose shqetësuese, gjithashtu duhet të mbrohen me nenin 10. Mirëpo, mendimi i ndarë i kushton më pak vëmendje kontekstit, ndikimit të vendimit dhe qëllimit të autorit, në krahasim me aktgjykimin dhe mendimin e shumicës.

Dink kundër Turqisë, (Kërkesa ankimore nr. 2668/07, 6102/08, 30079/08, 7072/09, 7124/09) e 14 shtatorit 2010

Shënim për procedurën:

Ankuesit janë 6 shtetas turk, të cilët kishin parashtruar pesë kërkesa ankimore kundër Republikës së Turqisë më datë 11 janar të vitit 2007, të cilat janë shqyrtuar nga ana e Gjykatës më datë 6 korrik të vitit 2010

Rezime e fakteve:

Ankuesit janë gazetarë (ankuesi i parë) i cili tani ka vdekur dhe 5 familjarë të tij të afërt. Ankuesi i parë ka qenë drejtor i botimeve dhe redaktor përgjegjës dhe kryesor i gazetës javore turke-armene, i cili ka shkruar disa artikuj në vitet 2003 dhe 2004. Në këto artikuj ai i ka theksuar qëndrimet e veta për identitetin e shtetasve turq me prejardhje nga Armenia

(si dhe vetë ankuesi i parë), duke komentuar konkretisht se armenët kanë qenë të obsesionuar me statusin e tyre si viktime të gjenocidit, që është bërë "raison d'être" e tyre (shkak për ekzistimin), ndjenjë ndaj të cilës populli turk kishte reaguar me indiferencë dhe si e tillë, kjo është bërë çështje aktuale. Ai e ka krahasuar komponentin e identitetit me helm dhe kundërhelm, gjithashtu duke theksuar se gjaku ka qenë "i helmuar nga turku".

Nacionalistët ekstremë ashpër kanë reaguar ndaj këtyre artikujve, kishin organizuar demonstrata, kishin shkruar kërcënime dhe kishin parashtruar padi penale kundër ankuesit, ku si rezultat është parashtruar kallëzimi i parë kundër ankuesit, i cili është shpallur fajtor në vitin 2005 për nxirjen e identitetit turk dhe është dënuar me dënim me burg. Gjykata e Kasacionit e ka konfirmuar dënimin, ndërsa në vitin 2007 Gjykata Penale ku ishte dërguar procedura e kishte ndërprerë atë, për shkak të vdekjes së ankuesit si rezultat i një atentati.

Më vonë ishin realizuar hetime për të konstatuar nëse xhandarmeria lokale dhe departamentet policore e kanë ditur për konspiracionin e atentatit dhe nuk kanë qenë të kujdesshëm kishin marrë pasa, por pothuajse të gjithë procedurat e tilla ishin ndërprerë.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesit janë ankuar për shkelje të nenit 2 (e drejta e jetës) dhe shkelje të nenit 10.

Vendimi i Gjykatës

Lidhur me nenin 2, Gjykata ka vërejtur se me të drejtë mund të konsiderohet se forcat e sigurisë kanë qenë të vetëdijshe për qëndrimin e shprehur armiqësor të qarqeve ekstreme nacionaliste ndaj ankuesit, veçanërisht nëpërmjet reagimeve të fuqishme kundër artikullit. Krahas kësaj, duke marrë parasysh se dy departamente policore dhe një departament i xhandarmerisë në atë kohë kishin qenë të informuar për mundësinë e tentimit për atentat, si dhe për identitetin e nxitësve të supozuar, e që kërcënimi për atentat ka qenë real dhe i drejtpërdrejtë. Gjykata ka konsideruar se autoritetet vendore është dashur të veprojnë konkretisht, sepse nuk e kanë bërë atë, Gjykata ka konstatuar se nuk janë ndërmarrë masa në dispozicion

për të penguar rrezik real dhe të drejtpërdrejtë ndaj jetës së ankuesit të parë.

Lidhur me nenin 10, Gjykata konsideroi se aktgjykimi i Gjykatës së Kasacionit për konfirmim të dënimit të ankuesit të parë për nxirjen e identitetit turk, kishte qenë ndërhyrje në realizimin e të drejtës së tij të lirisë së shprehjes. Gjykata ka vërejtur se Gjykata e Kasacionit e ka interpretuar konceptin për identitetin turk, kështu që në mënyrë indirekte e ka dënuar ankuesin e parë për kritikën ndaj mohimit të gjenocidit nga ana e institucioneve shtetërore. Gjykata njëkohësisht ka vërejtur një sërë artikujsh si tërësi nuk nxisin dhunë, rezistencë ose kryengritje. Gjykata ka vërejtur se ankuesi i parë i ka transmetuar idetë dhe mendimet e tij për çështje të interesit publik. Në këtë aspekt, Gjykata e ka vërejtur natyrën me rëndësi të veçantë të debateve lidhur me ngjarjet historike të natyrës së rëndë. Më tutje, Gjykata ka përsëritur se neni 10 nuk lejon kufizimin e natyrës së shprehjes në sferën e debateve politike për çështje me interes publik dhe e ka përsëritur edhe natyrën më të gjerë të kufijve të kritikës së lejuar në raport me pushtetin. Së këndejmi, Gjykata ka konstatuar se aktgjykimi i ankuesit të parë nuk ka qenë në drejtim të nevojës së domosdoshme shoqërore. Gjykata ka vendosur se shtetet kanë obligim pozitiv lidhur me të drejtën e lirisë së shprehjes, me qëndrimin se shtetet duhet të krijojnë ambient të volitshëm që të gjithë të mund të marrin pjesë në debatin publik dhe të shprehin mendimet dhe idetë e tij pa u frikësuar. Në rastin konkret, shteti nuk i ka plotësuar obligimet pozitive lidhur me të drejtën e lirisë së shprehjes së ankuesit të parë. Së këndejmi, Gjykata njëzëri ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Sugjerohet në atë se ky rast e zgjeron lirinë e shprehjes. Me të vërtetë rasti është një presedan në raport me faktin se neni 10 u imponon shteteve obligim pozitiv për të krijuar një ambient të volitshëm ku njerëzit mund të marrin pjesë në debate publike dhe t'i shprehin mendimet dhe idetë e tyre pa u frikuar nga pasojat e mundshme. Kjo në veçanti është e rëndësishme në një shoqëri demokratike me qëllim për të siguruar se mund të shprehen mendimet e ndryshme dhe se mundet të ketë debat publik.

Faber kundër Hungarisë, (Kërkesa ankimore nr. 40721/08) e 24 korrikut 2012

Shënim për procedurën:

Ankuesi është shtetas hungarez i cili ka parashtruar kërkesë ankimore kundër Hungarisë, e parashtruar më datë 12 gusht të vitit 2008, për të cilën Gjykata ka mbajtur seancë të mbyllur më datë 26 qershor të vitit 2012.

Rezime e fakteve:

Kërkesa e ankesës ka qenë për rastet që kishin ndodhur gjatë demonstratave të vitit 2007 të realizuara nga Partia Socialiste e Hungarisë (MSZP) për të protestuar kundër racizmit dhe urrejtjes, ku njëkohësisht edhe anëtarët e partisë së djathtë politike ishin mbledhur në një rajon të afërt për të shprehur pakënaqësinë e tyre. Ankuesi kishte mbajtur në dorë një flamur të ashtuquajtur me lenta Arpad, që mund të konsiderohet si simbol historik dhe simbol i një regjimi të kaluar. Policia që e monitoronte protestën kishte kërkuar nga ankuesi që ta largojë transparentin ose të largohet. Pas refuzimit të ankuesit, ai ishte arrestuar dhe dënuar me përafërsisht 200 euro.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkeljen e të drejtës së tij të lirisë së shprehjes në pajtim me nenin 10 duke e marrë parasysh nenin 11 (liria e mbledhjes paqësore).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se e drejta e lirisë së shprehjes së ankuesit dhe kërkesa e tij për lirinë e mbledhjes paqësore doemos duhet të baraspeshohet me të drejtën e demonstruesve për mbrojtje nga cenimi i mbledhjes së tyre. Si rezultat i kësaj, organet kombëtare kanë pasur një diskrecion të gjerë, me ç'rast edhe organet vendore kanë pasur pozitën më të mirë që të përcaktojnë masën e domosdoshme për të aritur këtë baraspeshë, por gjithashtu edhe se shteti doemos duhet t'i përmbahet obligimit për neutralitet gjatë sigurimit të mbrojtjes së barabartë të të dy të drejtave. Mirëpo, Gjykata ka vërejtur se kundërdemonstruesit kanë pasur

të drejtë që të shprehin mospajtim me demonstruesit, dhe sipas kësaj, shteti kur ndërmerr masa, doemos duhet të plotësojë të drejtën e vet të obligimeve pozitive për mbrojtjen e së drejtës të mbledhjes për të dy grupet e demonstruesve.

Në rastin konkret, Gjykata ka vërejtur se ndërhyrja në të drejtën e ankuesit, ka pasur qëllime legjitime për ruajtjen e rendit publik dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Gjykata ka vërejtur se prania e transparentit me lentat Arpad nuk ka qenë ndonjë simbol me kërcënime të qarta, e as që ka paraqitur ndonjë rrezik të dhunës ose prishjen e demonstratave. Njëkohësisht, Gjykata ka vërejtur se as sjellja e ankuesit, e as sjellja e të tjerëve nuk ka qenë kërcënuese dhe ofenduese. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata ka konstatuar se motivet që i kanë shënuar organet vendore si arsyetim për ndërhyrjen nuk kanë qenë relevante e as të mjaftueshme.

Gjykata ka ripërsëritur se liria për të marrë pjesë në mbledhje paqësore, ka rëndësi fundamentale dhe nuk mund të kufizohet deri sa personi që e shpreh atë, nuk kryen veprime që meritojnë dënime. GJDNJ-ja ka potencuar se madje edhe nëse ndonjë deklaratë ose simbol i caktuar mund të konsiderohet si ofendues, shokues ose provokues, vetëm sepse janë shprehur aty, nuk mund të arsyetohet ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes, ku procedura e tillë nuk është tmerruese ose nuk mund të nxisë dhunë. Kështu, Gjykata ka konsideruar se paraqitja e flamurit nga ana e ankuesit ka qenë një formë e shprehjes së qëndrimeve politike të ankuesit.

Koment për vendimin

Ky rast e zgjeron lirinë e shprehjes dhe paraqet lëndë të rëndësishme lidhur me të drejtën e lirisë së shprehjes në pajtim me nenin 10 që përfshin vepra dhe deklarata që janë ofenduese, shokuese ose shqetësuese. Gjykata kryen një kontroll të rreptë kur konstatohet nëse gjykatat vendore nuk kanë motive të mjaftueshme dhe relevante për ndërhyrje në lirinë e shprehjes së ankuesit, duke përcaktuar se shprehjet e ankuesit nuk kanë qenë kërcënim ose rrezik direkt për dhunë. Fakti se shprehja e ankuesit ka shkaktuar ndjenja të shqetësimit të viktimat, nuk ka mjaftuar që vetvetiu ta kufizojë lirinë e shprehjes. Rasti është presedan për faktin se

deklarimet ose veprimet që shkaktojnë dhunë ose ndjenja të këqija, që nuk nxisin dhunë, urrejtje ose frikësim, janë të mbrojtura në pajtim me nenin 10. Aktgjykimi e tregon shkallën deri ku aplikimi i simboleve dhe emblemave lidhur me lëvizje politike ose subjekt politik, është pjesë e mbrojtjes nga neni 10 i Konventës. Natyra politike e kontekstit ku shfrytëzohen këto simbole kërkon një kontroll të rreptë për secilin kufizim të aplikimit të tillë të lirisë së shprehjes. Paralelisht me këtë, neni 11 (e drejta e lirisë së mbledhjes) i mbron edhe ato forma të demonstratave që mund t'i ofendojnë, shokojnë ose provokojnë individët që i kundërshtojnë idetë që i promovojnë ose i deklarojnë demonstruesit. Si e tillë, kjo e drejtë e lirisë së mbledhjes nuk mund të kufizohet, përveç nëse shfrytëzimi i tyre nuk pengon ndonjë të drejtë ose nxit dhunë ose shmang parimet fundamentale të një shoqërie demokratike.

Niks kundër Gjermanisë (Kërkesa ankimore nr. 35285/16) e 13 marsit 2018 (vendim për lejueshmëri)

Shënim për procedurën:

Ankuesi (Hans Bukhard Niks), shtetas gjerman, ka parashtruar kërkesë në GJEDNJ-në më datë 14 qershor të vitit 2016 kundër Gjermanisë. Gjykata ka debatuar më datë 13 mars të vitit 2018.

Rezyme e fakteve:

Ankuesi është bloger me seli në Gjermani, publikon blogje për çështje që kanë të bëjnë me ekonominë, politikën dhe shoqërinë. Ankuesi ka hartuar 6 publikime me të cilat është ankuar për bashkëveprim të supozuar racist dhe diskriminues të Agjencisë së Punësimit me vajzën e tij (me prejardhje gjermane-nepaleze) lidhur me zhvillimin e saj profesional. Gjatë publikimit të tij të tretë, ankuesi ka përfshirë deklaratë me fotografi për kryeshefin e mëparshëm të Eskadrilës së mbrojtjes (SS), Hajnrih Himler, me uniformë të eskadrilës dhe me shenjën e partisë naziste dhe lentës me kryqin e lakuar në krah. Afër kësaj fotografie kishte shënuar një citat nga Himleri lidhur me shkollimin e fëmijëve në Evropën Lindore. Në janar të vitit 2015 ishte iniciuar procedurë penale

kundër ankuesit, me çka gjykata vendore e kishte dënuar për veprën penale të shpifjes dhe shfrytëzimit të simboleve të organizatave antikushtetuese. Ankesa e ankuesit ishte hedhur poshtë.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkeljen e supozuar të së drejtës së lirisë së shprehjes (neni 10) si rezultat i gjykimit të tij.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se aktgjykimi ndaj ankuesit paraqet ndërhyrje në të drejtën e tij të lirisë së shprehjes, të përcaktuar me ligj dhe në drejtim të realizimit të qëllimit legjitim që të ndalohet anarkia.

Gjykata e shqyrtoi edhe kontekstin historik gjatë konstatimit nëse ndërhyrja është e domosdoshme në një shoqëri demokratike. Gjykata në veçanti e ka vërejtur mungesën e përgjegjësisë penale kur simbolet naziste janë shfrytëzuar për arsimin qytetar, për luftën kundër lëvizjeve antikushtetuese, për promovimin e artit ose shkencës, për hulumtime dhe mësim ose për shqyrtimin e ngjarjeve historike dhe aktuale ose qëllime të ngjashme. Gjykata gjithashtu ka vërejtur përjashtim nga përgjegjësia penale kur ka qenë i qartë kundërshtimi i ideologjisë që është prezantuar nëpërmjet simboleve. Gjykata ka pranuar se ankuesi nuk ka pasur qëllim të përhapë propagandë totalitare, të nxisë dhunë ose të shprehë gjuhë të urrejtjes dhe se deklaratat e tij nuk kanë shkaktuar frikësime. Mirëpo, Gjykata ka vërejtur mungesë të lidhjeve të qarta ndërmjet publikimit të kontestuar dhe publikimeve të mëparshme, e as që ka pasur dyshime për racizëm ose diskriminim në atë publikim konkret. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata ka konstatuar se gjykatat vendore nuk kanë qenë fajtores që e kanë shqyrtuar vetëm deklaratën e kontestuar dhe publikimin gjatë vlerësimit të përgjegjësisë penale të ankuesit. Legjislatura vendase kishte pasur për qëllim që të pengojë përdorimin e panevojshëm të simboleve të organizatave antikushtetuese. Në këtë aspekt, Gjykata ka konstatuar se gjykatat vendore kanë mbetur në margjinën e tyre të vlerësimit dhe se ndërhyrja në të drejtën e ankuesit sipas nenit 10 ka qenë proporcionale me qëllimin e dëshiruar legjitim dhe ka qenë i domosdoshëm në një shoqëri demokratike.

Koment për vendimin

Rasti e konfirmon rëndësinë e veçantë që mund t'i jepet një konteksti të caktuar historik ose një nevojë të domosdoshme shoqërore që mund të arsyetojë ndërhyrje me të drejtën e lirisë së shprehjes. Ankuesi është dënuar për shkak të prezantimit, në një publikim të blogut, një fotografi të Hajnrih Himler me uniformën e Eskadrilës së Mbrojtjes (SS) me shenjën e partisë naziste dhe me lentën me kryq të lakuar në krahun e tij. Publikimi i kontestuar ka qenë lidhur me veprimin e supozuar diskriminues dhe racist me vajzën e tij nga ana e Agjencisë së Punësimit. Edhe pse ankuesi nuk ka pasur qëllim të përhapë propagandë totalitare, të nxisë dhunë ose të shprehë gjuhë të urrejtjes, nuk ka mundur të sqarojë se si bashkëveprimi i Agjencisë së Punësimit me vajzën e tij mund të krahasohet me atë se çfarë ka ndodhur gjatë regjimit nazist. Krahas kësaj, ai nuk e ka hedhur poshtë ideologjinë naziste në mënyrë të qartë dhe të dukshme, gjë që do ta lironte atë nga përgjegjësia penale. Duke marrë parasysh ndalimin e përdorimit të simboleve naziste, duke marrë parasysh përvojën historike të Gjermanisë, që ka qenë një faktor i rëndësishëm, Gjykata e ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit në pajtim me nenin 10, si e pabazë.

Në këtë rast, Gjykata e ka pranuar nevojën e shteteve që kanë përvojë të hidhur naziste, që të kenë një përgjegjësi morale për t'u distancuar nga krimet mizore dhe të pranohet një legjislacion më restriktiv. Lejimi i përdorimit të simboleve ku ka pasur një refuzim të qartë dhe të dukshëm të ideologjisë, ka qenë i mjaftueshëm për lirinë e shprehjes.

Miratimi i terrorizmit

V.

Leroj kundër Francës (Kërkesa ankimore nr. 36109/03) e 2 tetorit 2008

Shënim për procedurën:

Ankuesi (z. Denis Leroj), shtetas francez, ka parashtruar kërkesë për ankesë kundër Republikës së Francës më datë 12 nëntor 2003, që është shqyrtuar nga Gjykata më 9 shtator të vitit 2008.

Rezime e fakteve:

Ankuesi ka qenë karikaturist që ka punuar për disa botime lokale, përfshirë edhe gazetën javore *Ekaitza*. Ankuesi ka dorëzuar në gazetën një vizatim që paraqet sulmet e 11 shtatorit me titull parodie të sloganit të njohur reklamues “Të gjithë ne kemi ëndërruar për këtë...Hamasi e bëri”, kurse vizatimi ishte publikuar më datë 13 shtator të vitit 2001. Pas publikimit të këtij botimi, prokurori publik ngriti procedurë kundër ankuesit dhe drejtorit të botimit të gazetës për bashkëpjesëmarrje në miratimin e terrorizmit dhe për miratimin e terrorizmit. Në vitin 2002 ankuesit ishin dënuar dhe secili prej tyre ishte dënuar me dënim në para me nga 1.500 euro. Gjykata e Apelit në Pau e kishte konfirmuar aktgjykimit dhe Gjykata e Kasacionit, e kishte hedhur poshtë pjesën kryesore të ankesës për çështjet juridike që ishte parashtruar nga ankuesi.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkelje të supozuara të së drejtës së tij të lirisë së shprehjes sipas nenit 10 dhe shkelje të nenit 6 paragrafi 1 (e drejta e gjykimit të drejtë).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se aktgjykimi i ankuesit ka qenë një ndërhyrje në të drejtën e tij të lirisë

së shprehjes, që është përcaktuar me ligj dhe ka qenë e drejtuar ndaj qëllimeve legjitime (siguria publike dhe parandalimi i anarkisë dhe krimit). Gjykata ka vlerësuar se vizatimi i ankuesit e ka përkrahur dhe lartësuar shkatërrimin e dhunshëm të imperializmit amerikan që ankuesi e ka kritikuar. Gjykata ka konstatuar se nëpërmjet përdorimit të gjuhës pozitive, ankuesi e ka miratuar dhunën që është kryer gjatë sulmeve dhe në këtë mënyrë e ka nënçmuar dinjitetin e viktimave. Gjykata gjithashtu ka theksuar se gjykatat vendore kanë hulumtuar interesin publik se a e kanë arsyetuar përdorimin e provokimit ose teprimit nga ana e ankuesit. Gjykata konkretisht e kishte marrë parasysh kontekstin e ilustrimit që është bërë në ditën e sulmeve dhe që është publikuar 2 ditë më vonë, si dhe faktin se është publikuar në një rajon veçanërisht të ndjeshëm në aspekt politik (Baski). Gjithashtu, gjykata ka theksuar se artikulli ka shkaktuar reagime në publik që kanë shkaktuar dhunë dhe ndikim të konsiderueshëm ndaj rendit publik.

Gjykata e ka theksuar edhe dënimin e shqiptuar modest duke marrë parasysh kontekstin dhe rëndësinë e ilustrimit të kontestuar. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të nenit 10.

Gjykata ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 6 (1) për shkak se se ankuesit nuk i është kumtuar raporti i gjykatësit - raportues.

Koment për vendimin

Leroj kundër Francës është rast i rëndësishëm për faktin se shfrytëzimi i së drejtës së lirisë së shprehjes për lartësimin, arsyetimin ose përkrahjen e veprave terroriste nuk është pjesë e mbrojtjes me nenin 10 të Konventës. Megjithatë Gjykata e ka pranuar rëndësinë e mbrojtjes së lirisë së shprehjes në shoqëri demokratike, përdorimi i qëllimshëm i gjuhës pozitive dhe ilustrimit për lartësimin dhe përkrahjen e veprave terroriste që kanë ndodhur, nuk ka

qenë formë e shprehjes që është dashur të mbrohet me nenin 10. Vendimi ka rëndësi të veçantë sepse e fut lirinë e shprehjes në kontekst të lirisë së shtypit. Megjithëse në praktikën e mëparshme gjyqësore Gjykata ka insistuar në rëndësinë e lirisë së shtypit në shoqëri demokratike dhe rrezikun potencial nga ndikimi tmerrues ndaj çfarëdo kufizimi të lirisë së shtypit, në këtë rast tregon se kjo liri nuk është pa kufij. Së këndejmi, shteti ka të drejtë që ta kufizojë lirinë e shtypit kur ajo bëhet duke ndjekur një qëllim legjitim. Sipas Gjykatës, miratimi i veprave terroriste nuk bën pjesë në deklaratimet që kanë përfitime nga mbrojtja e lirisë së shtypit. Derisa e ka formuluar këtë konkluzion, Gjykata në veçanti i ka kushtuar vëmendje kontekstit kur është dhënë deklarata (e publikuar vetëm 2 ditë pas sulmeve të 11 shtatorit), si dhe ndjeshmërisë politike kontekstuale të rajonit konkret ku është publikuar ilustrimi.

**Roj TV A/S kundër Danimarkës
(Kërkesa ankimore nr. 24683/14)
e 17 prillit 2018 (veprim për
lejueshmëri)**

Shënim për procedurën:

Ankuesi është kompani daneze dhe kanal televiziv, që ka parashtruar ankesë kundër Danimarkës më datë 24 mars të vitit 2014 lidhur me shkelje të supozuara të nenit 10. Seanca dëgjimore e Gjykatës është mbajtur më datë 17 prill të vitit 2018.

Rezyme e fakteve

Ankuesi ka marrë licencë për transmetim në vitin 2003 nga Bordi Danez për radio dhe televizion, duke transmetuar programe kryesisht në gjuhën kurde në Evropë dhe në Lindjen e Mesme gjatë vitit 2004. Në vitin 2010, ankuesi dhe kompania e tij amë ishin akuzuar për shkelje të dispozitave antiterroriste të Kodit Penal danez, duke promovuar organizatën terroriste PKK nëpërmjet programeve të tyre të emetuara që nga qershori i vitit 2006 e deri në shtator të vitit 2010. Ankuesi është dënuar me 2,6 milionë krone daneze nga Gjykata Civile në Kopenhagë, vendim që është konfirmuar nga Gjykata e Lartë e Danimarkës Lindore, e

cila e ka vazhduar periudhën në fjalë por e ka rritur edhe dënimin në 5 milionë krone. Gjykata e Lartë gjithashtu ia ka hequr ankuesit lejen e transmetimit. Gjykata Supreme e ka konfirmuar edhe ndalimin e transmetimit.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkeljen e të drejtës së lirisë së shprehjes (neni 10).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka përsëritur se detyra e tij sipas nenit 10, lidhur me të drejtën vendore ka qenë që të konfirmojë se gjykatat vendore e kanë bazuar vendimin e tyre në vlerësimin e pranueshëm të fakteve relevante. Në këtë drejtim, Gjykata në Strasburg është bindur se gjykatat vendore i kanë bazuar konstatimet e tyre në vlerësimin adekuat të fakteve. Gjykata është bazuar në praktikën gjyqësore (*Zana kundër Turqisë*²⁸) duke theksuar se nuk ka shkelje të lirisë së shprehjes kur dikush dënohet për shprehje të përkrahjes për PKK-në.

Lidhur me zbatimin e nenit 17 në këtë rast, Gjykata ka përsëritur se dispozita e fundit mund të zbatohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur çfarëdo deklarate, goftë verbale ose joverbale, jepet drejtpërdrejt kundër vlerave themelore të Konventës. Duke marrë parasysh se shumë programe të ankuesit ishin financuar nga PKK-ja në periudhën ndërmjet viteve 2006 dhe 2010 dhe se programet kanë përfshirë pjesë që nxisin dhunë dhe përkrahje të aktiviteteve terroriste, Gjykata ka vendosur se aktivitetet e ankuesit bëjnë pjesë në kuadër të nenit 17 dhe si të tilla nuk mund të mbrohen me nenin 10 të Konventës.

Koment për vendimin

Ky rast shërben si presedan për faktin se ankuesit nuk mund të bazohen në të drejtën e tyre të lirisë së shprehjes, për të promovuar organizata terroriste duke shfrytëzuar kanalet televizive. Këto aktivitete nuk janë pjesë në fushën e nenit 10 në bazë të nenit 17. Për Gjykatën, ankesa e kompanisë ankuese, në bazë të nenit 17 nuk e ka aktivizuar mbrojtjen

28 Rasti i Zanës kundër Turqisë (Kërkesa ankimore nr. 69/1996/688/880), aktgjykim i 25 nëntorit 1997.

qe e jep neni 10, duke marrë parasysh se ndikimi dhe natyra e programeve të kontestueshme që janë transmetuar para një publiku të madh, duke përfshirë edhe nxitjen e dhunës dhe përkrahjen e një aktiviteti terrorist dhe në këtë mënyrë kanë qenë të lidhura drejtpërdrejt me parandalimin e terrorizmit, çështje që ka qenë më e rëndësishme në shoqërinë bashkëkohore evropiane. Konkretisht, “mbulimi i njëanshëm me nxitjen e përsëritur të pjesëmarrjes në luftime dhe aksione dhe për t’u bashkuar grupeve guerile, si dhe prezantimin e anëtarëve të vdekur të forcave guerile si heronj, ka qenë një propagandë për organizatën terroriste PKK dhe nuk mund të konsiderohet vetë si shprehje e ngushëllimit”.²⁹ Krahas kësaj, në periudhën relevante kohore, kompania-ankuese në masë të konsiderueshme është financuar nga PKK-ja. Megjithatë neni 17 zbatohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur deklarata ka qenë drejtpërdrejt në kundërshtim me vlerat themelore të Konventës, neni ka qenë i zbatueshëm në rastin konkret. Në të vërtetë, nxitja e dhunës dhe përkrahja e aktiviteteve terroriste nëpërmjet transmetimit të programit televiziv paraqet aktivitet që është në kundërshtim me vlerat themelore të Konventës dhe si e tillë nuk mund të ketë përfitim të mbrojtjes nga neni 10. Sugjerohet në faktin që rasti tregon refuzimin e GJEDNJ-së për të lejuar që të bazohet në të drejtën e lirisë së shprehjes për të promovuar urrejtje, diskriminim ose përkrahje të thirrjeve për dhunë, veçanërisht në bazë të përkatësisë etnike.

Stomahin kundër Rusisë, (Kërkesa ankimore nr. 52273/07), e 9 majit 2018

Shënim për procedurën:

Ankuesi (g. Stomahin), shtetas rus, që ka parashtruar kërkesë ankimore kundër Federatës Ruse më datë 7 nëntor të vitit 2007. Gjykata ka mbajtur seancë të mbyllur më datë 3 prill të vitit 2018.

Rezime e fakteve:

Ankuesi ka qenë redaktor, botues dhe distributor i një gazete mujore ndërmjet viteve 2000 dhe 2004 dhe kryesisht është marrë me luftën e atëhershme në Çeçeni. Në dhjetor të vitit 2003, organet kompetente kishin filluar një hetim kundër ankuesit me dyshimin se ka shprehur qëndrime që nënkuptojnë apel për aktivitete ekstremiste dhe nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare dhe sociale. Gjykatat vendore kanë konstatuar se ankuesi i ka arsyetuar dhe lartësuar veprat terroriste nga ana e çeçenëve dhe kishte thirrur për dhunë ndaj popullit rus. Ankuesi kishte deklaruar se ai vetëm e ka shprehur mendimin e tij politik, nuk e ka shpërndarë gazetën dhe ka mohuar se përkrah ekstremizmin. Ankuesi ishte gjykuar në vitin 2006 me dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 vitesh dhe 3 vite ndalim për gazetari.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar se dënimi i tij është në kundërshtim me nenin 10 (liria e shprehjes) dhe nenin 1 (liria e mbledhjes). Ankuesi gjithashtu është ankuar edhe për shkelje në pajtim me nenin 6 (e drejta për gjykim të drejtë).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërtetuar se gjykimi i ankuesit ka synuar qëllimet legjitime, veçanërisht mbrojtjen e të drejtave të tjerëve dhe mbrojtjes së sigurisë kombëtare, integritetit territorial, sigurisë publike dhe parandalimit të anarkisë dhe krimit. Gjykata e ka përsëritur domosdoshmërinë për shqyrtimin e kontekstit në të cilin janë publikuar deklaratat, natyra dhe formulimi i tyre, potenciali i tyre që të sjellin pasoja të dëmshme, si dhe motivet në të cilat bazohen gjykatat vendore. Gjykata i ka kufizuar deklaratat e ankuesit në tri grupe, deklaratat e grupit të parë që e kanë arsyetuar terrorizmin, kanë shpifur për ushtarët rusë dhe i kanë lavdëruar udhëheqësit çeçen që arsyetojnë dhunën. Lidhur me këto deklarata, Gjykata ka konsideruar se veprimi i gjykatës vendore ndaj tyre ka qenë proporcional. Deklaratat e grupit të dytë kanë qenë për kritikën e ankuesit që kanë nxitur urrejtje në drejtim të besimtarëve ortodoksë dhe etnikë rusë. Në këtë aspekt Gjykata ka konstatuar se shqyrtimet e gjykatave vendore janë relevante dhe të mjaftueshme. Në fund, deklarime të cak-

29 Roj TV A/S kundër Danimarkës (Kërkesa ankimore nr. 24683/14), vendim për lejueshmëri e 17 prillit 2018, § 46.

tuara të ankuesit nuk i kanë tejkaluar kufijtë e kritikës, veçanërisht lidhur me gjendjen e luftës. Lidhur me to, Gjykata ka vërejtur se autoritetet vendore nuk kanë arritur që ta dëshmojnë “nevojën e domosdoshme shoqërore” për ndërhyrje në lirinë e shprehjes së ankuesit. Meqë deklaratat përmbajnë çështje me interes publik, kufizimi që imponohet duhet doemos të interpretohet rreptësisht. Gjykata e ka pranuar natyrën e ashpër të dënimit të shqiptuar ndaj ankuesit, por nuk mund të konkludohet nëse ajo është e domosdoshme për rastin konkret. Gjykata e ka marrë parasysh edhe faktin se ankuesi asnjëherë më parë nuk është dënuar për një vepër të ngjashme, si dhe faktin se potenciali për ndikimin e deklaratës ka qenë i vogël sepse gazeta është shpërndarë në një numër shumë të vogël të ekzemplarëve dhe vetëm për persona të interesuar. Së këndejmi, Gjykata ka konstatuar se dënimi i ankuesit nuk ka qenë proporcional me qëllimet e dëshiruara legjitime. Gjykata një zëri ka konstatuar shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Ky rast paraqet shembull i cili e dëshmon lirinë e zgjeruar të shprehjes në raport me kritikën që kanë të bëjnë me pushtetin. Gjykata e ka pranuar rëndësinë e kufizimit të lirisë së shprehjes atëherë kur ajo shfrytëzohet për nxitjen e urrejtjes, dhunës dhe diskriminimit të grupeve dhe individëve të caktuar, ose për lartësimin dhe arsyetimin të veprave terroriste. Mirëpo, Gjykata ka konstatuar se ekziston liri më e madhe e kritikës atje ku kritikën bëhen ndaj pushtetit. Deri në këtë shkallë, Gjykata zbaton kontroll më të rreptë të kufijve të caktuar për lirinë e fjalës dhe kritikës ndaj pushtetit.

Më tutje, Gjykata ka potencuar se madje edhe aty ku diskriminimi i kritikës së tillë mund të arsyetohet, respektivisht ku ajo paraqet gjuhë të urrejtjes, shtetet nuk kanë pasur liri që të shqiptojnë dënime me burg, meqë ato është dashur të jenë proporcionale me vlerësimin e domosdoshmërisë në pajtim me nenin 10. Potencohet se kontrolli i tillë rigoroz i kufizimeve që janë imponuar ndaj lirisë së fjalës dhe që kanë të bëjnë me kritikën ndaj pushtetit, ka rëndësi të veçantë në shoqëri demokratike. Me të vërtetë, kjo formë e kontrollit është e domosdoshme për t'u siguruar se mendimet e kundërta ose mendimet që kundërshtojnë

mund lirshëm të shprehen, pa frikë nga dënimi ose sanksioni nga ana e pushtetit. Së këndejmi, kjo nënkupton se duhet të sigurohemi që liria e shprehjes të vlejë njësoj edhe për deklaratat që janë harmonizuar me mendimet e përgjithshme ose qëndrimet që përkrahen nga shteti, njësoj sikur edhe deklaratat që mund të shokojnë, ofendojnë ose shkaktojnë shqetësim në raport me mendimin e përgjithshëm ose të atyre që e kritikojnë ose kundërshtojnë shtetin.

Gjykata e ka lënë të hapur çështjen nëse ndalimi për kryerje të veprimtarive të gazetarisë, si e tillë është e përputhshme me nenin 10 të Konventës. Privimi nga liria së bashku me ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së gazetarisë ka qenë masë e rreptë, veçanërisht kur është shqiptuar për një periudhë aq të gjatë kohore. Në këtë aspekt, Gjykata nuk mund të miratojë konkluzion se dënimi i ankuesit ka qenë i domosdoshëm për shkak të rrethanave të caktuara në rastin e tij. Ankuesi asnjëherë nuk është dënuar për vepër të ngjashme (në të kundërtën, dënimi më i rreptë do të ishte më i pranueshëm). Krahas kësaj, ndikimi potencial ndaj deklaratave të kontestueshme është zvogëluar. Ato janë botuar në buletin të publikuar në mënyrë të pavarur, me një numër shumë të vogël të ekzemplarëve dhe tirazhit. Ekzemplarët janë distribuuar nga ankuesi personalisht ose nëpërmjet të njohurve të tij, gjatë organizimeve publike nëpër Moskë, vetëm për ata persona që kanë shprehur interesim. Sipas kësaj, dënimi i ankuesit nuk ka qenë proporcional me qëllimet e dëshiruara legjitime.

Gjuha homofobe e urrejtjes

VI.

Gjykata vazhdimisht kishte deklaruar se liria e shprehjes zbatohet jo vetëm për “informatat” ose “idetë” që janë të pranueshme ose që konsiderohen si joofenduese ose si indiferente, por edhe ata që ofendojnë, shokojnë ose shqetësojnë; si të tilla janë kërkesat për pluralizëm, tolerancë dhe lirinë e mendimit pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”. Liria e shprehjes ka përjashtime të cilat duhet doemos të interpretohen rreptësisht dhe të konstatohet bindshëm nevoja për çfarëdo qoftë kufizimi.³⁰ Gjykata duhet doemos të shqyrtojë ndërhyrjen për të cilën bëhet ankesa lidhur me rastin si tërësi dhe të përcaktojë nëse ajo është “proporcionale me qëllimin e paraparë legjitim” dhe nëse arsyet e theksuara nga autoritetet kombëtare për ta bërë atë janë “relevante dhe të mjaftueshme”. Me këtë rast, Gjykata doemos duhet të vërtetohet se autoritetet kombëtare kanë aplikuar standarde në pajtim me parimet e përfshira me nenin 10 dhe se janë bazuar në vlerësimin e pranuar të fakteve relevante³¹. Më tutje, një faktor i rëndësishëm që duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes në lirinë e shprehjes është edhe natyra dhe serioziteti i dënimeve.

Lidhur me atë nëse ndërhyrja në të drejtën e mbrojtur me nenin 10 ka qenë e domosdoshme në shoqëri demokratike dhe nëse kanë qenë proporcionale me qëllimin e dëshiruar legjitim, shtetet që janë palë kontraktuese të Konventës, gëzojnë margjinë të caktuar të vlerësimit. Margjina e vlerësimit e shtetit zbatohet së bashku me mbikëqyrjen evropiane. Gjykata në përgjithësi ka kuptuar se margjina e vlerësimit nënkupton se gjykata nuk është ajo që duhet ta zëvendësojë vlerësimin personal të bazës me atë të organeve kompetente kombëtare, kur gjykatat e pavarura dhe të paanshme vendore me kujdes do t’i shqyrtojnë faktet, duke

i zbatuar standardet adekuate për të drejtat e njeriut, në pajtim me Konventën dhe praktikën e saj gjyqësore dhe kështu në mënyrë përkatëse t’i baraspeshojnë në rastin konkret, interesat personale të ankuesit me interesin më të gjerë publik.

“Gjuha e urrejtjes”, siç interpretohet ky koncept në praktikën gjyqësore të Gjykatës, është pjesë e dy kategorive. Kategoria e parë e praktikës gjyqësore e Gjykatës për “gjuhën e urrejtjes” përbëhet nga format më të rënda të “gjuhës së urrejtjes”, për të cilat Gjykata konsideron se bëjnë pjesë në kuadër të nenit 17 dhe me këtë në tërësi përjashtohen nga mbrojtja sipas nenit 10. Kategoria e dytë përbëhet nga forma “më pak të rënda” të “gjuhës së urrejtjes” për të cilat Gjykata nuk konsideron se në tërësi bëjnë pjesë në mbrojtjen sipas nenit 10, por që i ka konsideruar si të lejueshme për kufizim nga shtetet që janë palë kontraktuese të Konventës. Në rastin *Beizaras dhe Levikas kundër Lituanisë*, Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 14, lidhur me nenin 8 dhe nenin 13, për shkak të refuzimit të autoriteteve për t’i përndjekur autorët e komenteve serioze homofobike në Facebook, përfshirë edhe thirrjet publike për dhunë. Për këtë arsye, Gjykata jo vetëm që nuk përkrah fjalim i cili në mënyrë eksplicite thirr për dhunë ose vepra tjera penale, por edhe ka vendosur që sulmet ndaj personave nëpërmjet ofendimeve, përqeshjeve ose shpifjeve të grupeve të caktuara të popullsisë, janë të mjaftueshme që t’u lejohet autoriteteve të luftojnë kundër gjuhës me paragjykime në kontekst të kufizimeve të lejuara të lirisë së shprehjes. Në rastet që kanë të bëjnë me gjuhën e cila fton në dhunë ose vepra tjera penale, por për të cilat Gjykata prapëseprapë konsideron se paraqesin “gjuhë të urrejtjes”, ai konkluzion bazohet në vlerësimin e përmbajtjes së shprehjes dhe mënyrës së shprehjes së tyre.

30 Bedat kundër Zvicrës [Këshilli i Madh Gjyqësor], Kërkesa ankimore nr. 56925/08, aktgjykim i 29 marsit 2016, §48.

31 Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë, Kërkesa ankimore nr. 1813/07, aktgjykim i 9 shkurtit 2012, §58.

Vejdeland dhe tjerë kundër Suedisë (Kërkesa ankimore nr. 1813/07) e 9 shkurtit 2012

Shënim për procedurën:

Ankuesit janë 4 shtetas suedezë që kanë parashtruar ankesë kundër Mbretërisë së Suedisë më datë 4 janar të vitit 2007, për të cilin rast Gjykata kishte diskutuar më datë 10 janar të vitit 2012.

Rezume e fakteve:

Ankuesit ishin dënuar në vitin 2006 nga Gjykata Supreme për agjitim kundër një grupi nacional ose etnik, pasi që kishin lënë fletushka homofobike nëpër sirtarët e nxënësve në një shkollë. Për 3 ankuesit e parë janë shqiptuar dënime me kusht dhe në para prej 200 deri në 2000 euro, ndërsa ankuesi i katërt është dënuar me dënim me kusht.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesit janë ankuar se aktgjykimet e tyre paraqesin shkelje të së drejtës së tyre për lirinë e shprehjes në pajtim me nenin 10.

Vendimi i Gjykatës

Në vendimin e vet, Gjykata e Strasburgut është pajtuar me Gjykatën Supreme suedeze, e cila ka konstatuar se madje edhe nëse deklaratat e ankuesit kanë kontribuar për një debat publik (për objektivitetin e arsimit në shkollat suedeze), është dashur patjetër t'i kushtohet vëmendje mënyrës së shprehjes në fletushka. Ishin përdorur nocione të turpshme dhe përbuzëse lidhur me homoseksualitetin, si dhe pohime që kanë qenë të pabaza. Gjykata ka vërejtur se megjithëse deklaratat e ankuesve nuk thirrin drejtpërdrejt në dhunë, përmbajnë deklarata serioze me paragjykime. Gjykata e Strasburgut në veçanti e ka vërejtur faktin se fletushkat janë lënë nëpër sirtarët e nxënësve, në kohën kur ata kanë qenë në një moshë të ndjeshme dhe ekspozuar ndaj ndikimeve dhe se fletushkat janë shpërndarë në një shkollë ku asnjë prej ankuesve nuk ka pasur qasje të drejtpërdrejtë e as që e ka ndjekur atë shkollë.

Gjykata gjithashtu ka vërejtur se dënimet e ankuesve nuk kanë qenë të tepërta në rrethanat e rastit. Sipas kësaj, Gjykata ka vendosur se dënimet dhe aktgjykimet nuk janë proporcionale me qëllimin e dëshiruar legjitim dhe gjykata vendore ka dhënë arsye relevante dhe të mjaftueshme për vendimin e vet. Për këtë arsye, ndërhyrja ka qenë e domosdoshme në shoqërinë demokratike, për të mbrojtur dinjitetin dhe të drejtat e tjerëve.

Koment për vendimin

Ky rast e kufizon lirinë e shprehjes deri në atë shkallë që pranon se ndërhyrja në lirinë e shprehjes është legjitime atje ku nevojitet në një shoqëri demokratike, për të mbrojtur të drejtat e tjerëve.

Si i tillë, rasti paraqet shembull që dëshmon se ankuesit nuk mund të bazohen në mbrojtjen e të drejtës së tyre të lirisë së shprehjes, kur deklaratat e tyre janë ndaj një grupi konkret (në këtë rast në bazë të orientimit të tyre seksual) dhe kur shprehja përmban deklarata që janë të pabaza ose me paragjykime.

Në këtë drejtim, Gjykata ka vërejtur se ankuesit i kanë shpërndarë fletushkat me qëllim tepër të filluar debat për mungesën e objektivitetit të arsimit nëpër shkollat suedeze. Gjykata është pajtuar me Gjykatën Supreme se madje edhe nëse kjo është qëllim i pranueshëm, patjetër duhet t'i kushtohet vëmendje tekstit të fletushkave. Gjykata ka vërejtur se, sipas fletushkave, homoseksualiteti ka qenë “një prirje devijuese seksuale” që ka “ndikim shkatërrues moral në esencën e shoqërisë”. Në fletushkat është shënuar se homoseksualiteti është një prej arsyeve kryesore ku bazohet përhapja e HIV-it dhe SIDA-s dhe se “lobi homoseksual” është munduar që në mënyrë fiktive ta zvogëlojë pedofilinë. Sipas mendimit të Gjykatës, megjithëse këto deklarata në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk rekomandojnë që individët e caktuar të kryejnë vepra të urrejtjes, ato janë deklarata serioze me paragjykime. Gjykata ka përsëritur se nxitja e urrejtjes nuk duhet patjetër të nënkuptojë thirrje për vepra të dhunshme ose vepra tjera penale. Sulmet ndaj personave që janë bërë nëpërmjet ofendimeve, përqeshjeve ose shpifjeve ndaj grupeve të caktuara të popullatës, mund të mjaftojnë që autoritetet të punojnë për parandalimin e fjalimeve raciste

gjatë lirisë së shprehjes, kur liria e tillë shfrytëzohet në mënyrë të papërgjegjshme. Në këtë aspekt, Gjykata ka potencuar se diskriminimi në bazë të orientimit seksual është serioze, sikur edhe diskriminimi në bazë të “racës, prejardhjes ose ngjyrës”. Fletushkat janë lënë nëpër sirtarët e personave të rinj që kanë qenë në një moshë të ndjeshme, kur janë ekspozuar ndaj ndikimeve dhe që nuk kanë pasur mundësi për t’i refuzuar fletushkat. Krahas kësaj, fletushkat janë ndarë në një shkollë që nuk e ndjek asnjëri nga ankuesit dhe asnjëri prej tyre nuk ka pasur aty qasje të drejtpërdrejtë.³² Gjithashtu, një faktor i rëndësishëm që duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes në lirinë e shprehjes është edhe serioziteti i dënimeve të shqiptuara. Gjykata ka vërejtur se ankuesit nuk janë dënuar me burg megjithëse vepra për të cilën janë dënuar, parashihet dënim me burgim prej dy vitesh. Në vend të kësaj, tre prej tyre kanë marrë dënime me kusht të kombinuara me dënime në para prej përafërsisht 200 deri në 2000 euro, kurse ankuesi i katërt është dënuar me dënim me kusht. Për këtë arsye dhe në këto rrethana, dënimet nuk kanë qenë të tepruara.³³

Edhe pse Gjykata e ka njohur interesin e mundshëm për fillimin e debatit publik, fakti se ankuesit kanë shpërndarë fletushka nëpër shkollë që ata nuk i kanë ndjekur, e ka tejkaluar shprehjen e thjeshtë të mendimeve të tyre, sepse ndarja e fletushkave mund të konsiderohet si imponim i qëndrimeve të tyre për një kategori të popullsisë që në veçanti është e ekspozuar ndaj ndikimeve, si dhe ndarja është bërë në vend të papërshtatshëm (shkollë).

Beizaras dhe Levikas kundër Lituanisë (Kërkesa ankimore nr. 41288/15) e 14 janar 2020

Shënim për procedurën:

Ankuesit (z. Pjius Beizaras - ankuesi i parë dhe z. Mangridas Levikas - ankuesi i dytë), të dy shtetas të Lituanisë, ka parashtruar kërkesë ankuese kundër Republikës së Lituanisë më datë 13 gusht të vitit 2015. Gjykata ka mbajtur seancë të mbyllur për këtë rast më datë 22 tetor të vitit 2019 dhe 26 nëntor të vitit 2019.

Rezime e fakteve:

Në vitin 2014, një prej ankuesve kishte publikuar një fotografi të çiftit (ankuesit të parë dhe të dytë) duke u puthur, në faqen e vet të Facebook-ut, me qëllim për ta publikuar lidhjen e tyre dhe të nxisë debat për të drejtat e lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe personave transgjjinorë (LGBT) nga Lituania. Publikimi kishte marrë shumë komente homofobike (me përmbajtje që thirrën për “kastime”, “vrasje” ose “djegie” të ankuesve). Me kërkesë të ankuesve dhe organizatës për mbrojtjen e të drejtave të personave LGBT, ankuesit kanë parashtruar ankesë në prokurori kundër 31 komentuesve të Internetit, duke kërkuar hetim për nxitjen e urrejtjes dhe dhunës homofobike. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga prokuroria, ndërsa ankesat ishin refuzuar nga gjykatat.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesit janë ankuar për shkeljen e të drejtave të tyre në pajtim me nenin 14 (ndalesa e diskriminimit) dhe neni 13 (mjete efektive juridike).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se komentet me urrejtje kundër ankuesve dhe komunitetit LGBT janë nxitur nga qëndrimet paragjyquese ndaj atij komunitetit dhe kjo gjendje diskriminuese gjithashtu është bazë e mosplotësimit të obligimit pozitiv të pushtetit për të bërë hetim efikas. Si rezultat i kësaj, Gjykata ka konstatuar se nuk ka pasur diskriminim në bazë të orientimit seksual të ankuesve pa ndonjë arsye të mirë. Së këndejmi, Gjykata ka konkluduar se në këndvështrim të parë (prima facie) është dukur

32 Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë, nr. 1813/07, shkurt 2012, § 54-56.

33 Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë, nr. 1813/07, shkurt 2012, § 58.

se orientimi homoseksual i ankuesve ka ndikuar në mënyrën se si kanë vepruar autoritetet me ta. Në raport me natyrën kriminale të komenteve kontestuese, Gjykata ka vërejtur se për të nxitur koment urrejtje, nuk është e domosdoshme të thirret në vepra të dhunshme ose vepra tjera penale. Ofendimet, përqeshjet dhe shpifjet janë të mjaftueshme kur shprehen pa përgjegjësi. Gjithashtu, Gjykata ka vërejtur se urrejtja në komente, së bashku me thirrjet që të “vriten” ankuesit, kanë qenë mjaftë serioze, madje edhe nëse autori ka publikuar vetëm një vërejtje (e nuk e ka bërë atë në mënyrë sistematike). Gjykata ka pranuar se sanksionet penale mund të thirren vetëm si “masë ultima ratio”, që zbatohet njësoj edhe për gjuhën e urrejtjes kundër orientimit seksual dhe jetës seksuale të të tjerëve. Mirëpo, Gjykata ka konstatuar se për shkak se ky rast ka të bëjë vetëm me thirrjet e drejtpërdrejta ndaj integritetit fizik dhe psikik të ankuesit, nevojitet mbrojtje edhe nëpërmjet së drejtës penale. Kështu, Gjykata ka konstatuar se mosplotësimi i obligimit pozitiv të autoriteteve që të bëjnë hetim efektiv për atë nëse deklaratat paraqesin nxitje dhe dhunë, në fakt është shkelje e nenit 14. Gjykata njëzëri ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 13 sepse qëndrimet diskriminuese të autoriteteve kanë ndikuar ndaj efektivitetit të mjeteve juridike.

Koment për vendimin

Ky është një rast i rëndësishëm i cili shërben si shembull kundër diskriminimit nga ana e individëve si dhe shtetit, në aspekt të orientimit seksual. Rasti është një presedan i veçantë që tregon se secila formë e diskriminimit, përfshirë edhe gjuhën e urrejtjes në bazë të orientimit seksual, ka rëndësi të njëjtë sikurse edhe diskriminimi në baza tjera, siç janë raca, përkatësia etnike ose religjioni. Në këtë rast GJEDNJ-ja e përcakton qartë domosdoshmërinë e shteteve që të sigurojnë se individë të caktuar nuk do të diskriminohen nga organet shtetërore në bazë të orientimit të tyre seksual, si dhe obligimit që të sigurohen se të drejtat e tyre nuk do të cenohen nga individë tjerë. Së këndejmi, ky rast e tregon obligimin pozitiv që u imponohet shteteve që të sigurohen se nuk duhet të sanksionohet çdo formë e gjuhës së urrejtjes në bazë të orientimit seksual ose jetës seksuale.

Liliendahl kundër Islandës (Kërkesa ankimore nr. 2929718) i 12 majit 2020 (vendimi për lejueshmëri)

Shënim për procedurën:

Ankuesi (z. Liliendahl), shtetas islandez, kishte parashtruar kërkesë ankimore kundër Islandës më datë 12 qershor të vitit 2018. Gjykata ka mbajtur seancë më datë 12 maj të vitit 2020.

Rezume e fakteve:

Në vitin 2015, organet kompetente lokale të një qyteti në Islandë kanë miratuar propozim në bashkëpunim me shoqërinë kombëtare LGBT (Samotkin '78), për forcimin e arsimit fillor dhe të mesëm për çështjet e LGBT-së. Ky vendim ka sjellë diskutim publik të rëndësishëm në kanalet e ndryshme të lajmeve dhe mediave sociale ku është përfshirë edhe ankuesi. Ankuesi nëpërmjet një komenti ka reaguar ndaj një artikulli në internet, duke e shprehur mllefin e tij me fjalë nënçmuese si “kynvilla” (devijim seksual) dhe “kyunvillingar” (devijues seksual).

Shoqata Samotkin'78 i ka denoncuar komentet e ankuesit në polici dhe pas një hetimi, ai është akuzuar për përqeshje, shpifje, nxitje dhe kërcënim publik të personit ose grupeve të personave për shkak të karakteristikave të caktuara, përfshirë edhe orientimin e tyre seksual ose identitetit gjinor. Gjykata Supreme e ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë për lirim e ankuesit, duke e dënua me dënim në para prej rreth 800 euro.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkeljen e nenit 10 (liria e shprehjes) dhe nenin 14 (ndalimi i diskriminimit).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se komentet nuk kanë qenë forma më e rëndë e “gjuhës së urrejtjes” dhe janë përjashtuar nga mbrojtja e nenit 10 duke zbatuar nenin 17, meqë nuk ka qenë e qartë menjëherë nëse komentet kanë për qëllim nxitjen e dhunës dhe urrejtjes ose ndërprerjen e të drejtave dhe lirive që janë të mbrojtura

me Konventën. Gjykata ka konstatuar se komentet megjithatë kanë përkrahur mostolerancën dhe urrejtjen ndaj homoseksualëve dhe prandaj ka qenë “formë jo shumë e rëndë” e gjuhës së urrejtjes. Gjykata gjithashtu është pajtuar me Gjykatën Supreme se ndërhyrja në lirinë e shprehjes së ankuesit është e përcaktuar me ligj dhe është bërë duke synuar një qëllim legjitim (mbrojtjen e të drejtave të tjerëve). Gjykata gjithashtu ka konkluduar se vlerësimi i Gjykatës Supreme ka qenë i arsyeshëm, duke marrë parasysh përpjekjet e Gjykatës Supreme për të matur lirinë e shprehjes së ankuesit dhe të drejtat e të tjerëve, që tregon se dënimi i shqiptuar nuk ka qenë i tepruar. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazë dhe e ka hedhur poshtë si e palejueshme.

Koment për vendimin

Ky rast ka një rol të rëndësishëm në praktikën gjyqësore të Gjykatës, meqë imponon se gjuha e urrejtjes në bazë të orientimit seksual është në kundërshtim me Konventën. Kjo vlen edhe për format e “rënda” të gjuhës së urrejtjes (thirrjet e drejtpërdrejta për dhunë, kërcënime...), si dhe për format “më pak të rënda” të gjuhës së urrejtjes, si në këtë rast. Së këndejmi, ky rast potencon se gjuha e urrejtjes në cilëndo formë në bazë të orientimit seksual nuk është pjesë e mbrojtjes së nenit 10. Rasti ka të bëjë me aktgjykimin dhe dënimin në paraqë ankuesi e ka bërë në shumë komente të paragjykuara homofobike në internet, në kontekst të debatit që është iniciuar nga vendimi i autoriteteve lokale për të përforcuar arsimin nëpër shkolla, për çështje lidhur me LGBT-në. Konkretisht, ai i ka përshkruar homoseksualët si “devijues seksual” dhe ka shprehur neveri. Megjithëse deklarimet e kontestueshme janë “gjuhë e urrejtjes”, sipas mendimit të Gjykatës, nuk e kanë arritur pragun e lartë të zbatimit të nenit 17. Mirëpo, Gjykata e ka miratuar zbatimin e baraspeshimit nga ana e gjykatave vendore dhe e ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit, në pajtim me nenin 10, si e pabazë. Shfrytëzimi i deklaratave të ankuesit që kanë shprehur mostolerancë të qartë dhe të rëndë ndaj një grupi të individëve, në bazë të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor nuk mund të konsiderohet se kontribuon për debat publik. Së këndejmi, ndërhyrja në lirinë e shprehjes së ankuesit nga ana e shtetit ka

qenë e arsyeshme sepse kjo ka lejuar që shteti të vendosë baraspeshë të domosdoshme dhe të drejtë ndërmjet të drejtave të kundërta.

VII.

Nxitja e diskriminimit ose urrejtjes racore

Gjykata ka pasur obligim të formojë qëndrim të qartë në shumë raste lidhur me deklaratat verbale ose joverbale për të cilat theksohet se nxisin ose arsyetojnë dhunë, urrejtje ose mostolerancë. Gjatë vlerësimit nëse ndërhyrja në realizimin e së drejtës së lirisë së shprehjes së autorëve, ose ndonjëherë edhe publikuesve, deklaratave të tilla ka qenë “e domosdoshme në një shoqëri demokratike” duke marrë parasysh parimet e përgjithshme të formuluar me praktikën e tyre gjyqësore, Gjykata ka marrë parasysh disa faktorë. Për shembull, është e rëndësishme nëse deklaratat janë dhënë kundër një prapavije të tensionuar politike ose sociale (atmosfera e tensionuar për luftimet e armatosura në PKK³⁴; probleme lidhur me integrimin e imigrantëve joevropianë dhe veçanërisht atyre myslimanë në Francë³⁵; dhe shpalljes së pavarësisë së saj në vitin 1990³⁶).

Faktor i rëndësishëm ka qenë edhe fakti nëse deklaratat, që janë interpretuar dhe shqyrtuar mjaftueshëm në kontekstin e tyre të drejtpërdrejtë dhe më të gjerë, mund të konsiderohen si thirrje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë për dhunë ose arsyetim të dhunës, urrejtjes dhe mostolerancës.³⁷

Gjatë vlerësimit të këtij faktori, Gjykata ka qenë sensitive ndaj deklaratave bindëse që sulmojnë ose nxijnë një grup të tërë etnik, fetar ose grupe të tjera³⁸. Gjykata gjithashtu i ka kushtuar vëmendje mënyrës se si janë dhënë deklaratat dhe potenciali i tyre për të shkaktuar pasoja të dëmshme. Në praktikën gjyqësore,

lidhshmëria e ndërsjellë ndërmjet faktorëve të ndryshme, e jo secili prej tyre veçmas, e ka përcaktuar rezultatin e rastit. Qasja e Gjykatës ndaj rastit të tillë mund të përshkruhet si tejet specifik për kontekstin. Në rastin *Aksu kundër Turqisë*, Gjykata, mes të tjerash, ka vendosur se paragjykimi negativ për një grup të caktuar etnik, kur të arrijë nivel të caktuar, mund të ndikohet ndaj ndjenjës së identitetit të grupit dhe ndaj ndjenjave të anëtarëve të tyre për vetërespekt dhe vetëbesim. Kështu, ka mundur të ndikojë në “jetën private” të tyre në kuptim të nenit 8 § 1 të Konventës. Në bazë të kësaj, Gjykata ka konstatuar se ky nen është shfrytëzuar në procedurën ku një person me prejardhje rome kishte kërkuar dëmshpërblim, meqë është ndier i ofenduar nga paragrafët e një libri dhe shënimeve në një fjalori lidhur me romët në Turqi.

Jersild kundër Danimarkës (Kërkesa ankimore nr. 15890/89) e 23 shtatorit 1994

Shënim për procedurën:

Ankuesi (z. Jens Olad Jersild) është shtetas danez i cili ka parashtruar kërkesë ankimore kundër Danimarkës deri te Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut më datë 25 korrik të vitit 1989.

Rezime e fakteve:

Në vitin 1985, një revistë e lajmeve ka publikuar një tregim për rritjen e grupeve ksenofobe dhe raciste (The Greenjackets), e më pas e njëjta media ka transmetuar një intervistë me 3 anëtarë të grupit që e ka udhëhequr ankuesi. Intervista në kohëzgjatje prej 5 orëve ishte shkurtuar në disa minuta ku anëtarët kanë dhënë deklarata ofenduese për minoritetet racore dhe imigrantët. I është parashtruar ank-

- 34 Surek kundër Turqisë (Kërkesa ankimore nr. 3) [Këshilli i madh gjyqësor], Kërkesa ankimore nr. 24735/94 e 8 korrikut 1999, §40.
- 35 Le Pen kundër Francës (vendim), Kërkesa ankimore nr. 18788/09 e 20 prillit 2010.
- 36 Ballsite-Lideikiene kundër Lituanisë, Kërkesa ankimore nr. 72596/01 e 4 nëntorit 2008, §78
- 37 Faber kundër Hungarisë, Kërkesa ankimore nr. 40721/08 e 24 korrikut 2012, §52 dhe 56-58.
- 38 *Narvud kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), Kërkesa ankimore nr. 23131/03, 2004-X.

esë në ministrit të Drejtësisë, i cili ka parashtruar aktakuzë kundër anëtarëve. Aktakuzat ishin parashtruar edhe kundër ankuesit dhe udhëheqësit të seksionit të lajmeve në Danmarks Radio. Udhëheqësi dhe ankuesi ishin shpallur fajtorë dhe ishin dënuar me dënime në para prej 2.000 dhe 1.000 kruna daneze, ose në mënyrë adekuate dënim me burg 5 ditor. Ankesat e njëpasnjëshme janë hedhur poshtë.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkeljen e së drejtës së tij të lirisë së shprehjes në pajtim me nenin 10.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se liria e shprehjes është veçanërisht relevante për mediat që luajnë rol kryesor në shoqëri si “rojtarë publikë”.

Gjykata ka konstatuar se ndërhyrja është bërë në pajtim me obligimin e shtetit sipas marrëveshjeve themelore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, por Gjykata ka konstatuar se dënimi i shqiptuar i ankuesit është joproportional, veçanërisht duke marrë parasysh se ankuesi ka qenë pjesë e mediave. Gjykata në veçanti e ka marrë parasysh faktin se megjithëse vërejtje të caktuara të Greenjackets të lexuara jashtë kontekstit kanë qenë shumë ofenduese, mënyra se si janë prezantuar ato e ka tejkaluar ndikimin e tyre ndaj dinjitetit ose të drejtave të tjerëve. Lidhur me këtë, Gjykata ka konkluduar se pushteti nuk ka treguar nëse ndërhyrja në lirinë e shprehjes së ankuesit është e arsyeshme me qëllim legjitim dhe se kjo është e domosdoshme në shoqëri demokratike.

Koment për vendimin

Ky rast ka rol të rëndësishëm në praktikën gjyqësore të Gjykatës sepse e potencon rëndësinë e lirisë së shprehjes, veçanërisht lirisë së shtypit. Rasti është shembull që e dëshmon edhe faktin se shtypi ka rol të rëndësishëm në shoqëri, si mbikëqyrës i demokracisë, transmeton informata dhe ide të dobishme për shumicën, por edhe të tilla që mund të shokojnë, shqetësojnë ose ofendojnë publikun e gjerë, ku kjo është në interes të debatit publik.

Sugjerohet në atë se është tejet interesant dallimi të cilin e bën Gjykata ndërmjet autorit të deklaratës dhe rolit të mediave dhe shtypit si shpërndarje dhe përhapje të këtyre deklaratave dhe informatave tjera relevante. Ky dallim mundëson mbrojtje më të fortë të shtypit dhe mundëson që të sigurohet roli i tyre kryesor si shpërndarës të mendimeve të ndryshme, përfshirë edhe ato kontraverse. Kjo ka rëndësi të veçantë sepse secila ndërhyrje e rëndësishme ose sanksionim i medimeve për përhapjen e informatave të caktuara do të ketë potencialisht ndikim frikësues ndaj shtypit.

Sullas dhe të tjerë kundër Francës (Kërkesa ankimore nr. 15948/03) e 10 korrikut 2008

Shënim për procedurën:

Ankuesit (z.Xhil Sulas dhe g.Gijom Feje - shtetas francez dhe kompania Société Européenne de diffusion et d'édition - e regjistruar në Paris) kanë parashtruar ankesë kundër Francës më datë 6 maj të vitit 2003. Gjykata ka mbajtur seancë më 27 maj dhe 17 qershor të vitit 2008.

Rezime e fakteve:

Ankuesit kanë qenë të përfshirë në botimin e librit “Kolonizimi i Evropës” me nëntitull “Vërejtjet e vërteta të imigrimit dhe islamit”. Dy ankuesit e parë ishin dënuar në cilësitë e tyre përkatëse të autorit (ankuesi i parë) dhe botuesit (ankuesi i dytë) për nxitjen e urrejtjes dhe dhunës kundër komuniteteve jomuslimane nga Afrika Veriore dhe Qendrore, me ç'rast secili prej tyre është urdhëruar të paguajë dënim prej 7.500 eurosh dhe shuma simbolike për dëmtim të Lidhjes Ndërkombëtare Kundër Racizmit dhe Antisemitizmit dhe Lëvizjes Kundër Racizmit dhe Miqësisë Ndërmjet Popujve. Ankuesi i tretë është dënuar me përgjegjësi civile.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesit janë ankuar për shkeljen e të drejtës së tyre të lirisë së shprehjes (neni 10).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata në veçanti ka vërejtur se gjykatat vendore u kanë kushtuar vëmendje nocioneve që janë përdorur në libër, e që kanë pasur për qëllim që të shkaktojnë ndjenjë të averzionit të lexuesit, që është përkeqësuar me përdorimin e shprehjeve ushtarake dhe etiketimit të komuniteteve në fjalë si armiq që i shpie lexuesit në zgjidhje të luftës për pushtime të serishme etnike. Në këtë kuptim, Gjykata ka konstatuar se bazat për gjykim në të cilat bazohen gjykatat vendore kanë qenë të mjaftueshme dhe relevante, e që ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes së ankuesve është e domosdoshme në një shoqëri demokratike. Së këndejmi, Gjykata ka vlerësuar se nuk ka shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Sulas dhe tjerë kundër Francës i tregon kufijtë e domosdoshëm të shteteve që kanë të drejtë t'i vendosin për lirinë e shprehjes, kur ajo shfrytëzohet për diskriminim dhe nxitje të urrejtjes në bazë racore. Rastet veçanërisht e njohin nevojën e një margjine të gjerë të vlerësimit (diskriminimit) të shtetit në sigurimin e mbrojtjes dhe paqes sociale dhe rendit publik, veçanërisht për çështjet lidhur me integritet politik dhe imigrimet. Rastet tregojnë se shfrytëzimi i lirisë së shprehjes për të përcjellë ndjenjë të refuzimit kundër një grupi të caktuar, veçanërisht duke përdorur fjalë të fuqishme dhe duke e paraqitur grupin si armik, nuk përputhet me vlerat e Konventës. Sugjerohet në faktin se vendimi ka rol të rëndësishëm në përsëritjen se përdorimi i lirisë së shprehjes që ka për qëllim diskriminim, nxitjen e urrejtjes ose ksenofobisë, nuk mund të garantojë mbrojtje sipas nenit 10.

Feret kundër Belgjikës, kërkesë ankimore (Kërkesa ankimore nr. 15615/07), e 16 korrikut 2009

Shënim për procedurën:

Ankuesi (z. Daniel Feret), shtetas belg, ka parashtruar ankesë kundër Mbretërisë së Belgjikës më datë 29 mars të vitit 2007, me ç'rast Gjykata ka mbajtur seancë më datë 16 qershor të vitit 2009.

Rezime e fakteve:

Ankuesi ka qenë kryetar i partisë "Fronti Kombëtar (Front National-Nationaal Front)" dhe anëtar i Dhomës Përfaqësuese belge në Parlamentin e Belgjikës. Gjatë fushatës parazgjedhore, partia e tij ka shpërndarë fletushka dhe pllakate në të cilët janë prezantuar komunitetet imigruese joevropiane si të prira ndaj krimin të cilët i shfrytëzojnë përfitimet e jetës në Belgjikë, duke i përqeshur njëkohësisht. Këto fletushka kanë shpjerë në ankesa për nxitjen e urrejtjes, diskriminimit dhe dhunës. Imuniteti i deputetit i ankuesit ishte shfuqizuar, ndërsa kundër tij si autor dhe redaktor kryesor dhe përgjegjës për fletushkat, është ngritur procedurë penale. Ankuesi është dënuar me 250 orë pune publike, lidhur me integritetin e imigrantëve dhe 10 muaj dënim me burgim me kusht dhe është shpallur si i papërshtatshëm të kandidohet për deputet në 10 vitet e ardhshme.

Ankesa e ankuesit drejtuar Gjykatës

Ankuesi është ankuar për shkeljen e të drejtës së tij të lirisë së shprehjes.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se ndërhyrja në të drejtën e ankuesit të lirisë së shprehjes është e përcaktuar me ligj dhe ka pasur qëllim legjitim për të penguar parregullsi dhe që të mbrohen të drejtat e tjerëve. Gjykata ka përsëritur se për nxitje të urrejtjes nuk duhet të thirret vetëm në dhunë, mjaftojnë ofendimet, përqeshjet dhe shpifjet ose edhe nxitja, diskriminimi ndaj një grupi të caktuar. Gjykata në veçanti e ka marrë parasysh pozitën e ankuesit si deputet dhe faktin se fletushkat janë shpërndarë si pjesë e fushatës zgjedhore (sipas kësaj, janë dedikuar për tërë popullatën).

Gjykata ka konfirmuar se për lirinë e shprehjes politike nevojitet nivel i lartë i mbrojtjes, veçanërisht nëpërmjet mekanizmave siç është imuniteti parlamentar, madje edhe kur idetë e partive politike e kanë shokuar, ofenduar ose shqetësuar popullatën.

Megjithatë, konteksti zgjedhor mund të kontribuojë për nxitjen e urrejtjes dhe mostolerancës kur liria e shprehjes përdoret në mënyrë të dëmshme. Gjykata ka vërejtur se formulimi i teksteve të kontestueshme paraqet nxitje të qartë për urrejtje dhe diskriminim racor, së këndejmi ndërhyrja në të drejtën e ankuesit është bërë duke synuar nevojë të domosdoshme shoqërore dhe këto motive kanë qenë të mjaftueshme dhe të konsiderueshme. Gjykata gjithashtu ka konkluduar se ndërhyrja ka qenë e domosdoshme për shoqërinë demokratike, ku me 4 vota “pro” dhe 3 “kundër” ka konstatuar se nuk ka shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Rasti paraqet shembull që dëshmon se sa ka rëndësi të merret parasysh identiteti i kreatorit të deklaratës, ndikimi i tij, ndikimi i deklaratës dhe fushëveprimi i publikut potencial, gjatë përcaktimit nëse përzjerja në zbatimin e lirisë së shprehjes ka qenë e arsyeshme. Edhe pse me rastin përsëritet rëndësia e lirisë së shprehjes në kontekstin e fjalimit politik, ai gjithashtu është konfirmim i seriozitetit të fushëveprimit më të gjerë të ndikimit që mund ta ketë fjalimi kur është dhënë në kontekstin politik. Veçanërisht në kontekstin e zgjedhjeve, që mund ta përkeqësojë urrejtjen dhe mostolerancën, që mund ta nxit fjalimin. Së këndejmi, ky rast e shfaq baraspeshimin që Gjykatat mund ta arrijnë gjatë sigurimit të lirisë së fjalimit politik, njëkohësisht duke siguruar se kjo liri nuk do të shfrytëzohet në mënyrën që do të nxisë urrejtjen ose dhunën.

Le Pen kundër Francës, kërkesë ankimore (Kërkesa ankimore nr. 18788/09), 20 prill 2010 (vendimi për lejueshmëri)

Shënim për procedurën:

Ankuesi (z. Zhan-Mari Le Pen), shtetas francez, kishte parashtruar ankesë kundër Francës më 3 prill 2009, për të cilën Gjykata ka diskutuar më 20 prill 2010.

Rezume e fakteve:

Ankuesi ka qenë kryetar i partisë politike franceze “Fronti Nacional (Front National)” dhe ishte dënuar me 10.000 euro në vitin 2005 për nxitjen e diskriminimit, urrejtjes dhe dhunës ndaj një grupi të njerëzve për shkak të prejardhjes së tyre, përkatësisë ose jopërkatësisë në grupin e caktuar etnik, kombin, racën ose religjionin. Ky gjykim konkretisht u referohet deklaratave të dhëna gjatë intervistës për gazetën franceze Le Monde. Në vitin 2008, ankuesi përsëri ishte dënuar me të njëjtën shumë për deklaratën tjetër që i referohej dënimit fillestar në gazetën ditore (Rivarol). Gjykata e Kasacionit e ka hedhur poshtë ankesën e parashtruar nga ankuesi.

Ankesa e ankuesit në Gjykatë

Ankuesi ishte ankuar për shkeljen e të drejtave të tij në pajtim me nenin 10 (e drejta e lirisë së shprehjes) dhe nenin 6 paragrafi 1 (e drejta e gjyqimit të drejtë).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata nuk e ka sjellë në pikëpyetje faktin se përzjerja në të drejtën e lirisë së shprehjes së ankuesit, që ka pasur formën e gjyqimit penal, ishte përcaktuar me ligj dhe kishte qëllim legjitim për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve.

Gjykata e ka përsëritur rëndësinë e lirisë së fjalës në shoqërinë demokratike, veçanërisht në kontekstin e debateve politike, sikur ato kur personi në fjalë është zgjedhur deputet, me ç'rast Gjykata duhet të zbatojë mbikëqyrje të repte ndaj intervenimit të përjetuar.

Gjykata në veçanti e ka marrë parasysh kontekstin në të cilën ishin dhënë deklaratat, si dhe liria e domosdoshme për veprim që i ishte dhënë shtetit për të vlerësuar se si është përzierja e domosdoshme në kontekste të tilla. Gjykata ka vërejtur se deklarata e ankuesit, si tërësi, ka nxitur ndjenjën e refuzimit ose mohimit dhe armiqësisë dhe e paraqet bashkësinë fetare në tërësi si kërcënim për dinjitetin dhe sigurinë e popullsisë franceze. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata ka konstatuar se përzierja ishte imponuar për shkak të motiveve të rëndësishme dhe të mjaftueshme dhe si e tillë nuk paraqet shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Potencohet në faktin se ky rast bën pjesë në praktikën e vendosur gjyqësore në Strasburg, që refuzon të pranojë çfarëdo forme të gjuhës së urrejtjes në kontekstin e debateve politike dhe refuzon të pranojë se fjalimi i tillë politik bën pjesë në mbrojtjen e nenit 10. Ky rast përsërit se sa është e rëndësishme të zbatohet kontrolli i rreptë për secilën formë të përzierjes në lirinë e shprehjes në kontekstin e debateve politike. Kështu, rasti insiston në rolin konkret të politikanëve dhe ndikimit të gjerë potencial të shfrytëzimit të tyre të së drejtës së lirisë së shprehjes. Potencohet fakti se ky rast është shembull që i dëshmon obligimet që i kanë politikanët për të siguruar se shfrytëzimi i tyre i lirisë së fjalimit politik nuk do të nxisë qëllimisht urrejtjen dhe mostolerancën ndaj grupit të caktuar.

Perinçek kundër Zvicrës, (Kërkesa ankimore nr. 27510/08), më 15 tetor 2015 (Këshilli i Madh)

Shënim për procedurën:

Ankuesi (z. Dogu Perinçek), shtetas turk, kishte parashtruar ankesë më 10 qershor 2008 kundër Zvicrës. Këshilli i Madh kishte mbajtur seancë jopublike për këtë rast më 28 janar dhe 9 korrik 2015.

Në aktgjykimin paraprak të Këshillit më 17 dhjetor 2013, Gjykata me 5 vota “për” dhe 2 “kundër” kishte thënë se kishte shkelje të nenit 10 të Konventës.

Rezime e fakteve:

Ankuesi ishte kryetar i Partisë Punëtore Turke. Në vitin 2005 ai kishte marrë pjesë në disa konferenca të organizuara në Zvicër, në të cilat publikisht e kishte mohuar gjenocidin ndaj armenëve nga ana e Perandorisë Osmane në vitin 1915 dhe viteve në vijim, duke konsideruar se ideja mbi gjenocidin armen është “gënjeshtër ndërkombëtare”. Shoqata Zvicër-Armeni kishte parashtruar kallëzim penal kundër ankuesit, për këtë arsye i ishte urdhëruar të paguajë dënim prej nëntëdhjetë gjobave ditore prej 100 frangave zvicerane, ishte suspenduar për 2 vjet, ishte dënuar me 3.000 franga zvicerane, dënim që kishte mundur edhe të zëvendësohet me dënim me burgim prej 30 ditëve dhe kompensim prej 1.000 frangave zvicerane për shoqatën.

Ankesa e ankuesit në Gjykatë:

Ankuesi ishte ankuar se dënimi dhe gjykimi i tij penal në Zvicër e kishin shkelur të drejtën e tij të lirisë së shprehjes (neni 10) dhe të drejtën e tij që të mos dënohet pa ligj (neni 6).

Vendimi i Gjykatës:

Lidhur me zbatimin e nenit 17 për këtë rast, Gjykata ka vërejtur se çështja relevante ishte nëse deklarata e ankuesit kishte për qëllim të nxisë urrejtje ose dhunë dhe më pak ai ishte tentuar të mbështetet në Konventë me qëllim që të marrë pjesë në aktivitetet, qëllimi i të cilave ishte prishja e të drejtave dhe lirive të promovuar me Konventën. Gjykata ka vërejtur se kjo çështje ka mundur të konstatohet vetëm së bashku me arsyeshmërinë e ankesës së ankuesit në pajtim me nenin 10.

Gjykata ka konstatuar se përzierja në të drejtën e ankuesit për lirinë e shprehjes kishte qenë e përcaktuar me ligj dhe ishte bërë duke synuar qëllimin legjitim për mbrojtjen e së drejtës së të tjerëve.

Lidhur me domosdoshmërinë e përzierjes në shoqërinë demokratike, Gjykata kishte vërejtur se ishte dashur të konstatohet nëse përzierja që kishte përjetuar ankuesi ishte e domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, në këtë rast të drejtave të armenëve për ta respektuar dinjitetin e tyre dhe dinjitetin e paraardhësve

të tyre, përfshirë edhe të drejtën për respektimin e identitetit të tyre (të interpretuar lidhur me qëndrimin se ky është komuniteti që kishte përjetuar gjenocid). Duke marrë parasysh këtë, Gjykata ka vërejtur se baraspesha që duhet të arrihet është ndërmjet së drejtës së ankuesit sipas nenit 10 dhe të drejtave të armenëve për privatësi sipas nenit 8.

Gjykata ka vërejtur se deklaratat e ankuesit ishin dhënë në kontekstin e debatit të ashpër dhe nuk i kishte përjetuar si formë e nxitjes së urrejtjes ose mostolerancës. Gjykata nuk ka konsideruar se këtu mund të zbatohet supozimi i njëjtë sikur edhe në lidhje me deklaratat e dhëna lidhur me Holokaustin, meqë u referohet deklaratave të dhëna në Zvicër, lidhur me ngjarjet në territorin e Perandorisë Osmane. Gjykata ka vërejtur se kundërthënia e deklaratës nuk e tangon jetën politike në Zvicër, as që ka dëshmi për kontekstin me ndjeshmëri të veçantë që i referohet kësaj çështjeje në periudhën kohore relevante. Gjykata ka vërejtur se koncepti i proporcionalitetit që është karakteristik me frazën “e domosdoshme për shoqërinë demokratike” kishte kërkuar lidhje të arsyeshme ndërmjet masave të ndërmarra dhe qëllimit të dëshiruar. Gjykata ka vërejtur se deklaratat e ankuesit që janë lexuar si tërësi dhe janë kuptuar në kontekstin e tyre të drejtpërdrejtë dhe të gjerë, nuk mund të konsiderohen thirrje për urrejtje, dhunë ose mostolerancë ndaj armenëve.

Gjykata ka vërejtur se ankuesi ishte dënua penalisht që paraqet formën më serioze të përzierjes në të drejtën e lirisë së shprehjes. Duke i marrë parasysh këta elementë të ndryshëm, Gjykata ka vërejtur se deklarata e ankuesit i referohej çështjes me interes publik dhe nuk ka qenë thirrje për urrejtje, mostolerancë ndaj dhunës. Nuk ka dëshmi për kontekstin e thekseve të veçanta historike ose tensionit të rritur në Zvicër për shkak që nevojitet reagim penal nga Zvicra. Sipas kësaj, Gjykata ka vlerësuar se përzierja nuk ishte e domosdoshme në shoqërinë demokratike, me ç’rast me 10 vota “për” dhe 7 “kundër” ka konkluduar se ka shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Ky rast mund të konsiderohet si zgjerim i lirisë së shprehjes, veçanërisht sepse imponon kontroll të rreptë të asaj që nënkupton përzierje që është e domosdoshme në shoqërinë demokratike. Veçanërisht duke u kushtuar vëmendje faktorëve gjeografikë dhe historikë, si dhe kornizës kohore në të cilën ishin dhënë deklaratat e kontestuara, ky rast dallohet nga praktika paraprake gjyqësore e Gjykatës, veçanërisht sepse ka të bëjë me negacionizmin lidhur me Holokaustin. Duke konstatuar se Zvicra nuk e ka treguar kontekstin e nevojshëm gjeografik ose historik që do ta arsyetonte përzierjen në lirinë e shprehjes së ankuesit, Gjykata në këtë rast i ka theksuar kushtet e rrepta që duhet duhet të përmbushen për të arsyetuar përzierjen në lirinë e shprehjes.

Shimuniq kundër Kroacisë, kërkesa ankimore (Kërkesa ankimore nr. 20373/17), 22 janar 2019 (vendimi për lejueshmëri)

Shënim për procedurën:

Ankuesi, shtetas kroat, kishte parashtruar kërkesë ankimore kundër Kroacisë më 9 mars 2017. Gjykata kishte mbajtur seancë më 22 janar 2019.

Rezime e fakteve:

Ankuesi ishte futbollist dhe ishte dënua për dërgimin e porosive shikuesve gjatë ndeshjes së futbollit, për të cilët ishte konsideruar se shprehin ose nxisin urrejtje në bazë të racës, nacionalitetit dhe fesë. Ankuesi ishte dënua për afërsisht 3.300 euro.

Ankesa e ankuesit në Gjykatë

Ankuesi ishte ankuar për shkeljen e së drejtës së tij të lirisë së shprehjes në pajtim me nenin 10.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata kishte vërejtur se aktgjykimi kundër ankuesit ishte përzierje e përcaktuar me ligj dhe kishte qëllim legjitim të pengojë parregullsinë dhe të luftojë kundër racizmit dhe diskriminimit në ndeshjet sportive.

Gjykata ka vërejtur se organi kompetent nacional e ka bazuar vendimin e vet në baza relevante dhe të mjaftueshme gjatë gjykim-it të ankuesit. Konkretisht ishte konstatuar se shprehja që kishte shfrytëzuar ankuesi ishte shfrytëzuar si përshëndetje zyrtare e lëvizjes ustashe dhe regjimit totalitar të Shtetit të Pavarur të Kroacisë, për çka Gjykata ka konstatuar se bazohet në fashizëm dhe racizëm, mes tjerash, duke simbolizuar urrejtje ndaj personave me religjion të ndryshëm ose identitet etnik. Gjykata në Strasburg e ka vërejtur rolin e ankuesit si futbollist i njohur që në mënyrë shtesë e ka rritur ndikimin negativ potencial me sjelljen provokuese.

Njëherazi, Gjykata ka theksuar se dënimi i shqiptuar nuk ishte joproporcional. Në këtë drejtim, Gjykata ka konstatuar se gjykata vendase në mënyrë të drejtë e ka baraspeshuar të drejtën e ankuesit për lirinë e shprehjes dhe interesin e shoqërisë për promovimin e tolerancës dhe respektimit të ndërsjellë, si dhe luftën kundër diskriminimit. Gjykata nuk ka konstatuar shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Ky rast mund të konsiderohet kufizim i lirisë së shprehjes, meqë ishte përcaktuar se deklarata e kontestuar është gjuhë e urrejtjes dhe nuk bën pjesë në mbrojtjen nga neni 10. Edhe pse ky vendim mund të jetë i kundërt nëse krahasohet me praktikën gjyqësore paraprake të Gjykatës dhe qëndrimin e tij se deklaratat që ofendojnë, shokojnë ose brengosin, gjithashtu, janë pjesë e mbrojtjes nga neni 10, sugjerohet fakti se ky vendim mbetet konsekuent. Me të vërtetë, në rastin konkret Gjykata i kushton vëmendje kontekstit historik dhe gjeopolitik konkret në të cilën ishte dhënë deklarata, veçanërisht duke i marrë parasysh tensionet ndëretnike që ishin theksuar në kohën kur ishte dhënë deklarata e kontestuar.

Gjuha e urrejtjes dhe interneti

VIII.

Delfi AS kundër Estonisë, kërkesë ankimore (Kërkesa ankimore nr. 64569/09), më 16 qershor 2015 (Këshilli i Madh)

Shënim për procedurën:

Ankuesi (Delfi AS), shoqëria publike me përgjegjësi të kufizuar, të regjistruar në Estoni, kishte parashtruar ankesë kundër Republikës së Estonisë më 4 dhjetor 2009. Gjykata kishte mbajtur seancë më 9 korrik 2014 dhe 18 mars 2015.

Me vendim të Këshillit më 10 tetor 2013, Gjykata njëzëri kishte konstatuar se nuk kishte shkelje të nenit 10.

Rezyme e fakteve:

Kompania ankuese ishte pronare e një prej portaleve më të mëdha të internetit për lajme në Estoni. Në vitin 2006, pas publikimit të artikullit në portal lidhur me kompaninë feribot, komentet që përmbanin kërcënime personale dhe fjalë ofenduese të drejtuar ndaj pronarit të kompanisë feribot të cilat ishin publikuar nën artikullin. Si rezultat i kësaj, ishte iniciuar procedurë për shpifje kundër kompanisë ankuese dhe ishin urdhëruar të paguajnë dënim në para prej 320 euro.

Ankesa e ankuesit në Gjykatë

Kompania ankuese ishte ankuar për shkeljen e të drejtave të saj për lirinë e shprehjes (neni 10).

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka vërejtur se komentet për të cilat bëhet fjalë paraqesin gjuhë të urrejtjes dhe nxitje të drejtpërdrejtë të dhunës që ka shkaktuar shqetësim të konsiderueshëm në publik. Vëlimi i vendimit të Gjykatës këtu ishte kufizuar në përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të portalit të internetit për lajme.

Gjykata ishte bindur se përzierja në të drejtën e kompanisë ankuese ishte përcaktuar me ligj dhe ishte konsideruar e domosdoshme, veçanërisht pasi me pjesëmarrjen e kompanisë ankuese në publikimin e komenteve në portal, kompania ankuese kishte rol më të madh se ajo e ofruesit pasiv të shërbimeve teknike. Njëherazi, gjykata ka vërejtur se sanksioni prej 320 euro nuk mund të konsiderohet joproporcional me shkeljen. Së këndejmi, Gjykata ka vlerësuar se përzierja e imponuar e kompanisë ankuese bazohet në bazë relevante dhe të mjaftueshme dhe nuk paraqet kufizim joproporcional të së drejtës së lirisë së shprehjes. Kështu, me 15 vota “për” dhe 2 “kundër” gjykata ka konkluduar se nuk ka shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Rasti është vendim udhëheqës lidhur me portalet e internetit për lajme dhe përgjegjësinë e tyre për komentet e personave të tretë. Vendimi duhet të ndikojë në atë mënyrë që do të imponohet përgjegjësia për portalet e internetit për lajme që kryejnë kontroll të caktuar ndaj komenteve. Për këtë qëllim, portalet e internetit duhet të kenë mekanizëm efektiv për të siguruar kontrollin dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe imponohet rreziku për përgjegjësinë e çdo komenti që mund të paraqesë formën e gjuhës së urrejtjes.

Vendimi është tentim për të vendosur baraspeshë ndërmjet lirisë së shprehjes së portalit të brendshëm, si dhe shfrytëzuesve të portalit të internetit (komentuesit dhe të tjerët) me të drejtat dhe reputacionin e të tjerëve. Mirëpo, është kontestuese që deri në shkallë të caktuar mund të konsiderohet se vendimi ka ndikim të dëmshëm ndaj lirisë së shtypit. Rreziku nga përgjegjësia potenciale mund të ketë ndikim të dëmshëm sepse do t'i detyrojë portalet e internetit që të ndalojnë çfarëdo qoftë komentesh në publikimet dhe artikujt e tyre me qëllim që të shmangjet përgjegjësia për të theksuarën, si rezultat i asaj që do të kufizohet mundësia për ndarjen e qëndrimeve dhe mendimeve të ndryshme, përfshirë edhe ato që janë në kufijtë e nenit 10.

**Magyar Tartalomsszolgáltatók
Egyesülete dhe Index.hu Zrt kundër
Hungarisë (Kërkesa ankimore nr.
22947/13) më 2 shkurt 2016**

Shënim për procedurën:

Rasti rrjedh nga kërkesa ankimore kundër Hungarisë që ishte parashtruar nga ankuesit (dy persona juridikë të regjistruar sipas së drejtës hungareze) më 28 mars 2013, ndërsa ishte shqyrtuar nga Gjykata në seancën jopublike më 5 janar 2016.

Rezyme e fakteve:

Ankuesi i parë ishte trup vetërregullues i ofruesve (provajderëve) të përmbajtjeve në internet, ndërsa ankuesi i dytë ishte pronar i portalit të internetit për lajme. Portalët e ankuesve kanë lejuar publikimin e komenteve nga shfrytëzuesit që nuk ishin redaktuar ose moderuar nga ana e ankuesve para publikimit, të dy portalët kishin përmbajtur mohimet e përgjegjësisë lidhur me komentet dhe kishin sistem të njoftimit dhe mënjanimit që u ka mundësuar shfrytëzuesve të kërkojnë të fshihet ndonjë koment i caktuar.

Në vitin 2010, ankuesi i parë kishte publikuar mendim lidhur me ueb faqet për menaxhimin e patundshmërive, për të cilën teksti ishte publikuar edhe në portalin e ankuesit të dytë. Artikulli kishte tërhequr komente nga shfrytëzuesit që kishin shfrytëzuar nocione fyese që sollli në procedurën civile kundër ankuesve nga ana e kompanisë që menaxhon me ueb faqet të cilave u referohen artikujt. Ankuesit i kanë mënjanuar komentet ofenduese, por përsëri ishin shpallur përgjegjës nga ana e gjykatave vendase dhe u ishte imponuar të paguajnë taksa për procedurën.

Ankesa e ankuesit në Gjykatë

Ankuesit ishin ankuar për shkeljen e të drejtave të tyre në pajtim me nenin 10 (liria e shprehjes).

Vendimi i Gjykatës

Nga Gjykata ishte kërkuar të vlerësojë nëse është arritur baraspesha adekuate ndërmjet të

drejtave të ankuesve të lirisë së shprehjes në pajtim me nenin 10 dhe të drejtën e reputacionit të paditësit në pajtim me nenin 8.

Gjykata ka marrë parasysh kontekstin në të cilin ishin publikuar komentet, duke theksuar se artikulli i referohej çështjes me interes publik. Njëherazi, gjykata ka vërejtur se edhe pse komentet e kontestuara përmbajnë shprehje vulgare, ato kanë stil të regjistrit (variacioni i gjuhës sipas kontekstit), i cili më shpesh ishte përdorur në portalet e internetit, dhe sipas kësaj, mund të zvogëlohet ndikimi që u shënohet. Gjykata, gjithashtu, ka vërejtur se gjykatat vendase nuk kanë filluar analizën e proporcionalitetit për të përcaktuar përgjegjësinë adekuate të autorëve të komenteve dhe ankuesve.

Gjykata ka vërejtur se ankuesit menjëherë i kanë refuzuar komentet pasi ishin njoftuar me procedurën civile dhe kishin mekanizëm të përgjithshëm për parandalimin ose mënjanimin e komenteve shpifëse. Duke marrë parasysh këtë, Gjykata ka konsideruar se për vendimin e gjykatës vendase nevojitet shqyrtim i kujdesshëm tej mase dhe i përzemërt që e kishte nënvlerësuar ndikimin e lirisë së informatave në internet. Gjykata veçanërisht e ka marrë parasysh ndikimin potencial frikësues ndaj lirisë së shprehjes në Internet, që mund të dalë si formë e përgjegjësisë objektive për komentet e personave të tretë.

Duke marrë parasysh mungesën e gjuhës së urrejtjes ose kërcënimit e drejtpërdrejta, Gjykata ka konstatuar se komentet ishin përcjellë me procedura efektive që mundësojnë përgjigje të shpejtë, ekzistimin e mekanizmit të njoftimit dhe mënjanimit vetvetiu që do të siguronte mbrojtje të realizueshme për reputacionin e paditësit. Së këndejmi, përzierja në të drejtën e ankuesit për lirinë e shprehjes ishte në kundërshtim me nenin 10.

Koment për vendimin

Ky rast mund të konsiderohet mbrojtje e lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit deri në atë shkallë që ishte përcaktuar se zgjerimi i përgjegjësisë së portaleve të internetit për lajme duke imponuar përgjegjësi të rreptë për komentet e personave të tretë do të paraqesë shkelje të nenit 10 të Konventës.

Sugjerohet në atë se Gjykata mundohet të arrijë baraspeshë të drejtë ndërmjet mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve. Sipas Gjykatës, në këtë rast, me ekzistimin e mekanizmave efektivë që kanë mundësuar largimin e komenteve, që shpejtë mund të realizohen, ishin përmbushur obligimet dhe përgjegjësia e ueb portaleve sipas Gjykatës. Krahas kësaj, në rastin konkret komentet e kontestuara në mënyrë të qartë nuk kishin përbërë fjalim joligjor. Sipas kësaj, ekzistimi i mekanizmave për largimin e komenteve kontestuese ishte e mjaftueshme që portalet ta përmbushin përgjegjësinë e tyre.

Pihl kundër Suedisë, kërkesë ankimore (Kërkesa ankimore nr. 74742/14), 7 shkurt 2017 (vendim për lejueshmëri)

Shënim për procedurën:

Ankuesi, shtetas suedez, kishte parashtruar kërkesë ankimore kundër Suedisë më 22 nëntor 2014, për të cilën GJEDNJ-ja kishte mbajtur seancë më 7 shkurt 2017.

Rezyme e fakteve:

Në publikimin në blog, ankuesi ishte akuzuar se ishte përfshirë në parti naziste, ku më pas me komentimin e publikimit e kishte akuzuar se është “i varur nga hashashi”. Me kërkesë të ankuesit dhe publikimit të blogut dhe komentit ishin fshirë, ndërsa shoqata që e ka mbajtur blogun kishte publikuar publikim me kërkim falje. Ankuesi kishte iniciuar procedurë civile kundër shoqatës; kjo procedurë ishte hedhur poshtë, si dhe kërkesa ankimore e ankuesit në Zyrën e Drejtësisë, për kompensimin e dëmit pasi shteti nuk e kishte përmbushur obligimin e vet pozitiv për ta mbrojtur jetën private të ankuesit.

Ankesa e ankuesit në Gjykatë

Ankuesi ishte ankuar për shkeljet në pajtim me nenin 8 të Konventës, duke pohuar se është shkelur e drejta e tij e respektimit të jetës së tij private.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata ka konstatuar se është arritur baraspesha adekuate ndërmjet të drejtës së ankuesit për respektimin e jetës së tij private dhe së drejtës së shoqatës për lirinë e shprehjes. Gjykata në veçanti ka marrë parasysh se shoqata nuk ka mund të parashikojë komentin, veçanërisht meqë nuk ishte i lidhur drejtpërdrejt me përmbajtjen e publikimit. Krahas kësaj, komenti nuk ishte gjuhë e urrejtjes ose nxitje e dhunës. GJEDNJ-ja, gjithashtu, ka theksuar se shoqata e ka larguar publikimin dhe komentin vetëm një ditë pasi ishte njoftuar nga ankuesi dhe kishte publikuar kërkim falje. Gjykata e ka përsëritur ndikimin potencial frikësues ndaj lirisë së shprehjes që mund të kishte shkaktuar nga përgjegjësia e internetit për komentet e personave të tretë.

Duke marrë parasysh këtë, Gjykata ka konstatuar se nuk ka shkelje të të drejtave të ankuesit në pajtim me nenin 8 të Konventës.

Koment për vendimin

Ky rast duhet të ketë ndikimin e vet ashtu që do të bëhet dallimi ndërmjet fjalimit të qartë joligjor si në rastin *Delfi*, në të cilin rast uebportali mund të ketë përgjegjësi pa marrë parasysh njoftimin, dhe format e tjera të fjalimit, të cilat edhe pse janë vulgare dhe ofenduese, është e qartë se nuk janë joligjore, sikur edhe në rastin konkret, ku obligimi për largimin e komentit del vetëm pasi portali e ka vërejtur komentin ose ka mund të parashikojë nëse komenti përmban shpifje. Sugjerohet në atë se dallimi i tillë ka për qëllim të sigurojë baraspeshë të drejtë ndërmjet mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së të drejtave dhe reputacionit të të tjerëve.

Njëherazi, theksohet se është vështirë të vendoset kjo baraspeshë meqë çdo formë e përgjegjësisë serioze ose përgjegjësisë që u imponohet ndërmjetësuesve, siç janë uebportalet për lajme, mund të ketë ndikim frikësues ndaj lirisë së shtypit.

Smajiq kundër Bosnjë e Hercegovinës, (Kërkesa ankimore nr. 48657/16) më 18 janar 2018 (vendim për lejueshmëri)

Shënim për procedurën:

Ankuesi është shtetas i Bosnjë e Hercegovinës, i cili kishte parashtruar kërkesë ankimore kundër Bosnjë e Hercegovinës më 29 korrik 2016, për çka GJEDNJ-ja kishte mbajtur seancë më 16 janar 2018.

Rezyme e fakteve:

Pas publikimeve që i kishte bërë ankuesi në internet, ai ishte shpallur fajtor për nxitjen e urrejtjes nacionale, racore dhe fetare, përçarjes ose mostolerancës dhe kishte marrë dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 1 viti, ndërsa i ishin marrë kompjuteri dhe laptopi i tij personal.

Ankesa e ankuesit në Gjykatë

Ankuesi ishte ankuar për shkeljen e të drejtave të tij në pajtim me nenin 10 (liria e shprehjes) dhe nenin 6 paragrafët 1 dhe 3 (e drejta e gjyqimit të drejtë dhe e drejta e ndihmës juridike sipas përzgjedhjes personale)

Vendimi i Gjykatës

GJEDNJ-ja ka theksuar se gjykatat vendase e kanë analizuar rastin e ankuesit dhe se vendimi i tyre ishte miratuar në pajtim me parimet e nenit 10 dhe sipas kësaj, ata kishin siguruar motive relevante dhe të mjaftueshme për aktgjykimet e tij. Gjykata në veçanti e kishte marrë parasysh faktin se përmbajtja e publikimit të ankuesit u ishte referuar shumë çështjeve të ndjeshme lidhur me marrëdhëniet etnike në shoqërinë boshnjake të pasluftës. Njëkohësisht, Gjykata e kishte marrë parasysh faktin se dënimet e shqiptuara për ankuesin nuk ishin të tepruara. Së këndejmi, GJEDNJ-ja kishte theksuar se përzjerja ishte përcaktuar me ligj dhe se kishte qëllim legjitim për të mbrojtur reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve. Si e tillë, ankesa dukshëm ishte e pabazë.

Lidhur me ankesat e ankuesit në pajtim me nenin 6, Gjykata nuk ka përcaktuar se konsta-

timet e gjykatave vendase ishin arbitrare ose të paarsyeshme. Gjykata ka konstatuar se nuk ka shkelje të nenit 6.

Koment për vendimin

Ky rast ka rol të rëndësishëm në konstatimin e përgjegjësisë lidhur me gjuhën e urrejtjes në internet. Në dallim nga rastet e analizuara paraprakisht të cilat i referohen përgjegjësisë së uebportaleve për komentet e personave të tretë, *Smajiq kundër Bosnjë e Hercegovinës* ka të bëjë me përzjerjen në lirinë e shprehjes së ankuesit, kur ankuesi është autor i publikimeve të kontestuara. Së këndejmi, rasti paraqet shembull i cili dëshmon se komentet dhe publikimet në internet që përbëjnë gjuhën e urrejtjes nuk kanë dobi nga mbrojtja në pajtim me nenin 10.

Gjykata, gjatë miratimit të vendimit të vet, i ka kushtuar vëmendje të veçantë kontekstit socio-politik të asaj kohe (duke marrë parasysh marrëdhëniet e ndjeshme etnike në Bosnjën e pasluftës), si dhe nivelit të dënimit, gjatë përcaktimit nëse gjykatat vendase kanë vepruar në kuadër të margjinës së tyre të pranimit dhe proporcionalisht me qëllimin e dëshiruar legjitim.

Sava Terentjev kundër Rosisë, (Kërkesa ankimore nr. 10692/09) më 28 gusht 2018

Shënim për procedurën:

Ankuesi, shtetas rus, kishte parashtruar ankesë kundër Federatës Ruse më 5 janar 2009. GJEDNJ-ja ishte mbledhur si Këshill dhe kishte mbajtur seancë jopublike më 3 korrik 2018.

Rezyme e fakteve:

Ankuesi ishte bloger që kishte publikuar koment në internet në të cilin i kishte quajtur të gjithë nëpunësit policorë “të pagdhendur” dhe “përfaqësues torollak dhe më pak të arsimuar në botën shtazore”. Ai kishte thirrur për “djegjen e policëve të pafe në furrat e Aushficerit” për t’u “pastruar shoqëria nga kjo papastërti e policëve - bukëshkelës”. Si rezultat i këtyre

komenteve, ai ishte dënua për nxitjen e urrejtjes kundër nëpunësve policorë si grup dhe ishte dënua me dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 1 viti.

Ankesa e ankuesit në Gjykatë

Ankuesi ishte ankuar në shkeljen e së drejtës së tij të lirisë së shprehjes në pajtim me nenin 10.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata kishte supozuar se përzierja është përcaktuar me ligj dhe ka qëllim legjitim për mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të tjerëve.

GJEDNJ-ja e kishte vërejtur natyrën shumë vulgare dhe ofenduese të komenteve, por njëkohësisht e kishte marrë parasysh faktin se ato janë publikuar në kontekstin e diskutimit që u referohej çështjeve me interes të përgjithshëm, pra përfshirjen e nëpunësve policorë në heshtjen e opozitës gjatë fushatave zgjedhore.

Njëherazi, Gjykata ka theksuar se komentet e ankuesit nuk kanë sulmuar personalisht nëpunës që mund të identifikohet, por ish-in kritikë e policisë si institucion publik, që Gjykata nuk e konsideron grup të cilit i nevojitet mbrojtja e shtuar. Gjykata ka vërejtur se si organ shtetëror, policia duhet të ketë shkallë më të lartë të tolerancës ndaj fjalimit ofendues. Gjykata, gjithashtu, kishte konstatuar se nuk kishte kontekst publik konkret që do të dëshmojë ndjeshmëri të veçantë ndaj kësaj çështjeje, e as që ankuesi kishte ndikim të konsideruar publik meqë nuk ishte bloger i njohur. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se gjykatat vendase nuk kanë arritur t'i marrin parasysh faktet dhe faktorët relevantë, sepse nuk kanë dhënë arsyetime përkatëse dhe të mjaftueshme për përzierje në të drejtën e lirisë së shprehjes së ankuesit. Së këndejmi, përzierja ishte joproporcionale me qëllimin e dëshiruar legjitim.

Koment për vendimin

Ky rast e potencon lirinë e shprehjes, nëpërmjet përdorimit të komenteve në internet. Konkretisht, Gjykata kishte refuzuar të lejojë keqpërdorimin e së drejtës dhe të drejtave të Konventës, për kufizimin ose kontrollimin e lirisë së shprehjes. Konkretisht, Gjykata nuk kishte pranuar se liria e shprehjes mund të kufizohet

legjitimisht me qëllim që të kufizohen fjalimet ofenduese drejtuar forcave policore.

Kështu, Gjykata ka refuzuar ta konsiderojë policinë grup historik që mund të lidhet me minoritetet e pambrojtura ose grup që ka të drejtë për mbrojtjen nga fjalimi ofendues. Në fakt, ishte theksuar se si organ shtetëror, policia duhet të ketë shkallë më të lartë të tolerancës ndaj komenteve ofenduese. Duke marrë parasysh se deklaratat kontestuese nuk paraqesin sulm personal ndaj nëpunësve të cilët mund të identifikohen, por kritikë ndaj organit shtetëror si tërësi, margjina e kritikave ishte më e gjerë.

IX.

Ofendimi i nëpunësve shtetërorë

Stern Taullats dhe Roura Kapelera kundër Spanjës, (Kërkesa ankimore nr. 51168/15 dhe 51186/15) më 13 mars 2018

Shënim për procedurën:

Rasti rrjedh nga dy kërkesa ankimore kundër Mbretërisë së Spanjës, nga dy shtetas spanjollë të cilët i kishin parashtruar kërkesat e tyre në GJEDNJ më 2 tetor 2015. GJEDNJ-ja kishte mbajtur seancë më 13 shkurt 2018.

Rezyme e fakteve:

Gjatë demonstratave publike ankuesit kishin djegur fotografi të madhe të çiftit mbretëror. Ata ishin dënuar me burgim prej 15 muajve për ofendimin e Kurorës, që më pas ishte zëvendësuar me dënim prej 2.700 euro, ndërsa nëse ankuesit nuk e paguajnë dënimin në para, do të duhet ta vuajnë dënimin me burgim.

Ankesa e ankuesit në Gjykatë

Ankuesit ishin ankuar për shkeljen e së drejtës së tyre të lirisë së shprehjes sipas nenit 10, meqë dënimi ishte përzjerje e paarsyeshme në të drejtën e tyre të lirisë së shprehjes. Ankuesit, gjithashtu, ishin ankuar për shkeljet e së drejtës së tyre të lirisë së mendimit, vetëdijes dhe religjionit sipas nenit 9.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata kishte vërejtur se përzjerja që u ishte imponuar ankuesve ishte përcaktuar me ligj dhe ishte bërë duke synuar qëllimin legjitim për mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve.

GJEDNJ-ja kishte vërejtur se veprimi i ankuesve ishte bërë si pjesë e demonstrimit politik me interes të përgjithshëm (që i referohet pavarësisë së Katalonisë), ky nuk ishte sulm personal ndaj Mbretërisë së Spanjës, por dënim i mbretit si Udhëheqës dhe simbol i shtetit. Së këndejmi, kjo ka qenë pjesë e sferës së kritikës politike dhe përkonte me shprehjen e refuzimit ndaj monarkisë si institucion.

Gjykata ka vërejtur se qëllimi i ankuesve nuk ishte që të nxisin dikë për të kryer vepra të dhunshme ndaj mbretit. Edhe pse veprimet e tyre përfshinin djegien e fotografisë, Gjykata atë e konsideroi mjet të të shprehurit të mendimit në seancën që i referohet çështjes me interes publik. Në këtë kontekst, Gjykata kishte përsëritur se fushëveprimi i lirisë së shprehjes është i zgjeruar dhe përfshin ide dhe mendime që ofendojnë, shokojnë ose shqetësojnë.

Gjykata kishte vërejtur se veprimi i ankuesve nuk mund të interpretohet si nxitje e urrejtjes ose dhunës dhe si i tillë nuk ishte gjuhë e urrejtjes që bie në nenin 17 të Konventës.

Në fund, Gjykata kishte konstatuar se dënimi me burgim paraqet përzjerje që nuk është proporcionale me qëllimin e dëshiruar legjitim të domosdoshëm në shoqërinë demokratike. Së këndejmi, Gjykata ka konstatuar se nuk kishte shkelje të nenit 10.

Koment për vendimin

Ky rast paraqet shembull që e përcakton nivelin e lirisë së shprehjes që është e mbrojtur me Konventë, kur vepra e kontestuar mund të konsiderohet ofendim i nëpunësit shtetëror. Në këtë rast, është konsideruar se vepra e kontestuar ishte kryer në kontekstine demonstrimit politik që ishte me interes të përgjithshëm. Kjo vepër nuk ishte sulm personal ndaj mbretit, por vepër kundër monarkisë si institucion, andaj në pajtim me praktikën paraprake gjyqësore, Gjykata ka konstatuar se niveli më i lartë i kri-

tikës ishte i pranueshëm meqë vepra ishte orientuar kundër shtetit dhe pushtetit.

Vendimi e kishte potencuar rëndësinë e lirisë së shprehjes në debatet politike në shoqërinë demokratike. Duke marrë parasysh se vepra e kontestuar ishte kryer në kontekstin e demonstrimit, nuk përbënte vepër të dhunshme kundër mbretit, por vepër të demonstrimit politik dhe si e tillë është nën mbrojtje të nenit 10. Sipas kësaj, rasti e përsërit natyrën gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e lirisë së fjalimit politik, ku përfshin deklarime dhe vepra që mund të ofendojnë, të shokojnë ose të shkaktojnë shqetësim.

PJESA B – Krimi nga urrejtja

Korniza e Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut për veprat penale të urrejtjes dhe pasqyra e obligimeve shtetërore të cilat konkretisht u referohen veprave penale të urrejtjes.

Me interpretimin e aspekteve esenciale dhe procedurale të Konventës, Gjykata ka theksuar një numër të madh të obligimeve dhe pikave operative që janë specifike për veprat penale të urrejtjes, që duhet t'i ndjekin organet nacionale, policinë dhe profesionistët e drejtësisë penale, me qëllim që t'i përmbushin obligimet në pajtim me Konventën.

Para se gjithash, kjo i referohet obligimit për të zbatuar hetim të shpejtë dhe efektiv të veprave penale të motivuar nga anshmëria, përfshirë edhe detyrën për të hetuar dhe zbuluar motivimin e mundshëm joobjektiv. Kjo detyrë del lidhur me nenin 2 (të drejtën e jetës), nenin 3 (të drejtën e personit që të mos i nënshtrohet maltretimit) dhe nenin 8 (të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare) të shqyrtuar lidhur me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit). Zhvillimi i praktikës gjyqësore ka treguar se fushëveprimi i kësaj detyre procedurale u referohet veprave penale me lloje të ndryshme të paragjyqimeve diskriminuese, siç janë prejardhja racore dhe etnike, orientimi politik, fetar, seksual, identiteti gjinor, me aftësi të kufizuara dhe baza të tjera potencialisht të mbrojtura. Më tutje, Gjykata konkretisht ka potencuar se kjo detyrë vlen edhe për veprat e dënueshme që janë kryer nga faktorët shtetërorë, si dhe për veprat e dënueshme që janë kryer nga personat privatë.

Me vetë zhvillimin e praktikës gjyqësore, Gjykata ka saktësuar se detyra për zbulimin e motivimit të mundshëm joobjektiv e përfshin detyrën e autoriteteve që t'i marrin parasysh indikatorët e anshmërisë së kriminit të urrejtjes që sugjerojnë në faktin se vepra mund të ketë motive diskriminuese. Krahas kësaj, detyra procedurale për hetimin dhe zbulimin e motivimit të mundshëm joobjektiv përfshin edhe krimin e urrejtjes për shkak të asociacionit ose bashkimit dhe krimin e urrejtjes me më shumë motive. Është me rëndësi që Gjykata është referuar konkretisht edhe për nevojën që sistemi shtetëror për drejtësi penale të mund të hetojë në mënyrë përkatëse,

të përndjekë dhe të dënojë krimin e urrejtjes, si dhe rëndësinë e neutralitetit dhe paanshmërisë në punën e organeve të hetimit dhe përndjekjes gjatë ballafaqimit me veprat penale të urrejtjes. Të gjitha aspektet e lartpërmendura janë analizuuar në pjesën e mëposhtme në bazë të aktgjykimeve konkrete të Gjykatës.

a. Shteti ka për detyrë të zbatojë hetim të shpejtë dhe efektiv për veprat penale të motivuara nga anshmëria, përfshirë edhe detyrën që të hetojë dhe të zbulojë motivimin e mundshëm joobjektiv

Në vitin 2005, Gjykata duke mbajtur seancë si Këshilli i Madh, e kishte shqyrtuar rastin *Naçova kundër Bullgarisë*³⁹, në të cilin policia ushtarake bullgare, gjatë tentimit për arrestim, kishte vlarë dy shtetas bullgarë me prejardhje rome, rekrutë që para një kohe kishin ikur nga forcat ushtarake ndërtimore dhe për të cilët ishte ditur se nuk janë të armatosur.

Gjykata kishte konstatuar se Bullgaria nuk i ka përmbushur obligimet e veta nga neni 2, sepse korniza relevante nacionale juridike për përdorimin e forcës kishte qenë me gabime esenciale dhe sepse policia ushtarake kishte përdorur forcë të tepruar. Më tutje, Gjykata ka vërejtur se neni 2 nënkupton edhe **detyrë pozitive të organeve që të zbatojnë hetim zyrtar efektiv për veprat penale që e pengojnë të drejtën e jetës.**

Për këtë qëllim, organet duhet të veprojnë sipas bindjeve të tyre menjëherë pasi të njihen me lëndën, duhet të vërtetohen se personat përgjegjës që e zbatojnë hetimin janë të pavarur dhe të paanshëm dhe t'i bazojnë konkluzionet hetimore në analizë bazike, objektive dhe të paanshme për të gjithë elementët relevantë. Hetimi gjithashtu duhet të jetë efektiv në kuptim se mund të konkludohet nëse forca e përdorur ka qenë ose jo e arsyeshme në rrethanat dhe të identifikohen dhe dënohen personat përgjegjës. Moszbatimi i hetimit efektiv është e barabartë

39 NaçovakundërBullgarisë, Kërkesa ankimore nr. 43577/98 dhe nr. 43579/98.

me shkeljen e nenit 2, që ishte konstatuar edhe në këtë rast për shkak të mangësive të shumta në hetim.

Më tej, Gjykata e ka shqyrtuar nenin 14 lidhur me nenin 2. Ajo ka konsideruar se nuk mund të konstatohet se qëndrimet raciste kanë pasur ndonjë rol lidhur me vdekjen e dy burrave, andaj edhe nuk ka konstatuar shkelje të nenit 14 të shqyrtuar së bashku me nenin 2 në aspektine tij esencial.

Mirëpo, në këtë rast, Gjykata ka marrë qasje të re që e lidh shkeljen eventuale të nenit 14 me aspektet materiale dhe procedurale të nenit 2 veçmas. Andaj, nga aspekti procedural, Gjykata ka deklaruar se neni 14 nënkupton edhe **detyrë procedurale që në mënyrë përkatëse të hetohen edhe motivet e mundshme raciste**. Konkretisht, “organet shtetërore kanë detyrë plotësuese **që t’i ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të zbuluar çdo motiv racist** dhe të konstatohet nëse urrejtja ose paragjykimet etnike ndoshta kanë pasur rol në këto ngjarje. Në të kundërtën dhe nëse me dhunë dhe brutalitet të shkaktuar racor vepronet njësoj sikurse edhe me rastet që nuk kanë konotacion racist, ajo nënkupton anashkalim të vetëdijshëm të natyrës specifike të veprave që janë në veçanti destruktive për të drejtat themelore”.⁴⁰

Gjykata saktëson se gjithmonë kur ka fakte për rastin të cilat sugjerojnë në rolin e mundshëm të konotacionit racor të ngjarjeve, ajo duhet të kontrollohet dhe - nëse konfirmohet - të ndërmerret hulumtimi bazik i të gjitha fakteve me qëllim që të zbulohen të gjitha motivet e mundshme raciste.⁴¹

Në këtë rast, organet kompetente kanë disponuar me informata të besueshme që mjaftojnë për t’i paralajmëruar për nevojën të kryhet verifikimi fillestar për konotacion të mundshëm racor në ngjarjet që kanë sjellë vdekjen e dy burrave, respektivisht deklaratën e fqinjtit të viktimave i cili kishte thënë se, menjëherë pas krismave, polici kishte thënë “cigan i mallkuar”, derisa e mbante pistoletën të drejtuar nga ai.

Deklarata e këtillë, së bashku me raportet e shumta që janë botuar për ekzistimin e paragjykimëve dhe armiqësisë në të kaluarën ndaj romëve në Bullgari ka imponuar verifikimin. Mirëpo, autoritetet bullgare nuk kanë bërë asgjë për ta konfirmuar deklaratën e fqinjtit ose arsyet për të cilat ishte konsideruar se është e domosdoshme përdorimi i shkallës së tillë të forcës. Kjo ka mjaftuar që Gjykata të konkludojë se organet kompetente

nuk e kanë përmbushur detyrën e tyre procedurale në pajtim me nenin 14 të shqyrtuar lidhur me nenin 2.

Në praktikën e vetë gjyqësore pas rastit *Naçova kundër Bullgarisë*, Gjykata në detaje e ka konstatuar fushëveprimin e detyrës për hetim dhe zbulim të motivimit të mundshëm racor dhe e ka zbatuar gjatë paragjykimëve tjera. Në rastin *Millanoviç kundër Serbisë* (2012)⁴², Gjykata i ka shqyrtuar sulmet e motivuara fetare ndaj liderit të komunitetit fetar hindus Vaishnava, i njohur edhe si Hare Krishna. Ankuesi kishte pësuar disa sulme fizike gjatë viteve 2001 dhe 2007 nga grupet ekstreme djathtiste, të cilat kishin ndodhur gjatë festave të mëdha fetare ortodokse serbe.

Së bashku me konstatimin e shkeljes së nenit 3 për shkak të mosparandalimit të maltretimit të sërishëm të ankuesit dhe moszbatimit të hetimit adekuat, Gjykata e ka shqyrtuar shkeljen e mundshme të nenit 14 lidhur me nenin 3. Pas arsyetimit nga *Naçova kundër Bullgarisë*, Gjykata kishte deklaruar se “njësoj si edhe lidhur me sulmet me motive racore, kur hulumtohen incidentet e dhunshme, organet kompetente shtetërore kanë detyrë shtesë për t’i ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të **zbuluar çfarëdo motivi fetar** dhe që të konstatojnë nëse urrejtja ose paragjykimet fetare ndoshta kanë pasur rol në këto ngjarje. [...]Veprimi me dhunën dhe brutalitetin me motive fetare njësoj sikur me rastet që nuk kanë konotacion të tillë do të ishte anashkalim i vetëdijshëm i natyrës specifike të veprave që janëveçanërisht shkatërruese për të drejtat fundamentale”.⁴³ Meqë organet kompetente serbe nuk kanë ndërmarrë veprime përkatëse, të vetëdijshëm se sulmet për të cilat bëhet fjalë me gjasë kanë qenë të motivuara nga urrejtja fetare, Gjykata ka vlerësuar se ka shkelje të nenit 14 të shqyrtuar lidhur me nenin 3.

Në rastin *Virabjan kundër Ermenisë* (2012)⁴⁴, Gjykata i ka zbatuar të njëjtat parime të veprave penale të urrejtjes, të motivuara nga **anshmëria politike**. Në këtë rast ankuesi, anëtar i një prej partive kryesore opozitare të Ermenisë, ka deklaruar se ishte keqtrajtuar kur ka qenë në paraburgim policor për shkak të mendimit të tij politik dhe se nuk ishte zbatuar hetim efektiv për deklarimet e tij për torturë. Gjykata ka konstatuar shkelje të aspektit esencial të nenit

40 *Id.*, § 160.

41 *Id.*, § 164.

42 *Millanoviç kundër Serbisë*, Kërkesa ankimore nr. 44614/07.

43 *Id.*, §§ 96-97.

44 *Virabjan kundër Ermenisë*, Kërkesa ankimore nr. 40094/05.

3 sepse veprimi të cilit i ishte nënshtruar ankuesi ishte torturë. Lidhur me aspektet procedurale të nenit 3, Gjykata ka saktësuar se për të qenë **hetimi efektiv** për konstatimet serioze për maltretim, ai duhet të jetë **themelor** (“organet kompetente gjithnjë duhet të bëjnë përpjekje serioze të zbulojnë çfarë ka ndodhur dhe konstatimet e tyre nuk duhet të bazohen në konkluzionet e zgjedhura ose të pabazuara për ta mbyllur hetimin e tyre ose si bazë e vendimeve të tyre”), **ekspeditiv** (“organet kompetente duhet të reagojnë shpejt ndaj ankesave në periudhën relevante kohore”) dhe të jetë **i pavarur** (“pavarësia e hetimit nënkupton jo vetëm mungesën e lidhjes së hierarkisë ose institucionale, por edhe pavarësisë në kuptimin praktik”).⁴⁵ Gjykata ka konkluduar se hetimi për këtë rast është “joefikas, joadekuat dhe i gabuar fundamentalisht” dhe me këtë paraqet shkelje procedurale të nenit 3.

Duke i analizuar konstatimet se shkeljet e nenit 3 ishin bërë nga diskriminimi i ankuesit për shkak të mendimeve të tij politike, Gjykata i ka shqyrtuar aspektet esenciale dhe procedurale të nenit 14 veçmas. Meqë Gjykata nuk ka pasur dëshmi të mjaftueshme për të konkluduar se tortura është bërë për shkak të mendimeve politike të ankuesit, ajo nuk është konstatuar shkelje të pjesës esenciale të nenit 14 të shqyrtuar lidhur me nenin 3. Mirëpo, nga aspekti procedural, Gjykata ka vërejtur se “Kur shqyrtohen incidentet e dhunës, organet shtetërore kanë detyrë plotësuese t’i ndër marrin të gjithë hapat e arsyeshëm për **zbulimin e çfarëdo motivi politik** dhe të përcaktojnë nëse mostoleranca ndaj mendimit të ndryshëm politik ndoshta ka pasur rol në ato ngjarje.

Nëse kjo nuk bëhet dhe nëse me dhunën dhe brutalitetin e nxitur politikisht veprohet njësoj sikur edhe me rastet që nuk kanë konotacion politik, ajo do të ishte anashkalim i vetëdijshëm i natyrës specifike të veprave që janë në veçanti destruktive për të drejtat fundamentale.”⁴⁶ Në këtë rast, Gjykata ka pranuar se do të jetë vështirë të dëshmojnë motivet politike, mirëpo ka theksuar se organet kompetente kanë disponuar me informata të besueshme që kanë qenë të mjaftueshme për të paralajmëruar për nevojën të kryejnë verifikim fillestar, por ata nuk kanë bërë pothuajse asgjë lidhur me këtë. Organet hetuese kanë pyetur vetëm dy policë të involvuar për përkatësinë politike të ankuesit dhe nuk e kanë shqyrtuar më tutje këtë pikë. Në pajtim me këtë, Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 14 të shqyrtuar së bashku me as-

45 *Id.*, § 162-164

46 *Id.*, § 218.

pektin procedural të nenit 3.

Në rastin *Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë* (2015),⁴⁷ Gjykata e ka zgjeruar detyrën për zbulimin e motiveve për anshmëri ndaj **veprave penale homofobike të urrejtjes**. Ky rast ka të bëjë me dhunën gjatë demonstratave paqësore në Tbilisi me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë. Demonstratat ishin shuar dhunshëm, pjesëmarrësit ishin ofenduar, ishin kërcënuar dhe në fund ishin sulmuar nga kundër protestuesit, të cilët kishin qenë në numër më të madh se pjesëmarrësit.

Disa nga ankuesit kishin marrë lëndime serioze si pasojë e sulmeve fizike. Ankuesit janë ankuar se autoritetet nuk kanë arritur që t’i mbrojnë nga sulmet dhe në mënyrë efektive ta hetojnë incidentin, përfshirë edhe me përcaktimin e motivit të anshmërisë së sulmuesve.

Gjykata ka konstatuar se dhuna, e cila kryesisht ka qenë me gjuhë të urrejtjes dhe kërcënime serioze, por gjithashtu edhe keqpërdorim të përkohshëm fizik për të treguar se kërcënimet kanë qenë reale, që kanë shkaktuar frikë, shqetësim dhe pasiguri të të gjithë ankuesit, ka qenë dhunë mjaft e fuqishme për të arritur pragun e nenit 3 të shqyrtuar lidhur me nenin 14. Më tutje, Gjykata ka vërejtur se në kontekst të qëndrimeve negative ndaj minoriteteve seksuale në disa pjesë të shoqërisë, si dhe faktit se organizatori i marshit në mënyrë të posaçme e ka paralajmëruar policinë për seriozitetin e keqpërdorimit, organet që duhet të zbatojnë ligjin kanë pasur “obligim të madh pozitiv për t’i mbrojtur protestuesit”, por ata nuk e kanë bërë atë. Në fund, organet shtetërore nuk e kanë përmbushur obligimin e tyre procedural për ta hulumtuar rastin për shkak se nuk kanë zbatuar hetim përkatës me theks të veçantë të zbulimit të motivit të anshmërisë. Gjykata ka konstatuar shkelje të obligimeve pozitive të shtetit në pajtim me nenin 3 të shqyrtuar lidhur me nenin 14.⁴⁸

Në vitin 2012, Gjykata e ka shqyrtuar rastin *Gjorgjeviq kundër Kroacisë*,⁴⁹ i cili i referohej abuzimit fizik dhe verbal të nënës dhe djalit të saj me aftësi të kufizuara mendore dhe trupore (fizike) më shumë se katër vjet nga fëmijët që jetonin në fqinjësinë e tyre, të motivuar nga anshmëria kundër **personave me aftësi të kufizuara**.

47 *Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, *Kërkesa ankimore nr. 73235/12*.

48 *Id.*, §§ 97-100.

49 *Gjorgjeviq kundër Kroacisë*, *Kërkesa ankimore nr. 41526/10*. Ky rast është analizuar në detaje në pjesën *Veprat penale të urrejtjes të motivuar nga anshmëria ndaj personave me aftësi të kufizuara*.

Shumica e autorëve të dyshuar në këtë rast ishin fëmijë nën moshën 14 vjeç, kundër të cilëve, sipas sistemit kombëtar, nuk ishte e mundur të zbatohen çfarëdo qoftë sanksionesh juridike-penale, ndaj Gjykata ishte deklaruar se rasti nuk kishte të bënte me obligimet procedurale të shtetit të zbatojë hetim efikas dhe të pavarur, por obligimeve pozitive të shtetit jashtë fushës së të drejtës penale t'u përgjigjet në mënyrave përkatëse veprave të dhunës dhe shqetësimit të ndodhura tashmë, si dhe të parandalojë çfarëdo qoftë veprash të mëtejshme. Gjykata konstatoi se nuk ishin ndërmarrë veprime përkatëse nga organet kompetente, pavarësisht nga njohuritë e tyre se ankuiesit ishin targetuar sistematisht dhe se abuzimi në të ardhmen ishte mjaft i mundshëm. Prandaj, miratoi konkluzion se kishte pasur shkelje të nenit 3⁵⁰ dhe nenit 8⁵¹. Lidhur me diskriminimin e pretenduar për shkak të mungesës së përgjigjes adekuate nga organet kompetente, Gjykata nuk ka mundur ta shqyrtojë këtë ankesë dhe e refuzoi për shkak se nuk ishin përdorur mjetet e brendshme juridike.

Megjithëse ky rast nuk mund të shqyrtohej nga perspektiva e obligimeve procedurale për të hetuar rastin maltretimit të pretenduar dhe obligimeve procedurale për të zbuluar motivin e anshmërisë pas maltretimit të tillë, rasti e ka konfirmuar obligimin e shtetit për t'iu përgjigjur në mënyrë të duhur dhunës ndaj personit me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore.

Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata është thirrur edhe në detyrën për të “zbuluar **motive të mundshme diskriminuese**” në rastet e sulmeve ndaj emigrantëve⁵² dhe dhunës me bazë gjinore.⁵³ Gjykata ka konsideruar se kjo detyrë përfshin parime të përcaktuara mirë të praktikës gjyqësore për nenet 2, 3 dhe 14 lidhur me obligimin procedural të shtetit kur përballet me rastet e incidenteve të dhunshme të shkaktuara nga qëndrime të dyshimta diskriminuese.

Në praktikën e saj më të re gjyqësore, Gjykata deklaroi se “ku ekziston dyshimi se qëndrimet diskriminuese kanë shkaktuar vepër të dhunshme, është veçanërisht e rëndësishme që hetimi zyrtar të kryhet në mënyrë energjike dhe të paanshme,

duke pasur parasysh nevojën për konfirmim të vazhdueshëm të dënimit të veprave të tilla nga shoqëria duke ruajtur besimin e grupeve minoritare në aftësinë e autoriteteve për t'i mbrojtur nga dhuna me **motiv diskriminues**”.⁵⁴

Praktika gjyqësore tregon se detyra përfshin edhe incidente të dhunshme të shkaktuara nga qëndrime të dyshimta diskriminuese lidhur me karakteristikat e mbrojtura të viktimës, duke përfshirë edhe ato që Gjykata nuk i ka shqyrtuar më parë.

Në kuptimin procedural, kjo detyrë nënkupton që autoritetet duhet të bëjnë “çdo gjë të arsyeshme në rrethanat për t'i mbledhur dhe siguruar provat, për t'i hetuar të gjitha mjetet praktike për të zbuluar të vërtetën dhe për të marrë vendime plotësisht të bazuara, të paanshme dhe objektive, pa lënë mënjanë faktet e dyshimta që mund të jenë tregues të dhunës të shkaktuar, për shembull, nga mos-toleranca racore ose fetare, ose dhuna e motivuar nga diskriminimi gjinor ose orientimi seksual”.⁵⁵

Organet kompetente janë të detyruara t'i shqyrtojnë të gjitha faktet e rastit që tregojnë për roline mundshme me konotacion diskriminues në ngjarjet.⁵⁶

b. Detyra procedurale për hulumtimin dhe zbulimin e motiveve diskriminuese i përfshin edhe veprat e dënueshme që janë kryer nga faktorët shtetërorë dhe veprat e dënueshme të kryera nga personat privatë

Në rastin *Naçova kundër Bullgarisë*, Gjykata për herë të parë e ka përcaktuar detyrën procedurale të shtetit në mënyrë përkatëse që t'i hulumtojë motivet eventuale diskriminuese që mund të kenë ndikim në ngjarjet. Meqë rasti referohet veprave të dënueshme që janë kryer nga faktorët shtetërorë, Gjykata e ka paraparë këtë detyrë lidhur me incidentet e dhunshme, veçanërisht ato **që kryhen nga faktorët shtetërorë**.

Në rastin *Seçiq kundër Kracisë* (2007),⁵⁷ Gjykata e ka shqyrtuar rastin e burrit me prejardhje rome i cili ishte rrahur keq nga dy persona që

50 *Id.*, §§ 147-150.

51 *Id.*, § 153.

52 Shih Sakir kundër Greqisë, që është analizuar në pjesën *Detyra procedurale për zbulimin e motiveve të mundshme diskriminuese dhe marrja parasysh e indikatorëve për anshmëri të krimit të urrejtjes*.

53 Shih B.S. kundër Spanjës, që është analizuar në pjesën *Interseksionaliteti*.

54 Sabaliq kundër Kroacisë, § 95.

55 *Id.*, § 94.

56 Kjo është eksploruar më tej në pjesën *Detyra procedurale për të zbuluar motive të mundshme diskriminuese dhe për të marrë parasysh treguesit e anshmërisë së krimit të urrejtjes*.

57 Sheçiq kundër Kroacisë, *Kërkesa ankimore nr. 40116/02*.

i përkisnin grupit të skinhedëve, me shkopinj druri duke bërëtur me keqpërdorime racore. Edhe krahas disa këshillave, autoritetet nuk kishin arritur të zbatojnë hetim efektiv për t'i zbuluar kryerësit dhe të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të hulumtuar motivimin racist të rastit. Gjykata kishte përsëritur se gjatë hetimit të incidenteve të dhunshme, organet kanë detyrë shtesë për t'i ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të zbuluar çdo motiv racist dhe kjo vlen gjithashtu edhe "në rastet kur veprimi që është në kundërshtim me nenin 3, respektivisht lëndimi, është **shkaktuar nga persona privat**".⁵⁸ Në këtë rast, Gjykata kishte konstatuar shkelje të nenit 3 sepse organet kompetente nuk kishin arritur të sigurojnë dëshmi materiale për të identifikuar dhe arrestuar sulmuesit gjatë periudhës më të gjatë kohore. Më tutje, gjykata kishte konstatuar se shkelja e nenit 14 është e lidhur me aspektin procedural të nenit 3, sepse konsideron se "është e papranueshme që duke e ditur ngjarjen për të cilën bëhet fjalë me siguri është shkaktuar të urrejtjes etnike, policia ka lejuar që hetimi të zgjasë më shumë se shtatë vjet pa ndërmarrë veprime serioze për identifikimin ose përndjekjen e kryerësve".⁵⁹

c. Detyra procedurale për hetimin dhe zbulimin e motiveve diskriminuese i referohet nenit 2 (të drejtën për jetë), nenit 3 (të drejtën e personit që të mos i nënshtrohet keqtrajtimit) dhe nenit 8 (të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare)

Në praktikën e vetë gjyqësore, Gjykata e ka konstatuar detyrën që të hulumtohen dhe zbulohen motivet diskriminuese lidhur me shkeljen e nenit 2 (të drejtën për jetë), nenit 3 (të drejtën e personit që të mos i nënshtrohet keqtrajtimit) dhe nenit 8 (të drejtë ne respektimit të jetës private dhe familjare), lidhur me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit). Në rastin e lartshënuar *Naçova kundër Bullgarisë* (2005), Gjykata ka vërejtur se neni 2 nënkupton detyrën e shtetit që të zbatojë hetim efikas për veprat penale që e pengojnë të drejtën e jetës dhe nëse ekziston dyshim se qëndrimet raciste kanë shkaktuar vepra të dhunshme, neni 2 që është shqyrtuar lidhur me nenin 14, gjithashtu nënkupton detyrë procedurale që në mënyrë përkatëse të hu-

lumtohen motivet e mundshme raciste. Gjykata e ka zbatuar parimin e njëjtë lidhur me nenin 3, p.sh. në rastin më lartë, Gjykata i ka shqyrtuar rastet *Seçiq kundër Kroacisë* (2007) dhe *Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë* (2015), duke e përsëritur këtë detyrë lidhur me veprat penale që e pengojnë të drejtën e personit për të mos iu nënshtrohet keqtrajtimit dhe torturës (mundimit).⁶⁰

Njëherazi, Gjykata e ka shqyrtuar detyrën për hetimin dhe zbulimin e motiveve diskriminuese lidhur me nenin 8, respektivisht përzierjen në të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare.⁶¹ Në rastin më të ri *Shoqata ACCEPT dhe të tjerët kundër Rumanisë* (2021),⁶² Gjykata e ka shqyrtuar lëshimin e supozuar të shtetit për t'i mbrojtur ankuesit nga keqpërdorimi verbalhomofob dhe kërcënimet gjatë shfaqjes së filmit në muajin që i kushtohet historisë së personave LGBT, si dhe lëshimin për të realizuar hetim efektiv të ankesës së ankuesve.

E para, Gjykata e ka shqyrtuar zbatimin e nenit 3 dhe ka konstatuar se niveli minimal i seriozitetit të nevojshëm për nenin 3 nuk është arritur. Konkretisht, Gjykata ka vërejtur se edhe pse veprimi diskriminues si i tillë, në parim mund të jetë veprim nënçmues, ankuesit nuk kanë potencuar fakte që do t'i mundësonin Gjykatës të zbulojë se niveli i vuajtjeve psikike që e kanë përjetuar ka qenë ie ngjashëm me nivelin që Gjykata e ka konstatuar edhe në raste të tjera të ngjashme.

Gjykata ka bërë dallim ndërmjet rastit të tanishëm nga rasti *Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë* (2015), ku keqpërdorimi verbal dhe kërcënimet serioze ishin pasuar me sulme të vërteta fizike. Më tutje, Gjykata ka përmendur se edhe pse kundër protestuesit kanë qenë më shumë në numër, policia vazhdimisht i ka ndjekur, nuk kanë ndodhur kurrfarë veprash, ndërsa keqpërdorimi verbal edhe pse është diskriminuese e hapur, nuk ka qenë aq e rëndë që mund të shkaktojë frikë, vuajtje ose ndjenjë të inferioritetit që janë të domosdoshme për të zbatuar nenin 3.

Më tutje, Gjykata e ka shqyrtuar zbatueshmërinë e nenit 8 të shqyrtuar lidhur me nenin 14 dhe ka konstatuar se veprimi që është lëndë e ankesës ndikon në mirëqenien psikologjike dhe dinjitetin e

58 *Id.*, §§ 66-67.

59 *Id.*, § 69.

60 Gjithashtu në rastet *Millanoviq kundër Serbisë*(2012), *Virabjan kundër Armenisë* (2012).

61 Gjithashtu në rastin *R. B. kundër Hungarisë*(2016).

62 *Shoqata ACCEPT dhe të tjerët kundër Rumanisë, Kërkesa ankimore nr. 19237/16. Rasti është analizuar më detajisht në pjesën Krimi i urrejtjes i motivuar nga orientimi seksual dhe anshmëria ndaj identitetit gjinor.*

ankuesve individualë, me çka bie në sferën e jetës së tyre private. Në mënyrë plotësuese, sulmet e dhunshme verbale ndaj ankuesve, që kanë ndodhur në kontekst të dëshmimeve si modele të dhunës dhe mostolerancës kundër minoriteteve seksuale, e ka arritur shkallën e seriozitetit të nevojshëm për të zbatuar nenin 8. Duke analizuar arsyeshmërinë, Gjykata fillimisht e ka konstatuar “detyrën e shtetit për të parandaluar dhunën e urrejtjes (sulmet fizike ose keqpërdorimet verbale) nga persona privatë dhe të hulumtojë ekzistimin e çfarëdo qoftë motivi diskriminues pas asaj dhune”.⁶³

Lidhur me obligimin për mbrojtje, Gjykata ka konstatuar se organet kompetente nuk kanë arritur që në mënyrë të duhur ta vlerësojnë rrezikun që e bartin ankuesit individualë si rezultat i sulmeve të furacakëve dhe të përgjigjen në mënyrë adekuate me qëllim që ta mbrojnë dinjitetin e ankuesve individualë nga sulmet homofobike të personave të tretë.⁶⁴ Lidhur me obligimin për hetim, Gjykata ka miratuar konkluzion se “autoritetet nuk kanë ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të hulumtuar nëse keqpërdorimi verbal ka qenë i motivuar nga homofobia. Nevoja për të zbatuar hulumtim të rëndësishëm lidhur me mundësinë për ekzistim të motiveve diskriminuese pas keqpërdorimit ishte absolute, duke marrë parasysh armiqtësinë ndaj komunitetit LGBT, në shtetin e analizuar dhe duke i marrë parasysh dëshmitë se ofendimet homofobike ishin shprehur nga furacakët gjatë incidentit.”⁶⁵ E lartpërmendura solli në shkeljen e nenit 14, të ndërmarrë lidhur me nenin 8.

d. Sistemi i drejtësisë penale doemos duhet të hulumtojë në mënyrë përkatëse, të përndjek dhe të dënojë veprat penale të urrejtjes

Në vitin 2007, Gjykata e ka shqyrtuar rastin *Angellova dhe Iliev kundër Bullgarisë*⁶⁶, i cili kishte të bënte me lëshim të supozuar të shtetit për të zbatuar hetim efikas dhe të shpejtë për keqtrajtimin dhe vdekjen e burrit me prejardhje romë. Një aspekt tjetër që ishte shqyrtuar ka qenë mungesa e legjislacionit vendase për veprat penale me motivim racor që ka sjellë në mospërkrahimin e mbro-

jtjes adekuate juridike nga veprat e këtilla penale. Në kohën e veprës penale, sistemi nacional juridik bullgar nuk e ka kriminalizuar në mënyrë të posaçme veprën e vrasjes me motive racore ose lëndimin e rëndë trupor, e as që ka përmbytur dispozita të prera për rritjen e dënimeve lidhur me shkeljet e këtilla nëse janë të motivuara nga racizmi. Për këtë, Gjykata ka deklaruar se **mungesa e ligjeve të drejtpërdrejta për krimin e urrejtjes nuk duhet ta zvogëlojë mundësinë e organeve kompetente për ta shqyrtuar motivimin racor gjatë procesit penal** dhe se korniza e përgjithshme penale-juridike duhet të mundësojë dënime përkatëse dhe të rritura për këto lloje të veprave penale.

Konkretisht, Gjykata ka deklaruar se **“mund të shfrytëzohen edhe mjete të tjera për të arritur rezultatin e dëshiruar nga dënimi i kryerësve që kanë motive raciste”**.⁶⁷ Në këtë rast, në legjislacionin vendas ka ekzistuar mundësia për shqiptimin dënim më të rreptë varësisht, mes tjerash, nga motivi i kryerësit; ndërsa organet kompetente i kanë akuzuar sulmuesit për vepra të rënda. Edhe pse me këtë nuk ishte siguruar referencë e drejtpërdrejtë për motivet raciste të kryerësve, përsëri ishin paraparë dënime më të rreptanga ato që janë paraparë me legjislacionin vendas për veprat e urrejtjes racore.

Kështu, Gjykata ka vërejtur se mungesa e dispozitave për rritjen e dënimit për vrasje raciste ose lëndim të rëndë trupor nuk duhet t'i kufizojë autoritetet që të zbatojnë hetim efektiv dhe në mënyrë efikase ta zbatojnë legjislacionin ekzistues vendas.⁶⁸ Gjykata ka konkluduar se autoritetet nuk e kanë përmbushur obligimin e tyre në pajtim me nenin 2, që në mënyrë efikase ta hulumtojnë menjëherë vdekjen, shpejt dhe me energjinë e nevojshme që do të çojë në gjykimin dhe dënimin e personave përgjegjës, duke i marrë parasysh edhe motivet racore të sulmit.⁶⁹

Nevoja që sistemi i drejtësisë penale të mund në mënyrë adekuate të hulumtojë dhe sanksionojë veprat penale të urrejtjes ishte theksuar edhe në rastin *Sabaliq kundër Kroacisë* (2021)⁷⁰, në të cilin një femër ishte sulmuar dhunshëm pasi kishte zbuluar se është lezbike.

63 *Id.*, § 96.

64 *Id.*, § 113.

65 *Id.*, § 123.

66 *Angellova dhe Iliev kundër Bullgarisë*, Kërkesa ankimore nr. 55523/00.

67 *Id.*, § 104.

68 *Ibid.*

69 *Id.*, § 105.

70 *Sabaliq kundër Kroacisë*, Kërkesë ankimore nr. 50231/13.

Autoritetet kroate nuk e kanë hulumtuar motivin e sulmit dhe kishin iniciuar vetëm procedurë për kundërvajtje më të vogël për prishjen e rendit dhe qetësisë publike; e më pas organet kompetente e kishin refuzuar ankesën e viktimës se ka pasur krim të urrejtjes në bazë të faktit se përndjekja penale ka qenë e ndaluar për aktgjykimet e kundërvajtjeve më të vogla.

Gjykata ka përsëritur se lidhur me veprat penale të urrejtjes “respektimin e obligimeve pozitive të shtetit kërkon sistemi juridik vendas për të treguar kapacitetin e vet për zbatimin e veprave penale kundër kryerësve të atyre veprave të dhunshme”.⁷¹ Në veçanti, ajo nënkupton **“zbatimin efikas të mekanizmave vendas për të drejtën penale që mund ta zbardhin motivin e mundshëm të urrejtjes** me konotacion homofobik pas incidentit të dhunshëm dhe t’i identifikojnë dhe nëse është përkatëse, **edhe t’i dënojnë në mënyrë përkatëse personat përgjegjës”**.⁷²

Dhe më e rëndësishmja, në rastet kur hetimi zyrtar ka sjellë deri te fillimi i procedurës në gjykatat nacionale, Gjykata e ka theksuar rolin e gjykatave nacionale për të parandaluar sulmet e rënda ndaj integritetit fizik dhe psikik, të mbeten të padënuara, ose të parandalojnë vepra të dënueshme serioze që të dënohen me dënime të lehta.

Në këtë drejtim, **roli i gjykatave nacionale është “që të sigurohen se është realizuar në mënyrë adekuate obligimi i shtetit për t’i mbrojtur të drejtat e atyre që janë në kompetencë të tij shtetërore,** që nënkupton se duhet ta ruajë funksionin e vet mbikëqyrës dhe të intervenojë në rastet e joproportionalitetit evident ndërmjet peshës së veprës dhe dënimit të shqiptuar”.⁷³

Gjykata më tutje ka vërejtur se përgjigjja e autoriteteve kroate përmes procedurave të kundërvajtjeve më të vogla nuk mund ta tregojë përkushtimin e tyre se shkeljet homofobike nuk do të injorohen edhe më tutje nga organet kompetente dhe se do të sigurohet mbrojtja efektive nga veprat e tilla.⁷⁴ Gjykata ka konkluduar se me iniciimin e procedurave joefektive për kundërvajtjet më të vogla dhe si rezultat i ndërprerjes së gabuar të procedurës penale në bazë formale, organet kompetente vendase nuk e kanë realizuar në mënyrë adekuate dhe efektive obligimin e vet procedural në pajtim me nenin 3 të shqyrtuar lidhur me nenin

14, si dhe se sjellja e tillë e autoriteteve është në kundërshtim me detyrën e tyre që të luftojnë kundër mosdënimit të veprave penale të urrejtjes.⁷⁵

e. Detyra procedurale për zbulimin e motiveve të mundshme diskriminuese nënkupton që të merren parasysh indikatorët për anshmëri të krimit të urrejtjes

Detyra e shtetit për t’i zbuluar motivet e mundshme diskriminuese imponon që organet kompetente t’i shqyrtojnë të gjitha faktet për rastin që tregojnë rol të mundshëm në konotacionin diskriminues të ngjarjeve. Me fjalë të tjera, organet kompetente duhet t’i marrin parasysh indikatorët e anshmërisë. **Indikatorët e anshmërisë ndaj krimit të urrejtjes** janë faktet objektive, rrethanat ose modelet që kanë lidhje me veprën e caktuar penale ose vepra që ekzistojnë në mënyrë të pavarur ose lidhur me rrethanat dhe faktet e tjera, ndërsa sugjerojnë në atë se vepra penale mund të ketë qenë e motivuar në tërësi ose pjesërisht nga ndonjë formë e anshmërisë.⁷⁶

Në rastin **Balazh kundër Hungarisë**(2015)⁷⁷, Gjykata në veçanti i është përkushtuar zbatimit të indikatorëve të veprave penale të urrejtjes. Rasti i referohet sulmit racist të burrit me prejardhje rome nga ana e nëpunësit ndëshkues-korrigjues dhe lëshimin konkret të autoriteteve që të zbatojnë hetim efektiv për sulmin dhe në veçanti për mungesën e veprimit të mjaftueshëm për të konstatuar motivin e mundshëm racist.

Edhe pse organet hetuese (prokuroria), kishin filluar hetimin e veprës dhe kishin vazhduar me shqyrtimin e motivit të mundshëm racor pas veprës, ata e kishin ndërprerë rastin me arsyetimin se edhe pse ekziston besueshmëria për motivet raciste, ajo nuk mund të konstatohet pa mëdyshje që të garantohet akuza ndaj kryerësit. Pastaj Gjykata i ka vërejtur faktet rreth rastit që ishin konstatuar nga organet hetuese, konkretisht se kryerësi kishte shfrytëzuar gjuhë ofenduese dhe raciste (p.sh. “Nuk mund të merresh me cigan të ndytë?”) para sulmit të viktimës; një ditë pas incidentit, ai në **mediumet sociale** kishte publikuar

71 *Id.*, § 95.

72 *Id.*, § 105.

73 *Id.*, § 109.

74 *Id.*, § 111.

75 *Id.*, §§ 115- 116.

76 Udhërrëfyes për resurse: Parandalimi dhe përgjigjja e veprave penale të urrejtjes, OSBE/ODIHR, 2009, <https://www.osce.org/odihr/36426>.

77 Ballazh kundër Hungarisë, *Kërkesa ankimore nr. 15529/12*.

dhe komentuar se “kishte goditur në kokë ciganin që qëndronte i shtrirë në tokë”; ai gjithashtu kishte publikuar edhe skenë filmi me porosi eksplicite raciste dhe kishte komentuar se “disa lloje të tjera të mbeturinave jetojnë në mesin tonë”. Gjykata ka vërejtur se organet e përndjekjes nuk kanë sqaruar se pse përmbajtja e publikimeve dhe dëshmitë e njëpasnjëshme të ankuesit nuk mund të lidhen me ngjarjet e kontestuara dhe nuk mund të konsiderohen dëshmi për motive anueshme racore.⁷⁸ Së këndejmi, Gjykata ka konkluduar se lëshimi i organeve të prokurorisë “për identifikimin e motivit racist kundrejt **indikatorëve të fuqishëm të krimit të urrejtjes**” [siç janë publikimet në rrejtet sociale]...e ka prishur përkatësinë e hetimit deri në shkallën që është në të kundërtën e obligimit të shtetit që në këtë fushë të zbatojë hetime intensive.⁷⁹ Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 14 të shqyrtuar lidhur me nenin 3.

Në këtë rast, Gjykata është thirrur edhe në Udhërrëfyesin për resurse të OSBE/ODIHR, *Parandalimi dhe përgjigjja e veprave penale të urrejtjes*, 2009,⁸⁰ që ka për qëllim t’u ndihmojë organeve kompetente për t’i identifikuar veprat penale të urrejtjes dhe, mes tjerash, t’i karakterizojë indikatorët e anshmërisë të veprave penale të urrejtjes.

Në udhërrëfyesin janë theksuar **llojet më të shpeshta të indikatorëve për anshmëri**, siç janë: perceptimi i viktimës/dëshmitarit; sjellja e kryerësit (komentet, deklaratat e shkruara ose gjestet); dallimet ndërmjet kryerësit dhe viktimës në bazë etnike, fetare ose kulturore; vizatimet, shenjat, simbolet dhe grafitet e lëna në vendngjarje; përfshirë edhe grupet e organizuara të urrejtjes dhe pjesëtarëve/anëtarëve të tyre; lokacioni dhe koha; modelet/shpeshësia e krimeve ose incidenteve paraprake, si dhe natyra e dhunës.

Në praktikën e vet gjyqësore, Gjykata është thirrur në llojet e ndryshme të informatave faktike dhe kontekstit lidhur me rastet që i ka shqyrtuar, e që sipas Gjykatës, u kanë imponuar organeve kompetente që të shqyrtojnë nëse veprat kanë ndoshta motive diskriminuese.

Konkretisht, në rastin *Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, Gjykata në veçanti e ka theksuar “gjuhën e qartë homofobike të urrejtjes së shqiptuar nga ana e sulmuesve gjatë incidentit” si fakt që imponon që autoritetet të zbatojnë hetim të kon-

siderueshëm për diskriminimin që qëndron pas sulmit.

Kjo ka qenë edhe më tepër e konfirmuar me rastin *Sabaliq kundër Kroacisë*, kur Gjykata ka theksuar se “vërejtjet diskriminuese dhe ofendimet raciste në çdo rast duhet të merren parasysh si faktor rëndues kur shqyrtohet rasti i dhënë i maltremit lidhur me nenin 3”.⁸¹

Në rastin *Sekiq kundër Kroacisë*, Gjykata i ka vërejtur faktet se “sulumësit i takonin **grupit skinhed**, i cili sipas natyrës së vet udhëhiqet nga ideologjia ekstremiste dhe raciste”⁸² dhe se autoritetet kanë qenë të vetëdijshme për atë se cilat fakte kanë treguar se sulmi me siguri ishte shkaktuar nga urrejtja etnike dhe për këtë nevojitet hetim përkatës nga autoritetet.

Ngjashëm me këtë, në rastin *Abdu kundër Bullgarisë* (2014)⁸³, Gjykata ka përmendur se kryerësit e supozuar kanë qenë të njohur për policinë si skinhedë, të njohur për nga **ideologjia e tyre ekstremiste dhe raciste** dhe ky ka qenë tregues i qartë për motivin e mundshëm të anueshëm pas veprimeve të kryerësit dhe për këtë arsye ishte dashur që të hetohet nga ana e organeve kompetente.

Në shumicën e rasteve, Gjykata gjithashtu ka përmendur nivel të përgjithshëm të mostolerancës ose paragjykimeve të përhapura gjerësisht ndaj grupit të caktuar minoritar në shoqëri ose në sferë të caktuar, si faktor i mundshëm që duhet të shqyrtohen nga autoritetet dhe të cilat, marrë së bashku me indikatorët e tjerë të krimit të urrejtjes, mund të sugjerojnë në motivet diskriminuese pas veprës. Në rastin *Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, Gjykata e ka vërejtur “historinë e qëndrimit armiqësor të publikut ndaj komunitetit LGBT në Gjeorgji” dhe në konkluzionine vet ka potencuar se “domosdoshmëria e zbatimit të hetimit të konsiderueshëm të diskriminimit pas sulmit të marshit [...] **ka qenë nevojë** duke marrë parasysh qëndrimin armiqësor kundër komunitetit LGBT nga njëra anë, si dhe në bazë të gjuhës së qartë homofobike të urrejtjes së shqiptuar nga sulmuesit gjatë incidentit, nga ana tjetër”.⁸⁴

Ngjashëm me këtë, në rastin *Naçova kundër Bullgarisë*, Gjykata ka deklaruar se deklarata raciste e kryerësit “e shikuar në aspekt të raporteve të

78 *Id.*, §§ 71-73.

79 *Id.*, § 75.

80 Udhërrëfyes për resurse: Parandalimi dhe përgjigjja e veprave penale të urrejtjes, OSBE/ODIHR, 2009, <https://www.osce.org/odihr/36426>.

81 *Sabaliq kundër Kroacisë*, § 65.

82 *Seçiq kundër Kroacisë*, §§ 68-69.

83 *Abdu kundër Bullgarisë*, *Kërkesa ankimore nr. 26827/08*. Ky rast është më detajisht i shqyrtuar në pjesën *Veprat penale të urrejtjes të motivuara nga prejardhja racore ose etnike*.

84 *Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, § 77.

shumta që janë botuar për **ekzistimin e paragjy-kimeve dhe armiqësisë ndaj romëve në Bullgari**, kërkon verifikim”.⁸⁵ Argumente të ngjashme kishte shfrytëzuar Gjykata në rastin *M.C. dhe A.C. kundër Rumanisë* (2016).⁸⁶

Rasti *Sakir kundër Greqisë* (2016)⁸⁷ i referohej sulmit ndaj afganit në qendër të Athinës, i cili ishte hospitalizuar si pasojë e sulmit, si dhe lëshimit të shtetit për të zbatuar hetim efektiv, përfshirë edhe t'i vlerësojë motivet e mundshme raciste pas sulmit. Në këtë rast, Gjykata kishte konstatuar shkelje të nenit 3, në aspektin e tij procedural.

Në arsyetim, Gjykata ka potencuar në **kontekstin e përgjithshëm të rastit** dhe në raportet e organizatave joqeveritare ndërkombëtare dhe organeve kompetente nacionale që e kanë theksuar **dukurinë e dhunës raciste në qendër të Athinës**, konkretisht rritjes së incidenteve të dhunshme të natyrës raciste (veçanërisht në rajonin Agios Panteleimon, ku kishte ndodhur sulmi ndaj ankuesit), ekzistimi i modeleve të përsëritura të sulmeve ndaj të huajve, të kryera nga grupet ekstremiste dhe lëshimet serioze nga ana e policisë për t'i shqyrtuar këto sulme.

Gjykata ka konkluduar se edhe pse incidenti në këtë rast ka ndodhur në Agios Panteleimon dhe natyra e sulmit ka karakteristika të sulmit racist, policia në tërësi nuk e ka sjellë këtë rast në kontekstin e përshkruar me raportet dhe e ka trajtuar si rast të izoluar. Kjo, së bashku me mangësitë e tjera procedurale në hetim, e ka detyruar Gjykatën të miratojë konkluzion se organet kompetente nuk kanë vepruar me rastin me nivelin e dashurisë ndaj punës dhe efikasitetit që e imponon neni 3.

Në rastet e kundërvajtjeve të kryera nga agjentët shtetërorë, Gjykata, në disa raste, e ka përmendur kontekstin e “**racizmit të institucionalizuar**”, “**përdorimit të tepërt të forcës nga organet e përndjekjes**” ose “**vazhdimin e incidenteve të keqpërdorimit policor**” ndaj grupit të caktuar minoritar në gjendjen e dhënë si sinjale që duhet t'i nxisin autoritetet t'i ndërmarrin të gjithë hapat e mundshëm për të hulumtuar nëse motivet diskriminuese ndoshta kishin rol në këto ngjarje.

Në rastin *Kobzaru kundër Rumanisë* (2007),⁸⁸ që ka të bëjë me keqtrajtimin e supozuar të burrit me prejardhje rome nga ana e policisë në stacionin policor, Gjykata i ka theksuar “**incidentet e shumta antirome**, që shpeshherë përfshinin agjentë shtetërorë pas rënies së regjimit komunist në vitin 1990, si dhe dëshmi të tjera të dokumentuara për **lëshimin e përsëritur të autoriteteve për t'i përmirësuar rastet e dhunës së tillë**”, që në fakt kanë qenë të njohura për publikun e gjerë, meqë rregullisht ishin transmetuar nga mediumet.

Meqë organet kompetente u kanë kushtuar rëndësi këtyre rasteve edhe qeveria rumune kishte miratuar masa për zgjidhjen e këtij problemi, ky kontekst ka qenë i njohur për organet hetuese të këtij rasti, “ose ishte dashur që të jetë i njohur, andaj ishte dashur të kihet kujdes gjatë hulumtimit të motiveve të mundshme raciste pas dhunës”.⁸⁹

Në rastin *Boaka dhe të tjerët kundër Rumanisë* (2016),⁹⁰ Gjykata e ka vlerësuar keqtrajtimin policor të rumunit me prejardhje rome dhe mungesën e njëpasnjëshme të hetimit efektiv për veprën, si dhe mungesën e hetimit për motive të mundshme racore.

Gjykata nuk ka mundur që të konstatojë përgjegjësi të shtetit për dhunën policore në bazë të prejardhjes etnike të viktimës për shkak të mungesës së dëshmive konkrete (ankuesit kishin akuzuar se kundër tyre ishte përdorur gjuhë ofenduese dhe raciste nga nëpunësit që zbatonin ligjin, por këto konstatime nuk kishin mbështetje).

Kështu, lidhur me detyrën e shtetit që t'i hulumtojë motivet e mundshme raciste, Gjykata i kishte marrë parasysh faktet se hetimi i organeve kompetente për keqtrajtimin ishte gabimisht në mënyrë procedurale (që ka sjellë shkeljen e nenit 3) dhe se e kishin hedhur poshtë ankesën për diskriminimin e ankuesve (pa siguruar arsyetim objektiv dhe të arsyeshem për të).

Gjykata më pas kishte deklaruar se këto fakte “të shikuar lidhur me raportet e shumta të botuara për **ekzistimin e paragjytimeve të përgjithshme dhe armiqësisë ndaj romëve në Rumani dhe për incidentet e vazhdueshme të keqpërdorimit policor të pjesëtarëve të këtij komuniteti**” krijojnë nevojën për verifikimin dhe hetimin e lidhjes së mundshme arsye – pasojë ndërmjet qëndrimeve të supozuara raciste të shfaqura nga nëpunësit

85 *Naçova kundër Bullgarisë*, § 163.

86 Ky rast është më detajisht i shqyrtuar në pjesën *Veprat penale të urrejtjes të motivuara nga anshmëria ndaj orientimit seksual dhe identitetit gjinor*.

87 *Sakiri kundër Greqisë*, Kërkesa ankimore nr. 48475/09 (versioni në gjuhën frënge).

88 *Kobzaru kundër Rumanisë*, Kërkesa ankimore nr. 48254/99.

89 *Id.*, § 97.

90 *Boaka dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Kërkesa ankimore nr. 40355/11.

policorë dhe keqpërdorimin që kishte përjetuar ankuesi prej tyre.⁹¹

Së këndejmi, Gjykata kishte konkluduar se mungesa e çfarëdo qoftë hetimi të qartë lidhur me ankesën për diskriminim paraqet shkelje të nenit 14, që shqyrtohet së bashku me nenin 3 në aspektin e tij procedural.

f. Hetimi nuk mund të përjashtojë motivimin e anshmërisë sepse ekzistojnë edhe motive të tjera

Në rastin *Ballazh kundër Hungarisë* (2015) që ishte shqyrtuar më lartë, së bashku me aspektet e tjera, organet kompetente kishin refuzuar që të iniciojnë aktakuzë kundër kryerësit të sulmit racist ndaj burrit me prejardhje rome në bazë të argumentit se motivet e tij raciste nuk mund të konfirmohen “pa hamendje dhe pa mëdyshje”.

Më saktë, ata theksonin se arsyeja e sulmit ndoshta kapërfshirë edhe motive të tjera përveç urrejtjes racore. Në këtë aspekt, Gjykata ka vërejtur se “jo vetëm veprat që bazohen në karakteristikat e viktimës mund të klasifikohen si vepra penale të urrejtjes.

Për Gjykatën, **kryerësit mund të kenë motive të përziera**, nën ndikimin e faktorëve të situatës që janë njësoj ose edhe më të fuqishëm se sa nën ndikimin e qëndrimit të tyre i anueshëm ndaj grupit që i takon viktimës”.⁹² Për këtë, Gjykata e kishte hedhur poshtë argumentin e organeve kompetente me të cilin dëshmojnë se sulmi ka qenë “preciz (pikërisht)” për shkak se ankuesi kishte qenë rom.

g. Organet hetuese dhe organet e prokurorisë duhet të jenë neutralë dhe të paanshëm gjatë vlerësimit të dëshmive që i kanë në dispozicion

Në rastin *Stoica kundër Rumanisë* (2008),⁹³ ku si pasojë e keqtrajtimit të supozuar nga ana e policisë ndaj djaloshit me prejardhje rome i cili kishte marrë aftësi të kufizuara të përhershme, Gjykata e ka shqyrtuar mënyrën e zbatimit të hetimit dhe kishte zbuluar se si rezultat i **mungesës së paanshmërisë**, në kombinim me mangësitë

tjera të hetimit, nuk ishte zbatuar hetim adekuat, me çka është bërë shkelja e nenit 3 në kontekst të aspektit të tij procedural.

Konkretisht, Gjykata kishte vërejtur se organet hetuese kishin marrë dëshmitë e vetëm tre prej njëzetë ose tridhjetë fshatarëve që ishin të pranishëm gjatë incidenteve dhe nuk kanë dhënë sqarime se pse fshatarët e tjerë nuk kanë dëshmuar gjatë hetimit.

Më tutje, deklaratat e fshatarëve ishin hedhur poshtë si të “anueshme dhe më pak të besueshme” nga ana e prokurorit ushtarak pa dhënë sqarim se pse ato ishin më pak të besueshme se sa ato të policëve, sepsetë gjithë pjesëmarrësit mund të konsiderohen njësoj të anueshëm për shkak të pozicioneve të tyre të kundërshtuara në procedurë (viktimë të supozuara kundrejt kryerësve të supozuar).⁹⁴ Krahas kësaj, prokurorët ushtarakë i kanë injoruar deklaratat e nëpunësve policorë se sjellja e fshatarëve është “e pastër cigane”, deklaratë e cila nga perspektiva e Gjykatës i tregon qëndrimet stereotipe të policisë dhe dëshmon se policët nuk kanë qenë neutralë nga pikëpamja racore, as gjatë incidenteve, e as gjatë hetimit.⁹⁵

Në rastin *Kobzaru kundër Rumanisë*, Gjykata, duke e analizuar detyrën e shtetit që t’i shqyrtojë motivet e mundshme racore, ka konsideruar se vërejtjet tendencioze të prokurorëve lidhur me prejardhjen rome të ankuesit gjatë hetimit zbulojnë **qëndrim të përgjithshëm diskriminues të organeve kompetente** dhe e vënë në pikëpyetje neutralitetin dhe efektivitetin e hetimit. Gjykata ka vërejtur se prokurorët nuk kanë kontrolluar nëse policët që ishin përfshirë në dhunë kanë qenë të përzier në incidente të ngjashme më herët osenëse ishin të akuzuar më herët për shfaqjen e ndjenjave anti-rome.⁹⁶ Nga perspektiva e Gjykatës, kjo së bashku me lëshimin e shtetit për të siguruar çfarëdo arsytimi për këto lëshime ka qenë faktor i rëndësishëm që është marrë parasysh nga Gjykata gjatë konstatimit të shkeljes së nenit 14, të shqyrtuar lidhur me nenin 3, në pjesën procedurale.

91 *Id.*, §§ 107-109.

92 *Ballazh kundër Hungarisë*, § 70.

93 *Stoica kundër Rumanisë*, *Kërkesa ankimore nr. 42722/02*.

94 *Id.*, §§ 70 – 73.

95 *Id.*, § 128.

96 *Kobzaru kundër Rumanisë*, *qëndrimi 98*.

h. Detyra procedurale për hetimin dhe zbulimin e motivimit të mundshëm për anshmëri përfshinë edhe krimin e urrejtjes për shkak të lidhshmërisë

Në rastin *Shkorjanec kundër Koracisë* (2017),⁹⁷ ankuesja, viktimë e sulmit racor për shkak të lidhjes me partnerin e saj, burrë me prejardhje rome, i cili gjithashtu ka qenë i sulmuar, ishte ankuar se organet kompetente nuk e kanë mbrojtur si viktimë e veprave penale të urrejtjes për shkak të lidhjes⁹⁸ dhe nuk i kanë kushtuar vëmendje të mjaftueshme konotacionit racor të sulmit, si dhe se nuk i kanë përndjekur sulmuesit vetëm sepse ajo vetë nuk ka qenë me prejardhje rome.

Duke e elaboruar vëllimin e detyrës që të shqyrtohet anshmëria e mundshme e sulmit të caktuar, Gjykata ka deklaruar se obligimi i organeve kompetente për të kërkuar lidhjen e mundshme ndërmjet qëndrimeve raciste dhe veprës së dhunshme në fjalë, sipas nenit 3 të shqyrtuar lidhur me nenin 14, “nuk ka të bëjë vetëm me dhunën në bazë të statusit të vërtetë ose të perceptuar personal ose karakteristikave të viktimës, por edhe veprave të dhunshme në bazë të **lidhshmërisë së vërtetë ose të supozuar ose bashkimit të viktimës me personin tjetër i cili në fakt posedon ose supozohet se posedon status të caktuar ose karakteristikë mbrojtëse**”.⁹⁹

Gjykata më tej kishte sqaruar se “disa viktima të veprave penale të urrejtjes janë përzgjedhur jo se posedojnë ndonjë karakteristikë të caktuar, por për shkak të lidhjes së tyre me personin tjetër i cili në fakt e posedon ose supozohet se e posedon karakteristikën përkatëse. Kjo lidhje mund të ketë formën e **përkatësisë ose lidhshmërisë së viktimës me grupine caktuar**, ose lidhje të vërtetë ose të perceptuar të viktimës me pjesëtarine grupit të caktuar përmes, për shembull, lidhjes personale, miqësisë ose martesës”.¹⁰⁰

Në këtë rast, organet kompetente e kishin kufizuar hetimin e tyre vetëm në elementin e krimin të urrejtjes gjatë sulmit të partnerit të ankueses, ndërsa ankuesen e kishin trajtuar vetëm si dëshmitare edhe përkundër faktit se ajo gjithashtu ka marrë lëndime gjatë këtij sulmi derisa ka qenë në kompaninë e saj. Së këndejmi, Gjykata ka deklaruar se ata “nuk kanë bërë vlerësim themelor të faktorëve relevantë të situatës dhe lidhjes ndërmjet raportit të ankueses me partnerin e saj dhe motivin racist për sulmin ndaj tyre. Kjo, nga këndvështrimi i Gjykatës, së bashku me faktin se insistimi i organeve kompetente ndaj faktit se vetë ankuesja nuk është me prejardhje rome dhe lëshimin e tyre që të identifikojnë nëse sulmuesit kanë konsideruar se edhe vetë ajo ka prejardhje rome, ka rezultuar me vlerësim të pamjaftueshëm të rrethanave të rastit. Së këndejmi, Gjykata ka konkluduar se organet kompetente nuk i kanë përmbushur obligimet e veta dhe ishte konstatuar shkelja e nenit 3 të aspektit të tij procedural lidhur me nenin 14.”¹⁰¹

97 *Shkorjanec kundër Kroacisë, Kërkesa ankimore nr. 25536/14.*

98 Veprat penale të urrejtjes nuk kishin për qëllim vetëm individë të grupeve të caktuara. Personat që lidhen vetëm me grup të caktuar ose konsiderohen anëtarë të grupit të caktuar që ndan karakteristikë të mbrojtur mund të jenë, gjithashtu, viktima të veprave penale të urrejtjes. OSBE/ODIHR Parandalimi dhe përgjigjja veprave penale të urrejtjes: Udhërrëfyesi për resurse për organizatat joqeveritare në rajonin e OSBE-së (2009), cituar më sipër.

99 *Id.*, § 56.

100 *Id.*, § 66.

101 *Id.*, qëndrimet 67 - 72.

Veprat penale të urrejtjes të motivuara nga prejardhja racore ose etnike



Abdu kundër Bullgarisë (Kërkesa ankimore nr. 26827/08) më 11 mars 2014

Shënime për procedurën

Ankuesi, shtetas sudanez, kishte deklaruar se organet kompetente nuk e kishin përmbushur obligimin e tyre që të realizojnë hetim efikas për sulmet raciste ndaj tij. Ai ishte bazuar në nenin 3 dhe nenin 14 të Konventës.

Rezime e fakteve¹⁰²

Në maj të vitit 2003, z.Abdu dhe miku i tij ishin përfshirë në rrahje me dy djem bullgarë, të cilët më vonë policia i kishte përshkruar si skinhedë. Një prej atyre djemve supozohet ta ketë shtyrë z.Abdu në tokë dhe e kishte shqelmuar derisa e quante “zezak i ndyrë”. Sulmuesi i dytë më pas kishte nxjerrë thikë duke i detyruar viktimat të ikin. Abdu dhe miku i tij më pas ishin takuar me nëpunësit policorë të cilët i kishin arrestuar sulmuesit e tyre. Mjeku i gjykatës që e kishte ekzaminuar z. Abdu kishte vërejtur se ka disa lëndime që mund të ishin shkaktuar gjatë rrahjes.

Pas përfundimit të hetimit, policia i kishte përcjellë dëshmitë te prokurori publik për të vendosur nëse do të fillojë procedurë penale për “dhunë me motive racore”, vepër sipas Kodit Penal bullgar. Në qershor të vitit 2007, prokurori publik kishte sjellë vendim se nuk ka rast për t’u përgjigjur; ai kishte konstatuar se në mungesë të dëshmimeve që dëshmojnë se sulmi ka pasur motive racore, nuk ishte përcaktuar vepra penale. Ankesat e parashtruara nga z.Abdu kundër këtij vendimi ishin hedhur poshtë dhe në gusht të vitit 2008, prokurori publik kishte refuzuar që t’i dorëzojë avokatit të ankuesit kopjet e dokumenteve të procedurës penale. Z.Abdu kishte deklaruar se organet kompetente nuk e kishin përmbushur obligimin e tyre

që të zbatojnë hetim efikas për natyrën raciste të sulmit ndaj tij. Sipas të njëjtave dispozita, ai gjithashtu kishte deklaruar se hetimi i pamjaftueshëm kishte qenë si rezultat i paragjytimeve të autoriteteve.

Analiza dhe konkluzionet e Gjykatës

Duke e vlerësuar seriozitetin e veprimit ndaj ankuesit, Gjykata kishte vlerësuar se lëndimet që ka marrë ankuesi, kërcënimi me thikë, dhe **në veçanti lëndimi i dinjitetit njerëzor të cilën e përbën motivi i supozuar racor për dhunën**, e kualifikon veprimin në fushëveprimin e nenit 3.

Sa i përket respektimit të obligimeve pozitive nga ana e shtetit, Gjykata kishte vërejtur se shpejt ka filluar hetimi preliminar, ishin mbledhur të gjitha dëshmitë dhe ishin dorëzuar te prokurori publik për të vendosur nëse dy djemtë bullgarë duhet të përndiqen penalisht për dhunë raciste. Mirëpo, prokuroria kishte vendosur se nuk ishte konstatuar vepra dhe konkretisht nuk ishte konstatuar motivimi racor për dhunën. Organet e prokurorisë i kishin fokusuar hetimet e tyre në konstatimin e asaj se kush e ka filluar rrahjen, vetëm duke vërejtur mungesën e dëshmimeve se dhuna kishte motive me bindje raciste. Gjykata konsideronte se duke marrë parasysh konstatimet e bazuara specifike për ofendimet raciste që ishin theksuar nga ankuesi (ofendimet racore, të dy kryerësit e supozuar ishin skinhedë që ishin mirë të njohur për policinë), organet kompetente kishin në dispozicion dëshmi të besueshme që sugjerojnë në motivimin e mundshëm racor për dhunë dhe nuk e kanë përmbushur obligimin e tyre për t’i ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për hetim të rastit. Organet e prokurorisë nuk e kanë pyetur dëshmitarin për vërejtjet që ndoshta i ka dëgjuar gjatë incidentit, e as që i kanë marrë në pyetje të akuzuarit për motivin e mundshëm racor gjatë veprimeve të tyre. Meqë organet kompetente kanë potencuar se ankuesi ka pasur edhe mjete të tjera juridike, siç është prokuroria private për shkelje më të lehta ose kërkimin e kompensimit të dëmit në rast të fajit kundër dy personave përgjegjës,

102 Kumtesë për medie më 11.03.2014.

Gjykata kishte vërejtur se prokuroria private nuk do ta përfshijë motivimin e supozuar racor për dhunë, që është pjesë themelore e ankesës së ankuesit. Sa i përket mundësisë për parashtrimin e padisë për kompensimin e dëmit, Gjykata ka vërejtur se procedura e këtillë, që mund të sjellë shpagimin e kompensimit, por jo edhe përndjekjen e përgjegjësve, nuk do t'i përmbush obligimet procedurale të shtetit nga neni 3 në rast të sulmit. Për këtë arsye, mjetet juridike alternative që ishin përmendur nga autoritetet nuk janë marrë parasysh në rrethanat e këtij rasti, si mjete që mund t'i përmbushin obligimet procedurale të shtetit.

Gjykata ka konkluduar se ka shkelje të nenit 3 në aspektin e tij procedural, të shqyrtuar veçmas lidhur me nenin 14.

Komentet

Me këtë rast, Gjykata e kishte konfirmuar detyrën e shtetit për ta hetuar motivin e mundshëm racor pas veprës së dhunshme, përfshirë edhe t'i marrë parasysh faktet e rastit që e potencojnë këtë motiv. Konkretisht në këtë rast, indikatorët kryesorë për motivin e anshmërisë janë ofendimet racore nga sulmuesit gjatë rrahjes. Gjithashtu, kryerësit e supozuar kanë qenë të njohur për policinë si skinhedë, të njohur për nga ideologjia e tyre ekstremiste dhe raciste. Më tutje, Gjykata ishte thirrur në konstatimet e organeve të ndryshme nacionale dhe ndërkombëtare lidhur me lëshimin e organeve kompetente bullgare për zbatimin efikas të dispozitave për dënimin e rasteve të dhunës raciste, si informatë e rëndësishme kontekstuale që duhej të merret parasysh.

Në këtë rast, Gjykata, gjithashtu, kishte theksuar se motivimi racist është faktor i rëndësishëm gjatë vlerësimit të seriozitetit të maltretimimit në bazë të nenit 3, e me këtë edhe zbatueshmëria e tij. Gjatë praktikës gjyqësore, Gjykata ka vërejtur se madje edhe aty ku viktima nuk ka lëndime serioze ose të përhershme fizike, veprimi mund të përshkruhet si “nënçmues”, sepse ka qenë sulm ndaj “pikërisht asaj që është një prej qëllimeve kryesore të nenit 3 për mbrojtjen, respektivisht, dinjitetin dhe integritetin fizik të një personi”.

Për shembull, në rastin *Gjorgjeviq kundër Kroacisë* (2012),¹⁰³ rast që ka të bëjë me keqtrajtimin e

¹⁰³ Ky rast është më detajisht i shqyrtuar në pjesën *Veprat penale të urrejtjes të motivuara nga anshmëria ndaj personave me aftësi të kufizuara*.

personit me aftësi të kufizuara fizike dhe psikike, Gjykata kishte vendosur se ndjenjat e frikës dhe mosndihmës të shkaktuara nga keqtrajtimi janë mjaft serioze për të arritur nivelin e seriozitetit që nevojitet për veprën të klasifikohet në kuadër të nenit 3, edhe pse ankuesi kishte marrë lëndime fizike vetëm në një rast.

Vërejtjet diskriminuese dhe ofendimet raciste sidoqoftë duhet të merren parasysh si faktor rëndësues gjatë vlerësimit të rastit të caktuar të maltretimimit në bazë të nenit 3, që është i zbatueshëm për të dyja veprat që u përcaktohen agjentëve shtetërorë (shih rastin *B.C kundër Spanjës* (2012))¹⁰⁴ dhe personave privatë, si në këtë rast.

Në kontekst të mostolerancës fetare, Gjykata ka konkluduar se garancitë sipas nenit 3 nuk mund të kufizohen në vepra të keqtrajtimimit fizik, por mund ta përfshijnë edhe shkaktimin e vuajtjeve psikike nga personat e tretë (shih rastin *Begeluri dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë* (2014)).¹⁰⁵

Burlia dhe të tjerët kundër Ukrainës (Kërkesa ankimore nr. 3289/10)¹⁰⁶ më 6 nëntor 2018

Shënim për procedurën

Ankuesit janë shtetas ukrainas të përkatësisë etnike rome, që pretendonin se sulmi ndaj shtëpive të tyre gjatë “pogrom-it” antiromë, ku autoritetet gjoja kishin qenë bashkëpjesëmarrës ose të paktën nuk e kishin parandaluar ose në mënyrë efektive nuk e kishin hetuar, si dhe kushtet e tyre joadekuate të jetesës pas shpërnguljes së tyre si rezultat i atij sulmi, kishte qenë shkelje e neneve 3, 8, 13 14¹⁰⁷ të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit numër 1.¹⁰⁸

¹⁰⁴ Ky rast është më detajisht i shqyrtuar në pjesën *Interseksionaliteti*.

¹⁰⁵ Ky rast është më detajisht i shqyrtuar në pjesën *Veprat penale të urrejtjes të motivuara nga anshmëria fetare*.

¹⁰⁶ Burlia dhe të tjerët kundër Ukrainës.

¹⁰⁷ Neni 13 – E drejta e mjetit efektiv juridik.

¹⁰⁸ Neni 1 i Protokollit nr. 1 – Ruajtja e pasurisë.

Rezyme e fakteve¹⁰⁹

Më 7 shtator të vitit 2002, ukrainasi 17-vjeçar ishte vrarë në fshatin Petrivka, në rajonin Odesa të Ukrainës, gjoja nga burri me prejardhje romë. Si përgjigje e kësaj, një turmë e banorëve kishin kërkuar dëbimin e të gjithë romëve nga fshati.

Në takimin e ditës së nesërme, këshilli lokal ishte pajtuar me atë qasje. Pas intervenimit të Administratës së Qarkut dhe Departamentit të Policisë së Qarkut, këshilli kishte vendosur që të kërkojë nga organet e përndjekjes që të dëbojnë “personat e rrezikshëm socialë, pa marrë parasysh prejardhjen etnike”.

Atë natë, kryetari i fshatit i kishte këshilluar banorët romë që të largohen para fillimit të “pogrom-it”. Po atë natë, një turmë që vlerësohet të ketë qenë e përberë nga disa qindra njerëz i kishte vjedhur shtëpitë e ankuesve duke i shkatërruar të gjitha gjësendet personale. Gjatë sulmit kishte pasur të pranishëm nëpunës policorë, por që nuk kishin bërë asgjë për të parandaluar plaçkitjen dhe ishin fokusuar vetëm që të parandalojnë viktimat njerëzore. Shumica e ankuesve kishin qenë në fshat gjatë mbledhjes për sulm, ndërmjet 7 dhe 9 shtatorit, edhe pse një pjesë e vogël kishin ikur më herët duke mos e ditur se çfarë kishte ndodhur derisa ishin kthyer në shtëpi.

Procedura penale ishte iniciuar menjëherë, më 10 shtator, për shkak të dyshimeve për sjellje që shkakton parregullsi të kryer nga turma. Hetimi, i udhëhequr nga hetuesi rajonal policor, por gjithashtu mepërfshirjen e policisë lokale, ishte suspenduar dhe filluar përsëri disa herë para suspendimit të tij përfundimtar në mars të vitit 2009.

Analiza dhe konkluzionet e gjykatës

Së pari, Gjykata kishte bërë dallimin ndërmjet dy grupeve të ankuesve: 1) ankuesit që kanë qenë të pranishëm në fshat gjatë sulmit natën më 9-10 shtator të vitit 2002 dhe ishte dashur që patjetër t'i lëshojnë shtëpitë e tyre në fshat me kërcënime për sulm, dhe 2) ankuesit të cilët, pas pranimit personal, kishin qenë larg shtëpive të tyre në momentin e ngjarjeve për të cilat bëhet fjalë dhe për këtë nuk kanë pasur njohuri për sulmin, e që më pas e kishin kuptuar dëmin e shkaktuar.

Shkelja e nenit 3 të shqyrtuar lidhur me nenin 14 në raport me Grupin I

Në raport me **aspektin esencial të nenit 3**, Gjykata ka konstatuar se sulmi ndaj shtëpive të ankuesve ka qenë i motivuar nga qëndrimi antiromë. Më tutje ishte konstatuar se policia nuk ka ndërmarre kurrfarë masash për mbrojtjen e shtëpive të ankuesve nga sulmi dhe nuk ishte dhënë arsye objektive për mosaktivitetin e tyre. Konkretisht, edhe policia në fshat dhe policia e nivelit të qarkut kishin ditur mjaft për pogromin që ishte përgatitur. Më tutje, aktvendimi i këshillit të fshatit dhe në veçanti prania dhe pasiviteti policor në vendin e sulmit kanë lënë përshtypje të përkrahjes zyrtare të këtij sulmi. Dhe, në fund, sulmi ka qenë veprim nënçmues, veçanërisht për shkak të raportit të autoriteteve. Konkretisht, Gjykata kishte vlerësuar se ky grup i ankuesve me siguri kishte ndier frikë, dhimbje, pafuqi dhe inferioritet kur ishin detyruar t'i lëshojnë shtëpitë e tyre, që ishte përkeqësuar me njohurinë se ata me siguri do të plaçkiten. Kjo seriozisht e kishte zvogëluar dinjitetin e tyre dhe ishte veprim nënçmues duke e shkelur nenin 3. Të gjitha të lartpërmendurat kishin kontribuar që Gjykata të konkludojë se ka shkelje të aspektit esencial të nenit 3, të shqyrtuar së bashku me nenin 14.

Në raport me **aspektin procedural të nenit 3**, Gjykata kishte vërejtur se hetimi i brendshëm për sulmin karakterizohet me shumë lëshime serioze. Më tutje, pjesëtarët e policisë lokale kishin pasur rol aktiv në hetim edhe përkundër faktit që ishin akuzuar për implikim në sulm. Rrumbullakimi i hetimit në atë mënyrë dhe lëshimi për të hetuar arsyen e tillë të qartë për hetim, nga perspektiva e Gjykatës kishte treguar jo vetëm mungesë të detajeve në hetim, por edhe mungesë të pavarësisë. Më tutje, edhe përkundër dëshmive të qarta se sulmi ka qenë i drejtuar ndaj pjesëtarëve të grupit të caktuar etnik, ai ishte hetuar si prishje e thjeshtë dhe nuk u është kushtuar vëmendje paragykykimeve antirome si rrethanë e mundshme rënduese.

Kjo e ka detyruar Gjykatën që të miratojë konkluzion se hetimi për këtë incident nuk konsiderohet efikas, sepse ekziston shkelje e aspekteve procedurale të nenit 3, të shqyrtuar lidhur me nenin 14.

109 Kumtesë për media më 06.11.2018.

Shkelja e nenit 3 të shqyrtuar lidhur me nenin 14 në raport me Grupin II

Në bazë të analizave dhe konkluzioneve lidhur me ankuesit e Grupit I, Gjykata kishte konstatuar se situata me ankuesit e Grupit II nuk bie në kuadër të nenit 3 dhe mund të jetë mjaft e përfshirë në pajtim me nenin 8. Sipas kësaj, Gjykata ka vërejtur se këto konkluzione vlejshme edhe për ankuesit e Grupit II sepse dallimi i vetëm ndërmjet tyre dhe grupit paraprak ka qenë sepse ata kanë munguar në fshat gjatë ngjarjeve më 7-10 shtator të vitit 2002 dhe më vonë ishin kthyer në fshat kur kanë parë se shtëpitë e tyre janë të dëmtuara. Gjykata i ka përsëritur konstatimet e veta të lartpërmendura dhe ka vlerësuar se ato shqyrtime janë të mjaftueshme që Gjykata të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 8, të shqyrtuar lidhur me nenin 14, për shkak të rolit që e kanë pasur organet kompetente para dhe gjatë sulmit ndaj shtëpive të ankuesve dhe për shkak se nuk kanë zbatuar hetim efektiv për sulmin.

Komentet

Gjykata e kishte theksuar rolin e organeve kompetente lokale për parandalimin dhe mbrojtjen nga sulmet, në këtë rast sulmit ndaj komunitetit dhe shtëpive të tyre, të motivuar nga ndjenjat anti-rome. Shkatërrimi i shtëpive të tyre paraqet veprim jonjerëzor dhe nënçmues, për çka autoritetet kanë qenë përgjegjës në bazë të faktit se kishin qenë bashkëpjesëmarrës në sulm dhe nuk kanë arritur t'i mbrojnë prej tij, respektivisht nuk kanë ndërmarrë kurrfarë hapash për ta parandaluar dhe e kanë ndjekur rastin siç ishte zhvilluar.

Në këtë rast, gjatë vlerësimit të fushëveprimit të zbatimit dhe përgjegjësisë sipas nenit 3, Gjykata ka potencuar dy aspekte që kanë kontribuar për uljen e dinjitetit të ankuesve. E para është **natyra e sulmit**, në fakt, motivi i tij i anshmërisë dhe ndikimi që e ka pasur ndaj njerëzve të cilët e ndajnë karakteristikën e njëjtë që është sulmuar. Konkretisht, ankuesit nuk ishin sulmuar për diçka që kanë bërë, por për shkak të asaj se kush janë, respektivisht për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Në shtojcë të dëmit fizik, kjo mund të ketë ndikim serioz psikologjik dhe të nxisë ndjenjë të frikës nga sulmet e ardhshme.¹¹⁰ Kjo në veçanti vlen për komu-

nitetin që ka qenë i marginalizuar gjatë historisë dhe i është nënshtruar diskriminimit, ose edhe përndjekjes, që është rasti me komunitetet rome në shumë vende të Evropës. Elementi i dytë që në këtë rast vetëm e ka forcuar ndjenjën e dhimbjes dhe pafuqisë tek ankuesit të cilët ishin paralizuar për sulmin ishte pikërisht ai se autoritetet kanë vendosur që të mos i mbrojnë ankuesit, por i kanë këshilluar që të largohen para “pogrom-it”. Kështu, ankuesit ishin në një situatë kur duheshin të konkludojnë se për shkak **të raporteve të tyre familjare dhe përkatësisë së tyre etnike, ata nuk mund të konsiderojnë në mbrojtjen e ligjit** në vendin ku kishin jetuar në kushte të zakonshme gjatë periudhës së caktuar kohore.

Vendimi për t'i lëshuar shtëpitë e tyre para sulmit nuk ka qenë rezultat i praktikimit të vullnetit të tyre të lirë, por mënyrë e mbrojtjes së integritetit të tyre fizik. Ndjenjat e tyre të frikës dhe inferioritetit në mënyrë shtesë janë përkeqësuar pas njoftimit se shtëpitë e tyre me gjasë do të plaçkiten, por që ata nuk janë në gjendje t'i mbrojnë pa u vënë jetën në rrezik. Marrë në përgjithësi, kjo seriozisht e ka ulur dinjitetin e tyre. Gjykata ka konkluduar se roli i policisë dhe fakti se ato ngjarje janë nxitur nga ndjenjat ndaj tyre si romë, paraqesin shkelje për dinjitetin e ankuesve që është mjaft serioze për ta kategorizuar si veprim “nënçmues”.¹¹¹

***Lingurar kundër Rumanisë,
(Kërkesa ankimore nr. 48474/14)
më 16 prill 2019***

Shënim për procedurën

Ankuesit janë familje të katër shtetasve rumunë me prejardhje rome që ishin ankuar se janë keqtrajtuar nga policia, se hetimi për konstatimet e tyre ka qenë joefikas dhe se arsyetimi i organeve kompetente për bastisjen (sulmin) ka qenë racist. Ata janë bazuar në nenin 3 dhe nenin 14.

Rezyme e fakteve¹¹²

Sipas familjes së ankuesit, disa nëpunës policorë dhe xhandarë, të veshur me veshje speciale për intervenim, përfshirë edhe fantomët, e kishin thy-

110 Të kuptuarit e nevojave të viktimave të krimit të urrejtjes, OSBE/ODIHR, 2020, <https://www.osce.org/odihr/463011>.

111 *Burlia dhe të tjerët kundër Ukrainës*, § 134.

112 Kumtesë për media më 16.04.2019.

er derën e tyre të hyrjes gjatë bastisjes (sulmit) në orët e hershme të mëngjesit më 15 dhjetor të vitit 2011, ku i kishin nxjerrë nga krevati dhe i kishin rrahur. Dy anëtarët meshkuj të familjes ishin keqtrajtuar përsëri në oborr, ndërsa më pas ishin dërguar për t'i marrë në pyetje në stacionin lokal të policë. Ata ishin liruar ditën e njëjtë me dënime në para për prerjen ilegale të druve. Pas bastisjes, familja kishte shkuar në spitalin lokal për shërim të lëndimeve në bark, gjoks dhe të ënjturave. Në raportet mjekësore për tre prej ankuesve ishte dhënë konkluzioni se lëndimet e tyre mund të jenë shkaktuar nga goditjet me sende të forta.

Në vitin 2012, familja kishte parashtruar kallëzim penal ku i kishte akuzuar organet e përndjekjes për dhunë. Pasi në hetimin e parë ishte konkluduar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për përndjekje, gjykatat i kanë urdhëruar organet e përndjekjes që të zbatojnë hetim shtesë, ndërsa konkretisht t'i arsyetojnë lëndimet e ankuesve. Me hetimin e ri ishte miratuar konkluzioni se meshkujt ankues me siguri ishin lënduar kur policia është detyruar që të përdorë forcë për t'i çmobilizuar, ndërsa lëndimet e femrave ankuese mund të sqarohen me "sjelljen që është specifike për romët", respektivisht shkuljes së flokëve dhe goditjes me shuplaka fytyrave të tyre. Njëherazi, prokurori kishte theksuar se shumica e banorëve të Valcesë ku kanë jetuar ankuesit, ishin të njohur për kundërvajtjet e ligjit dhe kishin qenë agresivë ndaj policisë. Në fund, gjykatat i kishin hedhur poshtë ankesat e ankuesve për vendimet e prokurorëve gjatë vitit 2014. Ata konsideronin se sqarimet e prokurorëve për lëndimet e ankuesve janë të besueshme dhe kanë konstatuar se policët nuk kanë përdorur forcë të tepruar. Organet e prokurorisë dhe gjykatat i kishin hedhur poshtë konstatimet e ankuesve se ka qenë praktikë sistematike në rajonin që policia ta sulmojë komunitetin rom.

Analiza dhe konkluzionet e gjykatës

Keqtrajtimi i supozuar

Gjykata ka vërejtur se ankuesit kishin marrë lëndime për të cilat nevojitet kurimi mjekësor pas bastisjes, që kishte arritur nivelin minimal të seriozitetit në pajtim me nenin 3. Asgjë nuk ka sugjeruar në faktin se katër nëpunësit policorë që kishin qenë përgjegjës për bastisjen, pjesë e grupit të nëpunësve të trajnuar profesionalisht ishin mundur nga ankuesit e paarmatosur; andaj, Gjykata e ka hedhur poshtë argumentin se përdorimi i

forcës ka qenë i domosdoshëm për shkak të sjelljes agresive të ankuesve. Krahas kësaj, asnjëherë nuk është iniciuar procedurë kundër ankuesve për çfarëdo vepre të dhunshme penale. Sa i përket hipotezës së organeve kompetente se lëndimet që i kishin përjetuar femrat ankuese janë vetë shkaktuar, nuk ka dëshmi që e konfirmojnë këtë hipotezë. Për këtë, Gjykata ka deklaruar se forca e shfrytëzuar nga nëpunësit gjatë zbatimit të ligjit në këtë bastisje nuk ka qenë proporcionale dhe ka konsideruar se ka pasur shkelje të nenit 3 në pjesën esenciale të tij.¹¹³

Motivet e supozuara racore për organizimin e bastisjes policore

Gjykata ka vërejtur se në planin për intervenim policor, që ishte përpiluar para sulmit policor më 15 dhjetor 2011, autoritetet e kishin identifikuar përbërjen etnike të target komunitetit dhe ishin përqendruar në sjelljen antisociale të romëve etnikë dhe shkallës së lartë të supozuar të krimit në mesin e romëve. Të njëjtat deklarime janë dhënë edhe nga hetuesit, që e kanë sqaruar agresivitetin e supozuar të ankuesve me karakteristikat e tyre etnike ose me shprehjet që janë "specifike për romët". Gjykata ka konsideruar se mënyra në të cilën autoritetet e kanë arsyetuar dhe realizuar sulmin policor tregon se policia i ka shfrytëzuar autorizimet e veta në mënyrë diskriminuese, duke pritur se ankuesit janë kriminelë për shkak të prejardhjes së tyre etnike. Gjykata ka konstatuar se ajo është **profilim etnik i ankuesve** dhe se ka qenë diskriminuese, që ka qenë shkelje e nenit 14 të shqyrtuar lidhur me nenin 3.¹¹⁴

Mungesa e supozuar e hetimit efektiv

Gjykata i ka vërejtur dëshmitë që ishin përpiluar nga palët dhe materialin në dispozicion që tregon se komunitetet romë në Rumani shpeshherë balafaqohen me racizëm të institucionalizuar dhe janë të ekspozuar ndaj përdorimit të forcës së tepërt nga ana e organeve të përndjekjes.

Në këtë kontekst, nga perspektiva e Gjykatës, vetë fakti se në rastin konkret stereotipat për "sjelljen e romëve" janë pjesë e vlerësimit të organeve kompetente për situatën, mund të shkaktojë mëdyshje për diskriminim në bazë etnike. Gjykata ka konkluduar se dyshimet e këtilla, së bashku

113 §§ 69 - 73.

114 §§ 74 -78.

me modalitetet e intervenimit më 15 dhjetor 2011, ishte dashur që t'i nxisin organet kompetente për t'i ndërmarrë të gjithë hapat e mundshëm për të hulumtuar nëse diskriminimi ka pasur rol në këto ngjarje. Mirëpo, konstatimet e ankuesve për diskriminim dhe kriminalizim të komunitetit rom ishin hedhur poshtë nga organet dhe gjykatat kompetente vendase pa bërë analizë të detajuar të rrethanave relevante për rastin. Njëherazi, ka pasur edhe shkelje të nenit 14 të shqyrtuar lidhur me nenin 3 në raport të hetimit. Pasi ishte konstatuar shkelja e neneve 3 dhe 14 së bashku, Gjykata ka konstatuar se nuk kanë dalë çështje të caktuara vetëm sipas nenit 3, që ka të bëjë me ankesën e ankuesve për joefikasitetin e hetimit penal.

Koment për vendimin

Ky rast e ka theksuar problemin me **racizmin institucional** dhe **profilimin etnik**.¹¹⁵ Në këtë rast, Gjykata për herë të parë në mënyrë të prerë e ka shfrytëzuar nocionin “profilimi etnik” lidhur me veprimin policor dhe ka konstatuar se është diskriminues. Gjykata ka vërejtur se sjellja e ankuesve ishte nxjerrë nga perceptimi stereotip që autoritetet e kanë pasur për komunitetin rom në tërësi dhe për këtë ankuesit kishin qenë caku, sepse ata ishin romë dhe për arsye se autoritetet e kanë perceptuar komunitetin rom si antisociale dhe kriminale.

Ky konkluzion e tejkalon shprehjen e thjeshtë të shqetësimit për diskriminimin etnik në Rumani. Konkretisht na tregon se vendimet për organizimin e sulmit policor dhe përdorimit të forcës kundër ankuesve ishin miratuar në bazë të mendimeve të bazuara në prejardhjen etnike të ankuesve. Autoritetet në mënyrë automatike e kanë lidhur përkatësinë etnike me sjelljen kriminale, në mënyrë që profilimi etnik i ankuesve ka qenë diskriminues.

Më tutje, Gjykata ka vërejtur se qëndrimin e njëjtë për komunitetin rom në Rumani e ndajnë edhe prokurorët dhe gjykatat nacionale. Edhe prokurori kishte konsideruar se sulmi policor kishte qenë i domosdoshëm për shkak të problemeve me komunitetin rom dhe sjelljen e tyre kriminale.

Kjo tregon se autoritetet e kanë zgjeruar sjelljen kriminale ndaj disa anëtarëve të komunitetit vetëm në bazë të prejardhjes së tyre etnike të përbashkët. Për në fund, gjykatat vendase e kanë pranuar si arsyetim për përdorimin e forcës, vlerësimin e bërë nga policia ku duket se konkluzioni negativ është nxjerrë nga përbërja etnike e komunitetit.

Gjykatat vendase nuk e kanë dënuar atë që dukej si përdorim diskriminues i profilimit etnik nga ana e organeve kompetente.¹¹⁶ Për këtë qëllim, më e rëndësishme është se Gjykata ka përsëritur se në situatat ku ekzistojnë dëshmitë për modelet e dhunës dhe mostolerancës kundër minoritetit etnik, “obligimet pozitive që i ndërmarrin organet nacionale kompetente kërkojnë standard më të lartë për përgjigjen ndaj incidenteve të supozuara të motivuara nga paragjykimet”.¹¹⁷

115 *Parandalimi i profilimit joligjor sot dhe në të ardhmen*: udhërrëfyes, Agjencia e të Drejtave Fundamentale, 2018, <https://fra.europa.eu/en/publication/2018/preventing-unlawful-profiling-today-and-future-guide>. Ky udhërrëfyes shpjegon se çfarë është profilimi, kornizat juridike që e rregullon atë dhe pse zbatimi i profilimit ligjor është i domosdoshëm për të harmonizuar të drejtat fundamentale dhe thelbësore për punën policore efektive dhe menaxhimin kufitar. Njëherazi, udhërrëfyesi përmban udhëzime praktike mbi mënyrat për të shmangur profilimin e paligjshëm në operacionet e policisë dhe operacionet e menaxhimit kufitar.

116 *Lingurar kundër Rumanisë*, §§ 75-76, 79

117 *Lingurar kundër Rumanisë*, § 80.

Veprat penale të motivuara nga anshmëria fetare



Begelluri dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë (Kërkesa ankimore nr. 28490/02) më 7 tetor 2014

Shënim për procedurën

Ankuesit janë 99 shtetas të Gjeorgjisë, nga të cilët me një përjashtim, janë Dëshmitarë të Jehovahit. Ata theksojnë se të drejtat e tyre sipas neneve 3, 6, 9, 10, 11, 13 dhe 14¹¹⁸ të Konventës ishin shkelur për shkak të dhunës së madhe të motivuar fetarisht në të cilën ishin ekspozuar në Gjeorgji dhe lëshimit të organeve relevante kompetente për t'i parandaluar, ndaluar ose hetuar shkeljet e supozuara.¹¹⁹

Rezyme e fakteve¹²⁰

Keqtrajtimi i supozuar përfshin 30 raste të dhunës fizike dhe keqpërdorimit verbal të Dëshmitarëve të Jehovahit. Konkretisht, në shtator të vitit 2000, takimi i rreth 700 Dëshmitarëve të Jehovahit, që mbahej në fshatin e Gjeorgjisë Perëndimore, në pronën e dy prej ankuesve, ishte ndërprerë nga policia. Sipas ankuesve, nëpunësit policorë kishin hapur zjarr, e kishin shkatërruar shtëpinë dhe kishin rrahur disa nga ankuesit. Ankuesit e tjerë deklarojnë se kishin qenë të sulmuar nga grupe njerëzish gjatë ahengut fetar në një shtëpi private, derisa kishin qenë në mbledhje fetare ose kur kishin ndarë literaturë fetare në rrugë. Të tjerët, derisa po udhëtonin në takim fetar në shtator të vitit 2000, ishin ndaluar nga policia në pikat e kontrollit në rrugë dhe ishin penguar që të arrijnë në takim. Njëkohësisht, besimtarëve të

Kishës Ortodokse të Gjeorgjisë u ishte lejuar që të hyjnë në vendin e takimit, ku kishin shkatërruar sende fetare dhe i kishin rrahur të pranishmit. Në një rast tjetër, një grup i madh i besimtarëve ortodoks kishin hyrë në sallë gjyqësore në Tbilisi, ku po mbahej seanca për vepra penale kundër dy Dëshmitarëve të Jehovahit. Të parët kishin sulmuar disa prej ankuesve, si dhe gazetarë dhe monitorues, mes tjerash edhe duke përdorur kryqe të mëdhenj nga druri.

Ankuesit kishin parashtruar rreth 160 ankesa tek organet hetuese, ku ishte theksuar se disa nga sulmet ishin bërë edhe me pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë të policisë dhe përfaqësuesve të tjerë të organeve kompetente ose me ndihmën e tyre. Ato ankesa nuk kanë dhënë rezultate konkrete. Vetëm në disa raste, ankuesit kishin marrë përgjigje me shkrim.

Në shumicën e rasteve, ankuesit ishin ankuar për mosaktivitetin e organeve hetuese të Prokurori i Përgjithshëm, pa procedurë përkatëse. Në tri raste, ankuesit kanë pasur mundësi që t'i shprehin ankesat e tyre në Gjykatën Supreme, e cila i kishte hedhur poshtë.

Disa trupa ndërkombëtare dhe organizata joqeveritare, përfshirë edhe Komisararin e Lartë të të Drejtave të Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara dhe Amnesty International, vazhdimisht kishin raportuar se në periudhën 2000-2001, Dëshmitarët e Jehovahit në Gjeorgji kishin qenë cak i dhunës nga personat privatë dhe besimtarët ortodoks dhe se organet përkatëse kompetente shtetërore nuk e kishin penguar ose parandaluar këtë dhunë.

Analiza dhe konkluzionet e gjykatës [aspekte të zgjedhura]

Në raport me veprimin dhe detyrën e organeve kompetente për parandalim dhe mbrojtje

Incidentet për të cilët janë ankuar ankuesit, dukshëm dallohen në aspekt të vëllimit të dhunës dhe shkallës së përzjerjes së supozuar të faktorëve

118 Neni 6 - E drejta e gjykimit të drejtë; Neni 9 - E drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes ose religjionit; Neni 10 - E drejta e lirisë së të shprehurit; Neni 11 - E drejta e lirisë së tubimit dhe shoqërimit.

119 Për nevojat e këtij publikimi, janë prezantuar vetëm shqyrtimet lidhur me nenet 3 dhe 14, me rezyme të konstatimeve kryesore të Gjykatës pa detaje të ankesave individuale.

120 Kumtesë për medie më 07.10.2014.

shtetërorë.¹²¹ Mirëpo, Gjykata ka vërejtur se karakteristikë e përbashkët e të gjitha incidenteve është ndjenja e frikës, dhimbjes dhe nënçmimit që supozohet se të gjithë ata ua kanë shkaktuar ankuesve.

Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 3 në raport me 32 ankuesit, për shkak të keqtrajtimit që e kishin përjetuar.¹²² Në këto raste, Gjykata ka konkluduar se është konstatuar, pa dyshim të bazuar, se ata i janë nënshtruar dhunës fizike dhe/ose keqpërdorimit dhe nënçmimit në kontekst të sulmeve të dhunshme. Në të gjitha ato raste, policia nuk ka bërë asgjë për t'i parandaluar sulmet; në disa raste, nëpunësit shtetërorë madje edhe ishin të përfshirë drejtpërdrejtë. Për shembull, lidhur me sulmet ndaj disa ankuesve gjatë marrjes gjyqësore në pyetje në Tbilisi, Gjykata ka vërejtur se procedura gjyqësore që është e kontestuar ka lidhje me lëndën penale të njohur në përgjithësi kundër dy Dëshmitarëve të Jehovait. Edhe pse autoritetet kanë qenë të vetëdijshëm për ndjeshmërinë e rastit dhe mundësinë për konfrontim të dhunshëm, ata nuk kanë ndërmarrë masa përkatëse të sigurisë. Gjatë vetë incidentit, gjykatësi dhe të punësuarit në sigurim nuk kanë intervenuar për të penguar përlëshjen.

Në raport me reagimin (përgjigjen) e organeve kompetente dhe dërgimin e ankesave

Gjykata ka vërejtur – edhe pushteti nuk ka kundërshtuar – se organet kompetente kanë qenë të njoftuara për veprat e dhunshme të supozuara. Për këtë, organet kompetente kanë qenë të detyruara që t'i kontrollojnë informatat dhe t'i ndërmarrin hapat e domosdoshëm për përndjekjen e çfarëdo veprave të kryera. Mirëpo, në raste të caktuara nuk ishte zbatuar hetimi. Në rastet e tjera, hetimet ishin rënduar për shkak të numrit të madh të mangësive. Kjo ka përfshirë edhe prolongimete konsiderueshme

121 Shumë ankesa u konsideruan të papranueshme për shkak të mungesës së dëshmive lidhur me veprimin të cilit ata pretendojnë se i nënshtroheshin; ose nuk kanë përbushur rregullin „gjashtë muaj“.

122 Në një numër të madh rastesh, Gjykata nuk ka konstatuar shkelje të nenit 3. Në disa raste, Gjykata ka vërejtur se, megjithëse incidentet ishin sigurisht shqetësuese, veçanërisht duke pasur parasysh motivin e dukshëm fetar, ata ankues nuk treguan se ishin ekspozuar ndaj dhunës që ndikon në integritetin e tyre fizik dhe emocional deri në shkallën e kërkuar nga neni 3. Në raste të tjera, ankuesit nuk dhanë asnjë dëshmi konkrete për të treguar se organet kompetente dinin ose duhej të kishin ditur për sulmet ndaj tyre.

në fillimin e procedurave penale; hapave kyçe hetuese që janë ndërmarrë vetëm pas prolongimeve të konsiderueshme; mungesa e kontrolleve mjekësore të atyre ankuesve që kanë pohuar se kanë përjetuar keqpërdorime fizike; kryerësit e supozuar nuk janë marrë në pyetje; si dhe përfshirja pamjaftueshme e ankuesve në procedurën penale.

Më tej, autoritetet nuk e kanë shqyrtuar motivin e mundshëm të diskriminimit pas dhunës ndaj ankuesve, që, nga perspektiva e Gjykatës, vetëvetiu inicion çështjen për hetim joadekuat dhe joefikas. Gjykata ka konsideruar se, duke marrë parasysh materialin në dispozicion, motivi diskriminues i sulmuesve, pa dallim nëse janë persona privatë ose nëpunës shtetërorë, gjatë sulmit të ankuesve – të gjithë kanë qenë Dëshmitarë të Jehovait – është i qartë për shkak të paragjyqimeve të përhapura gjerësisht dhe vëllimit të dhunës në Gjeorgji gjatë asaj kohe.¹²³

Të gjithë ankuesit në kundërshtimet e tyre penale, në mënyrë eksplicite theksonin se kanë qenë viktimat të dhunës për shkak të religjionit të tyre. Kështu, në asnjë prej hetimeve të porositura nuk janë bërë përpjekje për zbulimin e qëllimit diskriminues pas incidenteve të dhunshme.

Ato mungesa kishin qenë të mjaftueshme që Gjykata të konkludojë **se ka ekzistuar praktikë sistematike nga ana e autoriteteve të Gjeorgjisë që të refuzojnë në mënyrë adekuate dhe efikase t'i hetojnë** veprat e dhunshme kundër Dëshmitarëve të Jehovait. Në këtë kontekst, ka pasur shkelje të nenit 3 në pjesën procedurale. Më tej, Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 14 lidhur me nenin 3. Duke i marrë parasysh materialet në dispozicion, Gjykata ka konstatuar se format e ndryshme të dhunës kundër ankuesve, nga nëpunësit shtetërorë ose personat privatë, janë motivuar nga padurimi (paragjykimet) ndaj komunitetit të Dëshmitarëve të Jehovait.

Autoritetet e Gjeorgjisë nuk kanë ndërmarrë kurrfarë hapash për t'i hulumtuar motivet e supozuara fetare; ndërsa nëpunësit e ndryshëm policorë kanë dhënë vërejtje tendencioze lidhur me religjionin e ankuesve gjatë procedurës. Gjykata kishte përsëritur se vërejtjet zbulojnë qëndrim të përgjithshëm diskriminues

123 *Begullori dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, § 141-142.

të autoriteteve. I njëjti qëndrim diskriminues ka qenë bazë e mospërkrahjes së autoriteteve relevante publike, për të hulumtuar në mënyrë efektive incidentet e dhunës me motive fetare.

Komente

Ky rast e ka përsëritur obligimin e shtetit për të ofruar mbrojtje nga veprat e dhunshme, të motivuara nga anshmëria fetare dhe t'i shqyrtojë veprat e asaj dhune duke e marrë parasysh motivin e anshmërisë. Më tutje, Gjykata ka potencuar kontekstet e qëndrimeve armiqësore ose sjelljes ndaj grupeve të caktuara, që janë dokumentuar nga faktorët ndërkombëtarë dhe vendorë, mund të kenë rol më të madh në vlerësimin e veprave të dënueshme që supozohet të jenë motivuara nga anshmëria. Më saktë, në këtë rast, Gjykata e kishte marrë parasysh **atmosferën nacionale të mostolerancës fetare ndaj komunitetit të Dëshmitarëve të Jehovait në Gjeorgji** gjatë ngjarjeve si aspekt esencial që a) të konstatohet nëse veprimi në të cilin ishin ekspozuar ankuesit e ka përmbushur prapësin e seriozitetit që të bie në kuadër të nenit 3 dhe b) për të sinjalizuar për nevojën e hetimit për motivet diskriminuese pas sulmeve.

Më tutje, ky rast ka potencuar edhe një aspekt tjetër me rëndësi për dhunën të motivuar nga anshmëria, respektivisht se nëse nuk sigurohet përgjigjja adekuate, ngjarja **ka tendencë që të eskalojë** dhe si e tillë mund të paraqesë kërcënim të sigurisë jo vetëm për individët dhe komunitetet që janë cak i sulmit për shkak të karakteristikës së caktuar personale, por edhe për shoqërinë si tërësi. Në rastin konkret, autoritetet relevante kanë qenë joefektive në parandalimin dhe pengimin e dhunës me motive fetare. Përmes sjelljes së agjentëve të tyre, të cilët ose në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë marrë pjesë në sulmet ndaj Dëshmitarëve të Jehovait, ose për shkak të lëshimeve dhe heshtjes ndaj aktiviteteve të paligjshme të individëve, organet kompetente kanë krijuar atmosferë të mosndëshkimit, që në fund kanë nxjerrur sulme të tjera kundër Dëshmitarëve të Jehovait në tërë vendin. Më tutje, me mopërgatitje të dukshme për të siguruar përndjekje dhe ndëshkim të shpejtë dhe të drejtë të personave përgjegjës, organet kompetente i kanë anashkaluar ndikimin parandalues dhe frikësues lidhur me lëndimet e ardhshme kundër Dëshmitarëve të Jehovait.



Veprat penale të urrejtjes së motivuar nga anshmëria kundër personave me aftësi të kufizuara

**Gjorgjeviq kundër Kroacisë
(Kërkesa ankimore nr. 41526/10) më
24 korrik 2012**

Shënim për procedurën

Ankuesit janë dy shtetas kroatë, nëna dhe i biri i saj, Dalibori, me aftësi të kufizuara psikike dhe fizike (trupore). Ata ishin ankuar se kanë qenë të keqtrajtuar edhe fizikisht edhe verbalisht, më shumë se katër vite nga fëmijët që jetonin në fqinjësinë e tyre dhe se autoritetet nuk kishin arritur që t'i mbronin. Ata janë bazuar në nenet 2, 3, 8, 13 dhe 14.

Rezyme e fakteve¹²⁴

Dalibori nuk ka pasur aftësi juridike sepse ka pasur aftësi të kufizuara psikike dhe fizike, si rezultat i sëmundjes që e kishte pasur nga fëmijëria e hershme. Nëna e tij është kujdesur për të, përfshirë edhe ushqyerjen, veshjen dhe pastrimin. Ajo i ndihmon që të lëvizë sepse shputat e tij kanë deformim serioz.

Edhe Dalibori edhe nëna e tij ishin ankuar se kanë qenë vazhdimisht të keqtrajtuar në periudhën ndërmjet korrikut të vitit 2008 dhe shkurtit të vitit 2011 nga nxënësit e shkollës fillore të rrethinës dhe se organet kompetente nuk u kanë ofruar mbrojtjen përkatëse. Gjatë kësaj periudhe ishin evidentuar një sërë incidentesh, ku fëmijët çuditshëm i kanë rënë ziles së derës së familjes në kohë të papërshtatshme, e kanë pështyrë Daliborin, e kanë goditur dhe e kanë shtyrë përreth, i kanë djegur duhan në duar, e kanë vandalizuar tarracën e tyre dhe u kanë thënë fjalë të pahijshme. Këto sulme kishin shkakuar shqetësim, frikë dhe ankiozitet të madh për Daliborin. Sipas Daliborit dhe nënës së tij, keqtrajtimi ishte shkakuar nga aftësia e kufizuar e Daliborit dhe prejardhja e tyre serbe.

Dalibori dhe nëna e tij në disa raste ishin ankuar para organeve të ndryshme, përfshirë edhe shërbimet sociale dhe Avokatin e Popullit. Gjithashtu,

shumë herë ishin paraqitur edhe në polici dhe i kishin paraqitur incidentet dhe kishin kërkuar ndihmë. Pas secilës thirrje, policia kishte arritur në vendngjarje, ndonjëherë me vonesë, ndërsa ndonjëherë vetëm që t'u thonë fëmijëve që të shpërdahen ose të mos bëjnë zhurmë.

Ata kishin marrë në pyetje edhe disa nxënës duke konkluduar se, edhe pse nxënësit e kanë pranuar se ishin sjellë dhunshëm ndaj Daliborit, ata kishin qenë shumë të rinj për përgjegjësi penale. Në shumë raporte mjekësore për gjendjen e Daliborit, mjekët e kishin vërejtur shqetësimin e tij të thellë si rezultat i sulmeve të fëmijëve ndaj tij dhe i kishin rekomanduar psikoterapi, si dhe ambient të sigurt dhe të qetë.

Vlerësimi dhe konkluzionet e Gjykatës

Keqtrajtimi (neni 3) në aspekt të ankuesit të parë (Daliborit)

Gjykata kishte vërejtur se Dalibori vazhdimisht ishte keqtrajtuar dhe si rezultat i kësaj ishte ndier i pafuqisë dhe ishte frikësuar një kohë të gjatë. Në një rast ka qenë edhe i lënduar fizikisht. Keqtrajtimi i këtille ka qenë mjaft serioz për të iniciuar mbrojtjen nga neni 3 në rastin e tij.

Më tutje, Gjykata kishte vërejtur se për veprat e dhunshme që janë pjesë e nenit 3 ishin të nevojshme masa penale-juridike kundër kryerësve. Mirëpo, duke marrë parasysh se personat që e kishin keqtrajtuar Daliborin kishin qenë shumë të rinj (fëmijë nën moshën 14-vjeçare), ka qenë e pamundur që të sanksionohen penalisht. Për këtë arsye, Gjykata e dallon këtë rast nga rastet që kanë të bëjnë me obligimet procedurale shtetërore sipas së drejtës penale lidhur me procedurat e keqtrajtitimit që janë në kundërshtim me nenin 3 (detyra të zbatohet hetimi i detajuar, efektiv dhe i pavarur). Ky rast ka të bëjë me obligimet pozitive të shtetit në situata të ndryshme, jashtë sferës së të drejtës penale, ku organet kompetente janë të vetdijshme për situatën e keqtrajtitimit serioz kundër personit me aftësi të kufizuara fizike dhe psikike. Ajo ka të bëjë me mungesën e supozuar të përgjigjes adekuate ndaj situatës së këtille me qëllim

124 Kumtesë për media më 24.07.2012.

të zgjidhjes së drejtë të veprave të dhunshme dhe shqetësimit tashmë të ndodhura, si dhe për parandalimin e çfarëdo veprave të mëtejshme.

Që nga korriku i vitit 2008, nëna e Daliborit e kishte njoftuar policinë për keqtrajtimin rrjedhës të fëmijës së saj. Më pas, ajo vazhdimisht i kishte kontaktuar me ankesa plotësuese, për të cilat gjithashtu e kishte njoftuar edhe Avokatin e Popullit edhe shërbimet sociale. Për këtë arsye, autoritetet kanë qenë mjaft të vetëdijshme për situatën. Kështu, derisa policia kishte marrë në pyetje disa fëmijë për këto incidente, ata nuk kanë bërë tentime serioze që përkojnë me nivelin e problemit dhe për të penguar keqpërdorimet e mëtutjeshme. Policia kishte evidentuar se fëmijët e kishin ofenduar Daliborin, por ajo nuk ishte pasuar me veprime konkrete. Nuk janë marrë vendime për veprim të mëtejshëm dhe nuk ishin vendosur mekanizma për ndjekje me qëllim që të njihet dhe parandalohet shqetësimi i mëtejshëm. Gjykata ka qenë e befusuar nga mungesa e përfshirjes së vërtetë të shërbimeve sociale dhe nga mungesa e këshillimeve për Daliborin. Ka konkluduar se, përveç përgjigjeve për incidentet konkrete, organet kompetente përkatëse nuk kanë ndërmarrë veprime adekuate të natyrës së përgjithshme, edhe përkundër njohurive të tyre se Dalibori ka qenë i targetuar në mënyrë sistematike dhe se janë të mundshme edhe keqpërdorime të tjera. Sipas kësaj, ka pasur shkelje të nenit 3 lidhur me Daliborin.¹²⁵

Mbrojtja e jetës private dhe familjare (neni 8) në aspekt të ankuesit të dytë

Gjykata ka përsëritur se, sipas nenit 8, shtetet jo vetëm që janë të obliguara që të mos i dëmtojnë individët, por gjithashtu edhe kanë pasur detyrë që të veprojnë me qëllim që të mbrojnë integritetin moral të njerëzve nga veprimet e të tjerëve.

Duke marrë parasysh se Dalibori dhe nëna e tij i ishin nënshtruar keqtrajtimin të shumëfishtë, jeta private dhe familjare e nënës ka qenë negativisht e ndikuar.

Krahas faktit që autoritetet nuk kanë ndërmarrë masa përkatëse për të penguar keqtrajtimet e mëtutjeshme të djalit të saj, ata nuk kanë arritur që ta mbrojnë atë. Sipas kësaj, ka pasur shkelje të nenit 8 që ka të bëjë me ankuesin e dytë.

Komentet

Edhe pse këtë rast Gjykata nuk e ka shqyrtuar nga perspektiva e detyrës që të hetohet motivi për

anshmëri gjatë veprave penale kundër personave me aftësi të kufizuara, ky është rast i rëndësishëm që e ka theksuar përgjegjësinë e shtetit që të ofrojë mbrojtje nga keqpërdorimet e vazhdueshme dhe në mënyrë efikase t'u kundërvihet veprave penale të urrejtjes kundër personave me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara rregullisht janë cak i veprave penale të urrejtjes, ndërsa këto vepra penale në masë të madhe mbeten të padukshme dhe të pakuptueshme. Veprat penale të urrejtjes kundër personave me aftësi të kufizuara shpeshherë dallohen nga llojet e tjera të krimit të urrejtjes. Për shembull, shumë prej tyre vazhdimisht kryen me vite duke përfshirë njerëz që janë të afërt me viktimat. Dhunuesit mund të orientohen ndaj personave me aftësi të kufizuara, ose personave për të cilët konsiderohet se kanë aftësi të kufizuara, sepse besojnë se janë të cenueshëm për shkak të simptomave të dëmtimit të tyre ose gjendjes shëndetësore, për çka konsiderohen "caqe të lehta" që nuk do ta paraqesin veprën e dënueshme. Perceptimi i të gjithë personave me aftësi të kufizuara si të cenueshëm në fund i minimizon ose i injoron faktorët socialë lidhur me pjesëmarrjen e tyre dhe përfshirjen në shoqëri dhe është e paragjykuar, respektivisht përcaktuar paraprakisht.¹²⁶

Gjatë analizës së përgjigjes së organeve kompetente të situatës, respektivisht zgjidhjen e veprave të dhunës dhe shqetësimit dhe parandalimit të çfarëdo veprave të tilla në të ardhmen, Gjykata e ka potencuar rolin, jo vetëm të policisë, por edhe të shërbimeve sociale (qendrës për mbrojtje sociale) dhe organeve të tjera kompetente (Avokatin e Popullit për personat me aftësi të kufizuara, Avokatin e Popullit për fëmijë, autoritetet e shkollës).

Gjykata konkretisht e ka vërejtur lëshimin e autoriteteve "për vlerësimin e natyrës së vërtetë të situatës për të cilën ankohen dhe për **të zgjidhur mangësinë e qasjes sistematike** që ka rezultuar me mungesë të masave adekuate dhe gjithëpërfshirëse".¹²⁷ Miratimi i qasjes sistematike dhe të harmonizuar për të parandaluar keqpërdorimin e mëtejshëm në rastin e veprave penale të urrejtjes kundër personave me aftësi të kufizuara ka rëndësi të veçantë, sepse këto vepra penale shpeshherë përsëriten në periudhë më të gjatë kohore dhe nuk janë të dukshme.

¹²⁶ Krimit e urrejtjes kundër personave me aftësi të kufizuara, lista informative, OSBE/ODIHR, 2016. Lista informative përmban informacione se si të njihen dhe paraqiten veprat penale të urrejtjes kundër personave me aftësi të kufizuara.

¹²⁷ Gjorgjeviq kundër Kroacisë, § 148.

¹²⁵ Gjorgjeviq kundër Kroacisë, §§ 141 - 150.

IV.

Veprat penale të urrejtjes së motivuar nga orientimi seksual, identiteti gjinor dhe shprehja gjinore

**M. C. dhe A. C. kundër Rumanisë,
(Kërkesa ankimore nr. 12060/12)
më 12 prill 2016**

Shënim për procedurën

Ankuesit janë dy shtetas rumunë, M.C dhe A.C, të cilët konkretisht deklarojnë se hetimet për konstatimet e tyre për keqtrajtim të motivuar nga diskriminimi në bazë të orientimit social nuk kishin qenë efektive; respektivisht, ishin ankuar për shkeljen e neneve 3, 8 dhe 14 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit 12 të Konventës.¹²⁸

Rezime e fakteve¹²⁹

Më 3 qershor 2006, ankuesit kishin marrë pjesë në gej-paradën vjetore (marshi i homoseksualëve) në Bukuresht. Kur po ktheheshin në shtëpi, ishin sulmuar në metro nga një grup prej gjashtë djemve të rinj dhe një gruaje. Sulmuesit i kishin goditur me grushte dhe shqelma duke shprehur ofendime homofobike ndaj tyre. Të dy ankuesit kishin marrë lëndime, përfshirë edhe të ënjtura, kontuzione dhe traumë të vogël kranio-cerebrale të gjitha këto të konfirmuara nga kontrollet mjekësore të cilat u ishin bërë ankuesve. Njëherazi, ata theksonin se kanë vizituar terapi grupore për t'u përballur me traumën psikologjike nga këto sulme. Ankuesit menjëherë kishin ngritur kallëzim penal kundër sulmuesve, në të cilën theksohet se sulmi ishte bazuar në orientimin e tyre seksual. Ata kishin besuar se sulmuesit e tyre me gjasë i kanë identifikuar gjatë marshit dhe më pas i kanë ndjekur në metro, meqë sipas udhëzimeve të dhëna nga organizatorët, ata nuk kanë bartur kurrfarë shenjash të dukshme që do të tregonin se kanë marrë pjesë në marsh. Në afat

prej disa ditësh, ata i kanë dorëzuar të gjitha dëshmitë e disponueshme, veçanërisht fotografitë e bëra nga fotografi gjatë sulmit dhe identifikimi i sulmuesve të caktuar edhe nga fotografi edhe nga M.C., ankuesi i parë. Dosja e tyre në fund i ishte dhënë Stacionit Policor të Metros në prill të vitit 2007. Më pas ishte marrë në pyetje një dëshmitar dhe meqë ishte besuar se njëri prej sulmuesve ka qenë tifoz i klubit futbollistik, policia kishte marrë pjesë edhe në 29 ndeshje futbollistike dhe ka bërë kontrolle të rastësishme të stacioneve të metros. Mirëpo, në vitin 2011 policia kishte deklaruar se nuk ka ndërmend që të iniciojë përndjekje penale, sepse kishte konsideruar se është e pamundur që të identifikohen fajtorët, ndërsa veprat e supozuara penale në ndërkohë janë parashkuar. Organet e prokurorisë më pas e kishin miratuar propozimin policor dhe, në fund, në gusht të vitit 2012, gjykatat e kishin hedhur poshtë ankesën e ankuesve për vendimin që të mos iniciohet procedurë penale, gjithashtu duke konstatuar se veprat penale janë parashkuar.

Vlerësimi dhe konkluzionete gjykatës

Lejueshmëria

Gjykata ka konstatuar se ankuesit i kanë shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion që kishin qenë të mjaftueshme për nevojat e kësaj kërkesë të padisë dhe ishte ruajtur afati gjashtëmuor i rastit; sipas kësaj, e kishte shpallur ankesën si të lejueshme.

Arsyeshmëria

Në **pragun e seriozitetit**, Gjykata kishte përsëritur se keqtrajtimi duhet të arrijë nivelin minimal të seriozitetit që të bie në fushëveprimin e nenit 3. Vlerësimi i këtij minimumi është relativ sepse varet nga të gjitha rrethanat e rastit, siç është natyra dhe konteksti i veprimit, kohëzgjatja e tij dhe ndikimet e tij fizike dhe psikike, ndërsa në disa raste edhe gjinia, moshë dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Veprimi konsiderohet "nënçmues" në kuadër të nenit 3, nëse te viktimë ka shkaktuar ndjenjën e frikës, dhimbjes dhe inferioritetit, nëse e nënçmon

128 Neni 1 i Protokollit nr. 2 - Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit.

129 Kumtesë për media më 12.04.2016.

personalitetin, nëse e cenon rezistencën fizike ose morale të personit ose e nxitë që të veprojë kundër dëshirës ose vetëdijes së tij ose të saj, ose nëse tregon mungesë respekti ose e ulë dinjitetin njerëzor.¹³⁰

Në këtë rast, Gjykata e ka vërejtur keqpërdorimin fizik dhe verbal të ankuesve, si pasojë e të cilës kishin pasur lëndime dhe nevojë për terapi grupore për t'u përballur me traumat psikologjike, ndjenjat e shqetësimit, anksozitetit dhe nënçmimit që i kanë përjetuar për shkak të sulmit. Gjykata konkretisht e ka shqyrtuar rolin e anshmërisë homofobike në shkaktimin e traumës ndaj ankuesve dhe ka konsideruar se qëllimi i keqpërdorimit verbal dhe fizik "me gjasë është për t'i frikësuar ankuesit, në mënyrë që të heqin dorë nga shprehja e tyre publike e përkrahjes ndaj komunitetit LGBT". Në këtë drejtim, Gjykata konkretisht ka pranuar se "komuniteti LGBTI në Gjeorgji është në gjendje të pasigurt, i nënshtruar ndaj qëndrimeve negative për anëtarët e këtij grupi". Në bazë të kësaj, Gjykata ka konkluduar se veprimi nuk është i pajtueshëm me respektimin e dinjitetit të tyre njerëzor dhe për këtë e ka arritur pragun e nevojshëm të seriozitetit që të bie në kuadër të nenit 3 të shqyrtuar lidhur me nenin 14.¹³¹

Për **efektivitetin e hetimit**, Gjykata ka përsëritur se që hetimi të konsiderohet "efektiv" duhet të mundësojë konstatimin e fakteve për rastin dhe identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës, duhet të jetë i shpejtë dhe ekspeditiv në mënyrë të arsyeshme.¹³²

Më tutje, "kur hetohen incidentet e dhunshme, siç është keqtrajtimi, kjo detyrë nënkupton se organet kompetent kanë **detyrë që t'i ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm për të zbuluar çfarëdo motivesh të mundshme diskriminuese**" [...]. Obligimi i shtetit që duhet në mënyrë adekuate të përgjigjet ashtu që do t'i hetojë motivet e mundshme diskriminuese për veprën e dhunshme që nënkupton obligim për t'i shfrytëzuar përpjekjet veta më të mira për ta bërë atëdhe obligimi i këtellë nuk është absolut.

Organet kompetente doemos duhet të bëjnë "gjithçka që është e arsyeshme në rrethanat për të

mblodhur dhe siguruar dëshmi, t'i hetojnë të gjitha mjetet praktike për zbulimin e së vërtetës dhe të sjellin vendime tërësisht të bazuara, të paanshme dhe objektive, **pa lëshuar faktet e dyshimta që mund të jenë tregues për dhunën e shkaktuar, për shembull, nga mostoleranca racore ose fetare, ose nga dhuna e motivuar nga diskriminimi në bazë gjinore**"¹³³

Në këtë rast, Gjykata ka vërejtur se pas marrjes së ankesës, organet kompetente nuk kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në hetim, në periudhë prej pothuajse një viti, ka pasur periudha të konsiderueshme të mosaktivitetit nga ana e organeve kompetente gjatë hetimit dhe për më shumë se pse vite pas kallëzimit të parë penal, policia nuk e ka konstatuar identitetin e kryerësve.

Më tutje, ka pasur disa mangësinë hetim, ndërsa autoritetet nuk i kanë shfrytëzuar dëshmitë të dorëzuara nga ankuesit, konkretisht deklaratat, fotografitë dhe identifikimin e disa personave në grupin e sulmuesve. Edhe më i rëndësishëm është fakti se autoritetet nuk kanë ndërmarrë hapa të arsyeshëm për ta shqyrtuar rolin që e kanë motivet e mundshme homofobike pas sulmit.

"Domosdoshmëria për të zbatuar hulumtim të rëndësishëm të mundësisë për diskriminim që e ka motivuar sulmin ishte **nevoja duke marrë parasysh qëndrimin armiqësor kundër komunitetit LGBTI në vend** dhe në bazë të parashtrësive të ankuesve se është shprehur **gjuha e urrejtjes** nga ana e sulmuesve gjatë incidentit, që dukshëm ka qenë homofobik".¹³⁴ Në bazë të së lartpërmendurës, Gjykata ka konkluduar sehetimet për konstatimet e keqtrajtimit kishin qenë joefikase sepse kanë zgjatur tepër, janë cenuar me mangësi serioze dhe nuk i kanë marrë parasysh motivet e mundshme diskriminuese; në këtë mënyrë, është konstatuar edhe shkelja e nenit 3, pjesës së tij procedurale, të shqyrtuar së bashku me nenin 14.

Në raport me nenet e tjera për të cilat është iniciuar çështja nga ankuesit, nenet 8 dhe 1 të Protokollit nr.12 të Konventës, Gjykata ka vërejtur se këto ankesa gjithashtu janë të lejueshme, por ka konsideruar se i ka shqyrtuar çështjet kryesore juridike të ankuesve sipas neneve 3 dhe 14, me çka nuk ka nevojë të miratohet aktvendim i posaçëm për arsyeshmërinë e ankesave të tjera.

130 *M.C. dhe A.C. kundër Rumanisë*, §§ 107-108.

131 *Id.*, §§ 116 - 119.

132 *Id.*, § 111.

133 *Id.*, § 113.

134 *Id.*, § 124.

Komentet

Me këtë rast, Gjykata e ka përsëritur detyrën e shtetit për të zbatuar hetim efektiv për veprat penale të motivuara nga anshmëria, konkretisht, të motivuara nga anshmëria në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor. Detyra procedurale përfshin ndërmarrjen e të gjithë hapave të arsyeshëm për të zbuluar motivet eventuale diskriminuese. Arsyeya për këtë detyrë procedurale është ekzistimi i fakteve ose elementeve të veprave penale që sugjerojnë në rolin e mundshëm të konotacionit diskriminues të ngjarjeve. Në këtë rast, Gjykata ka vlerësuar se gjuha homofobike e urrejtjes që është shprehur gjatë incidentit, së bashku me kontekstin e përgjithshëm të qëndrimit armiqësor kundër komunitetit LGBTI në Gjeorgji, kanë qenë indikatorë të qartë se veprat penale të urrejtjesqë duhej të nxisin hetime për motivet e anshmërisë.

Një indikator tjetër i rëndësishëm për veprat penale të urrejtjes në këtë rast është ngjarja që drejtpërdrejtë i ka paraprirë sulmit ndaj ankuesve, respektivisht fakti që ankueset kanë marrë pjesë në gej-paradën vjetore (marshin e homoseksualëve) në Bukuresht. Është e sigurt se ata qëllimisht ishin ndjekur nga kryerësit, sepse nuk kanë pasur kurrfarë veshje ose shenje karakteristike që do t'i identifikonte se kanë marrë pjesë në marsh. Është dukuri e rregullt që veprat penale dhe incidentet e urrejtjes të ndodhin gjatë paradave të krenarisë ose ngjarjeve të tjera, siç janë festivalet ose projektimet e filmave, të kushtuar Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Bifobisë dhe Transfobisë, që shënohet më 17 maj, ose gjatë Muajit të Krenarisë që zakonisht është në qershor, por mund të mbahet edhe gjatë muajve të tjerë.

Lidhur me paradat e krenarisë dhe sulmet ndaj pjesëmarrësve në paradë, në aktgjykimin e *Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, Gjykata gjithashtu e ka theksuar **obligimin pozitiv të shtetit për të mbrojtur lirinë e pjesëmarrjes në tubime të qeta, nga dhuna të motivuar nga anshmëria**, që del nga neni 11 (liria e tubimit dhe bashkimit).

Konventa i mbron format publike të shprehjes, përfshirë edhe përmes mbajtjes së tubimeve të qeta dhe shprehjes së mendimeve lidhur me fushatën dhe ndërgjegjësimin për të drejtat themelore të minoriteteve të ndryshme sek-

suale.¹³⁵ Për t'i dhënë rëndësi kësaj lirie, organet kompetent jo vetëm që duhet ta respektojnë, respektivisht të mos përzihen, por edhe në mënyrë aktive të ofrojnë mbrojtje me masat pozitive.¹³⁶ Krahas kësaj, në këtë rast, Gjykata ka potencuar se organet kompetente kanë **barrë edhe më të rëndë për t'i mbrojtur** individët që parapakisht kanë pasur njohuri për qëndrimin armiqësor të publikut ndaj komunitetit LGBTI.¹³⁷

Duke marrë parasysh historinë e armiqësisë publike ndaj komunitetit LGBT në Gjeorgji, Gjykata ka konsideruar se autoritetet kanë ditur ose është dashur që të dinë mbi rreziqet lidhur me çdo ngjarje publike lidhur me atë komunitet të cenuar.

Shoqata Accept dhe të tjerët kundër Rumanisë (Kërkesa ankimore nr. 19237/16) më 1 qershor 2021

Shënim për procedurën

Kërkesa ankimore është parashtruar nga shoqata joprofitabile ACCEPT (“parashtruesi i kërkesës ankimore”) dhe pesë shtetasit rumunë (“parashtruesit individualë të kërkesës ankimore”). Kërkesa ankimore ka të bëjë me gjoja lëshimin për të ofruar mbrojtje për ankuesit nga keqpërdorimet dhe kërcënimet verbale homofobike dhe për të realizuar hetim efektiv me ankesën e ankuesve. Njëkohësisht, ka të bëjë edhe me pasojat e këtyre incidenteve ndaj të drejtës së lirisë së tubimit të qetë që e kanë ankuesit. Ankuesit janë bazuar në nenet 3, 8, 11, 13 dhe 14 të Konventës, si dhe në nenin 1 të Protokollit nr.12 të Konventës.

Rezyme e fakteve¹³⁸

Gjatë Muajit të Historisë së personave të LGBT-së të shoqatës së parashtruesve të kërkesës ankimore në shkurt të vitit 2013, ishte shfaqur filmi lidhur me familjen e gjinisë së njëjtë. Pesë parashtruesit e tjerë të kërkesës ankimore kishin marrë pjesë gjatë shfaqjes së filmit.

¹³⁵ *Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, § 97.

¹³⁶ *Id.*, § 94.

¹³⁷ *Id.*, § 72.

¹³⁸ Kumtesë për media më 01.06.2021.

Njëkohësisht ishte mbajtur protestë kundër shfaqjes së filmit. Rreth pesëdhjetë protestues kishin hyrë në sallë dhe e kishin ndërprerë shfaqjen. Kishin shprehur ofendime si “vdekje për homoseksualët”, “pederastë” dhe “njerëz të ndyrë”. Disa gjoja kanë pasur edhe flamuj të së djathtës ekstreme.

Duket se keqbërësit kishin qenë të lidhur me lëvizjen politike të së djathtës ekstreme, *Noua Dreaptă* (“E Djathta e Re”), e cila haptazi kundërshton, mes tjerash, edhe martesat e gjinive të njëjta dhe adoptimeve nga personat e së njëjtës gjini.

Organizuesit e kishin alarmuar edhe policinë, e cila kishte qenë e pranishme në këtë ngjarje. Policia kishte hyrë në këto hapësira, i kishte konfiskuar flamujt dhe kishin shkuar edhe përkundër faktit se ishte kërkuar që të qëndrojnë. Meqë protestuesit e kishin bllokuar projektorin, organizuesit në fund ishin detyruar që të anulojnë shfaqjen e filmit. Më 5 mars të vitit 2013, shoqata që kishte parashtruar kërkesën ankimore ishte ankuar në polici për incidentin. Hetimi ishte hapur, e më pas mbyllur më 14 tetor të vitit 2014 (incidenti ishte përshkruar si “shkëmbim i mendimeve”), vendim që ishte konfirmuar edhe nga organet kompetente. Hetimi për përdorimin e simboleve fashiste gjithashtu ishte ndërprerë më 11 gusht të vitit 2017. Të kosta ishin edhe disa ankesa nga parashtruesit e kërkesës ankimore te gjykatat. Në përgjithësi, nuk kishte pasur aktakuza.

Vlerësimi dhe konkluzionet e gjykatës

Shkelja e supozuar e neneve 3, 8 dhe 14 të Konventës dhe të nenit 1 të Protokollit nr.12 të Konventës

Gjykata fillimisht kishte vlerësuar zbatueshmërinë e nenit 3 dhe kishte potencuar se keqtrajtimi doemos duhet të arrij nivelin minimal të seriozitetit që të bie në fushëveprimin e nenit 3. Ajo i përfshin veprat e keqtrajtimit fizik, por edhe shkaktimin të vuajtjeve psikologjike. Më tutje, Gjykata kishte përsëritur se “veprimi diskriminues si i tillë, në princip, mund të jetë veprim nënçmues në kuptim të nenit 3, kur arrin nivel të seriozitetit që paraqet ofendim për dinjitetin njerëzor”.¹³⁹

Në këtë rast, ankesa është bazuar në ndikimin psikologjik që incidenti supozohet ta ketë pasur ndaj ankuesve. Mirëpo, parashtruesit e kërkesës ankimore nuk kanë sugjeruar në “kurrfarë faktesh që t’i mundësojnë Gjykatës të zbulojë nivelin e vuajtjeve psikike që e kanë përjetuar si rezultat i incidentit që ka qenë afër nivelit që Gjykata e ka konstatuar në raste tjera të ngjashme” (p.sh. *M.C dhe A.C kundër Rumanisë*, ku keqpërdorimi verbal ishte përcjellë me sulme fizike). Edhe pse kundër-protestuesit kishin qenë më të shumtë dhe i kishin rrethuar ankuesit, ata ishin përcjellë vazhdimisht nga policia, por nga korridori jashtë hapësirës së shfaqjes ku kishte ndodhur incidenti. Nuk kanë ndodhur vepra të agresionit fizik ndërmjet ankuesve dhe kundër-protestuesve. Keqpërdorimi verbal, edhe pse haptazi kishte qenë diskriminues dhe i kryer në kontekst të veprimeve që kishin dëshmuar model të dhunës dhe mostolerancës ndaj minoritetit seksual, nuk kanë qenë aq serioze që mund të shkaktojnë frikë, dhimbje ose ndjenjë të inferioritetit që janë të domosdoshme për t’u thirrur në nenin 3. Së këndejmi, Gjykata kishte konstatuar se niveli minimal i seriozitetit të nevojshëm për nenin 3, nuk është arritur, për këtë edhe është hedhur poshtë ankesa sipas këtij neni.¹⁴⁰

Sidoqoftë, veprimi që nuk arrin shkallën e seriozitetit të mjaftueshëm që të bie nën nenin 3, edhe përkundër kësaj, mund ta prish aspektin e “jetës private” të nenit 8, nëse ndikimet ndaj integritetit fizik dhe moral të ankuesit janë mjaft negative. Koncepti i “jetës private” është nocion më i gjerë dhe gjithashtu përfshin edhe integritetin fizik dhe psikologjik të një personi. Elementet e këtilla si orientimi seksual dhe jeta seksuale e një personi bëjnë pjesë në sferën personale të mbrojtur me nenin 8.¹⁴¹ Gjykata ka vlerësuar se sulmet e dhunshme verbale ndaj ankuesve të cilat mes tjerash, kanë ndodhur në kontekst të dëshmimeve për modelet e dhunës dhe mostolerancës kundër minoritetit seksual, e kanë arritur shkallën e seriozitetit të nevojshëm për t’u thirrur në nenin 8. Së këndejmi, Gjykata ka konstatuar se rasti bie në fushëveprimin e nenit 8.

Lidhur me **obligimin për mbrojtje**, Gjykata e ka shqyrtuar intervenimin e organeve kompetente dhe efikasitetin e saj gjatë incidentit. Incidenti i referohej grupit prej rreth 20 personave të cilët ishin keqtrajtuar verbalisht nga një grup prej 45

140 *Id.*, §§ 52-57.

141 *Id.*, § 63.

139 *Shoqata ACCEPT dhe të tjerët kundër Rumanisë*, § 52.

personave, që në mënyrë efektive e kanë ndërprerë ngjarjen e tyre.

Policia nuk i kishte penguar keqbërësit, në masë të madhe është përmbajtur nga intervenimi për deeskalimin e situatës dhe ka qëndruar jashtë hapësirës ku ka ndodhur incidenti edhe përkundër faktit se aty ka pasur numër të mjaftueshëm të nëpunësve policorë. Më tutje, Gjykata ka vërejtur se “qëndrimi dhe vendimi i organeve kompetente për të qëndruar anash dhe përkundër faktit se janë të vetëdijshëm për përmbajtjen e ofendimeve [...] duket se sugjerojnë në anshmërinë e caktuar kundër homoseksualëve”.¹⁴²

Raportet e përgatitura nga policia pas ngjarjeve nuk kanë përmbajtur referencë për ofendimet homofobike dhe e kanë përshkruar incidentin pa iu referuar homofobisë. Gjykata ka konkluduar se organet kompetent në mënyrë të drejtë nuk e kanë vlerësuar rrezikun nga keqbërësit në të cilin janë ekspozuar parashtruesit individualë të kërkesës ankimore dhe nuk janë përgjigjur në mënyrë përkatëse **për të mbrojtur dinjitetin e parashtruesve individualë të kërkesës ankimore nga sulmet homofobike të personave të tretë**.¹⁴³

Gjykata në mënyrë plotësuese e ka shqyrtuar **obligimin e shtetit për të realizuar hetim për motivet e mundshme diskriminuese pas ngjarjeve**. Është vërejtur se që nga fillimi, organet kompetente kishin pasur indikacione të qarta për keqpërdorim verbal ndaj ankuesve individualë, të motivuar nga orientimi seksual, për shkak të faktit që policia ka qenë e pranishme gjatë këtyre ngjarjeve. Kjo, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, “është urdhëruar për zbatimin efektiv të mekanizmave vendas për të drejtën penale që mund ta qartësojnë motivin e mundshëm të urrejtjes me konotacion homofobik pas incidentit të dhunshëm”.¹⁴⁴ Sidoqoftë, organet kompetente nuk kanë arritur që të ndërmarrin hapa efektive në hetim edhe përkundër faktit se kishin pasur disa udhëzime. Më tutje, natyra homofobike e sulmit nuk ishte hetuar në mënyrën e duhur nga autoritetet. Vetëm dy vite pas incidentit, prokurori kishte filluar t’i hetojë konstatimet se keqbërësit kanë shfaqur simbole fashiste; mirëpo, arsyet e supozuara homofobike për kryerjen e veprave nuk janë përmendur në

vendimet e prokurorëve. Njëherazi, gjykata ka vërejtur se gjuha e përdorur nga organet kompetente (“pasues” të marrëdhënies të gjinisë së njëjtë, “simpatizues” të organizatave ekstreme djathiste) tregon në anshmërinë nga ana e organeve ndaj ankuesve individualë. Krahas kësaj, Gjykata ka vërejtur se organet kompetente nuk i kanë shqyrtuar indikatorët e qartë për anshmërinë ndaj veprave penale të urrejtjes: shpifjet homofobike të shprehura gjatë sulmit dhe fakti se organizata që me gjasë kishte qëndruar pas sulmeve, kishte kundërshtuar me të keqe marrëdhëniet homoseksuale. Nga perspektiva e Gjykatës “absolute ka qenë domosdoshmëria të zbatohet hulumtimi i konsiderueshëm i mundësisë se keqpërdorimi është nxitur nga motivet diskriminuese, duke marrë parasysh qëndrimin armiqësor kundër komunitetit LGBT në Rumani”.

Në bazë të së lartpërmendurës, Gjykata ka konkluduar se autoritetet nuk kanë ofruar mbrojtje adekuate lidhur me dinjitetin e ankuesve individualë (dhe më gjerë, jetës së tyre private) dhe nuk kanë arritur që në mënyrë efektive ta hulumtojnë natyrën e vërtetë të keqpërdorimit homofobik të drejtuar kundër tyre. Me këtë ishte konstatuar se ankuesit individualë kanë përjetuar diskriminim në bazë të orientimit të tyre seksual; sepse në këtë mënyrë ka pasur shkelje të nenit 14, të shqyrtuar lidhur me nenin 8.

Shkelja e supozuar e neneve 11 dhe 14 të Konventës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës

Meqë nuk është mbrojtur e drejta e ankuesve për lirinë e tubimit të qetë dhe nuk janë hetuar veprimet që kanë çuar në ndërprerjen e ngjarjes së tyre, Gjykata ka përsëritur se e drejta e lirisë së tubimit të qetë përfshin edhe takime private dhe takime në vendet publike, pa dallim nëse takimi është në një vend fiks ose në formë të marshimit; krahas kësaj, kjo e drejtë mund të shfrytëzohet edhe nga pjesëmarrësit individualë dhe personat që e organizojnë tubimin. Gjykata ka deklaruar se ndërprerja e shfaqjes së filmit në këtë rast ka qenë përzierje në të drejtën e ankuesve për tubim të qetë. Gjykata ka konsideruar se faktet relevante janë të njëjta sikur edhe për ankesën sipas nenit 14, të miratuar lidhur me nenin 8. Si rezulzim, Gjykata ka konkluduar se autoritetet nuk kanë arritur që të sigurojnë zhvillimin e ngjarjes në këtë rast, duke dështuar sipas obligimeve të tyre nga neni 14 të shqyrtuar lidhur me nenin 11.

¹⁴² *Id.*, §112.

¹⁴³ *Id.*, §113.

¹⁴⁴ *Id.*, §114.

Komentet

Në këtë rast, Gjykata e ka zgjeruar zbatueshmërinë e nenit 8 (aspekti i “jetës private”) për të vepruar ndaj keqpërdorimit verbal dhe gjuhës së urrejtjes që nuk e kanë arritur nivelin e seriozitetit të mjaftueshëm për nenin 3. Veprimi që ndikon në mirëqenien psikologjike dhe dinjitetin është pjesë e sferës së jetës private.

Në mënyrë që të thirret në nenin 8, duhet të arrihet ndikimi i mjaftueshëm negativ ndaj integritetit psikologjik. Në këtë rast, Gjykata ka vlerësuar se sulmet e dhunshme verbale homofobike ndaj ankuesve, veçanërisht të marrë në kontekst të dëshmive për modelet e dhunës dhe mostolerancës kundër minoritetit seksual, e kanë arritur shkallën e seriozitetit që nevojitet për nenin 8. Si përgjigje e kësaj, organet kompetente kanë theksuar se kërcënimet (“vdekje për homoseksualët”) ose vërejtje të tjera ndaj ankuesve nuk e kanë arritur pragun e nevojshëm sipas ligjit në fuqi për të qenë vepër penale. Gjykata ka theksuar se “çdo shprehje e gjuhës së urrejtjes nuk është patjetër, që si e tillë, të tërheq përndjekje penale dhe sanksione penale”, mirëpo, “komentet që kanë nxitur gjuhë të urrejtjes dhe dhunë, e që dukshëm janë të paligjshëm, në princip mund të imponojnë nevojën që shtetet të ndër marrin masa të caktuara pozitive”.¹⁴⁵ Gjykata ka vlerësuar se në këtë rast, organet kompetente është dashur që të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të hulumtuar nëse keqpërdorimi verbal ndaj ankuesve individualë, ka qenë vepër penale e motivuar nga homofobia dhe përsëri e ka konfirmuar detyrën e shtetit për t'i zbuluar motivet diskriminuese dhe t'i hulumtojë indikatorët e anshmërisë lidhur me veprimin që bie nën nenin 8.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i rastit është shqyrtimi i Gjykatës për neutralitetin dhe efektivitetin e hetimit në bazë të pasqyrës së qartë të organeve kompetente për paragjykimet ndaj ankuesve. Pasqyra e tillë ishte konfirmuar edhe me fakti se në raportet policore nuk është përmendur keqpërdorimi homofobik dhe gjuha e urrejtjes që janë shprehur gjatë incidenteve, ndërsa prokuroria kishte shfrytëzuar gjuhën e anuar (“pasues” të marrëdhënieve të gjinisë së njëjtë, “simpatizues” të organizatave të djathta ekstreme) ose janë thirrur në incidentin vetëm si “diskutime” ose “shkëmbim i mendimeve”. Nga perspektiva e Gjykatës,

“shprehja e këtyllë, larg nga ajo neutrale ose e raste-sishme, mund të sugjerojnë në anshmërinë e autoriteteve ndaj ankuesve individualë, që mund të konsiderohet se dëshmon që autoritetet e kanë anashkaluar konotacionin homofobik të veprave të kryera, me çka **rezikohet saktësia dhe efektiviteti i procedurave vendase në tërësi**”.¹⁴⁶

Me këtë, Gjykata ka potencuar se mangësia e neutralitetit në hetim mund të sjellë në pikëpyetje efikasitetin e saj, që nga ana tjetër çon drejt mospërbushjes së obligimit pozitiv për hetim në mënyrë efektive, siç nevojitet në pajtim me standardet e Konventës.

Agdgomelashvili i Japarixe kundër Gjeorgjisë (Kërkesa ankimore nr.7244/11) më 8 tetor 2020

Shënim për procedurën

Dy ankueset janë shtetase gjeorgjiane, kërkesa ankimore e të cilave i referohet keqtrajtimit të supozuar diskriminues nga ana e policisë (në bazë të orientimit të tyre të vërtetë dhe/ose të perceptuar seksual dhe identitetit gjinor) dhe mangësisë së hetimit efektiv vendas për motivet homofobike dhe/ose transfobike pas keqtrajtimit. Ankuesit bazohen në nenet 3, 8 dhe 14 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit nr.12.

Rezime e fakteve¹⁴⁷

Më 15 dhjetor të vitit 2009, rreth 17 policë të pauniformuar kishin hyrë në hapësirat e Inclusive Foundation, organizatë joqeveritare e personave LGBT, ku përafërsisht tetë deri në dhjetë femra kishin përgatitur ekspozitë artistike. Policia kishte njoftuar se ka hyrë për bastisje, por nuk ka treguar kurrfarë urdhërese për bastisje, e as urdhëresë gjyqësore.

Ankueset, që të dyja të punësuar në OJQ, sikurse edhe kolegët e tyre, kishin thënë se kur nëpunësit policorë kanë kuptuar se janë në zyrat e organizatës së LGBT-së, ishin bërë agresivë. Njëri prej tyre gjoja se me dhunë e kishte marrë telefonin celular të ankueses së parë, ndërsa tjetri gjoja kishte thënë se do të donte që ta digjte hapësirën.

¹⁴⁶ *Id*, §121.

¹⁴⁷ Kumtesë për medie më 08.10.2020.

¹⁴⁵ *Id*, §119.

Nëpunësit policorë i kishin ofenduar femrat e pranishme, duke i quajtur “njerëz të sëmurë”, “pervers” dhe “pederastë”, dhe i kishin kërcënuar se do ta zbulonin orientimin e tyre seksual në publik dhe do t’i lëndonin anëtarët e familjeve të tyre. Policët më pas kishin bërë bastisje të pothuajse të gjitha femrave të pranishme, përfshirë edhe ankueset. Për këto bastisje nuk është përpiluar raport dhe femrat e prekura kanë konsideruar se kjo masë ka për qëllim që t’i nënçmojë, ndërsa nëpunësit policorë nuk kishin kryer bastisje të veshjeve për të cilën i kishin detyruar femrat që t’i heqin.

Ankesa penale për keqpërdorimin e fuqisë nga ana e policisë është parashtruar nga ankueset në janar të vitit 2010 për brutalitetin policor, ndërsa nga momenti i kërkesës ankimore në GJEDNJ, ende nuk ka përfunduar. Kërkesat që ishin parashtruar nga ankueset, të cilat kishin kërkuar statusin e viktimave ose kishin dashur që organet hetuese t’i shqyrtojnë dimensionet e supozuara diskriminuese të sjelljes së policisë gjatë këtij intervenimi, kishin mbetur pa përgjigje.

Vlerësimi dhe konkluzionet e gjykatës

Mospërshtatja e supozuar e hetimit

Gjykata ka përsëritur se sipas nenit 3, shteti duhet të zbatojë ndonjë formë të hetimit efektiv zyrtar për rastet e vuajtjeve individuale që paraqesin shkelje të nenit 3, të ndërmarrë nga ana e policisë ose organeve të tjera të ngjashme. Më tej, organet kompetente kanë për detyrë që t’i ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm për zbulimin e motiveve të mundshme diskriminuese që mund të kenë rol në këto ngjarje. Në këtë rast, edhe krahas faktit që ankueset në mënyrë decide kishin kërkuar nga organet kompetente që t’i marrin parasysh aspektet diskriminuese të sjelljes policore, organet kompetente nuk kanë ndërmarrë asnjë vepër hetuese dhe deri në datën e shqyrtimit të rastit nga Gjykata, hetimi nuk ka treguar kurrfarë konstatimesh bindëse. Gjykata ka vlerësuar se “prolongimi i tillë i ndaluar vetvetiu është jokompatibil me obligimin e shtetit që të zbatojë hetim efektiv në pajtim me nenin 3 të Konventës”. Është edhe më i rëndësishëm fakti që Gjykata ka konsideruar se zvarritja e këtillë e hetimit e ka zbuluar paaftësinë dhe mospërgatitjen e organeve kompetente për të hetuar rolin e motiveve homofobike dhe/

ose transfobike në keqpërdorimin e supozuar policor. Gjykata më tutje ka vërejtur indikatorë të qartë të anshmërisë ndaj veprave penale të urrejtjes, siç janë gjuha e urrejtjes nga policët gjatë incidentit, që së bashku me qëndrimin e mirë-dokumentuar armiqësor kundër komunitetit LGBT në Gjeorgji, është dashur të nxisë hetim të konsiderueshëm për mundësinë se diskriminimi ka qenë faktor motivues për sjelljen e policëve. Kështu, Gjykata ka konstatuar se hetimi ka qenë joefektiv dhe, sipas kësaj, ka pasur shkelje të nenit 3 në pajtim me aspektin e tij procedural, të shqyrtuar së bashku me nenin 14.

Keqtrajtimi i supozuar

Gjykata ka vlerësuar se versioni i fakteve të theksuara nga ankueset, që organet kompetente nuk i kanë kontestuar dhe për të cilat janë konfirmuar deklaratat precize dhe të argumentuara të dëshmitarëve okularë, është konfirmuar pa kurrfarë dyshimi. Gjykata ka konkluduar se sjellja e policisë, e motivuar nga urrejtja homofobike dhe/ose transfobike, ka qenë seriozisht joadekuate. Policia jo vetëm që qëllimisht i kishte nënçmuar ankueset përmes gjuhës së urrejtjes, por edhe u ishte kërcënuar: kërcënimi për zbatimin e forcës fizike dhe kërcënimi se kjo realisht do të realizohet. Më tutje, bastisjet duke i zhveshur, për të cilat as policia e as organet kompetente nuk kanë prezantuar ndonjë arsyetim, duket se janë tejet shqetësuese dhe e kanë detyruar Gjykatën që të konkludojë se qëllimi i tyre i vetëm ka qenë nënçmimi i ankuesve duke i dënuar për lidhjen e tyre me komunitetin LGBT. Sjellja e nëpunësve policorë, detyrimisht ka shkaktuar ndjenjëne frikës, vuajtjes dhe pasigurisë tek ankueset, që nuk ka qenë në përputhje me respektimin e dinjitetin e tyre njerëzor. Si pasojë e kësaj, Gjykata gjithashtu ka konstatuar shkelje të aspektit esencial të nenit 3 të shqyrtuar së bashku me nenin 14.

Komentet

Me këtë vendim, Gjykata sërish e ka konfirmuar detyrën e shtetit për të zbatuar hetim të shpejtë dhe efektiv, përfshirë edhe detyrën për të hetuar rolin e motiveve homofobike dhe/ose transfobike nga keqpërdorimi i supozuar policor. Sikurse edhe në rastet e tjera të krimeve të motivuara nga anshmëria, Gjykata konkret-

isht e ka përmendur detyrën e autoriteteve që t'i hetojnë indikatorët e anshmërisë, që në këtë rast kishin qenë ofendime homofobike dhe gjuhë e urrejtjes. Së këndejmi, Gjykata i ka kushtuar vëmendje edhe qëndrimin armiqësor që është dokumentuar mirë kundër komunitetit LGBT në Gjeorgji, që sipas mendimit të Gjykatës ka sugjeruar në nevojën urgjente për të zbatuar hetim të konsiderueshëm të mundësisë se diskriminimi ka qenë faktor motivues për sjelljen e nëpunësve policorë.

Sabaliq kundër Kroacisë (Kërkesa ankimore nr. 50231/13) më 14 janar 2021

Shënim për procedurën

Ankuesja është shtetase kroate, zonjusha Sabaliq, e cila ishte ankuar për mungesë të përgjigjes adekuate të dhunës homofobike nga ana e personit privat ndaj saj, veçanërisht inicimin vetëm të procedurës për kundërvajtje të vogël, mos'humlumtim dhe mosmarrje parasysh të motiveve të urrejtjes gjatë konstatimit të dënimit, ndërsa si pasojë e mos-ndëshkimit të agresorit të saj. Ankuesja është thirrur në nenin 3, nenin 8 dhe nenin 14.

Rezyme e fakteve¹⁴⁸

Më 13 janar 2010, zonjusha Sabaliq ishte sulmuar në klub nate në Zagreb nga burri, kur ajo e kishte refuzuar afrimin e tij, duke shtuar se ishte lezbike. Ai ashpër e kishte rrahur dhe shkelmuar, duke bërë titur "Të gjithë ju duhet të vriteni!" dhe "Do të të q..., lezbike!". Ajo kishte marrë disa lëndime në gjithë trupin, për çka ishte mjekuar në spital.

Agresori ishte dënuar në procedurë për kundërvajtje të vogël të prishjes së rendit dhe qetësisë publike duke marrë dënim prej 300 krunave kroate (rreth 40 euro (EUR)). Zonjusha Sabaliq e cila nuk ishte informuar për këto procedura, kishte parashtruar kallëzim penal kundër kryerësit pranë prokurorisë shtetërore, ku kishte theksuar se ka qenë viktimë e veprës së dhunshme penale të urrejtjes dhe diskriminimit.

Prokuroria shtetërore kishte iniciuar hetim penal, por në fund e kishte hedhur poshtë kallëzimin pe-

nal në korrik të vitit 2011, meqë kryerësi tanimë kishte qenë i përndjekur në procedurë për kundërvajtje të vogël dhe për këtë përndjekje e tij penale do të ishte rrezik i dyfishtë. Gjykatat vendase e kishin konfirmuar këtë vendim.

Vlerësimi dhe konkluzionet e Gjykatës

Lejueshmëria

Duke e vlerësuar zbatueshmërinë e nenit 3 në këtë rast, Gjykata i ka përsëritur principet e përgjithshme që dalin nga praktika e saj gjyqësore, veçanërisht duke e theksuar rolin e motivit diskriminues në atë vlerësim. Konkretisht, vlerësimi i nivelit minimal të seriozitetit të keqtrajtimit që nevojitet sipas nenit 3 varet nga të gjitha rrethanat e rastit, siç është kohëzgjatja e veprimit, ndikimet e tij fizike dhe psikike dhe në raste të caktuara, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës. "Veprimi diskriminues si i tillë në parim mund të nënkuptojë veprim nënçmues në kuptim të nenit 3, kur arrihet niveli i seriozitetit që paraqet shkelje për dinjitetin njerëzor. [...] **Vërejtjet diskriminuese dhe ofendimet raciste sidoqoftë patjetër duhet të merren parasysh si faktor vështirësues** kur shqyrtohet rastii i caktuar keqtrajtimit lidhur me nenin 3"¹⁴⁹ Në këtë rast, ankuesja ishte sulmuar dhunshëm (shtyrë drejt murit, më pas e goditur në tërë trupin, duke vazhduar edhe pasi kishte rënë në tokë), që kishte shkaktuar shumë lëndime fizike, përfshirë edhe kontuzion në kokë, hematome në ballë, gërvishtje në fytyrë, ballë dhe rreth buzëve, rrudha në qafë, kontuzion në gjoks dhe gërvishtje të duarve dhe gjunjve.

Më tutje, sulmi kishte qenë nën ndikimin e orientimit seksual të ankueses, meqë kishte filluar pasi ankuesja e kishte zbuluar orientimin e saj seksual të sulmuesit. Kështu, Gjykata kishte konkuduar se veprimi në të cilin ishte ekspozuar ankuesja që ishte orientuar drejt identitetit të saj dhe e kishte nënçmuar integritetin dhe dinjitetin e saj, të shkaktuar në ndjenjën e frikës, dhimbjes dhe pasigurisë, bie nën nenin 3.

Baza e veprimit

Duke marrë parasysh lëndimet e shkaktuara ndaj ankueses dhe motivimi i urrejtjes pas kësaj

148 Kumtesë për media më 14.01.2021.

149 Sabaliq kundër Kroacisë, §65.

dhune, Gjykata ka vendosur që ta shqyrtojë ankesën sipas nenit 3, të shqyrtuar lidhur me nenin 14, e jo sipas neneve të tjera në të cilët thirret ankuesja.

Sikurse edhe në raste të ngjashme nga e kaluara, Gjykata e ka përsëritur obligimin procedural të shtetit për të zbatuar hetim dhe për t'i ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për zbulimin e motiveve të mundshme diskriminuese "kur do të ballafaqohet me rastet e incidenteve të dhunshme të shkaktuara nga qëndrimet e dyshimta diskriminuese, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me **orientimin e vërtetë seksual të viktimës ose karakteristikat e tjera të mbrojtura**"¹⁵⁰

Këto kërkesa procedurale nënkuptojnë detyrën për të filluar dhe zbatuar hetim që mund të sjellë në konstatimin e fakteve dhe t'i identifikojë dhe - nëse mundet - t'i dënojë personat përgjegjës.¹⁵¹ Më saktë, në rast të krimit eventual të urrejtjes, për respektimin e obligimeve pozitive të shtetit, sistemi vendas juridik duhet të dëshmojë kapacitet për zbatimin e së drejtës penale kundër kryerësve të atyre veprave të dhunshme.¹⁵² Tjetër me rëndësi është se kur hetimi zyrtar do të sjellë në fillimin e procedurave në gjykatat nacionale, gjykatat nacionale në asnjë rast nuk duhet të përgatiten që të lejojnë që sulmet e rënda ndaj integritetit fizik dhe psikik të mbeten të pandëshkuara, ose kundërvajtjet serioze të dënohen me dënime tepër të lehta.¹⁵³ Në këtë kuptim, **roli i gjykatave nacionale** është "që të binden se obligimi i shtetit për t'i mbrojtur të drejtat e atyre që janë nën kompetencë të saj gjyqësore, është bërë në mënyrë adekuate, që nënkupton se patjetër duhet të ruaj funksionin e vetë mbikëqyrës dhe të intervenojë në rastet e joproporcionalitetit të dukshëm ndërmjet peshës së veprës dhe dënimit të shqiptuar".¹⁵⁴

Duke i zbatuar këto parime gjatë këtij rasti, Gjykata ka konstatuar se akoma në fazat fillestare të procedurës, autoritetet ishin orientuar me indicie të qarta për dhunën

të motivuar ose të paktën nën ndikimin e orientimit seksual të ankueses, për çka policia ishte dashur që të parashtrijë kallëzim penal para prokurorisë shtetërore, organ kompetent për zbatimin e hetimeve të mëtutjeshme për indikatorët për krimin e urrejtjes. Organet kompetente nuk e kishin bërë atë. Gjykata ka vërejtur se procedura për kundërvajtje të vogël, që ishte iniciuar në vend të saj, në çfarëdo mënyrë nuk e kishte përfshirë elementin e krimit të urrejtjes për sulmin fizik kundër ankuesit dhe dënimi ishte dukshëm joproporcional me peshën e keqtrajtimit që e kishte përjetuar ankuesja. Organet kompetente ishin arsyetuar se përndjekja penale nuk mund të vazhdohet në bazë të rrezikut të dyfishtë.

Kështu, Gjykata ka përsëritur se parimi i sigurisë juridike në çështjet penale nuk është absolut dhe autoritetet mund përsëri të hapin rast të dëmit të të akuzuarit kur, mes tjerash, ishte zbuluar "defekti fundamental" në procedurë (neni 4 § 2 të Protokollit nr.7).

Në këtë rast, Gjykata ka konstatuar se edhe moshulmtimi i motiveve të urrejtjes pas sulmit të dhunshëm ose mosmarrja parasysh e këtyre motiveve gjatë përcaktimit të dënimit për agresorin, kanë paraqitur "mangësi themelore" të procedurës në kuptim të nenit 4 paragrafi 2 të Protokollit nr.7. Gjykata ka vërejtur se autoritetet vendase mund ta përmirësojnë situatën, për shembull, me ndërprerjen ose anulimin e setit të paarsyeshëm të procedurave për kundërvajtje të vogla, anulimin e efekteve të tyre, e më pas shqyrtimin e sërishëm të rastit.

Në bazë të së lartpërmendurës, Gjykata ka konstatuar se organet kompetente në mënyrë përkatëse dhe efektive nuk e kanë kryer obligimin e tyre procedural në pajtim me Konventën, që është në kundërshtim me detyrën e tyre për të luftuar kundër mosdënimit të veprave penale të urrejtjes; prandaj, ekziston shkelje e nenit 3 të aspektit të tij procedural lidhur me nenin 14.

Komentet

Në këtë rast, Gjykata e ka përsëritur detyrën specifike të shtetit për luftën kundër krimit të urrejtjes, që mes aspekteve të tjera, nënkupton se sistemi i drejtësisë penale duhet të mund që në mënyrë përkatëse t'i hulumtojë dhe

150 *Id.*, §93.

151 *Id.*, §96.

152 *Id.*, §95.

153 *Id.*, §97.

154 *Id.*, §109.

sanksionojë veprat penale të urrejtjes. Gjykata ka potencuar se natyra e veprave penale të urrejtjes është veçanërisht destruktive për të drejtat themelore të njeriut dhe për këtë organet kompetente kanë për detyrë që të zbatojnë hetim zyrtar me energji dhe paanshmëri që në mënyrë të vazhdueshme ta konfirmojnë gjykimin e shoqërisë për veprat penale të urrejtjes dhe ta ruajnë besimin e grupeve minoritare në aftësinë e organeve kompetente për t'i mbrojtur nga dhuna me motive diskriminuese. Pa qasje të rreptë nga ana e autoriteteve, veprat penale të urrejtjes, “në mënyrë të pashmangshme do të trajtoheshin në mënyrë të barabartë sikur edhe rastet e rëndomta pa konotacion të tillë, ndërsa indiferenca do të jetë e njëjtë me pajtimin zyrtar, madje edhe harmonizim me veprat penale të urrejtjes”.¹⁵⁵Përgjigjja që autoritetet e kanë marrë këtë rast, nga perspektiva e Gjykatës, mund të konsiderohet përgjigje që nxitë ndjenjëne mosdënimit për veprat e krimit të dhunshëm të urrejtjes, se sa për mekanizëm procedural që tregon se veprat e këtilla nuk tolerohen.

Më tutje, në këtë rast, Gjykata e ka theksuar rolin specifik të gjykatave nacionale për të siguruar se sulmet e rënda ndaj integritetit fizik dhe psikik nuk do të mbeten të padënuara, ose nuk do të dënohen me dënime tepër të lehta. Në këtë drejtim, roli i gjykatave nacionale është që të sigurojnë që organet kompetente në mënyrë përkatëse ta përmbushin obligimin e tyre për t'i mbrojtur të drejtat e tyre që janë nën kompetencën e tyre, që nënkupton se gjykatat nacionale duhet të intervenojnë në rastet e joproportionalitetit të dukshëm ndërmjet peshës së veprës dhe dënimit të shqiptuar.

155 *Id.*, §95.

V.

Interseksionaliteti

B. S. kundër Spanjës (Kërkesa ankimore nr. 47159/08) më 24 korrik 2012

Shënim për procedurën

Ankuesja ishte grua me prejardhje nigeriane, B.C., e cila jetonte legalisht në Spanjë që nga viti 2003. Ajo u ankua se policët e policisë nacionale verbalisht dhe fizikisht e kishin keqtrajtuar kur e kishin ndalur për ta marrë në pyetje, si dhe për hetimin joadekuat të gjykatave vendase për ngjarjet. Ajo ishte thirrur në nënet 3 dhe 14 të Konventës.

Rezume e fakteve¹⁵⁶

Më 15 korrik të vitit 2005, ankuesja kishte qenë në rrugë në rajonin El Arenal në afërsi të Pallma de Majorka, ku kishte punuar si prostitute. Dy policët kishin kërkuar që të identifikohet dhe të largohet, gjë që ajo e kishte bërë menjëherë.

Menjëherë pas kësaj, në të njëjtin lokacion, i ishin afruar po të njëjtët policë dhe pasi ajo kishte tentuar të ikë, e kishin kapur, e kishin goditur me shkop gome në kofshën e majtë dhe nyjet duke i kërkuar përsëri dokumentet e saj personale; një prej policëve e kishte keqtrajtuar në aspekt racor. Më 21 korrik të vitit 2005, të njëjtët policë përsëri e kishin ndalur dhe e kishin marrë në pyetje, ndërsa njëri prej tyre e kishte goditur me shkop gome në dorën e majtë.

Ankuesja kishte parashtruar ankesë. Me kërkesë të gjykatësit hetues, policia kishte përpiluar raport për incidentin, ku mes tjerash, kishin mohuar se nëpunësit policorë kanë përdorur shprehje nënçmuese ose forcë fizike. Në vendimin më 17 tetor të vitit 2005, gjykatësi hetues kishte urdhëruar që përkohësisht të hedhet poshtë kjo dhe e kishte ndërprerë procedurën me arsyetimin se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për vepër penale. Ankuesja kishte parashtruar ankesë për rishqyrtimin e këtij vendimi, duke u ankuar se nëpunësit policorë kanë

shprehur qëndrim diskriminues, i cili ishte refuzuar me të njëjtën bazë. Trupi i Apelit e kishte hedhur poshtë vendimin dhe kishte urdhëruar inicimin e procedurës për kundërvajtje të vogël kundër dy policëve. Më 11 mars të vitit 2008, gjatë seancës publike ku të akuzuarit nuk ishin identifikuar zyrtarisht nga ankuesja, gjykatësi hetues i kishte liruar nëpunësit policorë.

Në një situatë tjetër, ankuesja përsëri ishte ndaluar për t'u marrë në pyetje më 23 korrik të vitit 2005. Ajo kishte parashtruar kallëzim penal dy ditë më vonë, ku ishte theksuar se ishte rrahur në dorë dhe gjunj me shkop gome dhe se kishte qenë cak për shkak të racës së saj. Kishte deklaruar se ishte dërguar me dhunë në stacionin policor me qëllim që të nënshkruaj deklarata me të cilën pranon se i ka kundërshtuar autoritetet. Më 22 shkurt 2006, gjykatësi hetues kishte miratuar urdhëresë të përkohshme për refuzim dhe e kishte ndërprerë procedurën me arsyetimin se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për vepër penale. B.C kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtimin e këtij vendimi. Kjo dhe ankesa e saj e radhës kishin qenë të pasuksesshme.

Vlerësimi dhe konkluzionet e gjykatës

Efektiviteti i hetimeve të realizuara nga organet kompetente nacionale

Gjykata ka vërejtur se edhe pse ankesat e ankueses me të vërtetë ishin shqyrtuar, gjykatësit hetues nuk kishin bërë asgjë më shumë përveç se kanë kërkuar raportet e shtabit policor dhe ishin bazuar vetëm në ato raporte gjatë ndërprerjes së procedurës.

Më tutje, raportet ishin përpiluar nga kryeshefi i policisë së Ishujve të Balearit, i cili kishte qenë personi zyrtar epror i policëve të akuzuar. Më tutje, Gjykata kishte vërejtur se në seancën publike më 11 mars 2008, të akuzuarit nuk ishin identifikuar zyrtarisht nga ankuesja, seanca mund të konsiderohet përmbushje e kërkesave nga neni 3 (meqë nuk ka dhënë mundësinë për identifikimin e nëpunësve të involvuar policorë). As gjykatësit hetues dhe as gjykata e provincës Audiencia Provincial nuk i kishin shqyrtuar raportet mjekësore për lëndimet e ankueses, por thjeshtë i kishin injoruar me arsyetimin

156 Kumtesë për media më 24.07.2012.

se nuk kanë datë ose nuk janë përfundimtare për arsye lëndimeve. Në fund, gjykatësit hetues nuk kishin ndërmarrë kurrfarë masash për t'i identifikuar dhe marrë në pyetje dëshmitë e dëshmitarëve, e as që i kanë shqyrtuar konstatimet e ankueses lidhur me transferimin e saj në stacionin policor. Kjo e kishte detyruar Gjykatën që të konkludojë se hapat e ndërmarrë hetues nuk kanë qenë mjaft të bazuar dhe efektiv për t'i përmbushur kërkesat nga neni 3, dhe kishte konstatuar shkelje të nenit 3 në aspekt të efektivitetit të hetimit.

Hetimi për ekzistimin e lidhjes së mundshme në mes të qëndrimeve raciste dhe aksioneve policore

Gjykata ka vërejtur se në ankesat e saj më 21 dhe 25 korrik të vitit 2005, ankuesja i kishte përmendur vërejtjet raciste, gjoja, të shprehura ndaj saj nga ana e policisë, siç janë “dil nga këtu, lavire e zezë” dhe kishte theksuar se policët nuk kishin ndalur dhe nuk kishin pyetur edhe femrat e tjera që kryejnë të njëjtin aktivitet, por që kanë “fenotip evropian”.

Këto parashtresa nuk ishin shqyrtuar nga gjykatat që e zgjidhin rastin, të cilat vetëm se e kishin miratuar përmbajtjen e raporteve të policisë pa realizuar hetim të detajuar për qëndrimet e supozuara raciste. Gjykata kishte vlerësuar se vendimet e miratuara nga gjykatat vendase “nuk e kanë marrë parasysh cenimin e posaçëm të ankueses që është karakteristike për pozitën e saj si femër afrikane që punon si prostitute”.¹⁵⁷

Për këtë arsye, Gjykata ka konstatuar se organet kompetente nuk e kanë përmbushur detyrën e tyre në pajtim me nenin 14 të shqyrtuar lidhur me nenin 3 për t'i ndërmarrë të gjithë hapat e mundshëm me qëllim që të konstatohet nëse qëndrimi diskriminues ndoshta ka rol në këto ngjarje. Sipas kësaj, ekziston shkelje e nenit 14 të shqyrtuar lidhur me nenin 3 në aspektin e tij procedural.

Komentet

Me këtë rast, Gjykata për herë të parë ka bërë interpretim interseksional të diskriminimit në praktikën e vet gjyqësore. Arsyetimi i Gjykatës në mënyrë të prerë nuk ka të bëjë me nocionin “interseksionalitet”, por në këtë rast është nevojitur **qasje e qartë interseksionale**. Duke u thirrur në lëshimet e autoriteteve për të marrë parasysh **“cenimin e posaçëm të ankueses që është karakteristike për pozitën e saj si grua afrikane që punon si prostitute”**, Gjykata në mënyrë të

prerë e ka njohur cenimin specifik të ankueses që është formuar nga ndërlidhja e racës dhe gjinisë së ankueses, së bashku me statusin e saj profesional. Me fjalë të tjera, këto nuk janë karakteristikat individuale personale, siç janë gjinia dhe raca, por kryqëzimi i tyre që e bënë ankuesen veçanërisht të cenueshme, për këtë patjetër duhet të shqyrtohen në tërësi, e jo si të ndara. Pozita e saj si “afrikane e cila punon si prostitute” e bënë të cenueshme ndaj veprimeve diskriminuese në mënyrë të ndryshme se sa që mund t'u ndodh femrave me prejardhje tjetër ose burrave me prejardhje afrikane.¹⁵⁸ Për këtë arsye, Gjykata kishte potencuar se organet kompetente spanjolle është dashur që ta marrin parasysh këtë cenueshmëri specifike kur i kanë hetuar motivet e mundshme diskriminuese pas incidentit.

Edhe pse ka pasur qasje interseksionale, Gjykata, përsëri e ka përdorur nocionin “cenueshmëri e posaçme” në vend të “diskriminimit interseksional”. Në praktikën e vet gjyqësore, Gjykata fillimisht kishte shfrytëzuar konceptin e cenueshmërisë në raport me romët dhe më pas e kishte zgjeruar fushëveprimin e vet të personave me aftësi të kufizuara, kërkuesve të azilit dhe personave me HIV. Koncepti i cenueshmërisë i mundëson Gjykatës që ta përfshijë pabarazinë në mënyrë më esenciale me atë që do të pranojë se grupet e marginalizuara dhe të privuara historikisht janë të ekspozuar ndaj keqtrajtimit për shkak të paragjyqimeve sociale dhe diskriminimit institucional. Mirëpo, praktika gjyqësore e Gjykatës shfrytëzon cenueshmërinë si shenjë fikse dhe të segmentuar. Me miratimin e interseksionalitetit si kriter për interpretim në këtë rast, Gjykata ka shmangur që në mënyrë esenciale ta analizojë cenueshmërinë e ankueses; me fjalë të tjera, cenueshmëria nuk duhet të konsiderohet gjendje e përhershme dhe kategorike, por shtresore dhe dinamike. Miratimi i interseksionalitetit si kriter interpretues jo vetëm që mundëson shqyrtimin e strukturave shoqërore dhe raporteve të fuqisë që e formojnë përvojën e njerëzve të marginalizuar, por edhe shqyrtimin e asaj se si përvojat individuale dallohen sipas kombinimeve të shumta të privilegjit, fuqisë dhe cenueshmërisë.¹⁵⁹

158 <https://strasbourgobservers.com/2012/10/17/racial-discrimination-in-strasbourg-part-ii-intersectionality-and-context/>

159 Ndaj implementimit të interseksionalitetit në praktikën evropiane juridike në shumë nivele: B. S. kundër Spanjës, nga Maria Katerina Lla Barbera, (Maria Caterina La Barbera), Marta Cruells Llopez (Marta Cruells López), për të parënhere është botuar më: 30 tetor 2019, <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/full/10.1111/lasr.12435>.

157 B. S. kundër Spanjës, §62.

VI.

Veprat penale të urrejtjes me bazë gjinore

Veprat penale të urrejtjes me bazë gjinore janë veprat penale të motivuara nga anshmëria ndaj gjinisë së një personi. Për veprat penale të urrejtjes me bazë gjinore, një prej faktorëve motivues është perceptimi i kryerësit për normat gjinore. Veprat penale të urrejtjes me bazë gjinore janë pasojë e pabarazisë gjinore që në mënyrë jo të drejtë i targetojnë femrat, si dhe të gjithë për të cilët konsiderohet se nuk u përmbahen normave dominuese gjinore. Viktimat mund të përzgjidhen ekskluzivisht për shkak të gjinisë së tyre, ose në bazë të disa karakteristikave të identitetit, siç janë gjinia e tyre, përkatësia etnike ose feja. Veprat penale të urrejtjes me bazë gjinore, gjithashtu mund të orientohen ndaj personave ose pronës për shkak të lidhjes së tyre, lidhshmërisë profesionale ose aktivizimit për çështjet gjinore, siç janë grupet e të drejtave të femrave dhe organizatat civile që punojnë me viktimat e dhunës. Veprat penale të urrejtjes me bazë gjinore shpeshherë kanë për qëllim që të ndjellin frikë dhe t'i shtypin mënyrat e jetesës ose shprehjes së identitetit për të cilin konsiderohet se nuk është në pajtim me normat tradicionale gjinore. Ato kanë ndikim të konsiderueshëm, afatgjatë ndaj viktimave dhe e shtypin sigurinë dhe kohezionin social duke mbrojtur pabarazinë gjinore.¹⁶⁰

Në bazë të përkufizimit të lartpërmendur për krimin e urrejtjes me bazë gjinore, të miratuar nga OSBE/ODIHR, është e rëndësishme që të bëhet dallimi ndërmjet **dhunës me bazë gjinore** dhe **krimin të urrejtjes me bazë gjinore**. Dhuna me bazë gjinore (ose dhuna seksuale dhe dhuna me bazë gjinore) ka të bëjë me çdo akt që është kryer kundër vullnetit të një personi dhe bazohet në normat gjinore dhe raporte e pabarabarta të fuqisë. Përfshin dhunën fizike, emocionale ose psikologjike dhe dhunën seksuale, dhe refuzimin e resurseve ose qasjen në shërbime. Dhuna përfshin

kërcënime për dhunën ose detyrim.¹⁶¹ Rastet e dhunës me bazë gjinore mund të paraqesin krim të urrejtjes me bazë gjinore, por jo automatikisht edhe jo gjithmonë; klasifikimi i këtyre, së këndejmi edhe përgjigjja, varen nga vlerësimi individual i secilit rast. Që dhuna me bazë gjinore të konsiderohet dhe të trajtohet si krim i urrejtjes, kryerësi duhet të ketë shfaqur anshmëri gjinore para, gjatë ose menjëherë pas incidentit. Indikatorët për anshmërinë gjinore mund të merren si përgjigje e këtyre pyetjeve të përpiluara nga OSBE/ODIHR:

- Nëse viktimat dhe dëshmitarët e kanë përjetuar incidentin si të motivuar nga anshmëria në bazë të gjinisë së viktimës?
- Nëse ka pasur komente, deklaratat me shkrim, gjeste ose grafitë që sugjerojnë në anshmëri? Kjo mund të përfshijë përdorimin e ofendimeve me bazë gjinore, stereotipave dhe paragjykimeve, siç janë ato që kanë lidhje me rolet e femrave në sferën publike ose private.
- Nëse prona e targetuar ka qenë vend me rëndësi profesionale, juridike, kulturore ose shëndetësore, siç është organizata e të drejtave të grave, shoqata e personave LGBTI, klinika për planifikimin e familjes dhe/ose vendet e tjera që mund t'i vizitojnë personat me gjini specifike?
- Nëse prona paraprakisht ka qenë cak i incidenteve me bazë gjinore ose krimin të urrejtjes? Në rast të sulmit kundër pronës, nëse në vendngjarje është lënë ndonjë send ose simbol që mund të kuptohet si ofendim ose kërcënim në bazë të gjinisë?
- Çfarë natyre ka pasur dhuna? Nëse caku kanë qenë simbolet që paraqesin gjini konkrete?

160 Krimi i urrejtjes me bazë gjinore, lista informative, OSBE/ODIHR, mars 2021, <https://www.osce.org/odihr/480847>

161 Parandalimi dhe përgjigjja e dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore, Doracaku për rastet urgjente, UNHCR, <https://emergency.unhcr.org/entry/51693/sexual-and-gender-based-violence-sgbv-prevention-and-response>

- Nëse i dyshuar i përket grupit të urrejtjes që ka për qëllim njerëz në bazë të gjinisë së tyre? Kjo mund të përfshijë lëvizjet që karakterizohen me pikëpamje mizogjiniste (siç janë “incelet”), aktivistët e dhunshëm për të drejtat e burrave dhe grupet që angazhohen për mostolerimin ndaj njerëzve në bazë të gjinisë së tyre. Nëse prejardhja ose dosja kriminale e të dyshuarit tregon se personi ka kryer incidente të ngjashme në të kaluarën?
- Nëse viktimja ka qenë aktiviste e të drejtave të grave, feministe ose aktiviste e LGBTI-së, ose mbrojtëse e të drejtave të njeriut që merret me mbrojtjen dhe sigurinë e grupeve të caktuara në bazë të gjinisë?
- Nëse incidenti ka ndodhur në datë të rëndësishme për kryerësin ose për komunitetet e goditura (p.sh, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Grave ose gjatë fushatës 16-ditore për aktivizimin kundër dhunës me bazë gjinore)?
- Nëse ekziston motiv tjetër i qartë? Mungesa e motiveve të tjera është gjithashtu arsye për ta shqyrtuar motivimin e anshmërisë.¹⁶²

Në praktikën e vet gjyqësore, Gjykata ka shqyrtuar një numër të madh të rasteve të dhunës kundër grave. Krimi i urrejtjes i ashtuquajtur “klasik” me bazë gjinore është rasti *B.C kundër Spanjës*,¹⁶³ ku një grua me prejardhje nigeriane ishte keqtrajtuar dhe ofenduar nga nëpunësit patrullues policorë në afërsi të vendit ku kishte punuar si prostitute në dy raste. Ajo kishte deklaruar se kishte përjetuar keqtrajtim dhe ishte diskriminuar për shkak të ngjyrës së lëkurës dhe gjinisë, ndërsa policia nuk u ishte qasur femrave me “fenotip evropian” të cilat e kryenin të njëjtin aktivitet në këtë rajon. Nëpunësit policorë kishin përdorur vërejtje racore, respektivisht “dil që këtu, lavire e zezë” (tregues për anshmërinë në aspekt të gjinisë dhe prejardhjes etnike), gjatë interaksionit me të. Në këtë rast, Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 3 sepse autoritetet nuk i kanë hetuar ankesat e saj kundër veprimeve policore dhe shkeljes së nenit 14 të shqyrtuar lidhur me nenin

3 sepse autoritetet “nuk e kishin marrë parasysh cenueshmërinë e posaçme të ankueses që ishte karakteristike për pozitën e saj si afrikane e cila punon si prostitute” dhe në këtë mënyrë nuk e kanë përmbytur detyrën e tyre për t’i ndërmarrë të gjithë hapat e mundshëm për të konstatuar nëse qëndrimi diskriminues mund të ketë pasur rol në këto ngjarje. Në këtë rast, gjinia kryqëzohet me karakteristikë tjetër personale të ankueses, respektivisht, prejardhjes së saj etnike, dhe Gjykata e kishte potencuar rëndësinë e organeve kompetente që ta shqyrtojnë në tërësi, e jo ndaras, me çka do të ndërmarrin qasje të ndërsjellë.

Në një seri tjetër të rasteve të shqyrtuara nga Gjykata, Gjykata i kishte analizuar rastet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave nga aspekti i detyrës së organeve kompetente për t’i parandaluar dhe mbrojtur gratë nga dhuna në familje dhe detyrës për të hulumtuar rastet e këtylla pa bërë diskriminim. Ky aspekt i fundit në veçanti ka të bëjë me mosaktivitetin e organeve për zbatimin e ligjit që të parandalojnë dhunën në familje dhe mosreagimin ose paadekuatshmërinë e përgjigjes së sistemit gjyqësor të sanksionimit. Organet kompetente kanë tendencë që ta nënvlerësojnë dhunën në familje me çka në esencë e miratojnë, ndërsa arsyet themelore për të janë që më herët të paramenduara si ide lidhur me rolin e grave në familje, zakonet ose traditat dhe idetë se kjo është punë familjare ku autoritetet nuk mund të përzihen. Gjykata ka vërejtur se autoritetet nuk e vlerësojnë në tërësi seriozitetin dhe shkallën e problemit me dhunën në familje dhe efektin e saj diskriminues ndaj grave. Gjykata e ka konsideruar dhunën me bazë gjinore si formë e diskriminimit ndaj grave.

Konkretisht, në rastin *Opuz kundër Turqisë* (2009),¹⁶⁴ ankuesja është shtetase turke e cila kishte deklaruar se autoritetet turke nuk e kanë mbrojtur të drejtën e jetës së nënës së saj, e cila ishte vrarë nga bashkëshorti z. Opuz dhe se ata kanë qenë të pandërgjegjshëm para dhunës së përsëritur, kërcënimeve me vdekje dhe lëndimeve të cilave ajo vetë ishte nënshtruar. Ajo më tutje ishte ankuar për mungesën e mbrojtjes së grave nga dhuna në familje sipas së drejtës vendase turke. Gjykata ka konstatuar se autoritetet turke nuk kishin arritur në obligimin e tyre pozitiv për të mbrojtur të drejtën e jetës së nënës së ankueses në kuptim të nenit 2, sepse nuk kanë

162 Krimi i urrejtjes me bazë gjinore, lista informative, OSBE/ODIHR, mars 2021, <https://www.osce.org/odihr/480847>

163 Rasti është analizuar në detaje në pjesën *Interseksionaliteti*.

164 *Opuz kundër Turqisë*, Kërkesë ankimore nr. 33401/02.

dhënë vëmendjen e duhur në masat e tyre për parandalimin e vrasjes dhe nuk kanë arritur që të zbatojnë hetim për vrasjen. Gjykata, gjithashtu, kishte konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 3 si rezultat i lëshimit të autoriteteve për të ndërmarrë masa mbrojtëse në formën e parandalimit efikas të shkeljeve serioze ndaj integritetit personal të ankueses nga ish-bashkëshorti i saj. Lidhur me mungesën e mbrojtjes së grave nga dhuna në familje, Gjykata kishte vërejtur se dhuna në familje ndikon kryesisht ndaj grave dhe se pasiviteti i përgjithshëm dhe diskriminues gjyqësor i Turqisë krijon rrethana të volitshme për dhunën në familje. Duke pasur parasysh këtë, dhunën që e kishte përjetuar ankuesja dhe nëna e saj mund të konsiderohet gjinore, që paraqet formë të diskriminimit ndaj grave. Mosreagimi i përgjithshëm i sistemit gjyqësor dhe mosdënimi që e gëzojnë agresorët, sikurse në rastin e ankueses, sugjeron në atë se nuk ka pasur përkushtim të mjaftueshëm për të ndërmarrë masa adekuate për zgjidhjen e dhunës në familje. Për këtë arsye, Gjykata kishte konkluduar se ka pasur shkelje të nenit 14, lidhur me nenet 2 dhe 3.¹⁶⁵

Në një rast tjetër, *Mudriç kundër Republikës së Moldavisë* (2013)¹⁶⁶, ankuesja, grua nga Moldavia e cila ishte divorcuar nga bashkëshorti për 22 vite, kishte theksuar se në shkurt të vitit 2010, ish-bashkëshorti i saj kishte vjedhur në shtëpinë e saj, e kishte rrahur dhe ishte shpërngulur përgjithmonë, e kishte keqtrajtuar deri në janar të vitit 2011 kur policia e kishte larguar atë. Ajo pohon se autoritetet e kishin toleruar keqpërdorimin që i ishte nënshtruar në shtëpinë e saj, duke u bazuar në sëmundjen psikike të ish-bashkëshortit të saj si arsye për moszbatimin e urdhëresave të ndryshme gjyqësore për mbrojtje kundër tij. Gjykata kishte konstatuar se mënyra në të cilën kishin vepruar autoritetet në këtë rast, veçanërisht prolongimet e gjata dhe të pasqaruara për zbatimin e urdhëresave gjyqësore për mbrojtje dhe nënshtrimin të ankueses A.M. për shërim të detyrueshëm mjekësor, paraqet mospërmbushje të obligimeve të tyre pozitive në pajtim me nenin 3. Ankuesja gjithashtu kishte theksuar se autoritetet nuk e kishin zbatuar legjislacionin vendas të dedikuar për mbrojtje nga dhuna në familje, si rezultat i ideve të paramenduara më parë lidhur me rolin e grave në familje. Sipas kësaj, Gjykata

kishte konstatuar se procedurat e organeve kompetente nuk kanë qenë lëshim i thjeshtë ose vonesë në ballafaqimin me dhunën ndaj ankueses, por kishin përbërë arsye të vazhdueshme të dhunës së atillë dhe kishin pasqyruar raport diskriminues ndaj saj si grua. Autoritetet nuk e kishin vlerësuar në tërësi seriozitetin dhe shkallën e problemit me dhunën në familje dhe ndikimin e tij diskriminues ndaj grave. Kështu, Gjykata gjithashtu kishte konstatuar shkelje të nenit 14 lidhur me nenin 3.

Në rastin *Talpis kundër Italisë* (2017),¹⁶⁷ lidhur me dhunën në familje së cilës i ishte nënshtruar nëna e dy fëmijëve dhe cila kishte rezultuar me vrasjen e djalit të saj dhe tentim për vrasjen e saj, ankuesja, mes tjerash, ishte ankuar për mospërmbushjen e detyrës së tyre nga organet kompetente italiane për ta mbrojtur nga veprat e dhunës në familje që ishin kryer ndaj saj. Konkretisht, gjykata kishte konstatuar se me lëshimin për të ndërmarrë veprime të shpejta sipas ankesës së parashtruar nga ankuesja, autoritetet e kishin privuar atë ankesë nga çfarëdo efekti, duke krijuar situatë të mosdënimit të volitshme për përsëritjen e veprave të dhunës, që atëherë kishte çuar në tentimin për vrasjen e ankueses dhe vdekjen e djalit të saj.

Për këtë arsye, organet kompetente nuk kishin arritur në obligimin e tyre për t'i mbrojtur jetët e personave të cenuar. Gjykata, gjithashtu kishte konstatuar se ankuesja kishte jetuar me fëmijët e saj në kushte të dhunës që kishte qenë mjaft serioze për t'u kualifikuar si keqtrajtim, dhe se mënyra në të cilën autoritetet i kanë mbajtur procedurat penale sugjeron në pasivitetin gjyqësor, që është e papërputhshme me nenin 3. Në fund, gjykata kishte konstatuar se ankuesja kishte qenë viktimë e diskriminimit si grua për shkak të mosaktivitetit të organeve kompetente, që e kishin nënvlerësuar dhunën për të cilën bëhet fjalë dhe me këtë në esencë e kanë miratuar; në kundërshtim me nenin 14 të ndërmarrë lidhur me nenet 2 dhe 3.¹⁶⁸

165 *Id.*, §184 - 202.

166 *Mudriç kundër Republikës së Moldavisë, Kërkesë ankimore nr. 74839/10.*

167 *Talpis kundër Italisë, Kërkesë ankimore nr. 41237/14.*

168 Kumtesë për media më 02.03.2017.

Lista e rasteve të gjuhës së urrejtjes

Garodi kundër Francës, Kërkesë ankimore nr. 65831/01, (vendim për lejueshmëri) nga 24 qershori i vitit 2003

Marlla M'Ballà kundër Francës, Kërkesa ankimore nr. 25239/13 më 20 tetor 2015 (vendim për lejueshmëri)

Villiamson kundër Gjermanisë, Kërkesa ankimore nr. 64496/17 më 8 janar 2019 (vendim për lejueshmëri)

Pastors kundër Gjermanisë, Kërkesa ankimore nr. 55225/14 më 3 tetor 2019 (vendim për lejueshmëri)

Pavell Ivanov kundër Ruisë, Kërkesa ankimore nr. 35222/04 më 20 shkurt 2007 (vendim për lejueshmëri)

Ballsit-Lideikiene kundër Lituaniës, Kërkesa ankimore nr. 72596/01 më 4 nëntor 2008

Hosll-Daum dhe të tjerët kundër Polonisë, Kërkesa ankimore nr. 10613/07 më 7 tetor 2014 (vendim për lejueshmëri)

Atamançuk kundër Ruisë, Kërkesa ankimore nr. 4493/11 më 11 shkurt 2020

Norvud kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa ankimore nr. 23131/03 më 16 nëntor 2004 (vendim për lejueshmëri)

I.A. kundër Turqisë, Kërkesa ankimore nr. 42571/98 më 13 shtator 2005

Erbakan kundër Turqisë, Kërkesa ankimore nr. 59405/00 më 6 korrik 2006

Bellkasem kundër Belgjikës, Kërkesa ankimore nr. 34367/14 më 27 qershor 2017 (vendim për lejueshmëri)

E.S. kundër Austrisë, Kërkesa ankimore nr. 38450/12 më 25 tetor 2018

Tagijev dhe Husejnov kundër Azerbajxhanit, Kërkesa ankimore nr. 13274/08 më 5 dhjetor 2019

Gunduz kundër Turqisë, Kërkesa ankimore nr. 35071/97 më 4 dhjetor 2003

Faruk Temell kundër Turqisë, Kërkesa ankimore nr. 16853/05 më 1 shkurt 2011

Alltintash kundër Turqisë, Kërkesa ankimore nr. 50495/08 më 10 mars 2020

Dink kundër Turqisë, Kërkesa ankimore nr. 2668/07, 6102/08, 30079/08, 7072/09, 7124/09 më 14 shtator 2010

Ibragim Ibragimov dhe të tjerët kundër Ruisë, Kërkesa ankimore nr. 1413/08, 28621/11 më 28 gusht 2018

Faber kundër Hungarisë, Kërkesa ankimore nr. 40721/08 më 24 korrik 2012

Niks kundër Gjermanisë, Kërkesa ankimore nr. 35285/16 më 13 mars 2018 (vendim)

Leroj kundër Francës, Kërkesa ankimore nr. 36109/03 më 2 tetor 2008

Roj TV A/S kundër Danimarkës, Kërkesa ankimore nr. 24683/14 më 17 prill 2018 (vendim për lejueshmëri)

Stomakin kundër Ruisë, Kërkesa ankimore nr. 52273/07 më 9 maj 2018

Vejdeland dhe të tjerët kundër Suedisë, Kërkesa ankimore nr. 1813/07 më 9 shkurt 2012

Beizaras dhe Levikas kundër Lituaniës, Kërkesa ankimore nr. 41288/15 më 14 janar 2020

Liliendahl kundër Islandës, Kërkesa ankimore nr. 29297/18 më 12 maj 2020 (vendim për lejueshmëri)

Jersilld kundër Danimarkës, Kërkesa ankimore nr. 15890/89 më 23 shtator 1994

Sullas dhe të tjerët kundër Francës, Kërkesa ankimore nr. 15948/03 më 10 korrik 2008

Feret kundër Belgjikës, Kërkesa ankimore nr. 15615/07 më 16 korrik 2009

Le Pen kundër Francës, Kërkesa ankimore nr. 18788/09 më 20 prill 2010 (vendim për lejueshmëri)

Perinçek kundër Zvicrës, Kërkesa ankimore nr. 27510/08 më 15 tetor 2015 (Këshilli i Madh)

Shimuniq kundër Kroacisë, Kërkesa ankimore nr. 20373/17 më 22 janar 2019 (vendim për lejueshmëri)

Otegi Mondragon kundër Spanjës, Kërkesa ankimore nr. 2034/07 më 15 mars 2011

Stern Taullats dhe Roura Kapelera kundër Spanjës, Kërkesa ankimore nr. 51168/15 dhe 51186/15 më 13 mars 2018

Delfi AS kundër Estonisë, Kërkesa ankimore nr. 64569/09 më 16 qershor 2015 (Këshilli i Madh)

Magyar Tartalomszolgáltatók Egyesülete dhe Index.hu Zrt kundër Hungarisë, Kërkesa ankimore nr. 22947/13 më 2 shkurt 2016

Bellkasem kundër Belgjikës, Kërkesa ankimore nr. 34367/14 më 27 qershor 2017 (vendim)

Pihll kundër Suedisë, Kërkesa ankimore nr. 74742/14 më 7 shkurt 2017 (vendim për lejueshmëri)

Stajiç kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kërkesa ankimore nr. 48657/16 më 18 janar 2018 (vendim për lejueshmëri)

Sava Terentjev kundër Rusisë, Kërkesa ankimore nr. 10692/09 më 28 gusht 2018

Lista e rasteve të krimit të urrejtjes

Naçova kundër Bullgarisë, Kërkesa ankimore nr. 43577/98 dhe 43579/98 më 6 korrik 2005

Millanoviç kundër Serbisë, Kërkesa ankimore nr. 44614/07 më 14 dhjetor 2010

Virabian kundër Ermenisë, Kërkesa ankimore nr. 40094/05 më 2 tetor 2012

Identoba dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë, Kërkesa ankimore nr. 73235/12 më 12 maj 2015

Gjorgjeviç kundër Kroacisë, Kërkesa ankimore nr. 41526/10) më 24 korrik 2012

Sakir kundër Greqisë, Kërkesa ankimore nr. 48475/09 më 24 mars 2016

B. S. kundër Spanjës, Kërkesa ankimore nr. 47159/08 më 24 korrik 2012

Seçiq kundër Kroacisë, Kërkesa ankimore nr. 40116/02 më 31 maj 2007

Shoqata Accept dhe të tjerët kundër Rumanisë, Kërkesa ankimore nr. 19237/16 më 1 qershor 2021

R. B. kundër Hungarisë, Kërkesa ankimore nr. 64602/12 më 12 prill 2016

Angellova dhe Iliev kundër Bullgarisë, Kërkesa ankimore nr. 55523/00 më 26 korrik 2007

Sabaliq kundër Kroacisë, Kërkesa ankimore nr. 50231/13 më 14 janar 2021

Ballazh kundër Hungarisë, Kërkesa ankimore nr. 15529/12 më 20 tetor 2015

Abdu kundër Bullgarisë, Kërkesa ankimore nr. 26827/08 më 11 mars 2014

M. C. dhe A. C. kundër Rumanisë, Kërkesa ankimore nr. 12060/12 më 12 prill 2016

Kobzaru kundër Rumanisë, Kërkesa ankimore nr. 48254/99 më 26 korrik 2007

Boaka dhe të tjerët kundër Rumanisë, Kërkesa ankimore nr. 40355/11 më 12 janar 2016

Stoica kundër Rumanisë, Kërkesa ankimore nr. 42722/02 më 4 mars 2008

Shkorjanec kundër Kroacisë, Kërkesa ankimore nr. 25536/14 më 28 mars 2017

Agdogomelatvili dhe Japarice kundër Gjeorgjisë, Kërkesa ankimore nr. 7224/11 më 8 tetor 2020

Burlia dhe të tjerët kundër Ukrainës, Kërkesa ankimore nr. 3289/10 më 6 nëntor 2018

Lingurar kundër Rumanisë, Kërkesa ankimore nr. 48474/14 më 16 prill 2019

Beghelluri dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë, Kërkesa ankimore nr. 28490/02 më 7 tetor 2014

Opuz kundër Turqisë, Kërkesa ankimore nr. 33401/02 më 9 qershor 2009

Mudriq kundër Republikës së Moldavisë, Kërkesa ankimore nr. 74839/10 më 16 korrik 2013

Tallpis kundër Italisë, Kërkesa ankimore nr. 41237/14 më 2 mars 2017

Bibliografia

<https://hatecrime.osce.org/>, OSBE/ODIHR

Parandalimi dhe reagimi ndaj krimit të urrejtjes: Udhërrëfyes për resurse për organizatat joqeveritare në rajonin e OSBE-së, 2009, OSBE/ODIHR

Të kuptuarit e nevojave të viktimave të krimit të urrejtjes, 2020, OSBE / ODIHR, <https://www.osce.org/odihr/463011>

Krimi i urrejtjes kundër personave me aftësi të kufizuara, lista informative, OSBE/ODIHR, 2016

Krimi i urrejtjes me bazë gjinore, lista informative, OSBE / ODIHR, 2021

Parandalimi i profilimit të paligjshëm sot dhe në të ardhmen: Udhërrëfyes, Agjencia për të Drejtat Fundamentale, 2018, <https://fra.europa.eu/en/publication/2018/preventing-unlawful-profiling-today-and-future-guide>

Zbulimi i motiveve të anshme në veprat penale: rastet e përzgjedhura të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Agjencia për të Drejtat Fundamentale, 2018, <https://fra.europa.eu/en/publication/2018/unmasking-bias-motives-crimes-selected-cases-european-court-human-rights>

Puna e policisë në fushën e krimit të urrejtjes kundër personave LGBTI: trajnim për përgjigjen profesionale, Këshilli i Evropës, 2017, <https://edoc.coe.int/en/lgbt/7405-policing-hate-crime-against-lgbti-persons-training-for-a-professional-police-response.html>

Mjetet e nëpunësve të policisë: Standardi i Këshillit të Evropës për veprat penale me motive racore dhe jodiskriminimin me fokus për romët dhe udhëtarët, Këshilli i Evropës, 2020, <https://www.coe.int/en/web/roma-and-travellers/-/toolkit-for-police-officers-council-of-europe-standards-on-racially-motivated-crimes-and-non-discrimination>

Udhërrëfyesi për nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, <https://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=caselaw/analysis/guides&c>

Udhërrëfyesi për nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, <https://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=caselaw/analysis/guides&c>

Udhërrëfyesi për nenin 12 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës, <https://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=caselaw/analysis/guides&c>

Parandalimi dhe përgjigja e dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore, Doracaku i Rasteve Urgjente, UNHCR, <https://emergency.unhcr.org/entry/51693/sexual-and-gender-based-violence-sgbv-prevention-and-response>

<https://strasbourgobservers.com/>

Drejt zbatimit të interseksionalitetit në praktikën juridike evropiane në disa nivele: B. S. kundër Spanjës, nga Maria Katerina La Barbera, (MariaCaterina La Barbera), Marta Cruells Llopez (Marta Cruells López), për herë të parë të botuar më: 30 tetor 2019, <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/full/10.1111/lasr.12435>.



